



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo


Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit- Ured Premiera - Office of the Prime Minister

Sekretariati Koordinues i Qeverisë/ Koordinacioni Sekretarijat Vlade/ Coordination Secretariat of the Government

UDHËZUESI DHE DORACAKU

PËR HARTIMIN E KONCEPT DOKUMENTEVE



PRISHTINË, MARS 2018

Ky Udhëzues dhe Doracak për Hartimin e Koncept Dokumenteve përcakton mënyrën se si Koncept Dokumentet duhet të hartohen. Udhëzuesi përkufizon kornizën e përgjithshme për analizat e politikave dhe vlerësimin e ndikimit. Doracaku përmban mjete, lista kontrolluese dhe sugjerime të cilat mbështesin bërjen e analizave për Koncept Dokumentet.

Doracaku për Hartimin e Koncept Dokumenteve është miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, bazuar në mandatin e përcaktuar në Rregulloren e Punës së Qeverisë dhe në pajtim me Vendimin e Qeverisë nr. 20/20 të datës 20.12.2017 për aprovimin e Udhëzuesit për Hartimin e Koncept Dokumenteve.

Nëse keni ndonjë pyetje për Udhëzuesin dhe Doracakun për Hartimin e Koncept Dokumenteve, dhe për mbështetje për hartimin e Koncept Dokumenteve, ju lutemi të kontaktoni:

Arben Krasniqi

Drejtor i Sekretariatit Koordinues të Qeverisë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit,

E: arben.krasniqi@rks-gov.net

T: 038 200 14 078

Arjeta Sahiti


Udhëheqëse e Divizionit për Koordinim të Politikave në kuadër të Sekretariatit Koordinues të Qeverisë

E: arjeta.sahiti@rks-gov.net

T: 038 200 14 166

UDHËZUESI


PËR HARTIMIN E KONCEPT DOKUMENTEVE



PËRMBAJTJA

UDHËZUESI PËR HARTIMIN E KONCEPT DOKUMENTEVE	10
Hyrje	11
Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit	12
Përshkrimi i politikës dhe kornizës ligjore ekzistuese	14
Problemi kryesor, shkaqet dhe palët e interesuara	15
Kapitulli 2: Objektivat	16
Kapitulli 3: Opsionet	20
Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme	22
Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi	26
Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve	30
Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm	32
Baza për hartimin e legjislacionit	33
Vlerësimi i ardhshëm	33
Shtojca 1: Përmbledhja e dokumentacionit për miratim të një koncept dokumenti nga Qeveria	34
Shtojca 2: Kapitujt e obligueshëm për një koncept dokument	36
Shtojca 3: Përmbledhje për një koncept dokument	37

HAPAT PËR HARTIMIN DHE PËRFUNDIMIN E KONCEPT DOKUMENTEVE DHE AFATI KOHOR INDIKATIV



Gjithsej kohëzgjatja

41 deri 67 javë

UDHËZUESI PËR HARTIMIN E KONCEPT DOKUMENTEVE

Qëllimi i këtij udhëzuesi është që të shpjegojë kërkesat që duhet të zbatohen gjatë hartimit të koncept dokumenteve bazuar në Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.09/2011. Shtojcat në këtë udhëzues tregojnë se si koncept dokumentet duhet të plotësohen për miratim nga Qeveria, pas përfundimit të analizave dhe konsultimit me palët e interesuara.

Ky udhëzues është i ndërlidhur me **Doracakun për hartimin e koncept dokumenteve**. Ky doracak jep shpjegime shtesë se si të realizohet analiza . Ai përmban disa mjete që ndihmojnë në strukturimin dhe realizimin e procesit analitik dhe konsultimit me palët e interesuara. Ky udhëzues rregullisht u referohet këtyre mjeteve. Ato japin sqarime praktike, përmbledhje, lista kontrolluese dhe këshilla se si të zhvillohen analizat për një koncept dokument.

Sekretariati Koordinues i Qeverisë (SKQ) është përgjegjës për shqyrtimin cilësor të koncept dokumenteve. Ju lutemi të kontaktoni Sekretariatit (1) në rast të pyetjeve; (2) për të diskutuar mënyrën e strukturimit dhe realizimit të analizave; (3) për prezantime për udhëzuesin, doracakun ose mjetet specifike; dhe (4) për trajnimin e stafit të ministrisë apo Grupit Punues që është duke përgatitur një koncept dokument.

HYRJE

Hyrja duhet të ofrojë informata të përgjithshme rreth koncept dokumentit. Informacioni bazik që duhet të jepet është paraqitur në tabelën më poshtë.


Kjo tabelë mund të zgjerohet sipas nevojës.



Figura 1: Tabela me informacione të përgjithshme për një koncept dokument

Titulli	(Shëno titullin e Koncept Dokumentit)
Ministria Bartëse	(Emri i Ministrisë); (Departamenti); (Divizioni)
Personi kontaktues	(Emri); (Numri i telefonit të zyrës)
PVPQ	(Shënoni numrin e aktivitetit në PVPQ për hartimin e koncept dokumentit.)
Prioriteti strategjik	(Nëse nuk ka, shënoni 'nuk ka'. Nëse ka, shënoni se në cilin dokument strategjik është përmendur përgatitja e këtij koncept dokumenti. Njëkohësisht shënoni (renditni) objektivin/objektivat strategjike që KD synon të zbattoj.)
Grupi punues	(Listoni organizatat dhe përfaqësuesit e tyre që ishin anëtar të Grupit Punues për Koncept Dokumentin.)
Informata shtesë	(Ky seksion mund të përdoret për ofrimin e informacioneve që nuk janë përmendur më sipër. Për shembull, kur një koncept dokument del si rezultat i një vlerësimi ose një traktati ndërkombëtar, informacioni mund të ipet këtu.)

01



KAPITULLI 1: PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Përkufizimi i problemit është baza e një koncept dokumenti. Të gjitha analizat e mëtejshme që bëhen për koncept dokumentin pasojnë nga përkufizimi i problemit. Një përkufizim i mirë i problemit e bën shumë më të lehtë hartimin e koncept dokumentit, pasi analiza rrjedh në mënyrë logjike nga ajo. Konkluzionet e analizës do të jenë solide, të kuptueshme dhe të justifikueshme.

Përkufizimi i problemit duhet të bëhet para analizave të mëtejshme për koncept dokumentin. Megjithatë, versioni i parë i përkufizimit të problemit shpesh nuk është ai përfundimtar. Me zhvillimin e analizës, përkufizimi i problemit do të mund të ketë nevojë për ndryshim. Kjo është krejtësisht normale, pasi hartimi i koncept dokumentit shton njohurinë rreth çështjeve që trajtohen. Njohuria shpie në të kuptuar. Të kuptuarit shpie në përmirësime. Përmirësimet shpiejnë në ndryshime.

PËRSHKRIMI I POLITIKËS DHE KORNIZËS LIGJORE EKZISTUESE

Çdo koncept dokument dhe çdo përkufizim i problemit dallon nga njëri-tjetri. Megjithatë, pikënisja e secilit koncept dokument duhet të jetë një përshkrim i hollësishëm i politikës dhe kornizës ligjore ekzistuese, institucioneve shtetërore përgjegjëse për zbatim, si dhe roleve dhe përgjegjësi të tyre, të prezantuara në tabelën në vijim. Ky përshkrim duhet të adresojë të gjitha çështjet relevante sa u përket temave të analizuara në koncept dokument. Ky përshkrim siguron informacionin e nevojshëm për të vlerësuar opsionet në raport me masat ekzistuese. Gjithashtu, formon bazën për vlerësimin se si opsionet (jo)rregullative të shqyrtuara në koncept dokument do të ndërlidheshin me politikën dhe kërkesat ligjore ekzistuese.



Figura 2: Përshkrimi i politikës dhe kornizës ligjore ekzistuese

Dokumenti i politikave, Ligji ose akti nën-ligjor	Lidhja me dokumentin e politikave përmes internetit dhe lidhja me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare	Institucioni(et) shtetërore përgjegjëse për zbatim	Roli dhe detyrat e Institucionit(eve)
Emri i dokumentit të politikës ose planifikues (shih gjithashtu pasqyrën e dokumenteve të politikave të mundshme në Pjesën 2 të Doracakut për hartimin e koncept dokumenteve)		Emri i institucionit shtetëror	
Emri i ligjit		Emri i institucionit shtetëror	
Emri i aktit nën-ligjor		Emri i institucionit shtetëror	
Emri i ligjit		Emri i institucionit shtetëror	
Etj.		Etj.	

Krahas politikës dhe kornizës ligjore ekzistuese, koncepti i dokumentit duhet të identifikojë të gjitha ndërhyrjet jo rregullatore, siç janë fushatat e informimit, programet e trajnimit etj., kur këto janë relevante për çështjet që analizohen në konceptin e dokumentit. Është gjithashtu e dobishme të listohen të gjitha dokumentet dhe raportet që kanë kontribuar në zhvillimin e përkufizimit të problemit.

PROBLEMI KRYESOR, SHKAQET, DHE PALËT E INTERESUARA

Një përkufizim i duhur i problemit përmban elemente të veçanta që ofrojnë një përshkrim të detajuar të gjendjes aktuale. Elementet janë si më poshtë:

- » Problemi kryesor
- » Shkaqet e problemit
- » Efektet e problemit
- » Identifikimi i palëve të interesuara të ndikuara


Problemi kryesor tregon se çfarë po ndodh. Shkaqet e problemit tregojnë pse problemi ekziston. Efektet e problemit tregojnë se cilat janë pasojat. Palët e interesuara përfshijnë të gjitha organizatat dhe (grupet) e individëve që janë disi të lidhura me këtë problem.

Doracaku për hartimin e koncept dokumenteve ofron mjete të dobishme që mbështesin procesin e përpunimit dhe të përkufizimit të problemit. Ai liston llojet e mangësive rregullative dhe ligjore që mund të ndodhin. Gjithashtu tregon mangësitë e tregut që mund të lidhen me probleme specifike në sferën ekonomike. Këto përmbledhje mund të konsultohen për të strukturuar përkufizimin e problemit për koncept dokumentin. Përveç kësaj, Doracaku jep udhëzime për identifikimin e palëve të interesuara.

Doracaku liston edhe dy mjete që mund të përdoren për të zhvilluar dhe paraqitur përkufizimin e problemit në mënyrë efektive. Këto janë Mjeti 1: Pema e problemit dhe Mjeti 2: Gjendja fillestare.



02



KAPITULLI 2: OBJEKTIVAT



Përkufizimi i problemit e bën të qartë se cili problem, cilat shkaqe dhe efekte duhet të adresohen. Pjesa që vijon pas përkufizimit të problemit në koncept dokument është pjesa mbi përcaktimin dhe përshkrimin e qëllimit të politikave; objektivin strategjik dhe objektivin/objektivat specifik/specifike. Këto elemente tregojnë në detaje se çfarë synon qeveria të arrijë. Ato sigurojnë informacionin që nevojitet për të kuptuar arsyen e hartimit të një koncept dokumenti.

Qëllimet dhe objektivat janë baza e masave që propozohen për ndryshimin e politikave ekzistuese ose futjen e të reja. Qëllimet dhe objektivat duhet të lidhen drejtpërdrejt me problemin e identifikuar. Ato duhet të japin përshkrimin e situatës së synuar të ardhshme në të cilën problemi zgjidhet në mënyrë efektive.

Qëllimet dhe objektivat duhet të paraqiten bazuar në mënyrën S.M.A.R.T., siç përshkruhet në figurën më poshtë. Gjithashtu ato duhet të shpjegohen në detaje. Doracaku për hartimin e koncept dokumenteve ofron informata shtesë për këtë.




Figura 3: Klasifikimi S.M.A.R.T. i qëllimeve të politikave, objektivave strategjike dhe objektivave specifike

Specifike	Qëllimet dhe objektivat duhet të jenë të sakta dhe konkrete. Ato duhet të jenë të qarta dhe të mos lënë hapësirë për interpretim.
Të matshme	Qëllimet dhe objektivat duhet të përshkruhen në bazë të synimeve shumë të qarta. Kjo do të thotë vendosjen e treguesve të qartë për ndryshimet që duhet të ndodhin. Kjo vlen në veçanti për objektivat specifike.
Të arritshme	Cilatdo qofshin qëllimet dhe objektivat, ato duhet të jenë të arritshme. Nuk ka vlerë të shtuar nëse planifikohet shumë dhe pastaj nuk mund të realizohen premtimet. Qëllimet dhe objektivat duhet të vendosen sa më realisht. Kjo do të thotë se ato duhet të bazohen në burimet njerëzore dhe buxhetore në dispozicion.
Relevante	Qëllimet dhe objektivat duhet të lidhen drejtpërdrejt me përcaktimin e problemit. Qëllimi është që ose të mënjanohet problemi duke eliminuar shkaqet e tij, ose të mënjanohen efektet që shkakton problemi.
Afatet	Qëllimet dhe objektivat duhet të zbatohen brenda një kohe të arsyeshme. Kjo do të thotë se ato janë të arritshme. Afatet gjithashtu duhet të vendosen në mënyrë të tillë që të mund të vlerësohen rezultatet e arritura.



03



KAPITULLI 3: OPSIONET

Përkufizimi i problemit i vë në pah çështjet, të cilat mund të adresohen. Qëllimi i politikave dhe objektivat strategjike shfaqin synimet që planifikon t'i arrijë Qeveria. Ato tregojnë vendin e koncept dokumentit brenda kornizës së politikave. Objektivat specifike, veçanërisht, shfaqin objektivat konkrete që duhet arritur.

Lloji i problemit, shkaqet dhe efektet e tij rregullisht ofrojnë një kornizë të opsioneve që mund të përdoren për adresimin e problemit në mënyrë efektive. Analiza e opsioneve është e dobishme pasi ndihmon për të menduar për opsionet e mundshme që nuk do të shpien në legjislacion shtesë apo ndryshime në kornizën rregullative ekzistuese. Ato lejojnë krahasimin në mes opsioneve për të përdorur legjislacionin dhe mundësitë e tjera jo rregullative për adresimin në mënyrë efektive të një problemi.

Të paktën tri opsione duhet të analizohen në secilin koncept dokument.


Opsioni i parë është opsioni status-quo që quhet ndryshe 'opsioni pa ndryshime'. Ky opsion bazohet në përmbledhjen e përkufizimit të problemit. Ky opsion shërben si opsion krahasues për opsionet e tjera. Ai përshkruan se si do të dukej gjendja në qoftë se nuk bëhen ndryshime. Mjeti 2: Gjendja fillestare, tregon se si mund të paraqitet opsioni pa ndryshime.

Së dyti, kur koncept dokumenti adreson probleme me rregullat ekzistuese, gjithnjë duhet të vlerësohet opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe fuqizimin e këtyre rregullave. Kur është e nevojshme, ky opsion mund të zëvendësohet nga një opsion më i përshtatshëm kur kjo përmirëson cilësinë e analizës së koncept dokumentit.

Opsioni i tretë do të varet nga natyra e temës që analizohet në koncept dokument. Varet nga vetë mangësitë dhe duhet të jetë një alternativë e duhur për opsionet e tjera të analizuara. Opsioni i tretë duhet të shqyrtojë mundësitë për adresimin e problemit pa përdorur legjislacionin. Opsione të tilla janë shpesh në dispozicion dhe mund të zbatohen relativisht shpejt pasi që nuk ka nevojë për ndryshime ligjore.

Doracaku për hartimin e koncept dokumenteve ofron një pasqyrë të opsioneve të mundshme që lidhen me problemet specifike të cilat mund të vlejnjë për gjendjen e analizuar në koncept dokument.

04



KAPITULLI 4: IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I NDIKIMEVE TË ARDHSHME

Kur është e qartë se çfarë mund të bëhet për zgjidhjen e një problemi, analiza për koncept dokumentin hyn në detaje të opsioneve të ndryshme dhe asaj që pritet të ndodhë në të ardhmen. Analizat e opsioneve të ndryshme kërkojnë buxhet dhe burime njerëzore të ndryshme. Në fund, aktivitetet dhe rezultatet (output) e nevojshme për t'i zbatuar këto opsione do të jenë të ndryshme.

Veprimet e Qeverisë duhet të vendosen në një kontekst të gjerë që merr parasysh të gjitha efektet e mundshme që veprimet e Qeverisë mund të kenë. Kjo nënkupton analizimin e pesë kategorive të ndikimeve potenciale në vijim:

- 1 ndikimet ekonomike: ndikimet mbi bizneset, punonjësit, rritjen ekonomike, Investimet e Huaja Direkte (IHD);
- 2 ndikimet shoqërore: ndikimet mbi arsimin, pozitën shoqërore të nëngrupeve brenda shoqërisë, pensionet, etj.;
- 3 ndikimet mjedisore: ndikimet mbi cilësinë e ajrit, ndotja, nivelet e mbeturinave, cilësia e ujit etj.;
- 4 ndikimet ndërsektorale: ndikimet mbi barazinë gjinore, të drejtat e qytetarëve etj.; dhe
- 5 ndikimet buxhetore: ndikimet mbi të ardhurat dhe shpenzimet e Republikës së Kosovës.

Kategoritë e ndikimeve janë shumë të gjera. Ndikimet reale në këto kategori mund të jenë pozitive apo negative. Ky fleksibilitet është paraparë me qëllim. Garanton se opsionet që janë sugjeruar në një koncept dokument marrin parasysh të gjitha llojet e ndikimeve që zbatimi i këtyre opsioneve mund të ketë në shoqëri. Cilat çështje duhet të analizohen në kuadër të kategorive të ndikimeve varet nga (1) problemi, shkaqet dhe efektet e tij; dhe (2) nga opsionet në dispozicion për të trajtuar problemin në mënyrë efektive.

Doracaku për hartimin e koncept dokumenteve rendit mjetet që mund të përdoren për identifikimin e ndikimeve të pritura dhe për përcaktimin e ndikimeve të caktuara në mënyrë më të detajuar. Kategoritë e ndikimit dhe mjetet janë paraqitur në pasqyrën e mëposhtme. Secili mjet ka një pjesë të veçantë në Doracak. Përveç kësaj, mjetet shpjegojnë se si mund të përcaktohet më së miri rëndësia e ndikimeve dhe hollësia e analizës, cilat janë mundësitë për mbledhjen e të dhënave dhe si mund të zhvillohet më së miri një koncept dokument për zbatimin e një direktive apo rregulloreje të BE-së. Këto mjete ofrojnë mbështetje për strukturimin e analizës për koncept dokumentin.


Së fundi, Doracaku përmban mjetet që mbështesin analizën për një koncept dokument. Këto mjete fokusohen posaçërisht në vendosjen e standardeve të përshtatshme dhe mundësive për zbatimin e tyre. Nga këto mjete, duhet të zbatohet Modeli i kostimit standard kur koncept dokumenti adreson problemet që lidhen me mënyrën se si rregullohen bizneset.



Figura 4: Kategoritë e ndikimeve dhe mjetet për strukturimin dhe kryerjen e analizave të politikave

Seksioni	Mjetet përkatëse në Doracakun për hartimin e koncept dokumenteve
1) Ndikimet ekonomike	Mjeti 3: Identifikimi i ndikimeve ekonomike
2) Ndikimet shoqërore	Mjeti 4: Identifikimi i ndikimeve shoqërore
3) Ndikimet mjedisore	Mjeti 5: Identifikimi i ndikimeve mjedisore
4) Ndikimet ndërsektoriale	Mjeti 6: Ndikimet në të drejtat themelore
	Mjeti 7: Vlerësimi i ndikimit gjinor
	Mjeti 8: Analiza e barazisë sociale
	Mjeti 9: Vlerësimi i ndikimit për të rinjtë
5) Ndikimet buxhetore	Mjeti 10: Plani i zbatimit për opsionet e politikës
	Mjeti 11: Kostimi për koncept dokumente
	Mjeti 12: Pajtueshmëria me vlerësimin e ndikimit buxhetor
6) Strukturimi i analizës për një koncept dokument	Mjeti 13: Përcaktimi i rëndësisë së ndikimeve
	Mjeti 14: Mbledhja e të dhënave
	Mjeti 15: Analiza e politikave për transpozimin e Aquis të BE-së
7) Vendosja dhe zbatimi i standardeve të përshtatshme	Mjeti 16: Modeli i kostimit standard
	Mjeti 17: Testi i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM-ve)
	Mjeti 18: Testi i konkurrueshmërisë rregullative

05



KAPITULLI 5: KOMUNIKIMI DHE KONSULTIMI

Komunikimi dhe konsultimi janë mënyra shumë të dobishme për mbledhjen e të dhënave, verifikimin e informacioneve, për të fituar njohuri të reja dhe për të paraqitur e shpjeguar politikat dhe vendimet.

Konsultimi ka për qëllim të ulë së bashku administratën dhe grupet e interesuara për të diskutuar problemet në detaje, për të trajtuar opsionet për adresimin e këtyre problemeve dhe për të vlerësuar se cili është përfitimi dhe kostoja. Qëllimi i komunikimit është që t'i ndërgjegjësojë grupet e interesuara për konsultimet publike dhe për të ndarë qëllimet e Qeverisë me publikun e gjerë.

Konsultimi publik nxit shkëmbimin e informacioneve, pikëpamjeve dhe të dhënave, të cilat më pas mund të inkorporohen në vendimmarrje nga qeveria. Së bashku me komunikimin efikas, mundëson pjesëmarrjen aktive të qytetarëve, kompanive, organizatave të shoqërisë civile, përfaqësuesve të bizneseve dhe partnerëve për zhvillim në hartimin e politikave.

Përkufizimi i problemit, përcaktimi i objektivave dhe opsioneve, identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve, krahasimi i opsioneve të ndryshme, përcaktimi i planit të zbatimit dhe segmentet tjera të një koncept dokumenti bëhen më cilësore falë konsultimit të brendshëm dhe konsultimit publik.

Qëllimi i konsultimit është mbledhja e të dhënave për një koncept dokument, por edhe për komunikimin e qëllimeve të Qeverisë për ndryshimin ose përmirësimin e politikave dhe motivin që qëndron pas këtyre qëllimeve. Nëse realizohen në mënyrë të duhur, ato nxisin të kuptuarit dhe në këtë mënyrë pranimin e politikave. Kjo, nga ana tjetër, rezulton në zbatim më të mirë dhe më efektiv.

Përfitimet e mundshme nga konsultimi me palët e interesuara janë të shumta. Për t'i arritur këto përfitime, aktivitetet konsultuese duhet të përgatiten me kujdes dhe të planifikohen mirë. Kjo është kryesisht për shkak të faktit që konsultimi me palët e interesuara mbulon të gjitha aktivitetet në të cilat personave jashtë administratës u kërkohet që të ofrojnë komentet, idetë, sugjerimet, të dhënat e tyre etj. për çështjet që janë relevante për atë koncept dokument. Një tjetër arsye e rëndësishme është që palët e interesuara në të vërtetë janë një grup i ndryshëm i personave dhe organizatave. Palë të ndryshme të interesuara kontaktohen në mënyra të ndryshme me qëllim që të lehtësohet sa më shumë pjesëmarrja e tyre në procesin e konsultimit.

Kjo nënkupton që aktivitetet e konsultimit duhet të përshtaten me resurset e palëve të interesuara që duhet të konsultohen. Ato duhet të komunikohen në mënyrën e duhur dhe mesazhet duhet të përshtaten për audiencën e synuar. Ajo që është më e rëndësishmja, administrata duhet të vlerësojë kohën dhe përpjekjet që palët e interesuara investojnë në konsultimin publik duke treguar që këto përpjekje vlerësohen dhe trajtohen siç duhet.

Dy aktivitete të konsultimit janë të detyrueshme për çdo koncept dokument, e këto janë: 1) Organizimi i një takimi publik që në fazën e hershme të hartimit të koncept dokumentit, dhe 2)


Konsultimi publik online për koncept dokumentin nëpërmjet portalit <http://konsultimet.rks-gov.net>. Që të jenë të dobishme, ato duhet të komunikohen në mënyrë efektive të të gjitha palët relevante të interesuara. Është me rëndësi të konsultohen palët e interesuara përtej këtyre dy aktiviteteve, për shembull përfshirja në grupet punuese dhe konsultimet e synuara.

Për strukturimin dhe planifikimin e aktiviteteve të konsultimit dhe komunikimit për një koncept dokument, Doracaku për hartimin e koncept dokumenteve ofron këto mjete praktike: Mjeti 19: Identifikimi i palëve të interesuara; Mjeti 20: Përzgjedhja e metodave të konsultimit; Mjeti 21: Planifikimi i konsultimit për një koncept dokument; dhe Mjeti 22: Komunikimi gjatë hartimit të koncept dokumentit, Mjeti 23: Planifikimi i komunikimit për një koncept dokument, Mjeti 24: Planifikimi i komunikimit dhe konsultimit për një koncept dokument, dhe Mjeti 25: Shembulli i planit të komunikimit dhe konsultimit.

Mjetet e konsultimeve janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Rregulloren për standardet minimale për procesin e konsultimit publik.



06




KAPITULLI 6: KRAHASIMI I OPSIONEVE

Gjatë hartimit të një koncept dokumenti mblidhen shumë informacione. Për profesionistët e politikave që janë të përfshirë në procesin e përgatitjes dhe analizës së çështjeve, koncept dokumenti mund të jetë i qartë pasi ata kanë punuar në të që nga fillimi, megjithatë, personave që nuk kanë qenë thellësisht të përfshirë në hartimin e koncept dokumentit duhet t'u paraqitet informacioni në një mënyrë logjike dhe të lehtë për t'u kuptuar.

Doracaku për hartimin e koncept dokumenteve liston tri mjete krahasuese, si dhe shpjegon mënyrën se si mund të përdoren ato. Mjetet janë: Analiza e kostos-efektivitetit (AKE); Analiza e kostos-përfitimit (AKP) dhe Analiza shumë-kriterëshe (ASHK).

Krahasimi i opsioneve tregon se cili është opsioni më i favorshëm që duhet të përzgjidhet bazuar në përfitimet dhe kostot që sjell ai.

07



KAPITULLI 7: KONKLuzionet dhe Hapat e ARDHSHËM

Koncept dokumenti është një hap brenda procesit të gjerë të zhvillimit të politikave dhe legjislacionit dhe përmirësimit të kornizës rregullative në përgjithësi. Prandaj, në dokument duhet të paraqiten dy tema, në mënyrë që lidhja me hapat e ardhshëm të shpjegohet në mënyrë të mjaftueshme.

BAZA PËR HARTIMIN E LEGJISLACIONIT

Kur konkluzionet e koncept dokumentit kërkojnë hartimin e një ligji të ri, një akti nënligjor ose ndryshimin e rregullave ekzistuese, korniza e synuar për legjislacionin e ardhshëm duhet të bëhet e qartë. Kjo do të thotë se masat ligjore aktuale që duhet të zhvillohen për të zbatuar opsionin e preferuar duhet të paraqiten në një përmbledhje praktike. Kjo përmbledhje do të jetë fillimi i procesit të hartimit të legjislacionit dhe siguron lidhjen midis analizës së politikave të kryera për koncept dokumentin dhe procesin e hartimit të legjislacionit.

VLERËSIMI I ARDHSHEM

Meqenëse vendimi që buron nga koncept dokumenti duhet të zbatohet, duhet të përcaktohet mënyra se si do të monitorohet zbatimi. Gjithashtu, mund të jetë e nevojshme që të vlerësohen edhe efektet. Kjo vlen veçanërisht në rastin kur ndikimet e pritura janë shumë të rëndësishme.

Pyetjet e rëndësishme duhet të adresohen në mënyrë efektive. E këto janë: nëse monitorimi mund të bëhet përmes strukturave ekzistuese të raportimit; ose duhet të zhvillohet një skemë specifike e monitorimit. Gjithashtu, indikatorët e përdorur për monitorim duhet të përcaktohen qartë dhe detyrat e organizatave të përfshira duhet të përcaktohen dhe të dakordohen.

Udhëzuesi për vlerësimin legjislativ u miratua në vitin 2015 dhe çdo vit kryhen disa vlerësime nën ombrellën e Strategjisë për rregullim më të mirë 2.0. Planifikimi i punës së Qeverisë është zgjeruar dhe ka një fokus afatmesëm. Aktivitetet që janë planifikuar të ndodhin viteve të ardhshme mund të shtohen në planin indikativ të punës së Qeverisë.

Mjeti 10: Plani i zbatimit mund të përdoret për të paraqitur hapat e opsionit të preferuar.

SHTOJCA 1: PËRMBLEDHJA E DOKUMENTACIONIT PËR MIRATIM TË NJË KONCEPT DOKUMENTI NGA QEVERIA

Dokumenti	Shpjegimi
Dokumenti përmbledhës	Ky dokument paraqet informatat kyçe dhe duhet të shoqërojë koncept dokumentin në procedurën për miratim nga Qeveria.
Koncept dokumenti	Analiza e kryer në përputhje me Udhëzuesin për hartimin e koncept dokumenteve. Kapitujt e mëposhtëm janë të detyrueshëm për një koncept dokument: Hyrje Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit Kapitulli 2: Objektivat Kapitulli 3: Opsionet Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm
Raporti për konsultimin ndërministror	Ky dokument ofron informacion të detajuar mbi konsultimin ndërministror që është organizuar për koncept dokumentin. Duhet të paktën të mbulojë përbërjen e Grupit punues, komentet e marra dhe përmbledhjen nga rezultati i konsultimit ndërministror sipas Rregullores së punës së Qeverisë (RrPQ Neni 7) Ky është një dokument i veçantë, por informacioni më i rëndësishëm në lidhje me konsultimin ndërministror duhet të integrohet në koncept dokumentin dhe në dokumentin përmbledhës.
Raporti për konsultimin publik	Ky dokument ofron informacion të detajuar mbi konsultimin publik që është organizuar për koncept dokumentin. Ky është një dokument i veçantë, por informacioni më i rëndësishëm në lidhje me konsultimin publik duhet të integrohet në koncept dokumentin dhe në dokumentin përmbledhës (RrPQ Neni 32).

Dokumenti	Shpjegimi
<p>Rekomandimi zyrtar i nënshkruar nga Ministri, që tregon shkurtimisht veprimin që Qeveria rekomandohet ta ndër marrë;</p> <p>Koncept dokumenti; Vlerësimi i ndikimit financiar (kur kërkohet) dhe opinioni i Ministrisë së Financave;</p> <p>Opinionii Ministrisë së Integrimeve Evropiane;</p> <p>Opinionii i zyrave përkatëse të Zyrës së Kryeministrit; Deklarata e përputhshmërisë me dispozitat e rregullores; Draft vendimi; Raport ose këshillë që del nga takimi i Këshillit të Sekretarëve të Përgjithshëm ku është diskutuar koncept dokumenti.</p>	<p>Këto janë dokumentet përcjellëse (të cilat duhet përgatitur në gjuhët zyrtare) të propozimit kur të dorëzohet së pari në SKQ për shqyrtim në Qeveri, sipas nenit 34 të RrP së Qeverisë dhe sipas nenit 36, kur propozimi përfundimtar dorëzohet në mbledhjen e Qeverisë.</p>

SHTOJCA 2: KAPITUJT E OBLIGUESHËM PËR NJË KONCEPT DOKUMENT

HYRJE

Titulli	(Shëno titullin e koncept dokumentit)
Ministria bartëse	(Emri i Ministrisë); (Departamenti); (Divizioni)
Personi kontaktues	(Emri); (Numri i telefonit të zyrës)
PVPQ	(Shënoni numrin e aktivitetit në PVPQ për hartimin e koncept dokumentit.)
Prioriteti strategjik	(Nëse nuk ka, shënoni 'nuk ka'. Nëse ka, shënoni se në cilin dokument strategjik është përmendur përgatitja e këtij koncept dokumenti. Njëkohësisht shënoni (renditni) objektivin/ objektivat strategjike që KD synon të zbatojë)
Grupi punues	(Listoni organizatat dhe përfaqësuesit e tyre që ishin anëtarë të Grupit punues për koncept dokumentin.)
Informata shtesë	(Ky seksion mund të përdoret për ofrimin e informacioneve që nuk janë përmendur më sipër. Për shembull, kur një koncept dokument del si rezultat i një vlerësimi ose një traktati ndërkombëtar, informacioni mund të theksohet këtu.)

KAPITULLI 1: PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

KAPITULLI 2: OBJEKTIVAT

KAPITULLI 3: OPSIONET

- » Opsioni asnjë ndryshim
- » Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit
- » Opsioni i tretë (përcaktohet veç e veç për secilin koncept dokument)

KAPITULLI 4: IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I NDIKIMEVE TË ARDHSHEM

KAPITULLI 5: KOMUNIKIMI DHE KONSULTIMI

KAPITULLI 6: KRAHASIMI I OPSIONEVE

KAPITULLI 7: KONKLUZIONET DHE HAPAT E ARDHSHËM

SHTOJCA 3: PËRMBLEDHJE PËR NJË KONCEPT DOKUMENT

(Teksti mes kllapave duhet të fshihet kur ofrohet informacioni.)

(Tabela e mëposhtme mund të plotësohet gjatë zhvillimit të koncept dokumentit. Mund të finalizohet vetëm pasi të jetë gati analiza për KD-në dhe vetë KD-ja. Kufizojeni këtë dokument përmbledhës në maksimum tri faqe.)

(Ky dokument ofron informacione kyçe për koncept dokumentin. Të gjitha informacionet e renditura këtu duhet të vijnë drejtpërdrejt nga ky koncept dokument dhe nuk mund të përmbajë informata të reja. Informacioni që duhet të renditet në këtë dokument lidhet drejtpërdrejt me mjetet analitike nga Doracaku për hartimin e koncept dokumenteve.)

(Kjo përmbledhje është për përdorim të brendshëm nga ana e Qeverisë. Kjo përmbledhje e informacioneve kyçe duhet ta shoqërojë koncept dokumentin gjatë procedurës për miratim nga Qeveria.)

Informata të përgjithshme	
Titulli	(Shënoni titullin e koncept dokumentit)
Ministria bartëse	(Emri i Ministrisë); (Departamenti); (Divizioni)
Personi kontaktues	(Emri); (Numri i telefonit të zyrës)
PVPQ	(Shënoni numrin e aktivitetit në PVPQ për zhvillimin e koncept dokumentit)
Prioriteti strategjik	(Nëse nuk ka, shënoni 'nuk ka'. Nëse ka, shënoni se në cilin dokument strategjik është përmendur përgatitja e këtij koncept dokumenti. Njëkohësisht shënoni (renditni) objektivin/ objektivat strategjike që KD synon të zbatojë.)


Vendimi	
Çështja kryesore	(Përshkruani këtu përmbledhjen e përkufizimit të problemit.)
Përmbledhje e konsultimeve	(Përshkruani këtu konkluzionet kryesore nga procesi i konsultimit ndërmënjësor që u zhvillua për koncept dokumentin. Nëse nuk ka mosmarrëveshje me ministritë tjera të linjës ose kur janë adresuar të gjitha mosmarrëveshjet fillestare, shënojeni këtë në mënyrë të qartë. Nëse ka mosmarrëveshje, listojini këtu dhe tregoni pse këto nuk janë adresuar.)
	(Listoni aktivitetet kryesore të konsultimit publik të realizuar. Gjithashtu shënoni datën e fillimit dhe datën e përfundimit të konsultimit publik online me shkrim. Listoni numrin e organizatave që ofruan përgjigje në këtë konsultim, numrin e komenteve të marra dhe përfundimet kryesore nga procesi i konsultimit publik. Referojuni raportit për konsultimin publik që duhet të dorëzohet së bashku me koncept dokumentin për miratim nga Qeveria)
Opsioni i propozuar	(Shënoni këtu opsionin e preferuar që është paraqitur në KD.)
Ndikimet kryesore të pritshme	
Ndikimi buxhetor	(Shënoni ndikimin në buxhet. Nëse opsioni i propozuar mbulohet nga tavanit aktual i buxhetit, shënoni 'zbatuar sipas tavanit aktual të buxhetit'.)
Ndikimi ekonomik	(Shënoni ndikimet më të rëndësishme në këtë kategori. Nëse nuk ka ndikime relevante, shënoni 'nuk ka ndikime relevante të pritshme në këtë kategori'.)
Ndikimi shoqëror	(Shënoni ndikimet më të rëndësishme në këtë kategori. Nëse nuk ka ndikime relevante, shënoni 'nuk ka ndikime relevante të pritshme në këtë kategori'.)
Ndikimi mjedisor	(Shënoni ndikimet më të rëndësishme në këtë kategori. Nëse nuk ka ndikime relevante, shënoni 'nuk ka ndikime relevante të pritshme në këtë kategori'.)
Ndikimet ndër-sektoriale	(Shënoni ndikimet më të rëndësishme në këtë kategori. Nëse nuk ka ndikime të relevante, shënoni 'nuk ka ndikime relevante të pritshme në këtë kategori'.)
Ngarkesa administrative për kompanitë	(Nëse nuk krijohen barrë administrative për kompanitë, shënoni 'nuk vlen'. Përndryshe listoni zvogëlimin ose rritjen e përgjithshme të pritshme të ngarkesës administrative.)
Test i NVM-ve	(Tregoni nëse është aplikuar Testi i NVM-ve, nëse jo, tregoni pse. Nëse po, tregoni gjetjet kryesore.)

Hapat e ardhshëm

Afatshkurtër	(Listoni aktivitetet më të rëndësishme që do të zhvillohen brenda një viti pas miratimit të koncept dokumentit.)
Afatmesëm	(Listoni aktivitetet më të rëndësishme që do të zhvillohen brenda dy deri pesë vjetëve pas miratimit të koncept dokumentit.)

DORACAKU

PËR HARTIMIN E KONCEPT DOKUMENTEVE



PRISHTINË, MARS 2018

PËRMBAJTJA

LISTA E HAPAVE PËR HARTIMIN DHE PËRFUNDIMIN E KONCEPT DOKUMENTEVE	46
PJESA 01: PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT	50
Si të zhvillohet një përkufizim i mirë i problemit?	52
Elementet e problemit	55
Dokumentacioni mbështetës	55
Problemi kryesor	55
Shkaqet e problemit	56
Mangësitë ligjore dhe rregullative	56
Mangësitë e tregut	60
Çështjet shoqërore	65
Identifikimi i palëve të interesuara	65
Identifikimi i problemit, shkaqeve dhe efekteve të tij	67
Mjeti 1: Pema e problemit	71
Mjeti 2: Skenari i gjendjes fillestare	73
PJESA 02: PËRCAKTIMI/PËRSHKRIMI I QËLLIMEVE DHE OBJEKTIVAVE	74
PJESA 03: PËRCAKTIMI I OPSIONEVE	80
Tri opsione do të analizohen	83
PJESA 04: IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I NDIKIMEVE TË ARDHSHME	94
Mjeti 3: Identifikimi i ndikimeve ekonomike	99
Mjeti 4: Identifikimi i ndikimeve shoqërore	102
Mjeti 5: Identifikimi i ndikimeve mjedisore	105
Mjeti 6: Ndikimet në të drejtat themelore	107
Mjeti 7: Vlerësimi i ndikimit gjinor	109

Mjeti 8: Analiza e drejtësisë sociale (ADS)	122
Mjeti 9: Vlerësimi i ndikimit te të rinjtë (VNRN)	133
Mjeti 10: Plani i zbatimit për opsionet e politikave	142
Mjeti 11: Kostimi për koncept dokumente	145
Mjeti 12: Pajtueshmëria me vlerësimin e ndikimit buxhetor	148
Mjeti 13: Përcaktimi i rëndësisë së ndikimeve	149
Mjeti 14: Mbledhja e të dhënave	151
Mjeti 15: Analiza e politikave për transpozimin e Acquis-it të BE-së	154
Mjeti 16: Modeli i kostimit standard	159
Llogaritja e ngarkesave administrative	162
Mjeti 17: Testi i NVM-ve	166
Mjeti 18: Testi i konkurrueshmërisë rregullative	169
PJESA 05: KOMUNIKIMI DHE KONSULTIMI	172
Mjeti 19: Duke iu përmbajtur standardeve minimale për konsultim	175
Standardet minimale për konsultim publik për koncept dokumente	178
Mjeti 20: Identifikimi i palëve të interesuara	181
Mjeti 21: Përzgjedhja e metodave të konsultimit	183
Mjeti 22: Komunikimi gjatë hartimit të koncept dokumentit	185
Roli i komunikimit gjatë procesit të zhvillimit të politikave	186
Struktura e komunikimit në Qeveri	188
Mjeti 23: Planifikimi i komunikimit për një koncept dokument	190
Mjeti 24: Planifikimi i komunikimit dhe konsultimit për një koncept dokument	192
Mjeti 25: Shembulli i planit të komunikimit dhe konsultimit	194
PJESA 06: PËRZGJEDHJA DHE PARAQITJA E ZGJIDHJES MË TË MIRË: KRAHASIMI I OPSIONEVE DHE NDIKIMEVE TË TYRE	196
Mjeti 26: Analiza e kosto-efektivitetit (AKE)	199
Mjeti 27: Analiza e Kosto-përfitimit (AKP)	203
Mjeti 28: Analiza shumë-kriterëshe (ASHK)	206
PJESA 07: PARAQITJA E KONKLUZIONEVE DHE HAPAVE TË ARDHSHËM PËR KONCEPT DOKUMENTIN	208
Koncept dokumenti, pjesë përbërëse në ciklin e zhvillimit të politikave	211

LISTA E HAPAVE PËR HARTIMIN DHE PËRFUNDIMIN E KONCEPT DOKUMENTEVE

HAPAT DHE AFATI INDIKATIV

INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE

1

PLANIFIKIMI I KONCEPT DOKUMENTIT

Udhërrëfyese gjatë gjithë vitit

PVPQ : 3.5 muaj (tetor-dhjetor-janar)

- Përgatitja e udhërrëfyesit për koncept dokumentin, varësisht prej fillimit të përgatitjes së koncept dokumentit
- Identifikimi i çështjeve për të cilat përgatiten koncept dokumentet dhe procedohen për vendimmarrje nga Qeveria gjatë vitit vijues
- Hartimi i draft listës së koncept dokumenteve për vitin vijues, si pjesë e PVPQ¹
- Dërgimi i draft listës së koncept dokumenteve për konsultim publik²
- Finalizimi i draft listës së koncept dokumenteve
- Miratimi i listës së koncept dokumenteve që do të hartohen në vitin e ardhshëm

Ministritë

SKQ, ministritë

SKQ, Organet tjera të QQ,
Sekretari i Përgjithshëm/ZKM

SKQ, ZQM

SKQ

SKQ,
Sekretari i Përgjithshëm/ZKM

¹ Në bazë të Nenit 29(3) dhe 48(7) të Rregullores së punës së Qeverisë nr. 09/2011

² Në bazë të Nenit 5(1.4) të Rregullores nr. 05/2016 mbi Standardet minimale për procesin e konsultimit publik.

HAPAT DHE AFATI INDIKATIV

INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE

2

GRUPI PUNUES PËR HARTIMIN E KONCEPT
DOKUMENTEVE

1 muaj

- Përcaktimi i përbërjes së grupit punues, duke përfshirë Kryesuesin e grupit punues, anëtarët e tjerë të ministrisë, organet e nivelit qendror të Qeverisë (QQ), institucionet dhe palët e interesuara
- Themelimi i grupit punues:

Anëtarët e rekomanduar të grupit:

- » Kryesuesi i grupit punues (zyrtar nga njësi përkatëse e politikës)
- » Zëvendëskryesuesi
- » Zyrtarë përkatës të politikave
- » Zyrtarë nga Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave
- » Zyrtarë nga Departamenti Ligjor
- » Zyrtarë nga Departamenti i Buxhetit
- » Zyrtarë nga Departamenti i Komunikimit Publik
- » Zyrtarë për barazi gjinore
- » Zyrtarë përgjegjës për organizimin e konsultimeve me palët e interesuara

Anëtarët varësisht prej temës:

- » Zyrtarë të ministrive tjera të linjës dhe agjencive
- » Zyrtarë nga organet relevante të Qeverisë (SKQ, ZPS, ZL, ZKP, MeF, MIE dhe ABGJ)

Anëtarët e jashtëm (rreth tre sish, të zgjedhur në bazë të ekspertizës):

- » OSHC-të
- » Organizata ndërkombëtare
- » Ekspertët dhe konsulentët

- Përpilimi i listës së detyrave, duke përfshirë aktivitetet e nevojshme për përfundimin e koncept dokumentit:

- » Fokusi dhe instrumentet analitike që duhet përdorur (në konsultim me SKQ)
- » Mbajtja e procesverbalit/pikat e veprimit
- » Mbledhja e të dhënave
- » Plani i konsultimit dhe komunikimit
- » Shkrimi i koncept dokumentit

- Takimi i parë, agjenda e propozuar për takimin e dytë dhe orari i planifikuar i takimit për procesin e plotë, i nevojshëm për të finalizuar koncept dokumentin

Sekretari i Përgjithshëm i
Organit Inicues, SKQ

Sekretari i Përgjithshëm
i Organit Inicues
SKQ

Kryesuesi i grupit punues i
emëruar nga organi inicues për
hartimin e koncept dokumentit
SKQ

Kryesuesi i grupit punues,
Grupi punues

HAPAT DHE AFATI INDIKATIV

INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE

3 TAKIMI PUBLIK³
2 jave

- Para hartimit të koncept dokumentit: përgatitja e pasqyrës së çështjeve dhe temave kryesore që duhet të përfshihen në analizat për koncept dokumentin
- Diskutimet me palët, të cilat kanë shprehur interesimin e tyre

Grupi punues i ministrisë

4 ANALIZA
3-6 muaj

- Përgatitja e pjesëve përkatëse të Koncept dokumentit
- Diskutime në grupin punues
- Konsultimet e fokusuara
- Format tjera të konsultimit
- Komunikimi
- Konsultimet brenda ministrisë
- Finalizimi i koncept dokumentit fillestar

Grupi punues

5 KONSULTIMI PARAPRAK/NDËRMINISTROR⁴
3 javë

- Konsultimi me institucionet e QQ, ministrinë e linjës dhe organet e tjera relevante të administratës shtetërore
- Përfundimi/përmirësimi i koncept dokumentit fillestar duke përfshirë integrimin e informatave më të rëndësishme nga faza e konsultimit paraprak në koncept dokument
- Përgatitja e tabelës së komenteve të marra gjatë fazës së konsultimit paraprak dhe shpjegimi se si janë përfshirë në KD dhe nëse jo, pse⁵

Organi iniciues/Grupi punues i ministrisë

³ Në bazë të Nenit 8 dhe 13 të Rregullores mbi standardet minimale për procesin e konsultimit publik⁴ Në bazë të Nenit 7 të Rregullores së punës së Qeverisë Nr. 09/2011⁵ Po aty, pika 4

HAPAT DHE AFATI INDIKATIV

INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE

6

KONSULTIMI PUBLIK⁶
1-3 muaj

- Përgatitja dhe realizimi i konsultimeve të gjera me shkrim
- Bashkëpunimi i ngushtë me Zyrën për Komunikim Publik gjatë këtij procesi
- Mbledhja dhe analiza e komenteve
- Të vendoset se si të merren parasysh komentet
- Përgatitja e pjesës për konsultimet në draft koncept dokumenti, e cili duhet të përfshijë përshkrimin e rezultateve të dala nga procesi i konsultimit
- Përgatitja e raportit të konsultimeve⁷
- Takimi i fundit i grupit punues dhe finalizimi i draftit të koncept dokumentit

Kryesuesi i grupit punues për hartimin e koncept dokumentit në bashkëpunim me koordinatorin e konsultimit publik

7

PROCEDURAT E MIRATIMIT NGA QEVERIA
1-2 muaj

- Procedimi në SKQ i draftit të koncept dokumentit përfundimtar për mbledhjen e Qeverisë⁸
- Përmirësimi dhe finalizimi i draftit të koncept dokumentit, nëse SKQ e kthen atë prapa tek organi iniciues⁹
- Rishikimi i draftit të koncept dokumentit nga institucionet relevante të QQ¹⁰ dhe, nëse është e nevojshme, përditësimi i koncept dokumentit
- Shqyrtimi dhe diskutimi i draftit të koncept dokumentit në mbledhjet e rregullta të sekretarëve të përgjithshëm,
- Dorëzimi i draftit përfundimtarë të koncept dokumentit në mbledhjen e Qeverisë¹¹
- Diskutimi/vendimi mbi draftin e koncept dokumentit në mbledhjen e Qeverisë
- Informimi i publikut për¹² vendimin e Qeverisë

Organi iniciues

Sekretarët e përgjithshëm, GP,SKQ

ZKM (SKQ, ZPS, ZL, ZKP)
MeF dhe MIE

SKQ, Organi iniciues

SKQ

Qeveria

Zëdhënësi i Qeverisë, ZKP/ZKM

⁶ Në bazë të Nenit 32 të Rregullores së punës së Qeverisë; Nenit 9 deri 16 i Rregullores mbi standardet minimale për procesin e konsultimit publik

⁷ Në bazë të Nenit 6 dhe 11 të Rregullores mbi standardet minimale për procesin e konsultimit publik

⁸ Në bazë të Nenit 10 dhe 34 të Rregullores së punës së Qeverisë


⁹ Në bazë të Nenit 10 të Rregullores së punës së Qeverisë

¹⁰ Në bazë të Nenit 35 të Rregullores së punës së Qeverisë

¹¹ Në bazë të Nenit 36 të Rregullores së punës së Qeverisë

¹² Në bazë të Nenit 72 të Rregullores së punës së Qeverisë

01



PJESA 01: PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Përkufizimi i problemit siguron bazën e koncept dokumentit dhe jep përgjigje se përse Qeveria duhet të veprojë. Kjo pjesë ju ndihmon:

- Të përshkruani kornizën ekzistuese të politikave dhe atë ligjore, organizimin institucional dhe përgjegjësitë në lidhje me çështjet e politikave të analizuar në koncept dokument;
- Të përshkruani ndërhyrjet jo rregullative që lidhen me çështjet e politikave të analizuar në koncept dokument;
- Të paraqitni përkufizimin e problemit duke përshkruar situatën aktuale, shkaqet dhe efektet;
- Të përshkruani mbivendosjet e mundshme, mangësitë, mosefikasitetin dhe kontradiktat në kornizën rregullatore;
- Të identifikoni grupet e prekura të interesuara dhe përshkruani lidhjen e tyre me problemin.

Hapi i parë në zhvillimin e politikave është përgjigjja në pyetjen pse Qeveria ka nevojë të promovojë ndryshimet në shoqëri. Kjo quhet zhvillimi i përkufizimit të problemit. Është hapi më i rëndësishëm në zhvillimin e politikave.

Përkufizimi i problemit është baza e një koncept dokumenti. Të gjitha analizat e mëtejshme që bëhen për koncept dokumentin pasojnë nga përkufizimi i problemit. Një përkufizim i mirë i problemit e bën shumë më të lehtë zhvillimin e koncept dokumentit, pasi analiza rrjedh në mënyrë logjike nga përkufizimi. Konkluzionet e analizës do të jenë të qëndrueshme, të kuptueshme dhe të justifikueshme.

Vlen edhe e kundërta. Përkufizimi i dobët i një problemi e bën shumë të vështirë kryerjen e analizave në mënyrë të duhur. Një ndërtesë me themele të dobëta do të shembet. Ngjashëm, një koncept dokument me një përkufizim të dobët të problemit do të jetë i vështirë për t'u kuptuar dhe mund të ketë kundërthënie.

Kjo pjesë shpjegon elementet e ndryshme që mund të përmbajë një përkufizim i problemit. Ofron njohuri se si mund të ndërtohet një përkufizim i problemit. Shpjegon përdorimin e pemës së problemit (problem tree) dhe gjendjen fillestare (baseline), dy mjete që mund të përdoren gjatë zhvillimit dhe paraqitjes së përkufizimit të problemit për një koncept dokument.

SI TË ZHVILLOHET NJË PËRKUFIZIM I MIRË I PROBLEMIT?

Koncept dokumentet përgatiten për tema të ndryshme dhe secili përkufizim i problemit varet nga tema e trajtuar. Ndonjëherë një përkufizim i problemit është relativisht i lehtë për t'u përgatitur. Megjithatë, përgatitja e përkufizimit të problemit shpesh merr kohë dhe kërkon përpjekje të konsiderueshme. Kjo është koha ku investohet shumë dhe ia vlen, pasi që përkufizimi i problemit është baza e analizave të mëtejshme për koncept dokumentin.

Përkufizimi i problemit duhet të bëhet para analizave të mëtejshme për koncept dokumentin. Megjithatë, versioni i parë i përkufizimit të problemit shpesh nuk është përfundimtar. Ndërsa zhvillohet analiza, përkufizimi i problemit do të mund të ketë nevojë për ndryshim. Kjo është krejtësisht normale pasi zhvillimi i koncept dokumentit shton njohuritë rreth temës që trajtohet. Njohuria shpie në të kuptuar. Të kuptuarit shpie në përmirësime. Përmirësimet shpiejnë në ndryshime.

PËRSHKRIMI I KORNIZËS EKZISTUESE TË POLITIKAVE DHE ASAJ LIGJORE

Çdo koncept dokument dhe çdo përkufizim i problemit dallon nga njëri-tjetri. Megjithatë, pjesa e parë e secilit koncept dokument duhet të jetë një përshkrim i hollësishëm i kornizës ekzistuese të politikave dhe asaj ligjore, institucioneve shtetërore përgjegjëse për zbatim, si dhe roleve dhe përgjegjësive të tyre. Përkufizimi i problemit siguron bazën e analizës për koncept dokumentin. Për të pasur një pasqyrë të plotë mbi çështjet që trajtohen dhe për të identifikuar elementet që nuk janë të plota ose nuk funksionojnë, është e rëndësishme të tregohet korniza aktuale e politikave dhe ajo ligjore rreth kësaj çështjeje. Një përshkrim i tillë siguron informacionin e nevojshëm për të vlerësuar opsionet në lidhje me masat ekzistuese. Ai përbën bazën për vlerësimin se si opsionet (jo-) rregullatore të shqyrtuara në koncept dokument do të ndërlidheshin me politikat ekzistuese dhe kërkesat ligjore.

Prandaj, paraqitja e përkufizimit të problemit duhet të fillojë me një pasqyrë të politikave, ligjeve dhe akteve nënligjore që lidhen me çështjet që trajtohen. Një përmbledhje e tillë tregon pozicionin e koncept dokumentit (rrjedhimisht edhe analizat dhe zgjidhjet e propozuara) brenda kornizës së politikave dhe asaj ligjore. Gjithashtu ofron një bazë të dobishme për të përcaktuar se cilat institucione qeveritare mund të jenë relevante.

Mund të ndodhë që një institucion shtetëror të jetë përgjegjës për zbatimin e disa politikave, ligjeve dhe/ose akteve nënligjore. Nëse është kështu, kjo duhet të përmendet qartazi. Gjithashtu, një politikë, ligj ose akt nënligjor mund të zbatohen nga dy ose më shumë institucione shtetërore që mbulojnë pjesë të ndryshme. Nëse është kështu, kjo duhet të ceket gjithashtu.



Figura 1: Shembull i përshkrimit të kornizës ekzistuese të politikave dhe asaj ligjore

Dokument i politikave, ligj ose akti nën-ligjor	Lidhja me politikën apo dokumentin planifikues përmes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare	Institucioni(-et) shtetëror (e) përgjegjës(e) për zbatim	Roli dhe detyrat e Institucionit(-eve)
Emri i politikës ose dokumentit planifikues (shih gjithashtu pasqyrën e dokumenteve të politikave të mundshme në Pjesën 2 të Doracakut për hartimin e koncept dokumenteve		Emri i institucionit shtetëror	
Emri i ligjit		Emri i institucionit shtetëror	
Emri i aktit nën-ligjor		Emri i institucionit shtetëror	
Emri i ligjit		Emri i institucionit shtetëror	
Etj.		Etj.	

Përmbledhja e ofruar nga figura më lart ndihmon në identifikimin e mbivendosjeve, mangësive, mosefikasitet dhe kontradiktave të mundshme në kornizën e politikave dhe atë ligjore. Paraqitja e përmbledhjes duhet të plotësohet me shpjegimin mbi cilësinë e këtyre kornizave. Nëse kjo konsiderohet si e pamjaftueshme, atëherë kjo duhet të pasqyrohet në përkufizimin e problemit.

Krahas kornizës ekzistuese të politikave dhe asaj ligjore, koncept dokumenti duhet të identifikojë të gjitha ndërhyrjet jorregullative siç janë fushatat e informimit, programet e trajnimit etj., kur këto janë relevante për çështjet që analizohen në koncept dokument.

ELEMENTET E PROBLEMIT

Secili koncept dokument dhe një përkufizim i duhur i problemit përmban elemente të veçanta që ofrojnë një përshkrim të detajuar të gjendjes aktuale. Elementet janë si më poshtë:

- Problemi kryesor
- Shkaqet e problemit
- Efektet e problemit
- Identifikimi i palëve të interesuara të ndikuara

DOKUMENTACIONI MBËSHTETËS

Për përshkrimin e problemit, është e dobishme të listoni dokumentet që janë analizuar për të vlerësuar problemin kryesor, shkaqet dhe efektet. Këto dokumente mund të jenë raporte dhe artikuj nga ministrinë, mediat, OJQ-të, organizatat ndërkombëtare dhe donatorët.

PROBLEMI KRYESOR

Problemi kryesor përmbledh arsyet për koncept dokumentin në një fjali ose në vetëm disa fjalë. Problemi kryesor fillimisht listohet në përmbledhje pasi që është temë qendrore e koncept dokumentit. Ai vendos kornizën për të gjitha aktivitetet dhe punën që duhet të kryhet për analizën e politikave. Problemi kryesor është konkluzioni që nxirret nga analiza që është kryer në mënyrë që të zhvillohet një përkufizim i qartë i problemit.

Problemi kryesor mund të identifikohet dhe paraqitet në mënyrë efektive përmes Mjetit 1: Pema e problemit.

Përcaktimi i problemit kryesor nuk është proces linear në të cilin çështjet kryesore vendosen qysh në fillim. Është një proces dinamik ku çështjet mendohen kohë pas kohe dhe përsëriten. Njohuritë e fituara gjatë analizës gjithashtu mund të shpiejnë në ndryshime në përkufizimin e problemit. Këto ndryshime janë një tipar normal i analizës së politikave.

SHKAQET E PROBLEMIT

Shkaqet e problemit janë arsyt pse ekziston problemi. Ekzistojnë tri shkaqe kryesore të problemeve:

- 1 Mangësitë ligjore dhe rregullative;
- 2 Mangësitë e tregut; dhe
- 3 Çështjet shoqërore.

Mangësitë ligjore dhe rregullative janë probleme që lidhen me zbatimin e kornizës ekzistuese të legjislacionit dhe akteve nënligjore. Për shkak të këtyre problemeve, rregullat dhe kërkesat nuk funksionojnë siç duhet dhe për këtë arsye nuk arrijnë efektin e synuar.

Mangësitë e tregut janë probleme që shfaqen në ekonomi. Ato kanë ndikim negativ në zhvillimin ekonomik.

Çështjet shoqërore janë probleme komplekse që lidhen me zhvillimin e tërë vendit në aspektet ekonomike, sociale dhe mjedisore.

Përkufizimi i problemit normalisht mund të lidhet me njërin nga këto tri kategori. Është shumë e rëndësishme të identifikohet shkaku i vërtetë i problemit. Njohja e këtyre shkaqeve i mundëson organit propozues të projektojë një zgjidhje efektive.

Shkaqet që janë listuar më poshtë janë ato që ndodhin më së shpeshti. Natyrisht, në raste të veçanta, ato mund të jenë shumë të ndryshme. Gjithashtu mund të ketë dy ose më shumë shkaqe për një problem e jo vetëm një shkak. Përmbledhja në vijim jep udhëzime për strukturimin e përkufizimit të problemit dhe jep udhëzime për analizën që duhet të bëhet për koncept dokumentin.

MANGËSITË LIGJORE DHE RREGULLATIVE

Siç thekson edhe titulli, mangësitë ligjore dhe rregullative ndodhin kur tashmë ka rregulla, por këto rregulla nuk funksionojnë mirë. Kur problemi shkaktohet nga një mangësi ligjore ose rregullative, zgjidhja e problemit do të thotë rregullimi i kornizës ligjore dhe rregullative. Për të arritur zgjidhjen më të mirë, duhet të vlerësohet në mënyrë të duhur lloji i mangësisë. Tabela e mëposhtme liston llojet më të zakonshme të mangësive ligjore dhe rregullative dhe disa nga efekte e tyre të mundshme.



Figura 2: Shembuj të mangësive të kornizës ligjore dhe rregullative

Lloji i mangësive ligjore dhe rregullative	Shpjegimi dhe shembujt
Rregullat nuk zbatohen siç duhet	<p>Zbatimi i legjislacionit dhe akteve nënligjore është thelbësor. Nëse ato nuk zbatohen fare, mund edhe të mos jenë të nevojshme. Në raste të tilla, rregullat mund të shfuqizohen. Në mënyrë alternative, në qoftë se rregullat shihen si thelbësore, atëherë duhet gjetur se cila është arsyeja e moszbatimit, si dhe duhet të identifikohet mënyra se si të funksionojnë ato. Zbatimi jo i duhur i rregullave mund të japë përshtypje “ të gabuar” që korniza ligjore nuk është e plotë dhe se nevojiten rregulla shtesë. Gjithashtu, zbatimi jo i duhur nënkupton se ngarkesa për kompanitë dhe qytetarët që duhet t’i përbushin këto rregulla është e lartë pa nevojë.</p> <p>Në rastet kur koncept dokumenti trajton mangësitë ligjore dhe rregullative , gjithmonë duhet të analizohet mënyra se si zbatohen rregullat. Kur problemi ekziston për shkak se “rregullat nuk zbatohen siç duhet”, duhet të përcaktohen mënyrat e përmirësimit të zbatimit. Kjo do të thotë që rregullat duhet të thjeshtësohen ose do të duhej të shfuqizohen kur të njëjtat nuk mund të zbatohen fare. Në raste të tjera ,ndoshta duhet të rezervohet buxhet shtesë ose të merren masa tjera për të siguruar që rregullat të zbatohen.</p>
Rregullat janë të pakompletuara	<p>Gjatë hartimit të legjislacionit dhe akteve nënligjore, personat e përfshirë në këtë proces ndonjëherë nuk i vërejnë apo i harrojnë disa gjëra. Kjo, fatkeqësisht, mund të ndodhë kur legjislacioni zhvillohet nga Qeveria dhe miratohet - me ose pa ndryshime - nga Parlamenti.</p> <p>Kur bëhen ndryshime, në shoqëri lindin mundësi dhe kërkesa të reja. Legjislacioni mund të mos kompletohet për shkak të këtyre ndryshimeve dhe mundësive të reja.</p> <p>Mund të mos ketë rregulla në disa fusha të politikave. Për të rregulluar veprimtaritë e reja të biznesit, për shembull në sektorin e TI-së, rregullat duhet të zhvillohen nga pika zero.</p> <p>Harmonizimi i legjislacionit me direktivat e BE-së gjithashtu mund të nxjerrë në pah nevojën e rregullimit të legjislacionit në mënyrë që të përputhet me rregullat e BE-së.</p> <p>Kur problemi ekziston për shkak se ‘rregullat janë të pakompletuara’, është e nevojshme të përcaktohet dhe të korrigjohet boshllëku aktual.</p>

Lloji i mangësive ligjore dhe rregullative	Shpjegimi dhe shembujt
Rregullat janë kontradiktore	<p>Ligjet dhe aktet nënligjore mund të hartohen në atë mënyrë në të cilën ato bien ndesh me njëri-tjetrin. Kjo mund të bëhet e qartë, për shembull, në gjykatë, kur ligjet vendosen kundër njëri-tjetrit, ose gjatë fazës së zbatimit. Gjithashtu, mund të ketë dispozita kundërthënëse brenda akteve ligjore.</p> <p>Rregullat kundërthënëse krijojnë pasiguri ligjore. Ato shkaktojnë konfuzion, pengojnë funksionimin e institucionit dhe mund të bllokojnë individët dhe kompanitë që të gëzojnë plotësisht të drejtat e tyre.</p> <p>Kur problemi ekziston sepse 'rregullat janë kundërthënëse', këto konflikte duhet të identifikohen qartazi dhe të mënjanohen.</p>
Rregullat të cilat rregullojnë institucionet shtetërore janë të vjetruara	<p>Administrata publike përbëhet nga një sërë institucioneve publike në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal. Ministrinë, komunitat, agjencitë dhe të tjera, të gjitha janë pjesë e administratës publike.</p> <p>Me kalimin e kohës ndryshojnë detyrat që kryejnë institucionet publike. Për shembull, agjencitë mund të krijohen për arritjen e një qëllimi të caktuar dhe kur ky qëllim arrihet, ato nuk janë më të nevojshme. Përgjegjësitë e dy institucioneve mund të mbivendosen dhe legjislativi, i cili i rregullon ato duhet të përshtatet. Ministrinë mund të shuhet ose të bashkohen në bazë të prioriteteve politike. Mund të kemi kursime në shpenzime nëse bashkohen dy institucione që kryejnë detyra komplementare.</p> <p>Njëkohësisht, ndoshta do të duhej të krijohen institucione të reja qeveritare për të përmbushur detyrat e reja ose për të përmirësuar mënyrën në të cilën zbatohet dhe ekzekutohet legjislativi. Ministrinë e reja mund të krijohen për të përmbushur prioritetet politike të Qeverisë.</p> <p>Kur ekziston problemi, për shkak se "Rregullat të cilat rregullojnë institucionet shtetërore janë të vjetruara", arsyet për këtë duhet të analizohen dhe të arsyetohen, duke përfshirë përfitimet dhe kostot.</p>

Lloji i mangësive ligjore dhe rregullative	Shpjegimi dhe shembujt
Rregullat shkaktojnë ngarkesë të panevojshme	<p>Legjislacioni dhe aktet nënligjore vendosin kërkesa që kompanitë dhe qytetarët duhet t'i përmbushin. Këto kërkesa janë të formave të ndryshme, si: leje, licenca, standarde minimale, norma mjedisore, e shumë të tjera.</p> <p>Këto kërkesa mund të jenë (ose mund të bëhen me kalimin e kohës) ngarkesë e panevojshme. Për shembull, legjislacioni mund të kërkojë që një informacion i caktuar të ofrohet në kopje fizike, ndërsa ekziston formati elektronik i të njëjtit informacion. Një kompani mund të detyrohet të aplikojë për disa leje për të njëjtën veprimtari afariste, siç është hapja e një restoranti.</p> <p>Kur ngarkesat e shkaktuara nga legjislacioni janë të pajustificueshme, ato shkaktojnë një kosto të panevojshme për shoqërinë. Këto ngarkesa mund të kenë efekte shumë negative. Ato mund të kufizojnë konkurrencën, demotivojnë njerëzit nga hapja ose regjistrimi i biznesit të tyre etj.</p> <p>Kur problemi ekziston për shkak se 'rregullat shkaktojnë ngarkesë të panevojshme', ato duhet të thjeshtohen në mënyrë që të ulin ngarkesën.</p>
Rregullat nuk janë më të nevojshme	<p>Aktet ligjore dhe nënligjore mund të humbasin plotësisht rëndësinë e tyre. Kjo mund të ndodhë për shkak se legjislacioni tjetër ngadalë zëvendëson elementet që këto akte kanë rregulluar. Prioritetet shoqërore dhe politike mund të ndryshojnë. Transpozimi i direktivave dhe rregulloreve të BE-së mund t'i bëjë aktet ekzistuese ligjore dhe nënligjore të panevojshme.</p> <p>Ajo që vlen për aktet në përgjithësi, vlen edhe për pjesë të caktuara të akteve ligjore dhe nënligjore.</p> <p>Kur problemi ekziston për shkak se 'rregullat nuk janë më të nevojshme', ato rregulla duhet të shfuqizohen.</p>

MANGËSITË E TREGUT

Mangësitë e tregut ndodhin kur ekonomia e tregut nuk funksionon siç duhet duke rezultuar me ndikime negative. Kjo tingëllon shumë e ndërlikuar, por shpesh nuk është. Mangësitë e tregut vërehen në probleme shumë praktike. Shembujt e mangësive të tregut janë të shënuara në tabelën e mëposhtme në lidhje me disa efekte që mund të paraqiten.



Figura 3: Shembuj të mangësive të tregut

Lloji i mangësisë së tregut	Shpjegimi dhe shembujt
<p>Çmimet nuk reflektojnë kostot reale për shoqërinë</p>	<p>Prodhimi dhe/ose konsumi i produkteve të caktuara ka kosto. Nganjëherë, kostot reale për shoqërinë nuk janë pjesë e çmimit të një produkti. Kjo shpjenë në situata ku efektet negative për shoqërinë mund të jenë shumë të larta për shkak të stimuljeve të gabuar të shkaktuar nga një çmim i gabuar.</p> <p>Shpesh, ndotja është shembull i mirë i një çmimi që nuk i mbulon të gjitha kostot. Djegia e qymyrit në dimër është zgjedhje logjike pasi që është i lirë dhe shtëpia duhet të ngrohet. Megjithatë, ndotja që shkaktohet nga shumë njerëz që përdorin qymyr për të ngrohur shtëpitë e tyre ka pasoja të rënda, siç janë sëmundjet e mushkërive dhe vdekja e hershme. Këto janë kosto që nuk reflektohen në çmimin e qymyrit.</p> <p>Pirja e duhanit është dëshmuar të jetë shumë e dëmshme për shëndetin, jo vetëm për personin që pi duhan, por edhe të tjerët përreth. Pirja e duhanit dëmton të gjithë, por sidomos fëmijët janë në rrezik të madh, veçanërisht në hapësira të ngushta, siç janë automjetet dhe në shtëpi. Pirja e duhanit dhe qëndrimi në tymin e duhanit shkakton shumë sëmundje. Këto sëmundje gjithashtu kanë kosto. Ato nuk reflektohen në çmimin e cigareve.</p> <p>Hedhja e mbeturinave në rrugë dhe natyrë është një shembull tjetër. Për individët është lehtë t'i hedhin mbeturinat, sepse nuk u kushton asgjë. Megjithatë, mbeturinat dëmtojnë fshatrat dhe qytetet dhe shpesh duhet të pastrohen nga shteti.</p> <p>Kur çmimet nuk reflektojnë koston aktuale, heqja e produkteve nga tregu apo detyrimi i kompanive për të përshtatur proceset e tyre të prodhimit (duke i detyruar të instalojnë filtrat për parandalimin e ndotjes së ajrit) janë shembuj të mënyrave për korrigjim. Shembuj të tjerë janë vendosja e taksave dhe gjobave për të rritur çmimet në mënyrë që të reflektojnë kostot reale. Megjithatë, për të zgjidhur një problem të tillë, është shumë e rëndësishme të vlerësohet nëse ka mundësi alternative dhe/ose nëse njerëzit mund të përballojnë zëvendësimin me produkte të tjera.</p>

Mungesa e të mirave publike

Sektori privat prodhon mallra dhe ofron shërbime me qëllim të fitimit. Megjithatë, nuk është e mundur të fitohet mbi çdo gjë. Mund të nevojiten investimet për të siguruar që shoqëria të përfitojë. Kur sektori privat nuk ofron një mall apo shërbim të caktuar, atëherë Qeveria duhet t'i sigurojë ato kur analizat tregojnë se është e nevojshme. Mallrat dhe shërbimet e ofruara nga Qeveria janë të mira publike.

Parqet publike dhe rezervat natyrore janë shembuj të mirë të të mirave publike. Ato ofrojnë një vend të mirë ku njerëzit mund të kalojnë ditën, por nuk është e mundur të takohen personat për qasje në çdo park, pyll etj.

Mbrojtja kombëtare, forcat policore, kujdesi emergjent dhe parandalimi i fatkeqësive janë gjithashtu të mira publike. Ato duhet të organizohen nga shteti për të siguruar që të gjithë të përfitojnë prej tyre.

Arsimi, ndihmat sociale, ndihmat për të papunët dhe shembuj të tjerë ku shteti përkrah individët gjithashtu mund të konsiderohen si të mira publike. Shteti duhet t'i organizojë ato për të siguruar mobilitetin social, të parandalojë varfërinë dhe zhbllokojë ndihma të tjera për shoqërinë, ç'gjë sektori privat nuk mund ta bëjë.

Kur problemi shkaktohet nga 'mungesa e të mirave publike', shteti mund të vlerësojë nëse është e mundur të rezervojë burimet e nevojshme për të ofruar këtë të mirë. Subvencionet gjithashtu mund të ofrojnë stimuj për kompanitë për të ofruar të mira publike.

Mungesa e stimujve të tregut

Sektori privat investon në mënyrë që të fitojë. Pritjet janë se do të ketë kthim pozitiv të këtyre investimeve. Kur të bëhen investime, kompanitë do të kenë parasysh rreziqet potenciale që projektet mund të dështojnë ose të japin më pak fitim se sa pritej. Kur investimet paraprake janë shumë të larta dhe/ose rreziqet janë shumë të mëdha, nuk do të bëhen investime. Si rezultat i kësaj, nuk do të zhvillohen as aktivitetet.

Ndërtimi i një autostrade është shumë i kushtueshëm, por me një lloj të duhur të koncesioneve, investitorët privatë mund të jenë të gatshëm të marrin përsipër koston e ndërtimit dhe të mirëmbajtjes së rrugës. Veçanërisht kur pritet që shumë njerëz ta shfrytëzojnë këtë rrugë.

Prezantimi i metodave të reja bujqësore mund të jetë shumë e shtrenjtë, veçanërisht për fermerët me ferma të vogla. Për shembull, subvencionet mund të ulin shpenzimet për teknologji të re. Shpenzimet mund të arsyetohen, në raste kur inkurajohet bujqësia më e mirë, siç është reduktimi i ndjeshëm i përdorimit të pesticideve, etj.

Mungesa e stimujve gjithashtu ndodh kur personi, i cili duhet të bëjë investimin, nuk ka marrë përfitim. Pronari që ofron me qira shtëpinë e tij për dikë tjetër, nuk paguan faturën e energjisë. Pronari nuk ka arsye të investojë në izolim të shtrenjtë të shtëpisë përveç nëse qiraja mund të rritet.

'Mungesa e stimujve të tregut' mund të trajtohet në mënyra të ndryshme. Ofrimi i stimujve tatimorë për investime dhe subvencione janë dy mënyra me të cilat qeveria mund të mbulojë drejtpërdrejt një pjesë të shpenzimeve të investimeve. Zhvillimi i rregullave të qarta dhe të zbatueshme mund të ofrojë siguri ligjore që është e nevojshme për investime, përfshirë investimet e huaja.

Është e rëndësishme të theksohet: problemi i shkaktuar nga 'mungesa e stimujve të tregut' dhe 'mungesa e të mirave publike' janë të ngjashme me njëra-tjetrën. Dallimi në mes të dyjave është se të mirat publike nuk mund të ofrojnë fitim dhe për këtë arsye nuk tërheqin investime nga biznesi. Për shembull, nuk është e mundur që shoferët të ngarkohen për çdo rrugë që ata shfrytëzojnë. Rrugët e tilla janë të mira publike. Megjithatë, kompanitë mund të kërkojnë pagesë për përdorimin e kanaleve, disa autostradave dhe për infrastrukturë tjetër. Dallimi kryesor në mes të dy shkaqeve të problemit është se a ka mundësi të fitohet me kosto të arsyeshme.

Mungesa e konkurrencës

Konkurrenca e tregut ka një sërë ndikimesh pozitive. Ajo çon në çmime më të ulëta të mallrave dhe shërbimeve. Kjo u mundëson më shumë njerëzve që t'i blejnë ato. Konkurrenca po ashtu mbështet investimet në inovacione dhe rezulton me cilësi më të mirë të mallrave dhe shërbimeve.

Vlen edhe e kundërta. Kur konkurrenca është e ulët apo nuk ekziston fare, çmimet zakonisht janë më të larta nga ç 'është e nevojshme. Meqë konsumatorët nuk kanë alternativa prej të cilave të zgjedhin, përmirësimi i një shërbimi ka më pak prioritet dhe investimet në inovacione mund të jenë shumë të pakta.

Mungesa e konkurrencës mund të jetë një gjendje "normale" e tregut. Kjo vlen sidomos kur kostoja për ofrimin e një malli është tejet e lartë. Tregjet e furnizimit me ujë dhe energji elektrike zakonisht kanë vetëm një ose disa ofrues, pasi që ndërtimi i rrjetit për shpërndarjen e ujit dhe energjisë elektrike është shumë i kushtueshëm. Nuk ka kuptim ekonomik që një shtëpi të ketë më tepër se një gyp që sjell ujë, bie fjala. Si rrjedhojë, një ndërmarrje e vetme furnizon me ujë një vend apo rajon.

Në rast se problemi shkaktohet nga 'mungesa e konkurrencës', duhet të analizohen nevojat e tregut për të parë nëse nevojitet kontrollimi i caktimit të çmimeve. Natyrisht kjo duhet të bëhet me kujdes.

E rëndësishme: mungesa e konkurrencës mund të shkaktohet edhe nga një mangësi ligjore ose rregullative, si për shembull kur rregullimi është tejet i ndërlikuar apo zbatimi i të cilit është i kushtueshëm pa nevojë. Kjo pengon hyrjen në treg të kompanive të tjera. Kjo trajtohet në pjesën 'Mangësitë ligjore dhe rregullative'.

Nivelet e pabarabarta të informacionit

Mund të ndodhë që tregu të mos funksionojë mirë për shkak se jo të gjithë i kanë informatat e njëjta apo i dinë rregullat e zbatueshme. Në rast se njerëzit nuk i dinë të drejtat e tyre, ata janë në disavantazh të qartë.

Një veturë mund të kushtojë lirë pasi që është joeficiente dhe shpenzon shumë karburant. Një veturë që është më efiçiente në aspektin e karburantit shpenzon më pak, mirëpo kushton më shtrenjtë. Se cila veturë është më e përshtatshme varet nga sa shpesh synon ta përdorë veturën blerësi i saj dhe sa kilometra në vit do ta vozisë. Blerësi i veturës duhet ta dijë se sa karburant shpenzon vetura në 100 km në mënyrë që ta marrë vendimin më të mirë.

Zakonisht kompanitë i dinë të drejtat e konsumatorëve, mirëpo konsumatorët jo domosdoshmërisht i dinë të drejtat që kanë. Një kompani ajrore mund të mos i informojë pasagjerët e saj se atyre u takojnë shujtat falas ose kompensime të tjera në rastet kur një fluturim anulohet apo vonohet tejmasë. Nëse pasagjerët nuk i dinë të drejtat e tyre, ata nuk do t'i kërkojnë ato. Në këtë mënyrë konsumatorët i humbasin të drejtat e tyre, megjithëse synimi do të duhej të ishte që atyre t'u jepen të drejta dhe të kompensohen siç duhet.

Në rastet kur problemi shkaktohet nga 'nivelet e pabarabarta të informacionit', zgjidhja e tij qëndron në sigurimin që të gjithë të marrin informatat thelbësore. Ofrimi i informatave mbi konsumin e energjisë nga mallrat e konsumit, si frigoriferët; dorëzimi i detyrueshëm i fletushkave që tregojnë të drejtat e konsumatorëve dhe fushatat informuese të organizuara nga qeveria janë shembull i promovimit të qasjes së barabartë në informata.

ÇËSH TJET SHOQËRORE

Çështjet shoqërore janë çështje që ndikojnë në shoqëri në masë të madhe. Kur krahasohen me mangësitë e tregut dhe mangësitë ligjore dhe rregullative, çështjet shoqërore kanë tendencë që të kenë një shtrirje shumë më të gjerë. Problemet shpesh shkaktohen nga faktorë të shumtë dhe ndikojnë te shumë akterë. Ato gjithashtu kanë tendencë për të mbuluar disa fusha të politikës dhe për këtë arsye një numër i institucioneve qeveritare mund të përfshihen kur bëhet fjalë për zgjidhjen e problemit të identifikuar. Shkaqet e çështjeve shoqërore janë shpesh të ndërlikuara për shkak se lidhen me shumë faktorë, siç janë qëndrimet kulturore, perceptimet në bazë të gjendjes socio-ekonomike, normat shoqërore dhe shumë të tjera.

Çështjet shoqërore janë çështje të politikave, siç janë mungesa e barazisë gjinore, diskriminimi, korrupsioni, fëmijët që nuk kanë përfunduar shkollën e mesme, papunësia vazhdimisht e lartë e të rinjve, të drejtat pronësore etj. Këto tema janë shumë komplekse dhe kur trajtohen, ato duhet të analizohen në thellësi dhe me kujdes të madh. Kjo do të thotë se duhet bërë rezervimin e kohës së nevojshme për të siguruar që problemi, shkaqet e tij dhe efektet janë identifikuar siç duhet.

IDENTIFIKIMI I PALËVE TË INTERESUARA

Identifikimi i palëve të interesuara ndjek drejtpërdrejt shkaqet e identikuara, efektet dhe organizatat e përfshira qeveritare.

Një mënyrë praktike për të paraqitur përfshirjen e palëve të interesuara është paraqitur në përmbledhjen e mëposhtme. Është e dobishme të dihen se cilat palë të interesuara janë të ndikuara nga problemi pasi që kjo ndihmon në zhvillimin e analizave për koncept dokumentin. Palët që janë veçuar, duhet të konsultohen drejtpërdrejt dhe/ose duhet të promovohet pjesëmarrja e tyre në konsultime publike.



Figura 4: Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit

Emri i palëve të interesuara	Shkaku-qet me të cilat është e lidhur pala	Efektet me të cilat është e lidhur pala	Mënyra në të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) apo efektin (efektet)
Emri i institucionit qeveritar	Mungesa e cilësisë lidhur me inspektimin e kompanive		Nuk zbaton rregulla ekzistuese për shkak të mungesës së trajnimit të stafit
Emri i palës së jashtme të interesuar		Konkurrenca është e shtrembëruar	Kompanitë që përcjellin rregullat kanë shpenzime më të mëdha se sa ato që shkelin ligjin. Ato të cilat shkelin ligjin kanë përparësi në çmim.
Etj.	Etj.	Etj.	Etj.

IDENTIFIKIMI I PROBLEMIT, SHKAQEVE DHE EFEKTEVE TË TIJ

Kategorizimi i shkaqeve të një problemi në mangësitë ligjore dhe rregullative, mangësitë e tregut dhe çështjet shoqërore ndihmojnë në strukturimin fillestar të përkufizimit të problemit.

Është thelbësore që përkufizimi i problemit të shtjellohet në fillim të përgatitjes së koncept dokumentit. Megjithatë, përkufizimi i problemit me shumë gjasa do të duhej të përpunohet, përdërisa zhvillohet analiza. Ky është rezultat i analizës së mirë dhe shfrytëzimit të dëshmvive.

Meqenëse zhvillimi i përkufizimit të problemit është baza e koncept dokumentit, ia vlen dhe është e arsyeshme të investohet kohë e konsiderueshme në këtë proces. Një përkufizim i mirë i problemit do ta bëjë më të lehtë zhvillimin e koncept dokumentit. Hapat tjerë që janë të nevojshëm për të përfunduar koncept dokumentin kanë tendencë të ndjekin rrjedhën logjike nga përkufizimi i problemit. Përkufizimi i problemit është i mirë atëherë kur dokumenti ofron përgjigje dhe qartësi për ata që e lexojnë.



Figura 5: Vlerësimi i ndikimit gjinor dhe përkufizimi i problemit

Mjeti 7: Vlerësimi i ndikimit gjinor siguron informacionin e nevojshëm për të vlerësuar çështjet e lidhura me gjininë për secilin koncept dokument. Ky mjet - dhe Doracaku mbështetës për vlerësimin e ndikimit gjinor - gjithashtu ofron informacion të dobishëm për të përmirësuar përkufizimin e problemit duke vlerësuar problemin, shkaqet dhe efektet nga perspektiva gjinore. Vlerësimi i ndikimit gjinor është kështu një mjet për të përmirësuar më tej cilësinë e përkufizimit të problemit.

Vlen edhe e kundërta. Kur përkufizimi i problemit nuk është i kompletuar ose edhe i gabuar, analiza e koncept dokumentit do të jetë shumë më e vështirë. Gabimet mund të ndodhin. Në qoftë se ato korrigjohen, kjo është pjesë e procesit normal analitik. Kur gabimet injorohen qëllimisht ose kur njerëzit nuk duan të përmirësojnë mënyrën e tyre të menduarit, koncept dokumenti do të jetë i palogjikshëm dhe mund të përmbajë kontradikta. Një koncept dokument me një përkufizim të keq të problemit do të shkaktojë pyetje dhe do t'i ngatërrojë ata që e lexojnë atë. Natyrisht, kjo duhet të shmanget.

Figura në vijim paraqet procesin që do të jetë i dobishëm në zhvillimin e një përkufizimi të mirë të problemit.



Figura 6: Procesi i përkufizimit të problemit, shkaqet dhe efektet e tij

Hapi 1	Mbledhja e të dhënave	Të mblidhen të gjitha të dhënat relevante që i dini se ekzistojnë. Këto të dhëna mund të përfshijnë raporte, artikuj dhe lajme mediale, pyetje parlamentare, program qeveritar dhe çdo burim tjetër informacioni që ndihmon për të kuptuar problemin. Mjeti 14 për mbledhjen e të dhënave jep sugjerime për burimet relevante të të dhënave.
Hapi 2	Analiza e të dhënave	Pasi që informatat relevante mund të jenë të shpërndara në dokumente të ndryshme, këto dokumente duhet të lexohen dhe të analizohen. Vetëm informacioni i dobishëm duhet të përdoret për koncept dokumentin. Informata të dobishme janë informata që ndihmojnë për të kuptuar problemin.
Hapi 3	Përmbledhni të dhënat tuaja dhe bëni draftin e parë të përkufizimit të problemit	<p>Përderisa ju analizoni të dhënat, ju duhet të filloni të shkruani një përmbledhje. Ky do të jetë versioni i parë i përkufizimit tuaj të problemit.</p> <p>Kur ju hartoni një përmbledhje, sigurohuni që të tregoni shumë qartë se cili është problemi, cilat janë shkaqet dhe çfarë efektesh ka.</p> <p>Gjithashtu tregoni kush ndikohet nga problemi, cilat institucione qeveritare janë përgjegjëse për politikën dhe legjislacionin lidhur me këtë problem dhe kush mund ta shkaktojë problemin.</p> <p>Sigurohuni që ju t'u referoheni si duhet dokumenteve që përdoren për përkufizimin e problemit.</p> <p>KËSHILLË: Mjeti 1 sqaron si mund të përdoret Pema e problemit për përkufizimin dhe paraqitjen e problemit. Mund të përdorni këtë mjet për të zhvilluar përmbledhjen tuaj.</p>

Hapi 4	Verifikoni të dhënat që ju keni dhe finalizoni draftin tuaj të dytë të përkufizimit të problemit	<p>Kur ta keni identifikuar problemin, shkaqet dhe efektet e tij, ju mund të verifikoni nëse ka informata shtesë në dispozicion. Ju mund, për shembull, të kërkonte në internet për informacion në lidhje me shkaqet, të cilat i keni identifikuar apo efektet që i keni veçuar.</p> <p>Verifikimi i të dhënave ju ndihmon në përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së përkufizimit të problemit tuaj.</p> <p>Sigurohuni që kur të shtoni informata t'u referoheni dokumenteve shtesë që përdoren për përcaktimin e problemit.</p>
Hapi 5	Konsultohuni për përmbledhjen tuaj	<p>Bisedoni rreth përmbledhjes me profesionistët në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none">» me kolegët tuaj» me anëtarët e grupit punues për koncept dokumentin» personin tuaj kontaktues në Sekretariatit Koordinues të Qeverisë <p>» Sipas nevojës, ju mund të merrni në konsideratë konsultimin e palëve tjera të interesuara:</p> <ul style="list-style-type: none">» Stafin nga ministritë e linjës, të cilat janë përgjegjëse për politikatat që ndërlidhen me përkufizimin e problemit, shkaqet dhe efektet e tij» Agjencitë zbatuese» Organizatat e shoqërisë civile» Donatorët ndërkombëtarë» Përfaqësues të biznesit» Bizneset individuale» Ekspertët e jashtëm» Grupet tjera të ndikuara <p>Konsultimi i palëve të jashtme është shumë i dobishëm kur ju keni identifikuar se ato ndikohen nga ky problem, ose kur ato janë të ndërlidhura me shkaqet e problemit</p>
Hapi 6	Finalizoni draftin e tretë të përkufizimit të problemit	<p>Bazuar në raundin tuaj të konsultimit, ju mund të finalizoni versionin e tretë të përkufizimit të problemit tuaj. Ky do të jetë versioni që ofron bazën për analizën tuaj dhe finalizimin e koncept dokumentit.</p>

<p>Hapi 7</p>	<p>Përmirësoni përkufizimin tuaj të problemit gjatë punës në koncept dokumentin</p>	<p>Lexoni përkufizimin e problemit disa herë brenda muajit. Kur ju ta bëni këtë, jeni në gjendje të vëreni nëse ai duhet të ndryshohet pak. Kjo mund të jetë e nevojshme pasi që ju mund të zbuloni informata dhe njohuri të tjera për shkaqet e problemit dhe efektet e tij. Kjo gjithashtu ndihmon që analizën tuaj ta fokusoni në temat që me të vërtetë kanë rëndësi.</p> <p>Është e rëndësishme të theksohet: derisa jeni duke punuar në koncept dokumentin tuaj, ju mund të zbuloni se kur e keni filluar zhvillimin e përkufizimit të problemit nuk e keni pasur gjithë informacionin përkatës. Nga ana tjetër, kjo mund të nënkuptojë që duhet të ndryshoni në mënyrë të konsiderueshme përkufizimin e problemit. Ndonjëherë ndoshta duhet edhe ta zëvendësoni këtë.</p> <p>Është krejtësisht normale nëse kjo ndodh. Kjo është pjesë e përmirësimit të cilësisë së analizës. Për shembull, palët e interesuara mund të ofrojnë informacion që nuk ishte në dispozicion më përpara. Rëndësia e shkaqeve ose efekteve të veçanta mund të nënvlerësohet apo mbivlerësohet në fillim. Përshtatja ndaj informacionit dhe provave që keni është shtylla qendrore për zhvillimin e politikave dhe legjisllacionit.</p> <p>Kur shihni se përkufizimi i problemit duhet të përshtatet në mënyrë të konsiderueshme, filloni përsëri nga Hapi 4. Kur konsultoheni për përkufizimin e përmirësuar të problemit, shpjegoni qartë pse duhet të përditësohet. Pasi që ekziston një grup punues për koncept dokumentin, konsultimi për përkufizimin e problemit të përmirësuar mund të bëhet përmes këtij grupi.</p>
<p>Hapi 8</p>	<p>Finalizoni përkufizimin e problemit para se të dërgohet koncept dokumenti për miratim në Qeveri</p>	<p>Përderisa përkufizimi i problemit është fillimi i punës suaj në koncept dokument, ai gjithashtu është pika thelbësore për finalizimin e dokumentit. Kur koncept dokumenti konsiderohet se është gati për miratim nga ana e Qeverisë, ju duhet t'i bëni një kontroll përfundimtar përkufizimit të problemit. Kjo është e rëndësishme pasi që është baza e koncept dokumentit.</p>

MJETI 1: PEMA E PROBLEMIT

Identifikimi i problemeve aktuale, shkaqet e tyre dhe efektet që shkaktohen nga to është një proces që bëhet më lehtë kur është mirë i strukturuar. 'Pema e problemit' është një mjet që ndihmon paraqitjen e përkufizimit të problemit në mënyrë grafike, që tregon në mënyrë logjike dallimin ndërmjet problemeve, çështjet që i nxisin ato dhe efektet që ato shkaktojnë. Pema e problemit mund të përdoret nga fillimi dhe mund të jetë pjesë e koncept dokumentit.

Pema e problemit është e ndarë në tri pjesë: trungun, rrënjët dhe degët. Problemi kryesor është i shënuar në trung. Rrënjët paraqesin shkaqet e problemit dhe tregojnë pse ai ekziston. Degët tregojnë efektet e problemit.



Figura 7: Pema e problemit



Përfitimet nga pema e problemit janë të shumta. Para së gjithash, ajo ofron një prezantim të dobishëm të përkufizimit të problemit dhe ndihmon për ta bërë specifik përkufizimin e problemit. Është e lehtë për të kuptuar dhe lehtëson paraqitjen e problemit, shkaqet dhe efektet e tij. Si e tillë, pema e problemit është mjet i dobishëm për të diskutuar përkufizimin e problemit. Kjo, nga ana tjetër, ndihmon në zhvillimin e zgjidhjeve të mira për trajtimin e origjinës dhe efekteve negative të një problemi.

Nëpërmjet identifikimit të shkaqeve dhe efekteve, pema e problemit ndihmon në identifikimin e palëve të interesuara relevante: atyre që ndikohen negativisht nga problemi, atyre që shkaktojnë ose kontribuojnë në këtë problem dhe atyre që duhet të përfshihen në zgjidhjen e problemit.

Me ndarjen e problemit në shkaqe dhe efekte të ndryshme, pema e problemit tregon se çfarë lloj informacioni do të ishte i dobishëm për analizën e koncept dokumentit. Pema e problemit gjithashtu mund të ndihmojë me vendosjen e prioriteteve të punës që duhet bërë për koncept dokumentin. Disa nga shkaqet dhe efektet e problemit do të jenë më të rëndësishme se të tjerët. Analiza për koncept dokumentin mund të përqëndrohet në veçanti në këto.

Përderisa pema e problemit e bën më të lehtë paraqitjen e një problemi, është e rëndësishme të jemi të hapur në lidhje me të. Është shumë mirë të mbahet pema e problemit si një pikë referimi që mund të përmirësohet për sa kohë është duke u zhvilluar analiza për koncept dokumentin. Përcaktimi i problemit funksionon më së miri kur kjo është një proces i hapur që përfshin ekspertë nga organizatat relevante përmes konsultimeve të shënjestruara. Po ashtu është e mundur të organizohet një konsultim publik për një përkufizim të problemit për të marrë inpute nga palët e interesuara në një fazë shumë të hershme të procesit. Qasja e hapur dhe përfshirja e palëve të interesuara është e dobishme pasi që nuk është gjithmonë e mundur që të identifikohen të gjitha shkaqet dhe efektet që në fillim. Gjithashtu mund të ndodhë që problemi kryesor që është identifikuar në fillim ka nevojë që të përshtatet, sepse diskutimet dhe analizat tregojnë se nuk ishte më i miri. Ndryshimet e tilla tregojnë fuqinë e punës analitike. Konsultimi me palët e interesuara gjithashtu ndihmon në identifikimin e shkaqeve më të rëndësishme të një problemi dhe për këtë arsye në vendosjen e prioriteteve për analizë të koncept dokumentit dhe mënyrave për të trajtuar problemin.

MJETI 2: SKENARI I GJENDJES FILLESTARE


Pema e problemit ofron një pasqyrë të shkaqeve të një problemi dhe efektet e tij, siç janë në kohën kur është krijuar pema e problemit. Një paraqitje e tillë do të jetë e mjaftueshme për zhvillimin e një koncept dokumenti.

Megjithatë, kur problemi pritet të përkeqësohet në të ardhmen, ose kur shpenzimet e shkaktuara nga një problem janë shumë të larta në vit, zhvillimi i skenarit bazë mund të jetë shumë i dobishëm për arsyetimin e investimeve dhe shpenzimeve buxhetore.

Funksioni i skenarit të gjendjes fillestare është për të treguar se si një problem pritet të zhvillohet. Ky është një parashikim për të ardhmen nën supozimin se asgjë nuk do të bëhet për të trajtuar problemin dhe shkaqet e tij. Ky informacion mund të përdoret si justifikim që Qeveria të ndërmarrë veprime. Një skenar i gjendjes fillestare mund të jetë i dobishëm për të justifikuar shpenzimet e nevojshme dhe për të trajtuar një problem, për të treguar se vetëm ndërhyrja e qeverisë mund t'i largojë shkaqet, apo për të treguar se investimet e larta të drejtpërdrejta janë të arsyeshme me kalimin e kohës.



02



PJESA 02: PËRCAKTIMI/PËRSHKRIMI I QËLLIMEVE DHE OBJEKTIVAVE



Vendosja e qëllimeve dhe objektivave tregon se çfarë synon të arrijë qeveria në fusha të caktuara të politikave dhe si synon t'i arrij ato. Kjo pjesë ju ndihmon:

- Të identifikoni të gjitha dokumentet relevante të planifikimit afatmesëm të Qeverisë, që përcaktojnë qëllimet e përgjithshme të Qeverisë;
- Të identifikoni qëllimet e politikave dhe objektivat strategjike që lidhen me çështjen e politikës që trajtohet.

Përkufizimi i problemit e bën të qartë se cilat probleme, shkaqe dhe efekte duhet të adresohen. Pjesa që vijon pas përkufizimit të problemit në koncept dokument është pjesa mbi përcaktimin dhe përshkrimin e qëllimit të politikave, objektivin strategjik dhe objektivin/objektivat specifík/specifíke. Këto elemente tregojnë në detaje se çfarë synon qeveria të arrijë. Ato sigurojnë informacionin që nevojitet për të kuptuar arsyen e zhvillimit të një koncept dokumenti. Qëllimet dhe objektivat janë baza e masave që propozohen në të për ndryshimin e politikave ekzistuese ose futjen e të reja. Qëllimet dhe objektivat duhet të lidhen drejtpërdrejt me problemin e identifikuar. Ato duhet të japin përshkrimin e situatës së synuar të ardhshme në të cilën problemi zgjidhet në mënyrë efektive. Qëllimet dhe objektivat gjithashtu duhet të tregojnë rolin dhe pozitën e koncept dokumentit brenda prioriteteve të Qeverisë ose ministrisë, kur një koncept dokument pason drejtpërdrejt nga prioritetet e tilla.



Figura 8: Definimi i objektivave strategjike dhe specifíke

Objektivat strategjikë – janë qëllime afagjate që ndihmojnë në ndarjen e qëllimit të politikës nga një vizion më i gjerë në plane dhe projekte më specifíke. Ato përcaktojnë faktorët e suksesit dhe janë të disanjuara të jenë të matshme, specifíke dhe të japin një ndarje të vërtetë të deklaratës së misionit që mund të përdoret nga qeveria dhe menaxhmenti brenda administratës për të udhëhequr vendimmarrjen. Objektivat strategjikë zakonisht zhvillohen si pjesë e një plani afatgjatë dhe ato përcaktojnë pritjet specifíke që do të lejojnë një institucion të veçantë për të arritur misionin e tij më të gjerë ose për të përmbushur vizionin e tij.

Objektivat specifíké - Objektivat strategjikë mund të ndahen në pjesë më të vogla dhe specifíke që janë logjikisht të ndërlidhura. Këta janë objektivat specifíké. Ata janë më afatshkurtër se objektivat strategjikë dhe përqëndrohen në aktivitete konkrete. Objektivi strategjik arrihet duke përmbushur të gjitha objektivat specifíké.

Qeveria përcakton qëllimet e përgjithshme në një sërë dokumentesh të planifikimit të politikave, si Programi qeveritar, Strategjia kombëtare për zhvillim, Deklarata e prioriteteve afatmesme, Plani kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Agjenda e reformave evropiane, Programi i reformave ekonomike dhe strategjitë (sektoriale apo ndërsektoriale). Shumica e koncept dokumenteve pasojnë logjikisht nga qëllimet e politikave të nivelit të lartë.

Përveç këtyre dokumenteve, Qeveria shpeshherë shpjegon qëllimet e saj në më shumë detaje. Kjo bëhet në diskutime me Kuvendin, në intervistat me mediat dhe në shumë mënyra të tjera. Përveç kësaj, disa koncept dokumente mund të zhvillohen në bazë të kërkesave që bën Kuvendi ose e gjejnë origjinën e tyre diku tjetër. Një koncept dokument, për shembull, mund të jetë hapi logjik për të zbatuar gjetjet nga vlerësimi i zbatimit të një ligji të caktuar. Lidhja në mes të koncept dokumentit dhe qëllimeve të Qeverisë duhet të paraqitet në mënyrë të qartë.

Qëllimet dhe objektivat e paraqitura në koncept dokument duhet të vendosen në mënyrën S.M.A.R.T. Kjo vlen në veçanti për objektivat specifike të përcaktuar në koncept dokument.

Meqenëse objektivat e politikave shpeshherë përcaktohen përpara se të zhvillohet koncept dokumenti, ato nuk duhet të ndryshohen më. Ato mund të kopjohen nga dokumentet përkatëse të Qeverisë që i kanë paraprirë koncept dokumentit.

Ajo që vlen për qëllimet e politikave, gjithashtu vlen edhe për objektivat strategjike. Ato duhet të mbahen ashtu siç janë paraqitur më parë në dokumentet e qeverisë, përveç nëse ka nevojë të qartë për t'i rishikuar.


Objektivat specifike duhet të marrin vëmendjen e detajuar në një koncept dokument. Këta shpeshherë zhvillohen vetëm në koncept dokumente. Ata kanë të bëjnë me zgjidhjen e problemit dhe realizimin e qëllimeve të politikave dhe objektivave strategjike në realitet përmes masave konkrete të politikave, si ndryshimi i legjisllacionit ekzistues, ndryshimi i strukturës organizative të administratës etj.



Figura 9: Klasifikimi S.M.A.R.T. i qëllimeve të politikave, objektivave strategjike dhe objektivave specifike


Specifike	Qëllimet dhe objektivat duhet të jenë të sakta dhe konkrete. Ato duhet të jenë të qarta dhe të mos lënë hapësirë për interpretim.
Të matshme	Qëllimet dhe objektivat duhet të përshkruhen në bazë të synimeve shumë të qarta. Kjo do të thotë vendosjen e treguesve të qartë për ndryshimet që duhet të ndodhin. Kjo vlen në veçanti për objektivat specifike.
Të arritshme	Cilatdo qofshin qëllimet dhe objektivat, ato duhet të jenë të arritshme. Nuk ka vlerë të shtuar nëse planifikohet shumë dhe pastaj nuk mund të realizohen premtimet. Qëllimet dhe objektivat duhet të vendosen sa më realisht. Kjo do të thotë se ato duhet të bazohen në burimet njerëzore dhe buxhetore në dispozicion.
Relevante	Qëllimet dhe objektivat duhet të lidhen drejtpërdrejt me përcaktimin e problemit. Qëllimi është që ose të mënjanohet problemi duke eliminuar shkaqet e tij ose të mënjanohen efektet që shkakton problemi.
Afatet	Qëllimet dhe objektivat duhet të zbatohen brenda një kohe të arsyeshme. Kjo do të thotë se ato janë të arritshme. Afatet gjithashtu duhet të vendosen në mënyrë të tillë që të mund të vlerësohen rezultatet e arritura.

Në koncept dokument, qëllimi dhe objektivat duhet të shpjegohen në detaje. Mënyra më e lehtë për ta bërë këtë është paraqitja e tyre në një tabelë, si ajo e paraqitur në figurën më poshtë. Figura tregon objektivat e politikave, objektivat strategjike dhe objektivat specifike që janë formuluar, si dhe dokumentin nga i cili ato e kanë origjinën. Paraqitja e qëllimit dhe objektivave ka për qëllim të tregojë logjikën dhe arsyetimin prapa zhvillimit të një koncept dokumenti. Nëse koncept dokumenti nuk pason nga një dokument strategjik, pasqyra e mëposhtme mund të adresojë vetëm objektivat specifike.

 Figura 10: Formati i tabelës për paraqitjen e origjinës së qëllimeve të politikave, objektivave strategjike, si dhe objektivave specifike

Lloji i objektivit	Origjina
Qëllimi i politikave (i përcaktuar në dokumentet strategjike/politikave dhe duhet të mbahet i njëjtë)	<ul style="list-style-type: none"> » Programi qeveritar » Strategjia kombëtare për zhvillim » Deklarata e prioriteteve afatmesme » Plani kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit » Agjenda e reformave evropiane » Programi i Reformave Ekonomike » Strategjitë (sektoriale ose ndër-sektoriale) » Programi i Kosovës për barazi gjinore » Dhe dokumente të ngjashme të nivelit të lartë të Kuvendit dhe Qeverisë
Objektivi strategjik (i përcaktuar në strategji dhe i detajuar në planet e veprimit; duhet të mbetet i njëjtë përveç nëse nuk ka ndonjë arsye të qartë për ta përmirësuar atë)	<ul style="list-style-type: none"> » Udhërrëfyeni për sStrategjinë kombëtare për zhvillim » Aktivitetet që lidhen me masat prioritare të paraqitura në Programin e reformave ekonomike » Objektivat e përcaktuar në strategjitë (sektoriale ose ndër-sektoriale)
Objektivat specifike (këta objektiva duhet të vendosen në koncept dokument bazuar në përkufizimin e problemit; objektivat specifike, për shembull, adresojnë shkaqet dhe efektet e problemit)	<ul style="list-style-type: none"> » Objektivat specifike synojnë ose mënjanimin e një ose më shumë shkaqeve të problemit, në adresimin e efekteve që sjell problemi ose kombinimin e të dyjave. » Objektivat specifike lidhen drejtpërdrejt me çështjet që Qeveria synon t'i zgjidhë. » Objektivat specifike tregojnë përmirësimet e pritura që Qeveria dëshiron t'i arrijë.

03



PJESA 03: PËRCAKTIMI I OPSIONEVE

Opsionet janë mundësitë për të trajtuar problemin në mënyrë efektive në kuadër dhe përtej kuadrit ligjor dhe rregullator ekzistues. Kjo pjesë ju ndihmon:

- Të identifikoni mangësitë që rrjedhin nga përkufizimi i problemit;
- Të shqyrtoni opsionet e mundshme që mund të zbatohen për mangësitë dhe situatat konkrete;
- Të analizoni të paktën tri opsione që mund të shërbejnë për të trajtuar problemin kryesor të politikave:
 - 1 “Opsionin pa ndryshime”, për të treguar situatën aktuale të së politikës dhe vazhdimin e saj nëse nuk bëhen ndryshimet,
 - 2 Opsionin për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit të politikave dhe legjislacionit ekzistues,
 - 3 Opsioni që është një alternativë e duhur dhe i cili, kur është relevante, shqyrton mjete tjera përveç atyre legjislative, për të trajtuar problemin e identifikuar.

Përkufizimi i problemit shfaq çështjet të cilat mund të adresohen. Qëllimi i politikave dhe objektivat strategjikë shfaqin synimet që synon të arrijë Qeveria. Ato tregojnë vendin e koncept dokumentit brenda kornizës së përgjithshme të politikave. Objektivat specifike, veçanërisht, shfaqin synimet konkrete që duhet arritur.

Kjo pjesë e opsioneve radhit mundësitë ekzistuese për arritjen e objektivave specifike. Këto opsione janë aktivitetet dhe rezultatet që duhet të zhvillohen në mënyrë që të rregullohet problemi duke eliminuar shkaqet, duke adresuar efektet e tij, ose kombinimin e të dyjave.

Lloji i problemit, shkaqet dhe efektet e tij rregullisht ofrojnë një kornizë të opsioneve që mund të përdoren për adresimin e problemit në mënyrë efektive. Analiza e opsioneve është e dobishme pasi ndihmon për të menduar për opsionet e mundshme që nuk do të shpiejnë në legjislacion shtesë apo ndryshime në kornizën rregullative ekzistuese. Gjithashtu, lejon krahasimin në mes opsioneve për të përdorur legjislacionin dhe mundësitë e tjera jorregullative për adresimin në mënyrë efektive të një problemi.

Ndonjëherë, numri i opsioneve për zgjidhjen e problemit mund të duket shumë i kufizuar. Për shembull, kur problemi shkaktohet nga një mangësi ligjore apo rregullative, ndryshimi i ligjit mund të jetë opsioni më i dobishëm. Megjithatë, vendimet e tilla duhet të merren me kujdes. Edhe kur shtegu duket të jetë i qartë, prapëseprapë opsione të tjera mund të japin rezultate më të mira.

Se cilat opsione duhet të analizohen varet nga natyra e problemit, qëllimi dhe objektivat. Disa tabela në këtë pjesë paraqesin shembujt e opsioneve që mund të jenë relevante për zhvillimin e politikave dhe, rrjedhimisht, edhe për koncept dokumentin. Shumica e koncept dokumenteve do t'i shfrytëzojnë këto opsione ose kombinime të tyre. Megjithatë, lista nuk është e plotë dhe ende mund të merren parasysh opsione të tjera, sidomos për çështje komplekse shoqërore.

TRI OPSIONE DO TË ANALIZOHEN

Të paktën tri opsione duhet të analizohen në secilin koncept dokument.

Opsioni i parë është opsioni status-quo që quhet ndryshe 'opsioni pa ndryshime'. Ky opsion shpesh mund të zhvillohet në bazë të përmbledhjes së përkufizimit të problemit. Ky opsion shërben si opsion krahasues për opsionet e tjera. Ai përshkruan se si do të dukej gjendja në qoftë se nuk bëhen ndryshime. Mjeti 2: Gjendja fillestare tregon se si mund të paraqitet opsioni pa ndryshime.

Së dyti, kur koncept dokumenti adreson probleme me rregullat ekzistuese, duhet të vlerësohet opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit të këtyre rregullave. Analiza e këtij opsioni shërben për disa qëllime dhe është e dobishme përtej vetë opsionit. Njohuria mbi mënyrën se si zbatohen rregullat ekzistuese ndihmon në përcaktimin e zgjidhjeve të mundshme të një problemi meqë tregon shumë qartë se ku shtrihen përgjegjësitë. Kur opsioni për të përmirësuar zbatimin dhe ekzekutimin e rregullave ekzistuese nuk shton vlerë të mjaftueshme për krahasimin e opsioneve në koncept dokument, ai mund të zëvendësohet nga një opsion më i zbatueshëm. Kjo zgjedhje duhet të shpjegohet në koncept dokument.

Opsioni i tretë do të varet nga natyra e temës që analizohet në koncept dokument. Kjo varet nga mangësitë aktuale dhe duhet të jetë një alternativë e duhur për opsionet e tjera të analizuar. Opsioni i tretë duhet të shqyrtojë mundësitë për adresimin e problemit pa përdorur legjislacionin. Opsione të tilla janë shpesh në dispozicion dhe mund të implementohen relativisht shpejt pasi që nuk ka nevojë për ndryshime ligjore.

Të dy figurat në vijim paraqesin një pasqyrë të mangësive ligjore dhe rregullative dhe të mangësive të tregut. Ky informacion është i lidhur me opsionet e mundshme për adresimin e këtyre mangësive. Përmbledhja ka për qëllim të udhëzojë për identifikimin e opsioneve. Kjo nuk është një listë shteruese. Një figurë e tretë shkurtimisht prek çështjet shoqërore. Megjithatë, pasi që çështjet e tilla janë shumë komplekse, nuk ofrohet një pasqyrë specifike e opsioneve.


 Figura 11: Mangësitë ligjore dhe rregullative dhe opsionet e mundshme për trajtimin e tyre

Lloji i mangësisë ligjore dhe rregullative	Opsionet, të cilat mund të merren parasysh	Shpjegimi dhe lidhja me shkaqet e problemit
Rregullat nuk zbatohen siç duhet	Përmirësimi i zbatimit të rregullave ekzistuese	<p>Ky opsion duhet të analizohet në çdo koncept dokument që mbulon mangësitë në rregullat ekzistuese. Analiza e zbatimit aktual të këtyre rregullave ofron informata esenciale mbi atë se si duhet trajtuar problemin, i cili ka bllokuar zbatimin e duhur.</p> <p>Analiza duhet të shpjegojë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Çfarë rregullohet me ligj/akt nënligjor; 2. Cilat janë detyrimet që rrjedhin nga ligji/akti nënligjor; 3. cilat institucione janë të përfshira në zbatimin e ligjit/aktit nënligjor; 4. nëse detyrat e tyre janë përcaktuar siç duhet; 5. nëse janë në gjendje t'i kryejnë detyrat siç duhet. <p>Për shembull, zbatimi i rregullave mund të shfaqë mangësi sepse institucionet të cilat duhet t'i zbatojnë ato nuk i dinë ose nuk i kuptojnë obligimet e tyre. Kjo mund të vlejë për institucionet qeveritare, nga njëra anë, dhe palët e interesuara (komunitetin e biznesit, shoqërinë civile dhe/ose qytetarët), nga ana tjetër. Opsioni për zgjidhjen e këtij lloji të problemit është që të sigurohemi se të gjithë e kuptojnë në mënyrë të duhur se çfarë pune pritet të bëhet nga ta. Një opsion për zgjidhjen e një mangësie të tillë është fushata informuese.</p>
	Shfuqizimi i rregullave	<p>Kur rregullat janë aq komplekse ose të kushtueshme saqë nuk mund të zbatohen, ato mund të shfuqizohen. Kjo heq obligimin që administrata t'i zbatojë ato, pastron kornizën rregullative dhe siguron që Qeveria të mos mbahet më tutje ligjërisht përgjegjëse për rregulla që ajo nuk mund t'i zbatojë në radhë të parë. Gjithashtu, kjo e bën kornizën ligjore më të qartë për qytetarët dhe kompanitë.</p> <p>Në vend të shfuqizimit të rregullave alternativë do të ishte shtyrja zyrtare e zbatimit të tyre ose zbatimi i dispozitave të caktuara rregullative.</p>

	Rezervimi i buxhetit të mjaftueshëm për zbatimin	Mungesa e zbatimit të duhur të rregullave mund të jetë rezultat i mungesës së burimeve të nevojshme për institucionin/et që janë përgjegjës/e për zbatim. Në raste të tilla, rezervimi i një buxheti të nevojshëm është një opsion për zgjidhjen e problemit.
Rregullat janë kontradiktore	Zgjidhni kontradiktat dhe përshtatni gjithë legjislacionin relevant	<p>Rregullat e vendosura në ligje të ndryshme ose akte nënligjore mund të jenë në kundërshtim me njëra-tjetrën dhe mund të ketë edhe dispozita kontradiktore brenda të njëjtit akt ligjor. Këto kontradikta shkaktojnë konfuzion dhe pasiguri ligjore. Prandaj, ato duhet të adresohen dhe të harmonizohen siç duhet. Përkufizimet që përdoren në legjislacion dhe kërkesat që legjislacioni përcakton duhet të përkufizohen siç duhet.</p> <p>Adresimi i kësaj çështjeje do të thotë që duhet shpjeguar saktë se cilat janë kontradiktat e ndryshme, cilat ligje dhe akte nënligjore ndikohen dhe se çfarë problemesh shkaktohen nga kjo kontradiktë.</p> <p>Një shpjegim i qartë duhet të përcaktojë se si do të trajtohen kontradiktat e ndryshme, çfarë ndryshimesh duhet bërë, për cilat ligje dhe akte nënligjore dhe kush është përgjegjës për zbatimin e legjislacionit të përmirësuar.</p>

<p>Rregullat janë jo të plota</p>	<p>Ndryshimi i ligjit apo aktit nënligjor ekzistues</p>	<p>Kur shkaku i problemit është mangësia në kornizën aktuale rregullative, rregullat ekzistuese duhet përditësuar.</p> <p>Rregullat mund të jenë jo të plota në tri mënyra kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ato lejojnë aktivitete që nuk duhet të lejohen, 2. Ato nuk lejojnë aktivitete që duhet lejuar, 3. Ato kanë vendosur kërkesa, por nuk mbulojnë të gjitha çështjet relevante. <p>Ka pesë aspekte që duhet të përmbushen kur analizohet ky opsion:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Problemi në mënyrë të qartë duhet të tregojë se rregullat jo të plota janë me të vërtetë shkaku i problemit, 2. Këto mangësi duhet të shpjegohen në mënyrë të qartë, 3. Koncepti dokumenti duhet të tregojë se opsionet e tjera jorregullative nuk do të jenë të suksesshme, 4. Duhet analizuar shpenzimet buxhetore për zbatimin e ligjit të ndryshuar (shih Mjetin 11: Kostimi për koncept dokumente), 5. Duhet të përcaktohen kostot e zbatimit për komunitetin
	<p>Hartimi i një ligji ose akti nënligjor të ri</p>	<p>Kur mangësitë në kornizën aktuale rregullative janë shkaku i problemit, hartimi i një ligji të ri mund të jetë një alternativë për të zgjidhur problemin. Megjithatë, ky është një opsion që duhet të trajtohet me kujdes.</p> <p>Ka gjashtë aspekte që duhet të përmbushen gjatë analizës së këtij opsioni. Në radhë të parë, problemi duhet të tregojë në mënyrë të qartë se mungesa e ligjeve apo akteve nënligjore është me të vërtetë shkaku i problemit. Së dyti, mangësia duhet të shpjegohet në mënyrë të qartë. Së treti, analiza duhet të tregojë se problemi nuk mund të zgjidhet me përshtatjen e kornizës ligjore ekzistuese. Së katërti, koncepti dokumenti duhet të tregojë se opsionet e tjera jorregullative nuk do të jenë të suksesshme. Së pesti, duhet analizuar kostot buxhetore për zbatimin e rregullave të reja (shih Mjetin 11: Kostimi për koncept dokumentet). Së gjashti, duhet të përcaktohen kostot e zbatimit për komunitetin e biznesit (shih Mjetin 16: Modeli i kostimit standard).</p>

<p>Vendosja e rregullave dhe standardeve vullnetare (vetë-rregullimi)</p>	<p>Kur rregullat janë jo të plota, legjislatiioni nuk është e thënë të jetë mënyra më e mirë për trajtimin e problemit. Një opsion tjetër alternativ është diskutimi me palët e interesuara që shkaktojnë problemin për të parë nëse ata janë të gatshëm të vendosin standarde dhe procedura vullnetare për t'i zgjidhur shkaqet e problemit.</p> <p>Ky opsion mund të funksionojë, kur homologu është i besueshëm dhe ka interes në zgjidhjen e problemit. Ky mund të jetë një interes financiar, një interes i ndërlidhur me imazhin e një sektori apo ndonjë interes tjetër. Grupi, i cili duhet të punojë me rregullat e vetimponuara, duhet të jetë i vogël. Kjo bën të mundur që të kontrollohet nëse rregullat ndiqen në të vërtetë.</p> <p>Rregullat dhe standardet vullnetare mund të dakordohen duke vënë kushte. Për shembull, kur problemi nuk zgjidhet ose kur rregullat e vetimponuara nuk zbatohen siç duhet, legjislatiioni mund të zhvillohet në të ardhmen.</p> <p>Përfitimi i rëndësishëm i vetërregullimit është se pronësia mbetet tek ata që kanë i hartuar rregullat. Administrata mund të kufizojë rolin e saj për të kontrolluar nëse rregullat funksionojnë në praktikë. Administrata mund të drejtojë përmbajtjen e vetërregullimit përmes dokumenteve që nuk janë ligjërish të detyrueshme, siç janë shënimet udhëzuese dhe propozimet mbi atë që duhet të arrihet me anë të vetërregullimit.</p>
<p>Zhvillimi i bashkërregullimit</p>	<p>Bashkërregullimi është një kombinim mes legjislatiionit dhe vetërregullimit. Rregullat janë të përcaktuara në legjislatiion dhe akte nënligjore, por zbatimi bëhet nga sektori i industrisë që është i rregulluar.</p> <p>Ky opsion është më i fortë se vetërregullimi. Nëse rregullat nuk zbatohen, zbatueshmëria e detyrueshme mund të bëhet me ligj. Por, meqë zbatueshmëria i është lënë vetë industrisë, pronësia ende qëndron tek ata që duhet t'i përdorin rregullat.</p> <p>Ashtu si me vetërregullimin, numri i palëve të interesuara që duhet zbatuar rregullat duhet të jetë i vogël. Kjo e bën të mundur kontrollin nëse rregullat zbatohen në të vërtetë.</p>

<p>Rregullat që rregullojnë institucionet shtetërore janë të vjetruara</p>	<p>Ndryshimi dhe plotësimi i bazës ligjore të institucioneve për të mundësuar funksionimin më të mirë të tyre</p>	<p>Është e mundur që baza ligjore e një institucioni nuk lejon ushtrimin e disa përgjegjësive që duhet ushtruar, e detyron institucionin qeveritar të zbatojë rregullat në mënyrë joefikase ose jep mandat të paqartë të institucionit.</p> <p>Në këto raste, korniza ligjore ekzistuese duhet të përditësohet në mënyrë që institucioni të ekzekutojë detyrat e veta në mënyrë efektive dhe efikase.</p>
	<p>Krijimi i institucioneve të reja</p>	<p>Për zbatimin e legjislacionit (p.sh. direktivat e BE-së) ose zbatimin e një prioriteti politik, ndoshta do të duhet të krijohen institucione të reja. Kjo duhet të shpjegohet mirë dhe institucioni duhet të projektohet në përputhje me detyrat që pritet t'i përmbushë.</p> <p>Një aspekt i rëndësishëm për t'u marrë parasysh është nëse institucioni duhet të jetë i natyrës së përhershme ose nëse ekzistenca e tij duhet të kufizohet në kohë. Preferohet opsioni i fundit pasi që vendos pritje të qarta për arritjet e një institucioni.</p>
	<p>Sigurimi i buxhetit të mjaftueshëm për ekzekutimin e detyrave</p>	<p>Institucionet mund të kenë vështirësi në funksionimin si duhet, sepse detyrat që ato pritet t'i kryejnë kërkojnë më shumë burime njerëzore dhe buxhetore se sa janë në dispozicion. Në situata të tilla, mospërputhja në mes të detyrave të kryera dhe detyrave që duhet të kryhen duhet të jetë i madh. Opsioni duhet të vlerësojë nëse problemi është mungesa e stafit dhe buxhetit, apo ndarja e gabuar e burimeve ekzistuese. Institucionet mund të jenë të paefektshme për shkak të menaxhimit të keq ose aranzhimeve të punës që janë komplekse pa nevojë.</p>
	<p>Shfuqizimi i institucioneve të panevojshme</p>	<p>Një institucion, i cili nuk është më i nevojshëm, duhet të shfuqizohet. Natyrisht, ndikimet për stafin, siç janë respektimi i kontratave të tyre të punës, etj. duhet të merren në konsideratë dhe të trajtohen si duhet.</p>

	Bashkimi i institucioneve në një të vetëm	<p>Institucionet mund të jenë të paefektshme ose të bëhen të tilla me kalimin e kohës. Këto paefektshmëri nuk thonë asgjë për dobinë e detyrave që janë kryer. Ato mund të jenë ende të nevojshme dhe të vlerësuara. Megjithatë, paefektshmëritë kërkojnë burime buxhetore, të cilat mund të shpenzohen në mënyrë më efikase. Raporti ndërmjet stafit që punon në detyrat aktuale në institucion dhe numrit të njerëzve të përfshirë për të siguruar që një institucion ekziston, mund të jetë tregues i mirë për paefektshmëritë. Kur institucionet bashkohen (për shembull, për shkak se kryejnë detyra, të cilat janë të ngjashme ose ka dyfishim në veprimtari), ato mund të kombinojnë detyrat, siç janë menaxhimi i burimeve njerëzore dhe administrimi financiar. Ato mund të ndajnë dhe t'i përdorin më mirë zyrat, veturat dhe gjërat e tjera. Institucionet më të mëdha mund të kenë pozitë më të mirë në negocimin e çmimeve më të ulëta për mallra dhe shërbime.</p>
Rregullat krijojnë ngarkesa të panevojshme	Modifikimi i rregullave ekzistuese në mënyrë që të zvogëlohet ngarkesa	<p>Kërkesat që kompanitë të aplikojnë për licenca dhe leje, të deklarojnë taksat e tyre dhe për shkëmbime të tjera të informatave tek administrata mund të krijojnë kosto të panevojshme. Në rast se rregullat hartohen në mënyrë jo të mirë, ato krijojnë kosto të panevojshme. Me kalimin e kohës, duhet të zhvillohen teknologji dhe njohuri të reja. Ato duhet të aplikohen për zbatimin e rregullave në mënyrë që të sigurohet se janë lehtë të zbatueshme. Përfitimet nga krijimi i rregullave më efikase mund të vlerësohen me zbatimin e Mjetit 16: Modeli i kostimit standard.</p> <p>Pas kërkesave për informata, legjislati përcakton kërkesat për mënyrën se si kompanitë duhet të kryejnë aktivitetet e tyre afariste. Këto investime mund të jenë të lidhura me zvogëlimin e emetimeve të ndotësve, investimet në teknologji, ndryshimet në proceset e prodhimit dhe aktivitete të tjera aktuale, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në proceset e punës së kompanive. Këto kosto mund të arsyetohen kur japin përfitime shumë herë më të mëdha se kostot. Megjithatë, edhe kostot për përputhje me legjislatin duhet të mbahen sa më të ulëta që është e mundur.</p>

	Bashkimi i ligjeve dhe akteve nënligjore ekzistuese dhe detyrimeve që ato përcaktojnë	Nëse shikohen në mënyrë individuale, shumë pjesë të legjislacionit mund të duket që janë të dobishme dhe të përshtatshme. Megjithatë, kur merret parasysh efekti i këtyre pjesëve të legjislacionit në shoqëri, ato mund të shkaktojnë ngarkesa të panevojshme. Për shembull, pesë institucione qeveritare mund të kërkojnë leje për aktivitete të caktuara të biznesit, të cilat janë të arsyetueshme. Megjithatë, kur duhet që të gjitha këto kërkesa të përmbushen nga kompanitë individuale, bashkimi i lejeve do të rrisë efikasitetin, zvogëlojë kostot dhe potencialisht të kursejë burimet buxhetore.
	Shfuqizimi i rregullave	Rregullat duhet të kenë vlerë të shtuar. Kur kostot e rregullave të shoqërisë (kostot e buxhetit, kostot që kompanitë dhe qytetarët duhet të zbatojnë) janë më të larta se sa përfitimet dhe kur përmirësimi i tyre nuk ofron vlerë të shtuar, atëherë rregullat duhet të shfuqizohen.
Rregullat nuk janë më të nevojshme	Shfuqizimi i rregullave	Në rast të vlerësimit të përgjithshëm se rregullat nuk janë të nevojshme më, ato shfuqizohen.



Figura 12: Mangësitë e tregut dhe opsionet e mundshme për trajtimin e tyre

Lloji i mangësive të tregut	Opsionet, të cilat mund të merren parasysh	Shpjegimi
Çmimet nuk pasqyrojnë kostot reale për shoqërinë	Vendosja e kërkesave, të cilat ndryshojnë çmimin e mallit ose shërbimit	<p>'Stimujt ekonomik' është fraza gjithëpërfshirëse e një game të gjerë mundësish, të cilat mund të përdoren për të ndikuar në funksionimin e ekonomisë. Në vend se të ndryshohen në tërësi pjesët e legjislacionit, ndryshimet e tilla mund të jenë të vogla dhe të mbulojnë vetëm një ose pak nene.</p> <p>Ngarkesa me tatime, siç është TVSH-ja, ndryshon koston e produkteve dhe shërbimeve të caktuara. Atëherë kur kostot rriten, shitjet ka mundësi që të bien. Kjo gjë ndodh për arsye se pak njerëz janë në gjendje të përballojnë mallrat dhe shërbimet që kanë kosto më të lartë.</p> <p>Gjobat për sjellje të padëshiruar, siç është hedhja e mbeturinave në vendet publike, e bëjnë edhe më të shtrenjtë atë lloj të sjelljes. Por, kur mundësitë për t'u zënë gjatë kryerjes së sjelljeve të tilla janë shumë të mëdha, njerëzit nuk do të veprojnë më në atë mënyrë.</p>
	Kufizimi i përdorimit të mallrave	Mallra të caktuara, siç janë kimikatet, mund të jenë shumë të dëmshme. Megjithatë, me pajisjet e duhura për aplikimin e tyre (siç janë veshjet mbrojtëse) dhe me njohuritë se si të përdoren ato në mënyrë të sigurt, dëmi nga to mund të ulet. Shfrytëzimi i mallrave të tilla mund të kufizohet duke kërkuar nga kompanitë të aplikojnë ato mallra në kushte të veçanta dhe duke siguruar që këto mallra nuk shiten te konsumatorët, të cilët nuk i kanë pajisjet ose trajnimin e duhur.
	Ndalimi i mallrave, të cilat shkaktojnë dëm të tepërt	Mallrat mund të shkaktojnë dëme të mëdha, saqë nuk duhet të shiten fare, sidomos kur ka alternativa të tjera të mira që mund t'i zëvendësojnë ato. Duhet të analizohen efektet e këtyre ndalimeve.

Mungesat e mallrave dhe shërbimeve publike	Përcaktimi i nevojës reale dhe kostos buxhetore për ofrimin e këtyre mallrave ose shërbimeve	Kur është e qartë se tregu nuk ofron një mall të caktuar dhe përkufizimi i problemit tregon se kjo gjë ka shumë efekte negative, shteti e ka mundësinë që të mbulojë kostot për ofrimin e mallrave dhe shërbimeve publike. Për këtë opsion, kostot duhet të caktohen kundrejt përfitimeve të ofrimit të mallrave dhe shërbimeve publike.
Mungesa e stimuljeve të tregut	Stimujt pozitiv ekonomik	<p>Ulja e tatimeve, siç është TVSH-ja, ndryshojnë kostot e produkteve dhe shërbimeve të caktuara. Atëherë kur kostot ulen, shitjet ka gjasa që të rriten. Kjo ndodh për arsye se shumica e njerëzve janë në gjendje të përballojnë mallra dhe shërbime që kanë kosto më të ulëta.</p> <p>Subvencionet ua lehtësojnë kompanive dhe qytetarëve që të shfrytëzojnë mundësitë, pa i obliguar të gjithë që t'u përmbahen rregullave të caktuara.</p> <p>Ndryshimi i kodit tatimor, siç është ulja/zbritja e kostove që kanë të bëjnë me investime, mund t'i bindin kompanitë të investojnë në fabrika, etj. Në nivel personal, kur lejohet zbritja e kostos për arsimim personal, individët mund të binden të mësojnë aftësi të reja dhe të zgjerojnë njohuritë e tyre.</p>
	Kushtet për shpenzimet e Qeverisë	Një pjesë të madhe të taksave që i merr nga shoqëria, Qeveria i investon në ta. Ky lloj i shpenzimit mund të lidhet me kushte të veçanta. Për shembull, procedurat e prokurimit për mallra të caktuara mund të përmbajnë kushte që përcaktojnë se produktet duhet të jenë në përputhje me standardet specifike mjedisore dhe shumë më tepër. Për shembull, blerja e naftës mund të lidhet me kërkesën që një përqindje e caktuar duhet të jetë bio-naftë.
Mungesa e konkurrencës si mangësi e tregut	Vendosja e rregullave të qarta për firmat dominuese për të mbrojtur konsumatorët	<p>Sigurimi i mallrave dhe shërbimeve të caktuara mund të jetë aq i kushtueshëm sa që mund edhe të mos ketë konkurrencë fare. Shembull i mirë për këtë është furnizimi me ujë. Nuk është e arsyeshme të vendosen dy ose më shumë lidhje të ujit për një shtëpi.</p> <p>Kur krijohet monopoli i natyrshëm ose kur vetëm disa kompani e dominojnë tregun, duhet të rregullohet mënyra se si ato kompani e vendosin çmimin. Për shembull, mund të vendoset një tavan për rritjen e çmimit, në mënyrë që të shmangen ndryshimet e tepërta në çmime.</p>

Mungesa e konkurrencës si mangësi ligjore ose rregullative	Rregullimi i kornizës rregullative	Legjislacioni mund të vendosë kufizime të panevojshme mbi konkurrencën. Për shembull, kjo gjë ndodh kur ka kërkesa certifikimi ose arsimimi për profesione të caktuara. Këto mund të konsiderohen si kërkesa të panevojshme. Një kirurg i zemrës duhet të përballet me kërkesat e vështira profesionale për shkak të përgjegjësisë së pozitës së tij. Profesione të tjera, për shembull kuzhinierët ose ciceronët, kanë nivele të ndryshme të rrezikut. Ato duhet të rregullohen në përputhje me rreziqet që lidhen me profesionin.
Nivelet e pabarabarta të informatave	Informimi dhe edukimi	<p>Mungesa e informatave mund të jetë arsye e rëndësishme pse rregullat nuk funksionojnë fare ose nuk funksionojnë siç duhet.</p> <p>Përmirësimi i njohurive që njerëzit posedojnë dhe sigurimi që ata kanë qasje në të gjitha informatat relevante mund të jetë mënyrë e thjeshtë për trajtimin e problemeve që shkaktohen nga fakti se njerëzit nuk i kërkojnë të drejtat .</p> <p>Fushatat informative dhe edukative mund të jenë të rëndësishme kur zbatohen politikat dhe legjislacioni i ri.</p>




Figura 13: Çështjet shoqërore dhe opsionet e mundshme për trajtimin e tyre

Pjesa e përkufizimit të problemit në fillim të këtij Doracaku tashmë ka theksuar se çështjet shoqërore shpeshherë kanë një numër të madh shkaqesh. Këto mund të jenë kombinim i mangësive ligjore ose rregullative, të tregut dhe të tjera. Marrë parasysh ndërlikueshmërinë e çështjeve shoqërore, nuk janë identifikuar shkaqet e problemit. Si rezultat i kësaj, nuk është formuluar asnjë zgjidhje specifike sa u përket shkaqeve të tilla.

Identifikimi i zgjidhjeve për problemet shoqërore duhet të jetë një proces i kujdesshëm, në rastin më të mirë. Problemi ka gjasa të jetë shumë i madh. Zhvillimi i një zgjidhjeje të problemeve duhet gjithashtu të bëhet në mënyrë të kujdesshme. Kjo nënkupton zhvillimin e një përmbledhjeje të duhur dhe të detajuar të problemit, shkaqeve dhe efekteve të tij. Kjo gjë do të shmangë vështirësitë e mundshme dhe problemet e reja që lindin më vonë.

04



PJESA 04: IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I NDIKIMEVE TË ARDHSHME

Zbatimi i opsioneve të identifikuara çon në lloje të ndryshme ndikimesh në shoqëri. Kjo pjesë ju ndihmon:

- Të analizoni pesë kategori të ndikimeve potenciale: ndikimet ekonomike, ndikimet sociale, ndikimet mjedisore, ndikimet ndërsektoriale dhe ndikimet buxhetore;
- Të identifikoni çështjet që duhet të analizohen brenda këtyre kategorive të ndikimeve;
- Të përcaktoni rëndësinë e ndikimeve dhe thellësinë e analizës;
- Të përcaktoni procesin e grumbullimit të të dhënave;
- Të përshtatni analizën për një Koncept Dokument, në rast se ai trajton zbatimin e legjislacionit të BE-së;
- Të përdorni parimin e analizës proporcionale, për të përcaktuar thellësinë e analizës së ndikimeve;
- Të vendosni standardet e duhura dhe mundësitë për zbatimin e tyre;
- Të zhvilloni planin e zbatimit, duke përfshirë logjikën e produktit-aktivitetit për zgjidhjet e mundshme që trajtojnë problemin e politikës;
- Të përcaktoni shpenzimet për zbatimin e opsioneve duke u bazuar në planin e zbatimit;
- Të zbatoni rregullat e Ministrisë së Financave, kur vlerësimi i shpenzimeve tregon se tavanin e buxhetit të një ministrie është tejkaluar.

Kur është e qartë se çfarë mund të bëhet për zgjidhjen e një problemi, siç përcaktohet nga objektivat specifike, analiza për koncept dokumentin hyn në detaje për t'i analizuar opsionet e ndryshme të asaj që pritet të ndodhë në të ardhmen. Opsionet e ndryshme kërkojnë buxhet dhe burime njerëzore të ndryshme. Në fund, aktivitetet dhe rezultatet e nevojshme për t'i zbatuar këto opsione do të jenë të ndryshme.

Kjo pjesë shërben për identifikimin e ndikimeve të mundshme dhe tregon se si duhet të analizohen ato.



Figura 14: Efektiviteti, efikasiteti dhe ndikimet e pritshme

Efektiviteti ka të bëjë me arritjen e qëllimeve. Një masë është efektive kur qëllimi arrihet plotësisht.

Efikasiteti ka të bëjë me mënyrën në të cilën arrihen këto qëllime. Ai ka të bëjë me arritjen e qëllimeve pa humbje të buxhetit dhe burimeve njerëzore (pasi këto janë të kufizuara).

Ndikimet e pritshme janë ndryshimet pozitive dhe kostot e ndërlidhura që do të ndodhin nëse Qeveria vendos ta kthejë një opsion në hapa konkretë për zbatimin e tij.

Kur kombinohen efektiviteti, efikasiteti dhe ndikimet e pritshme, është e mundur të vendoset nëse një qëllim mund të arrihet me buxhet dhe burime njerëzore të arsyeshme, me ndikime të mjaftueshme pozitive dhe ndikime të pranueshme negative.

Për analizën e një koncept dokumenti nuk është e mjaftueshme të deklarohet se shkaqet e problemit do të largohen dhe se problemi rrjedhimisht do të zgjidhet. Veprimet e Qeverisë duhet të vendosen në një kontekst të gjerë që merr parasysh të gjitha efektet e mundshme që veprimet e Qeverisë mund të kenë. Kjo nënkupton analizën e pesë kategorive të ndikimeve potenciale në vijim:

- 1 ndikimet ekonomike: për shembull ndikimet mbi bizneset, punonjësit, rritjen ekonomike, investimet e huaja direkte (IHD);
- 2 ndikimet shoqërore: për shembull ndikimet mbi arsimin, pozitën shoqërore të nëngrupeve brenda shoqërisë, pensionet, etj.;
- 3 ndikimet mjedisore: ndikimet mbi cilësinë e ajrit, ndotjen, nivelet e mbeturinave, cilësinë e ujit etj.;
- 4 ndikimet ndërsektorale: ndikimet mbi barazinë gjinore, të drejtat e qytetarëve etj.; dhe
- 5 ndikimet buxhetore: ndikimet mbi të ardhurat dhe shpenzimet e Republikës së Kosovës.

Kategoritë e ndikimeve janë shumë të gjera. Ndikimet reale në këto kategori mund të jenë pozitive apo negative. Ky fleksibilitet është paraparë me qëllim. Ai garanton se opsionet që janë sugjeruar në një koncept dokument marrin parasysh të gjitha llojet e ndikimeve që zbatimi i këtyre opsioneve mund të ketë në shoqëri.

Se cilat çështje duhet të analizohen në kuadër të kategorive të ndikimeve varet nga (1) problemi, shkaqet dhe efektet e tij; dhe (2) nga opsionet në dispozicion për të trajtuar problemin në mënyrë

efektive. Këto mjete funksionojnë me lista kontrolluese (check list) dhe pyetje të dobishme për të përcaktuar nëse një ndikim pritet të ndodhë apo jo. Në këtë rast, duhet të vlerësohet rëndësia e ndikimit. Kjo ndihmon në përzgjedhjen e ndikimeve që duhet të analizohen në mënyrë të detajuar dhe atyre për të cilat analiza mund të bëhet në një nivel të përgjithshëm. Një listë kontrolluese gjithmonë rendit një sërë ndikimesh të mundshme. Sigurisht, më shumë se një nga këto mund të jenë relevante për koncept dokumentin. Gjithashtu, kur mendohet se vetëm njëri nga ndikimet mund të jetë relevant, ai mund të jetë i një rëndësie të tillë që duhet të analizohet në hollësi.

Mjete të caktuara mund të përdoren për identifikimin e ndikimeve të pritura dhe për përcaktimin e ndikimeve të caktuara në mënyrë më të detajuar. Kjo duhet të bëhet për çdo opsion për të cilin ato vlejnë. Kategoritë e ndikimeve, si dhe mjetet janë paraqitur në përmbledhjen e mëposhtme. Çdo mjet shpjegohet në mënyrë të veçantë në këtë pjesë.

Përveç kësaj, tri mjete shpjegojnë se si mund të përcaktohet më së miri rëndësia e ndikimeve dhe hollësia e analizës, cilat janë mundësitë për mbledhjen e të dhënave dhe si mund të zhvillohet më së miri një koncept dokument për zbatimin e direktivës apo rregullores së BE-së. Këto mjete ofrojnë mbështetje për strukturimin e analizës për koncept dokumentin.

Ky kapitull mbyllet me paraqitjen e tri mjeteve që mbështesin analizën për një koncept dokument. Këto mjete fokusohen posaçërisht në vendosjen e standardeve të përshtatshme dhe mundësive për zbatimin e tyre.



Figura 15: Kategoritë e ndikimeve dhe mjetet për strukturimin dhe kryerjen e analizave të politikave

Seksioni	Mjetet përkatëse
1) Ndikimet ekonomike	Mjeti 3: Identifikimi i ndikimeve ekonomike
2) Ndikimet shoqërore	Mjeti 4: Identifikimi i ndikimeve shoqërore
3) Ndikimet mjedisore	Mjeti 5: Identifikimi i ndikimeve mjedisore
4) Ndikimet ndërsektoriale	Mjeti 6: Ndikimet në të drejtat themelore
	Mjeti 7: Vlerësimi i ndikimit gjinor
	Mjeti 8: Analiza e drejtësisë sociale
	Mjeti 9: Vlerësimi i ndikimit të rinjtë
5)Ndikimet buxhetore	Mjeti 10: Plani i zbatimit për opsionet e politikave
	Mjeti 11: Kostimi për koncept dokumente
	Mjeti 12: Pajtueshmëria me vlerësimin e ndikimit buxhetor
6) Strukturimi i analizës për një koncept dokument	Mjeti 13: Përcaktimi i rëndësisë së ndikimeve
	Mjeti 14: Mbledhja e të dhënave
	Mjeti 15: Transpozimi i direktivave të BE-së
7) Vendosja dhe zbatimi i standardeve të përshtatshme	Mjeti 16: Modeli i kostimit standard
	Mjeti 17: Testi i NMV-ve
	Mjeti18: Testi i konkurrueshmërisë rregullative

MJETI 3: IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE EKONOMIKE

Opsioni do të ketë ndikime të rëndësishme ekonomike atëherë kur ndikon drejtpërdrejt në mënyrën në të cilën duhet të punojnë bizneset. Në fund të fundit, zhvillimi ekonomik rezulton nga bizneset e hapura, investimet e bëra dhe krijimi i vendeve të punës. Prandaj, pyetjet kryesore janë nëse opsioni ndikon drejtpërdrejt në mundësitë për të bërë biznes, ndikon në aktivitetet e bizneseve dhe/ose ka ndikime në punonjësit e tyre.

Nëse përgjigjja është “jo”, atëherë opsioni nuk pritet të ketë ndikime të rëndësishme ekonomike.

Nëse përgjigjja është ‘po’, atëherë sigurisht se do të ketë ndikime ekonomike. Lista kontrolluese e mëposhtme rendit kategoritë kryesore të ndikimeve ekonomike që ndihmojnë në përcaktimin e ndikimeve të pritshme. Është e mundshme që të ketë disa pyetje, përgjigjja ndaj të cilave është ‘po’. Të gjitha këto duhet të analizohen. Se sa e detajuar duhet të jetë analiza mund të vendoset në bazë të rëndësisë së ndikimit. ‘Mjeti 13: Përcaktimi i rëndësisë së ndikimeve’ përcakton mënyrën e identifikimit të rëndësisë së ndikimeve.



Figura 16: Lista kontrolluese me pyetjet kryesore për veçimin e ndikimeve ekonomike

Kategoria e ndikimeve ekonomike	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?	
		Po	Jo
Vendet e punës ¹³	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?		
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		
	A do të ndikojë në nivelin e pagesës?		
	A do të ndikojë në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?		
Bërja e biznesit	A do të ndikojë në qasjen në financa për biznes?		
	A do të largohen nga tregu produkte të caktuara?		
	A do të lejohen në treg produkte të caktuara?		
	A do të detyrohen bizneset të mbyllën?		
	A do të krijohen biznese të reja?		

¹³ Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime shoqërore.

Ngarkesa administrative	A do të detyrohen bizneset t'i përmbushin detyrimet e dhënjes së informatave të reja?	Nëse po, përdorni	
	A janë thjeshtuar detyrimet e dhënjes së informatave për bizneset?	Mjetin 16: Modeli i kostimit standard	
Tregtia	A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të importit?		
	A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të eksportit?		
Transporti	A do të ketë efekt në mënyrën e transportit të pasagjerëve dhe/ose mallrave?		
	A do të ketë ndonjë ndryshim në kohën e nevojshme për të transportuar pasagjerë dhe/ose mallra?		
Investimet	A pritet që kompanitë të investojnë në veprimtari të reja?		
	A pritet që kompanitë t'i anulojnë ose shtyjnë për më vonë investimet?		
	A do të rriten investimet nga diaspora?		
	A do të zvogëlohen investimet nga diaspora?		
	A do të rriten investimet e huaja direkte?		
	A do të zvogëlohen investimet e huaja direkte?		
Konkurrueshmëria	A do të rritet çmimi i biznesit të produkteve, siç është energjia elektrike?		
	A do të ulet çmimi i inputeve të bizneseve, siç është energjia elektrike?		
	A ka gjasa që të promovohen inovacioni dhe hulumtimi?		
	A ka gjasa që inovacioni dhe hulumtimi të pengohen?		

Ndikimi në NVM	A janë kompanitë e prekura kryesisht NVM?	Nëse po, përdorni Mjetin 17: Testi i NVM-ve	
Çmimet dhe konkurrenca	A do të rritet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?		
	A do të zvogëlohet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?		
	A do të rriten çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		
	A do të ulen çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		
Ndikimet ekonomike rajonale	A do të ndikohet ndonjë sektor i veçantë i biznesit?		
	A është ky sektor i koncentruar në një rajon të caktuar?		
Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik	A do të ndikohet rritja e ardhshme ekonomike?		
	A mund të ketë ndonjë efekt në normën e inflacionit?		

MJETI 4: IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE SHOQËRORE

Kategoria e ndikimeve shoqërore është një kategori shumë e larmishme. Ka shumë gjasa që një opion të ketë ndikime shoqërore. Përmbledhja e mëposhtme ofron pyetjet kryesore për identifikimin e ndikimeve të rëndësishme shoqërore.

Lista kontrolluese e mëposhtme rendit kategoritë kryesore të ndikimeve shoqërore që ndihmojnë në përcaktimin e ndikimeve të pritshme. Ka gjasa që të ketë disa pyetje ku përgjigjja do të jetë 'po'. Të gjitha këto duhet të analizohen. Se sa e detajuar duhet të jetë analiza mund të vendoset në bazë të rëndësisë së ndikimit. 'Mjeti 13: Përcaktimi i rëndësisë së ndikimeve' e përcakton mënyrën e identifikimit të rëndësisë së ndikimeve.



Figura 17: Lista kontrolluese me pyetjet kryesore për veçimin e ndikimeve shoqërore

Kategoria e ndikimeve shoqërore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?	
		Po	Jo
Vendet e punës ¹⁴	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?		
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		
	A ndikohen vendet e punës në një sektor të caktuar të biznesit?		
	A do të ketë ndonjë ndikim në nivelin e pagesës?		
Ndikimet shoqërore rajonale	A janë ndikimet shoqërore të përqendruara në një rajon apo qytete të veçanta?		
Kushtet e punës	A ndikohen të drejtat e punëtorëve?		
	A parashihen apo shfuqizohen standardet për punën në kushte të rrezikshme?		
	A do të ketë ndikim mbi mënyrën e zhvillimit të dialogut social ndërmjet punonjësve dhe punëdhënësve?		

¹⁴ Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime ekonomike.

Përfshirja sociale	A do të ketë ndikim mbi varfërinë?		
	A ndikohet qasja në skemat e mbrojtjes sociale?		
	A do të ndryshojë çmimi i mallrave dhe shërbimeve themelore?		
	A do të ketë ndikim në financimin apo organizimin e skemave të mbrojtjes sociale?		
Arsimi	A do të ketë ndikim në arsimin fillor?		
	A do të ketë ndikim në arsimin e mesëm?		
	A do të ketë ndikim në arsimin e lartë?		
	A do të ketë ndikim në aftësimin profesional?		
	A do të ketë ndikim në arsimimin e punëtorëve dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës?		
	A do të ketë ndikim në organizimin apo strukturën e sistemit arsimor?		
	A do të ketë ndikim në lirinë akademike dhe vetëqeverisjen?		
Kultura	A ndikon opsioni në diversitetin kulturor?		
	A ndikon opsioni në financimin e organizatave kulturore?		
	A ndikon opsioni në mundësitë për personat që të përfitojnë nga aktivitetet kulturore ose të marrin pjesë në to?		
	A ndikon opsioni në ruajtjen e trashëgimisë kulturore?		
Qeverisja	A ndikon opsioni në aftësitë e qytetarëve të marrin pjesë në procesin demokratik?		
	A trajtohet çdo person në mënyrë të barabartë?		
	A do të informohet më mirë publiku në lidhje me çështje të caktuara?		
	A ndikon opsioni në mënyrën se si funksionojnë partitë politike?		
	A do të ketë ndonjë ndikim në shoqërinë civile?		

Shëndeti dhe siguria publike ¹⁵	A do të ketë ndonjë ndikim në jetën e njerëzve, siç është jetëgjatësia apo shkalla e vdekshmërisë?		
	A do të ketë ndikim në cilësinë e ushqimit?		
	A do të rritet apo zvogëlohet rreziku shëndetësor për shkak të substancave të dëmshme?		
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në nivelet e zhurmës apo cilësinë e ajrit, ujit dhe/ose tokës?		
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në përdorimin e energjisë?		
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në deponimin e mbeturinave?		
	A do të ketë ndikim në mënyrën e jetesës së njerëzve, siç janë nivelet e interesimit për sport, ndryshimet në ushqyeshmëri, ose ndryshimet në përdorimin e duhanit ose alkoolit?		
	A ka grupe të veçanta që përballen me rreziqe shumë më të larta se të tjerat (të përcaktuar sipas faktorëve, të tillë si moshja, gjinia, aftësia e kufizuar, grup shoqëror apo rajoni)?		
Krimi dhe siguria	A ndikohen gjasat që të kapen kriminelët?		
	A ndikohet fitimi i mundshëm nga krimi?		
	A ndikon në nivelet e korrupsionit?		
	A ndikohet kapaciteti i zbatimit të ligjit?		
	A ka ndonjë efekt në të drejtat dhe sigurinë e viktimave të krimit?		

¹⁵ Kur ka ndikim në shëndet publik dhe siguri, atëherë rregullisht ka ndikime mjedisore.

MJETI 5: IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE MJEDISORE

Ndikimet mjedisore më së shpeshti ndërlihen me ndikimet ekonomike dhe shoqërore. Përmbledhja e mëposhtme ofron pyetjet kryesore për identifikimin e ndikimeve mjedisore që janë të rëndësishme.



Figura 18: Lista kontrolluese me pyetjet kryesore për veçimin e ndikimeve mjedisore

Kategoria e ndikimeve mjedisore	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?	
		Po	Jo
Klima dhe mjedisi i qëndrueshëm	A do të ketë ndikim në emetimin e gazrave serë (dioksid karboni, metani etj)?		
	A do të ndikohet në konsumin e karburanteve?		
	A do të ndryshojë shumëllojshmëria e burimeve që përdoren për prodhimin e energjisë?		
	A do të ketë ndonjë ndryshim në çmim për produktet miqësore ndaj mjedisit?		
Cilësia e ajrit	A do të ketë ndikim në emetimin e ndotësve të ajrit?		
Cilësia e ujit	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave të ëmbla?		
	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave nëntokësore?		
	A ndikon opsioni në burimet e ujit të pijshëm?		
Cilësia e tokës dhe shfrytëzimi i tokës	A do të ketë ndikim në cilësinë e tokës (në lidhje me acidifikimin, ndotjen, përdorimin e pesticideve apo herbicideve)?		
	A do të ketë ndikim në erozionin e tokës?		
	A do të humbet tokë (përmes ndërtimit, etj.)?		
	A do të fitohet tokë (përmes dekontaminimit, etj.)?		

	A do të ketë ndonjë ndryshim në shfrytëzimin e tokës (p.sh. nga shfrytëzimi pyjor në shfrytëzim bujqësor apo urban)?		
Mbeturinat dhe riciklimi	A do të ndryshojë sasia e mbeturinave të gjeneruara?		
	A do të ndryshojnë mënyrat në të cilat trajtohen mbeturinat?		
	A do të ketë ndikim në mundësitë për riciklimin e mbeturinave?		
Përdorimi i burimeve	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve të ripërtëritshme (rezervave të peshkut, hidrocentraleve, energjisë diellore etj.)?		
	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve, të cilat nuk janë të ripërtëritshme (ujërat nëntokësore, mineralet, qymyri etj.)?		
Shkalla e rreziqeve mjedisore	A do të ketë ndonjë efekt në gjasat për rreziqe, të tilla, si zjarret, shpërthimet apo aksidentet?		
	A do të ndikojë në gatishmërinë në rast të fatkeqësive natyrore?		
	A ndikohet mbrojtja e shoqërisë nga fatkeqësitë natyrore?		
Biodiversiteti, flora dhe fauna	A do të ketë ndikim në speciet e mbrojtura apo të rrezikuara apo në zonat ku ato jetojnë?		
	A do të preket madhësia apo lidhjet midis zonave të natyrës?		
	A do të ketë ndonjë efekt në numrin e specieve në një zonë të caktuar?		
Mirëqenia e kafshëve	A do të ndikohet trajtimi i kafshëve?		
	A do të ndikohet shëndeti i kafshëve?		
	A do të ndikohet cilësia dhe siguria e ushqimit të kafshëve?		

MJETI 6: NDIKIMET NË TË DREJTAT THEMELORE

Të drejtat themelore sigurojnë mbrojtjen themelore ligjore për të drejtat politike, sociale dhe procedurale që individët dhe subjektet juridike i gëzojnë.

Disa të drejta themelore janë të drejta absolute. Ato nuk mund të ndryshohen. Të tjerat janë të drejta që duhet të garantohen në masën më të madhe të mundshme. Ato duhet të kufizohen vetëm në situata të justifikuar dhe të shpjeguara mirë.

Në rast se ndikohet një e drejtë themelore, gjithmonë duhet të bëhen më shumë hulumtime mbi mënyrën se si kjo mund të funksionojë në praktikë. Të drejtat themelore duhet të promovohen dhe fuqizohen sa më shumë që është e mundur. Kufizimet ndaj të drejtave themelore duhet të trajtohen me kujdes. Ato duhet të justifikohen siç duhet para se të mund të aprovohen.



Figura 19: Lista kontrolluese me pyetjet kryesore për veçimin e ndikimeve në të drejtat themelore

Kategoria e ndikimit në të drejtat themelore	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?	
		Po	Jo
Dinjiteti	A ndikon opsioni në dinjitetin e njerëzve, në të drejtën e tyre për jetë apo në integritetin e një personi?		
Liria	A ndikon opsioni në të drejtën e lirisë së individëve?		
	A ndikon opsioni në të drejtën e një personi për privatësi?		
	A ndikon opsioni në të drejtën për t'u martuar apo krijuar familje?		
	A ndikon opsioni në mbrojtjen ligjore, ekonomike ose shoqërore të individëve apo familjes?		
	A ndikon opsioni në lirinë e mendimit, ndërgjegjes apo fesë?		
	A ndikon opsioni në lirinë e shprehjes?		
	A ndikon opsioni në lirinë e tubimit ose asociimit?		

Të dhënat personale	A përfshin opsioni përpunimin e të dhënave personale?		
	A janë të drejtat e individit për qasje, korrigjim dhe kundërshtim të garantuara?		
	A është e qartë dhe e mbrojtur mirë mënyra në të cilën përpunohen të dhënat personale?		
Azili	A ndikon ky opsioni në të drejtën për azil?		
Të drejtat pronësore	A do të ndikohen të drejtat e pronësisë?		
	A ndikon opsioni në lirinë për të bërë biznes?		
Trajtimi i barabartë ¹⁶	A e mbron opsioni parimin e barazisë para ligjit?		
	A ka gjasa që grupe të caktuara do të dëmtohen në mënyrë direkte apo indirekte nga diskriminimi (p.sh. ndonjë diskriminim në bazë gjinore, racore, ngjyrë, etni, opinioni politik ose tjetër, moshë ose orientimi seksual)?		
	A ndikon opsioni në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara?		
Të drejtat e fëmijëve	A ndikon opsioni në të drejtat e fëmijëve?		
Administrimi i mirë	A do të bëhen procedurat administrative më të komplikuara?		
	A ndikohet mënyra në të cilën administrata merr vendime (transparenca, afati procedural, e drejta për qasje në një dosje, etj.)?		
	Për të drejtën penale dhe ndëshkimet e parashikuara: a ndikohen të drejtat e të paditurit?		
	A ndikohet qasja në drejtësi?		

¹⁶ Barazia gjinore trajtohet në Mjetin 7: Vlerësimi i ndikimit gjinor

MJETI 7: VLERËSIMI I NDIKIMIT GJINOR

Kushtetuta e Kosovës e konsideron Barazinë Gjinore si “një vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, dhe kjo që të arrihet duhet të ofrohen mundësi për pjesëmarrje të barabartë të grave dhe burrave në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe fusha të tjera të jetës shoqërore.” Gjithashtu, Neni 22 i Kushtetutës i ka dhënë përparësi dhe status kushtetues dispozitave të Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër gruas (KEGJFDG). Kushtetuta, si një nga kornizat ligjore themelore të një vendi, është një parakusht thelbësor për zbatimin e parimeve të barazisë gjinore.

Kosova ka një kornizë ligjore dhe institucionale të mirë-zhvilluar për të siguruar mbrojtjen dhe nxitjen e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimin. Garancitë ligjore dhe dispozitat shoqëruese që sigurojnë të drejta të barabarta, mjetet për të kërkuar dhe fituar këto të drejta dhe strukturat e përgjegjshme gjinore për zbatimin dhe forcimin e tyre, janë themeltare për të krijuar qartësinë e koncepteve dhe vendosjen e standardeve. Ligji për barazi gjinore (LBGJ) Nr. 05/L-020 i Kosovës është ligji më i rëndësishëm në të gjithë hierarkinë e ligjeve të miratuara dhe në veprim për barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin. Ligji garanton mbrojtjen dhe nxit barazinë gjinore në të gjitha nivelet dhe në të gjithë sektorët e shoqërisë kosovare.



Figura 20: Nenet e Ligjit për barazinë gjinore më të rëndësishme për vlerësimin e ndikimit gjinor

- Neni 4, “Ndalimi i diskriminimit gjinor”
- Neni 5 “Masat e përgjithshme për të parandaluar diskriminimin gjinor dhe për të siguruar barazinë gjinore”.

Sipas LBGJ-së, parimet dhe integrimi i barazisë gjinore duhet të zbatohen në planifikimin, buxhetimin dhe zbatimin e të gjitha veprimeve të lartpërmendura nga institucionet publike dhe private. Në vazhdim, institucionet publike të Kosovës në të gjitha nivelet: legjislativ, ekzekutiv, gjyqësor e më tej, në hartimin dhe zbatimin e kornizave të politikave publike dhe ligjore duhet të sigurojnë që këto korniza të përfshijnë një numër të elementeve themelore të barazisë gjinore. Këto elemente përfshijnë koncepte, procese, sisteme dhe instrumente. Natyrisht, kjo do të thotë që vlerësimi i ndikimit gjinor, si një instrument për zbatimin e analizës gjinore, duhet të jetë pjesë integrale e zhvillimit dhe hartimit të politikave dhe proceseve për hartimin e koncept dokumenteve. Tabela më poshtë përmbledh kërkesat kyçe të LBGJ-së për integrimin gjinor:



Figura 21: Përmbledhja e kërkesave të LBGJ-së për integrimin gjinor

- » Të dhënat në baza gjinore në të gjithë sektorët për të gjitha informatat statistikore
- » Analiza gjinore për të dhëna të tilla dhe statusin e burrave dhe grave në sektorët respektivë apo me problemin/et që ata/ato ballafaqohen
- » Integrim gjinor të të gjitha politikave, dokumenteve dhe legjislacionit
- » Adoptimi i strategjive dhe planit të veprimit për promovimin dhe krijimin e barazisë gjinore në pajtim me Programin e Kosovës për barazi gjinore (PKBGJ)
- » Përfshirja e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në të gjitha fushat, si një mjet i domosdoshëm që garanton se parimi i barazisë gjinore respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe zotimin e burimeve
- » Zotimi adekuat i burimeve njerëzore dhe financiare për kornizën politike për arritjen e barazisë gjinore.

Në këtë qasje, Kosova përcjell hapat e platformave kyçe ndërkombëtare institucionale që aspiron t'u bashkohet.



Figura 22: Barazia gjinore në Kosovë në perspektivën ndërkombëtare

Sikurse u vu në dukje, Kushtetuta e Kosovës ua nje statusin kushtetues dispozitave të KEGJFDG. Në KEGJFDG pabarazitë gjinore janë kuptuar si prodhime bazuar në diskriminimin seksual. Ato janë riprodhuar dhe fitojnë vazhdimësi përmes strukturave institucionale shtetërore dhe shoqërore. Për të tejkaluar diskriminimin dhe pabarazitë, KEGJFDG ofron një këndvështrim tre-dimensional të barazisë. Në vend të vetëm konsiderimit të barazisë në kushte formale dhe legalistike dhe të theksuarit se ligjet dhe politikat sigurojnë barazinë mes grave dhe burrave thjesht përmes të qenit nga aspekti gjinor asnjans, KEGJFDG kërkon që ndikimi dhe efekti i tyre i vërtetë të merret gjithashtu në konsideratë. Nën KEGJFDG, shteti jo vetëm ka detyrimin të shfuqizojë ligjet që diskriminojnë drejtpërdrejt në baza gjinore, por duhet gjithashtu të sigurojë të gjitha përgatitjet dhe rregullat që ekzistojnë dhe që lejojnë gratë të përjetojnë barazinë dhe të gëzojnë të drejtat në jetën e tyre. KEGJFDG konsideron se shtetet jo vetëm kanë përgjegjësinë për veprimet e tyre, por ato duhet të eliminojnë diskriminimin dhe pabarazitë që shkaktohen nga individë privatë dhe organizma institucionale. (shih: Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (1979), <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/>)

Qasja e Kosovës mbështetet në platformën globale për veprim, adoptuar në Konferencën e katërt për gruan në Pekin në vitin 1995. Kjo platformë veprimi kërkon që të gjitha qeveritë dhe aktorët e tjerë të integrojnë perspektivën gjinore në të gjitha politikat dhe programet, kështu që para se ata të ndërmarrin vendime, një analizë me perspektivë gjinore të zbatohet në të gjitha politikat dhe programet për të zbuluar efektet e tyre respektive mbi burrat dhe mbi gratë. (shih: Konferenca e katërt botërore për gratë (1995), <http://www.un.org/womenwatch/daw/beijing/platform/>)

Traktati i Amsterdimit formalizoi përkushtimin ndaj integritetit gjinor në nivelin evropian. Nenet (2) & (3) qartazi kërkojnë eliminimin e pabarazive dhe promovimin e barazisë mes burrave dhe grave, si një nga detyrat dhe objektivat e Bashkimit Evropian. Traktati i Amsterdimit mbetet një hap cilësor progresi në të gjitha direktivat dhe traktatet e Bashkimit Evropian duke e zgjeruar qëllimin e barazisë gjinore përtej fushës së punësimit dhe trajtimit të saj të mëparshëm si një subjekt i politikës sociale, duke kërkuar zbatimin e integritetit gjinor në të gjitha nivelet dhe politikat. Në vijim, një numër direktivash dhe udhëzimesh të BE-së reflektojnë këtë zgjerim të mëtejshëm. (shih: Traktati i Amsterdimit (1997), <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=legissum:a10000>)

Përsa i përket integritetit gjinor, Komisioni Evropian adoptoi në vitin 1996 një Komunikim mbi integritetin gjinor dhe e përkufizoi atë si vijon: 'Parimi i "integritetit gjinor" konsiston në vlerësimin sistematik të dallimeve mes kushteve, situatave dhe nevojave të grave dhe burrave në të gjitha politikat dhe veprimet e komunitetit.' (shih: COM(96) 67 finale e 21 shkurt 1996 me titull 'Përfshirja e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat në të gjitha politikat dhe aktivitetet e komunitetit')

Me vendosjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e gruas në qendër të agjendës kombëtare për demokratizim, institucionet e Kosovës dhe shoqëria në tërësi pranon se rritja gjithëpërfshirëse ekonomike, ulja e varfërisë, dhe ndërtimi i shoqërisë paqësore dhe të qëndrueshme kërkon shfrytëzimin e barabartë të talentit dhe aftësive njerëzore. Institucionet e Kosovës kanë nevojë të zbërthejnë potencialet e burrave dhe grave në mënyrë të barabartë.

Kjo kërkon që institucionet e Kosovës të konsiderojnë barazinë gjinore si pjesë integrale e programeve, politikave dhe kornizave ligjore. Të kontribuosh për barazinë gjinore do të thotë të pranosh se politikave dhe kornizat afektojnë burrat dhe gratë në mënyra të ndryshme. Do të thotë gjithashtu se mjete të reja dhe relevante kanë nevojë të krijohen dhe të vendosen në proceset e hartimit të politikave dhe legjislacionit që t'u mundësojnë politikëhartuesve dhe aktorëve të përfshirë të dallojnë dhe rrokin të tilla dallime dhe të përshtasin politikave në mënyrë të qenësishme.

Një nga masat, metodat dhe mjetet kyçe që e rrënjosin integrimin gjinor në të gjitha nivelet e politikave, në të gjithë sektorët, që më në fund të arrihet barazia gjinore është vlerësimi i ndikimit gjinor.



Figura 23: Definimi i vlerësimit të ndikimit gjinor

Vlerësimi i ndikimit gjinor (VNGJ) është procesi i krahasimit dhe vlerësimit sipas kriterëve relevante gjinore të situatës aktuale dhe trendit me zhvillimet e pritura, që rezultojnë me paraqitjen e politikës së propozuar. Vlerësimi i ndikimit gjinor është vlerësim i efekteve të ndryshme (pozitive apo negative apo neutrale) të çdo politike apo aktiviteti për mjetet specifike për barazinë gjinore.

(shiko gjithashtu: Komisioni Evropian (1998), Udhëzues për vlerësimin e ndikimit gjinor <http://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/toolkits/gender-impact-assessment/what-gender-impact-assessment>)

ÇFARË PËRFITIMI MUND TË ARRIHET DUKE PËRFSHIRË VNGJ (VLERËSIMIN E NDIKIMIT GJINOR)?

Përfshirja e VNGJ-së nga institucionet publike si mjet analitik dhe si proces i integrit, ju mundëson politikëhartuesve dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në proces të përcaktojnë nëse politikave të propozuara, ligjet apo programet, reduktojnë, mbështesin apo rrisin pabarazinë gjinore në mes burrave dhe grave.

Duke qenë një analizë që duhet të ndodhë para fazës së zbatimit, VNGJ pajis politikëhartuesit me mjetin e duhur dhe u mundëson atyre që të zbulojnë efektet pozitive dhe negative gjatë fazës së hartimit. Kjo lejon parashikimin e hershëm, ndikimin e nismave të reja mbi statusin e burrave dhe të grave, politikat dhe ligjet e propozuara në lidhje me efektin dhe ndikimin e nismave të reja për statusin e burrave dhe grave. Kjo është veçanërisht relevante në ditët e sotme, duke qenë se politikat publike pritet që gjatë gjithë jetës së tyre të përfshijnë në hartimin e tyre dhe të zbatojnë disa parime kyçe vepruese sikurse janë: shpërndarja e njëjtë e pasurive dhe burimeve publike, mundësitë e barabarta, gjithëpërfshirja, eficientia e kostos dhe efektiviteti i saj, oportuniteti i kostos i bazuar në fakte dhe prova, dhe të luajë një rol të rëndësishëm në transformimin social. Politikat publike karakterizohen shpesh si mjete për shpërndarjen e burimeve dhe përfitimeve të pakta, të çmueshme, përmes mekanizmave të sektorit publik. Është i njohur fakti se mënyra se si zotohen dhe përdoren burimet ndikon qenësisht mbi orientimin e shoqërisë. Kur përfitimet e politikave publike janë të kufizuara në krijimin e mirëqenies së një grupi njerëzish, atëherë kostoja e politikave publike rritet, ato janë ndërhyrje joefektive dhe jo rrallëherë ato bëhen burime të tensioneve sociale dhe konflikteve. Prandaj është e rëndësishme që gjatë procesit të hartimit të politikave të propozuara, politikëhartuesit dhe aktorët e përfshirë t'i përgjigjen pyetjes nëse politika e propozuar ndikon në orientimin e shoqërisë drejt integritit, që ajo të bëhet më gjithëpërfshirëse apo përjashtuese, polarizuese, dhe ashtu e drejton shoqërinë drejt shpërbërjes.

Si një instrument i politikës publike, VNGJ është e mirë-pozicionuar të moderojë diskursin dhe të vlerësojë ndikimin e politikës së propozuar mbi gratë dhe burrat. Njëkohësisht, zbatimi i VNGJ-së sfidon hierarkinë e pushtetit, kërkon transformimin e modeleve ekzistuese të punës dhe vendos në pikëpyetje radikale proceset e politikave publike dhe aktorët e tyre.

Përmbledhtazi, Vlerësimi i ndikimit gjinor, si një instrument dhe proces, ua mundëson aktorëve të përfshirë të fitojnë një kuptim të thelluar të problemit në shqyrtim, të hartojnë politika dhe ligje që promovojnë shpërndarjen e njëjtë dhe mundësi të barabarta, dhe mbeten një hap i rëndësishëm në sigurimin e përputhshmërisë ligjore për realizimin e barazisë gjinore në jetën reale. Në praktikë, kjo ndodh përmes analizës dhe shfrytëzimit të koncepteve specifike dhe blloqeve kyçe që kanë të bëjnë me barazinë gjinore, që mundësojnë përcaktimin e aspekteve kryesore të mëposhtme:

- a) Nëse politika apo ligji i propozuar në mënyrë të barabartë dhe në mënyrë adekuate ofron për të dy palët, gratë dhe burrat, dhe nëse është e tillë, aktorët e përfshirë në proces duhet të vazhdojnë me zbatimin e politikës apo ligjit të propozuar,
- b) Nëse politikat apo ligjet e propozuara paraqesin sfida për një shërbim adekuat dhe të barabartë, si të grave dhe burrave dhe nëse rrethanat, sikurse rezultatet e dala nga aplikimi i VNGJ-së, lejojnë që të gjitha palët e përfshira të rregullojnë objektivat e politikave dhe ligjeve të propozuara, burimet apo kapacitetet e nevojshme që nevojiten, që në mënyrë efektive të zbatojnë këto politika apo ligje,
- c) Nëse politika apo ligji e/i propozuar, ndikon në mënyrë negative te gratë, e zgjeron pabarazinë mes statusit të grave dhe burrave, dhe më tej zgjeron diskriminimin dhe nuk ekziston asnjë faktor potencial apo veprim që duhet të ndërmerret brenda politikës së propozuar apo ligjit që mund ta zbusë ndikimin potencial negativ në marrëdhëniet gjinore, atëherë politika e propozuar duhet të braktiset.

Institucionet publike luajnë rol vendimtar në arritjen e agjendës së barazisë gjinore përmes reformave dhe politikave sektoriale që kanë për qëllim krijimin e shoqërive sociale të drejta dhe forcimin e demokracisë. Duke përfshirë VNGJ-në, institucionet publike përmirësojnë proceset e tyre planifikuese, administrimin dhe menaxhimin e burimeve. Përveç kësaj, përfshirja e VNGJ-së në politikëbërje dhe procesin e zbatimit, i bën institucionet publike më të parashikueshme dhe transparente, efikase dhe efektive në shfrytëzimin e burimeve, më përfshirëse dhe llogaridhënëse ndaj qytetarëve. Në këtë mënyrë, përfshirja e VNGJ-së ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në rritjen e qeverisjes së mirë në institucionet publike dhe në procesin dhe sistemet e vendimmarrjes.



Figura 24: Doracaku për vlerësimin e ndikimit gjinor

Ky Doracak mbi vlerësimin e ndikimit gjinor ofron një udhëzim pune rreth vlerësimit të ndikimit gjinor dhe se si duhet aplikuar. Doracaku mbi vlerësimin e ndikimit gjinor tregon në detaje si të kryhet ky lloj vlerësimi i ndikimit.

VLERËSIMI I NDIKIMIT GJINOR: KONCEPTET BAZË DHE PËRKUFIZIMET

Ekzistojnë disa koncepte, të cilat janë kyçe në vlerësimin e ndikimit gjinor. Këto janë prezantuar në publikimin “Koncepte dhe përkufizime gjinore” të hartuar nga Agjencia për Barazi Gjinore:

Gjinia dhe përkatësia seksuale – Gjinia është një përkufizim social për gratë dhe burrat. Është një disenj social për përkatësinë biologjike, e përcaktuar nga konceptimi i detyrave, funksioneve dhe rolet që u atribuohen grave dhe burrave në shoqëri dhe në jetën publike e private. Është një përkufizim kulturor i veçantë femëror dhe mashkullor dhe kështu ndryshon në kohë dhe hapësirë (Këshilli i Evropës 1998). Gjinia nuk është sinonim për përkatësinë seksuale të gruas. Ajo ndryshon fokusin nga individi në fushën ndërpersonale dhe institucionale. Nuk është thjesht tipar i një individi, mirëpo parim i organizimit social.

Relacionet gjinore – Këto janë relacionet sociale mes grave dhe burrave. Ato kanë të bëjnë me shpërndarjen e fuqisë së vendimmarrjes në mes të dy gjinive. Ato e përkufizojnë mënyrën se si përgjegjësitë dhe pritjet sociale janë të ndara dhe mënyrën se si secilës i jepet vlera e saj. Relacionet gjinore ndryshojnë sipas kohës dhe vendit dhe në mes grupeve të ndryshme të njerëzve. Kjo do të thotë, ato ndryshojnë sipas relacioneve të tjera sociale, si klasa, raca, etnia, paaftësia, mosha dhe kultura. Qasja ndaj relacioneve gjinore në politika domethënë qasje e mënyrës se si ndodhin bashkëveprimet në mes grave dhe burrave dhe rrethanave në të cilat ata bashkëveprojnë, si dhe a janë relevante për politikën ekzistuese apo të propozuar. Nga kjo perspektivë, gjinia është më shumë proces sesa karakteristikë e personit. Ne nuk kemi gjini; ne bëjmë gjini.

Barazia gjinore – domethënë vizibilitet i barabartë, fuqizim dhe pjesëmarrje e të dy gjinive në të gjitha sferat e jetës publike dhe private (Këshilli i Evropës 1998). Ky kuptim i barazisë na çon përtej një kuptimi të thjeshtëzuar të qasjes ndaj barazisë gjinore, i cili ka krijuar burra dhe kushtet e tyre si normë. Është e rëndësishme të njihet që shqetësimet e para të grave në lidhje me barazinë nuk shtyhen nga dëshira për barazinë me burrat, mirëpo nga çështjet e bazuara në komunitet dhe të drejtat themelore njerëzore.

Drejtësia gjinore – është rezultat i të qenit të drejtë ndaj grave dhe burrave. Kjo i bën të domosdoshëm adresimin dhe faktorët korrigjues që kontribuojnë në nënshtrimin e grave.

Gjinia dhe analiza kulturore – e zgjeron kornizën “e bazuar në gjini” që të përfshijë dhe reflektojë përvojat shumëdimensionale të grave të varfra dhe grave që kanë të kaluar të ndryshme kulturore dhe linguistike.

Analiza neutrale gjinore – pretendon se politikat/ programet/projektet ndikojnë te të gjithë njerëzit në të njëjtën mënyrë, apo që politika/programi/projekti ka ndikimin neutral mbi njerëzit. Analiza neutrale gjinore nuk rezulton në rezultate të barabarta për gratë dhe burrat. Nëse ju adoptoni qasjen gjinore neutrale, ju në mënyrë të paqëllimshme gjithmonë do të keni pabarazi mes jetës së burrave dhe grave.

Organizimi gjinor i punës – i referohet mënyrës se si gratë në shoqërinë tonë kanë përgjegjësinë primare për detyrat e kryera në sferën e amvisërisë, në veçanti në kujdesin dhe ushqimin e fëmijëve dhe atyre që kanë aftësi të kufizuara. Në të kundërtën, supozohet se burrat në përgjithësi janë më të lirë që të përkushtohen për punë jashtë shtëpisë. Kjo ndarje jo e barabartë për përgjegjësitë e kujdesit shpesh domethënë se gratë gjenden në sektorin e veçantë të tregut të punës, duke punuar p.sh. me orar të shkurtuar. Rolet e kujdesit dhe të ushqimit që kanë gratë po ashtu reflektojnë në segregimin e pjesëmarrjes së tyre në industri të caktura dhe në zgjedhjen apo paracaktimin e profesioneve.

Organizimi gjinor i lidhjeve personale – u referohet lidhjeve ndërpersonale dhe ndërfamiljare. Ai hedh dritë mbi mënyrat se si normat heteroseksuale presupozojnë meshkuj dominantë dhe femra të nënshtruara dhe i gjykojnë lidhjet jo-heteroseksuale si shmangie. Këtu përfshihen gjithashtu të gjitha vendimarrjet komplekse për shtatzaninë dhe kujdesin e fëmijëve dhe mënyrën se si këto aktivitete nënvlerësohen në shoqëri.



Figura 25: Shembuj nga vlerësimi i ndikimit gjinor

Sektori i transportit dhe infrastrukturës zakonisht perceptohen si asnjans ndaj çështjeve gjinore. Megjithatë kjo nuk është e vërtetë kur analizohen faktorët si pjesëmarrja, burimet, të drejtat, normat dhe vlerat. Shembujt janë marrë nga Udhëzuesi i zbatimit të VNGJ-së, në të cilin ofrohen shembuj të zhvilluar për çdo sektor të cituar socio-ekonomik dhe sektorët e menaxhimit publik në seksionet e lartpërmendura të këtij dokumenti.

Shembull: Duke parë në pamje të parë sektorin e transportit, i cilësuar si neutral ndaj çështjeve gjinore e politike, mirëpo një vëzhgim më i kujdesshëm do të nxjerrë dallime themelore në mes grupeve të ndryshme, mes burrave dhe grave në përdorimin dhe qasjen në mjetet publike dhe private të transportit. Derisa gratë më pak kanë qasje sesa burrat në mjetet private të transportit, ato më shumë frekuentojnë transportin publik. Si rrjedhojë, gratë janë ato që do të përfitojnë më tepër nga përmirësimi dhe disponueshmëria e transportit publik dhe kostoja e tij. Këto pabarazi kanë ndikim në pjesëmarrjen e grave dhe burrave të targetuar në grupet e ndryshme të sektorit të transportit. Ato ndikohen nga mungesa e barazisë gjinore në mesin e vendimmarrësve në këtë fushë. Ato reflektojnë dallime gjinore në shpërndarjen e burimeve (si veturat private) dhe theksojnë pabarazitë ekzistuese në lidhje me kohën e cunuar (në atë masë që veturat private përkojnë me menaxhimin e kohës në mënyrë efektive). Procesi i vendimmarrjes brenda familjes lidhur me përdorimin e kufizuar të burimeve të kufizuara, si makina e familjes, ka njëkohësisht më shumë gjasa të influencohet dhe nga normat dhe vlerat sociale që kanë të bëjnë me dallimin që bëjnë mes nevojave të burrit dhe të gruas, të cilat i shohin në favor të burrit dhe jo të gruas. (Adaptuar nga "Një udhëzues mbi vlerësimin e ndikimit gjinor" (EC 1998), www.ec.europa.eu/social/BlobServlet?docId=4376)

RELEVANCA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT GJINOR

Pa marrë parasysh besimin se politikat në përgjithësi janë neutrale, realiteti demonstroi se ato nuk janë. Një analizë më e thukët tregon se ato ndikojnë ndryshe te gratë dhe ndryshe te burrat. Gjinia është një dallim strukturor, i cili ndikon në tërë popullsinë dhe shpesh thekson dallimet në mes të grave dhe burrave. Zmadhon dobësinë e tyre që ka të bëjë me dallime të tjera strukturore, si raca/ klasa, etnia, mosha, paaftësia, orientimi seksual, etj. Këto dallime mund të bëjnë që politikat neutrale në pamje të parë të ndikojnë ndryshe te gratë dhe burrat. Këto mund të fuqizojnë pabarazitë ekzistuese.

Për këtë arsye, aplikimi i vlerësimit të ndikimit gjinor nuk duhet të përjashtojë asnjë kornizë të politikës publike të çfarëdo sektori socio-ekonomik.



Figura 26: Sekorët relevantë socio-ekonomikë për Aplikimin e VNGJ-së

- Bujqësia dhe sigurimi i ushqimit,
- Arti,
- Ndryshimet klimatike
- Arsimi
 - » Sistemi parashkollor dhe shërbimet,
 - » Sistemi arsimor primar dhe sekondar,
 - » Arsimi terciar,
 - » Trajnimi i mësimdhënësve
 - » Arsimi, lidershipi dhe menaxhmenti,
 - » Kurrikula dhe zhvillimi i teksteve,
- Punësimi dhe puna
- Energjia,
- Pylltaria,
- Shëndeti
 - » Shëndeti reprodaktiv dhe seksual,
 - » Shëndeti i nënës dhe fëmijës,
 - » HIV/ SIDA
 - » Shërbimet dhe sistemet shëndetësore ,
 - » Shëndeti mendor,
- Miniera,
- Menaxhimi i burimeve natyrore,
- Sigurimi dhe siguria,
- Shkenca, hulumtimi dhe teknologjia,
- Tregtia dhe industria
 - » Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme,
 - » Politikat tregtare
- Planifikimi urban,
- Mirëqenia dhe mbrojtja sociale,

Në fushat e mëposhtme të menaxhimit të sektorit publik, aplikimii VNGJ-së duhe të konsiderohet si i domosdoshëm:

- » Menaxhimi ekonomik,
- » Menaxhimi publik fiskal dhe shpenzimet publike,
- » Administrata publike,
- » Decentralizimi,
- » Ligji dhe gjyqësori,
- » Demokratizimi (reforma zgjedhore),
- » Integrimi evropian.

Sektorët e identifikuar më lart dhe fushat që kërkojnë aplikimin e VNGJ-së do të zgjerohen më tutje në Doracakun e VNBGJ-së.

Hapi i parë për të vendosur nëse vlerësimi i ndikimit gjinor është relevant nënismat e politikave të propozuara është të ngrihen pyetjet e mëposhtme:

- » A ka të bëjë politika vetëm me një apo më shumë grupe të targetuara?
- » A ekzistojnë dallimet në mes grave dhe burrave në këtë fushë të politikës (në lidhje me të drejtat, burimet, pjesëmarrjen, vlerat dhe normat që kanë të bëjnë me gjininë?)
- » A e merr në konsideratë politika e propozuar relevancën e gjinisë në organizimin e punës dhe organizimin e lidhjeve personale dhe organizimin e qytetarisë?

Nëse përgjigjja për secilën prej këtyre pyetjeve është pozitive, gjinia është relevante për koncept dokumentin dhe duhet të kryhet vlerësimi i ndikimit gjinor. Kriteret e mëposhtme duhet të merren parasysh për të kryer vlerësimin e ndikimit gjinor të iniciativës së propozuar të kornizës së politikave.



Figura 27: Kriteret për vlerësimin e ndikimit të gjinisë

Dallimet mes burrave dhe grave në fushën politike, si:

- » **Pjesëmarrja** (përbërja gjinore për grupet/popullsinë e targetuar, përfaqësimin e grave dhe burrave në pozitë vendimmarrëse),
- » **Burimet** (shpërndarja e burimeve kyçe si koha, hapësira, informatat dhe paratë, fuqia politike dhe ekonomike, arsimi dhe trajnimi, puna dhe karriera profesionale, teknologjitë e reja, shërbimet e kujdesit shëndetësor, banimi, mjetet e transportit, koha e lirë),
- » **Normat dhe vlerat** që kanë ndikim në rolet gjinore, ndarjen e punës sipas gjinisë, respektivisht qëndrimin dhe sjelljen e grave dhe burrave, dhe pabarazitë në vlerat që kanë të bëjnë me burrat dhe gratë apo për karakteristikat mashkullore dhe femërore,
- » **Të drejtat** që kanë të bëjnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me diskriminimin gjinor, të drejtat e njeriut (duke përfshirë lirinë nga dhuna seksuale dhe degradimi) dhe qasja në drejtësi, në ambientin ligjor, politik dhe socio-ekonomik. (shih: “Udhëzues për vlerësimin e ndikimit”, (EC 1998),

Gjatë VNGJ (vlerësimin të ndikimit gjinor), elementet kyçe janë të dhënat në baza gjinore. Ligji për barazi gjinore kërkon që të gjitha institucionet të grumbullojnë, përpunojnë dhe publikisht të shpërndajnë të dhëna në baza gjinore. Të dhënat në baza gjinore mund të merren përmes çdo institucioni të administratës publike, Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe çdo institucioni të financuar nga taksapaguesit. Publikimet e mëposhtme mund t’ju ndihmojnë gjatë këtij procesi:

- Gratë dhe burrat në Kosovë: Gratë dhe burrat në Kosovë është një botim dyvjetor i Agjencisë së Statistikave të Kosovës që ofron të dhëna statistikore mbi baza gjinore.
- Profili gjinor i Kosovës: Profili gjinor i Kosovës siguron të dhëna dhe analiza mbi dallimet mes burrave dhe grave dhe rolet që u janë caktuar sipas gjinive: në pozicionet e tyre socio-ekonomike, nevojat, pjesëmarrjen, qasjen në burime, kontrollin e aseteve, pushtetin në vendimmarrje, liritë individuale dhe kushtet e të drejtave të njeriut. Publikimi mund të gjendet në faqen e Agjencisë për Barazi Gjinore: www.abgj.rks-gov.net.
- Indeksi gjinor i Kosovës: I pari publikim i Indeksit të Kosovës për barazi gjinore do të botohet në vitin 2018 dhe në bashkëpunim me Agjencinë e Statistikave të Kosovës.



Figura 28: Etapat e vlerësimit të ndikimit gjinor

Etapat e VNGJ-së	Shpjegimi
Etapa 1	<p>Vlerësimi dhe përshkrimi i situatës aktuale:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Mblidhni çdo statistikë në baza gjinore, fakte dhe informacion që lidhet me veprimin/objektivin e propozuar, ● Identifikoni se çfarë është e njohur mbi përvojat e ndryshme, situatat dhe rolet e burrave dhe grave, duke përdorur matje sasiore dhe cilësore. P.sh. grupi me pagë të ulët - a ekziston dimensionimi gjinor në të, ● Identifikoni normat dhe vlerat që kanë ndikim në izolimin gjinor dhe ndarjen e punës, ● Bëni analizën gjinore dhe vlerësoni nëse korniza aktuale ligjore është apo jo diskriminuese, apo nëse korniza ligjore është e pamjaftueshme për të mbështetur barazinë gjinore apo zbatohet pamjaftueshmërisht ● Konsultohuni me gra dhe burra që ka gjasa të preken nga prioritetet e politikave që propozohen, ● Konsultohuni dhe përfshijini në grupet punuese zyrtarët/et e barazisë gjinore nga ministritë e linjës, komunat dhe institucionet publike, ● Konsultohuni me Agjencinë për Barazi Gjinore gjatë gjithë procesit, si burim ekspertize dhe informacioni, ● Kërkoni dhe angazhoni shërbimet e ekspertëve jashtë institucioneve publike të Kosovës.
Etapa 2	<p>Vlerësoni dhe përshkruani ndikimin potencial të politikës së propozuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Analizoni trendet e ardhshme dhe zhvillimet e mundshme pa ndërhyrjen e politikave, ● Analizoni trendet mbi pozitat e burrave dhe grave, në mënyrë të pavarur nga efektet e çdo politike të propozuar, ● Cilat janë ndikimet potenciale mbi burrat dhe gratë dhe marrëdhëniet gjinore? ● Kush do të ishte i prekur drejtpërdrejt apo i ndikuar në mënyrë të tërthortë ? ● Cilët burra/gra në grupin e veçantë? ● Pjesëmarrja, burimet dhe të drejtat, ● Cili është dallimi mes ndikimit gjinor të parashikuar dhe situatës aktuale? ● Bazuar në vlerësimin e bërë, identifikoni se cilat mjete janë më relevante në mënyrë që të arrihet performanca e dëshirueshme.

Etapa 3	<p>Rregullimi i politikave:</p> <ul style="list-style-type: none">• Bazuar në rezultatet e vlerësimit të etapave (1) dhe (2) përcaktoni nëse duhet të bëhen ndryshimet e mëposhtme:<ol style="list-style-type: none">a) Ripërcaktonii përkufizimin e problemitb) Ripërcaktoni objektivat e politikave të propozuarac) Rikonsideroni dhe përcaktoni se cilat prioritete mund ta promovojnë në mënyrë aktive barazinë gjinore dhe të kenë ndikim te gratë dhe burrat.• Kini parasysh se disa politika nuk kanë përkushtime të veçanta për barazinë gjinore, mirëpo mund të kenë efekt shumë pozitiv apo negativ ndaj saj,• Diskutoni ndryshimet bazuar në vlerësimet e kryera me grupet punuese për koncept dokumentin.
Etapa 4	<p>Përcaktoni prioritetin, i cili duhet t'u bashkëngjitet politikave që në mënyrë aktive promovojnë barazinë gjinore dhe përcaktojnë qasjen apo veprimet e politikave specifike që duhet t'u bashkëngjiten politikave të propozuara për të siguruar se grupet specifike brenda burrave dhe grave përfitojnë nga ndërhyrjet e politikave të propozuara.</p>
Etapa 5	<p>Identifikoni se cilat veprime duhet të ndërmerren nga institucionet publike të përfshira për të siguruar përparimin dhe nëse ka mungesë njohurish për çështjet gjinore në të gjitha nivelet e politikëbërjes. Përfshini këto veprime në Mjetin 10: Plani i zbatimit për opsionet e politikave</p>
Etapa 6	<p>Në se analizat tuaja në etapat (1) dhe (2) demonstrojnë që politikat janë neutrale ndaj aspekteve gjinore, përfshini vlerësimin e bërë në Koncept Dokument.</p>
Etapa 7	<p>Nëse politika juaj, e propozuar në koncept dokument është e lidhur me gjendjen e çështjeve gjinore, vendoseni këtë në mënyrë të qartë që gjatë konsultimeve publike, Agjencia për Barazi Gjinore, ZBGJ-të në ministritë e linjës të sektorëve që janë ndikuar nga politikat e propozuara dhe entitetet tjera të institucioneve publike të Kosovës të jenë plotësisht të informuara dhe komentet/sugjerimet e tyre të jenë përfshirë në versionin final të koncept dokumentit.</p>



Figura 29: Pyetje udhëzuese për vlerësimin e ndikimit gjinor

Pyetjet e mëposhtme udhëzuese nuk duhet të trajtohen si një listë definitive, ato duhet të përshtaten dhe të ndryshojnë në përputhje me rrethanat nga përdoruesit për t'iu përshtatur më mirë nevojave të tyre dhe iniciativës së propozuar të politikave.

Transporti dhe infrastruktura (pyetje udhëzuese)

- A ekzistojnë dispozita diskriminuese apo paragjykime të nënkuptuara gjinore në kornizën e politikave publike për zhvillimin e infrastrukturës, apo dispozita tjera që mund ta vënë gruan në disavantazh? Për shembull:
- A është paragjyquese strategjia e investimeve strategjike në zhvillimin e infrastrukturës për përdorim komercial (sesa për përdorim të amvisërive)?
- A ekzistojnë mekanizma joadekuate për t'u konsultuar me gratë lokale për vendin dhe disenjimin e objekteve/pajisjeve dhe risistemimin e tyre?
- A ka taksa dhe tarifa të larta për lidhje me shërbimet komunale (p.sh blloqet apo skemat e pagesave për instalimet për amvisëritë/familjet e varfra)?
- A është forcimi i ligjit të punës në lartësinë jo të duhur në kantieret ndërtimore?
- A paguajnë kontraktorët paga më të ulëta për gratë për punë të barabartë në projekte të tilla?

- A ekzistojnë barriera formale dhe joformale për pjesëmarrjen e grave në sektor? Kjo mund të përfshijë:
 - » kontrollin tradicional mashkullor të vendimmarrjes në komunitet,
 - » edukimin e kufizuar të grave në zonën rurale për të marrë pjesë (por merrni në konsideratë se çfarë niveli i arsimit është i nevojshëm për pjesëmarrjen e grave në sektor); dhe
 - » gratë kanë mungesë të kohës, lëvizshmërisë apo vetëbesimit për të marrë pjesë në konsultime për disenjimin e infrastrukturës dhe risisteminin.
- Si është barazia gjinore në organizatat kyçe në sektor (duke përfshirë ministritë e infrastrukturës, zyrat e tyre lokale dhe kontraktorët e ndërtimit)? Cilat janë shkaqet e mundshme të pabarazisë gjinore? A ofrojnë organizatat pagesë të njëjtë për punë të njëjtë? A ofrojnë objekte dhe shërbime të duhura për burrat dhe gratë?
- Cilat ndryshime në kornizën politike janë propozuar në projekt/program? A adresojnë këto ndryshime mbi paragjykimet gjinore në ligj dhe kornizën e politikave publike? A mund të jenë në disavantazh për gruan këto ndryshime të propozuara (psh. rritja e tarifave të transportit që rëndon shtresat e varfra; krijimi i fondeve për mirëmbajtjen e rrugëve apo institucionet e reja në komunitetet e risistemuara pa përfaqësim adekuat të grave, monitorim joadekuat të kushteve të punës dhe vendpunishteve, apo fonde të pamjaftueshme dhe monitorim të komuniteteve - programeve vetëdijesuese për rrezikun për përhapjen e SIDA-s dhe trafikimin?)
- Veprimet e mundshme përgjegjëse gjinore mund të përfshijnë si më poshtë:
 - » Zhvillimin e **strategjisë specifike gjinore të sektorit dhe veprime të veçanta** brenda kornizës së politikës publike të propozuar për të adresuar çështjet gjinore dhe mangësitë,
 - » **Amendamentet apo shtesat për ligjet ekzistuese dhe politikat** për të përmirësuar paragjykimin gjinor apo mangësitë, apo anulimin e dispozitave diskriminuese,
 - » **Trajnimi i stafit të Ministrisë së Infrastrukturës** për vetëdijesimin gjinor për të përfshirë gratë në aktivitete të infrastructures,
 - » **Mekanizmat për të lehtësuar përfshirjen e grave** në disenjimin e mjeteve të infrastrukturës, në punësim, në ndërtimtari dhe mirëmbajtje dhe në planifikimin e risistemimit dhe menaxhmentit (si targetet e punësimit, dispozitat për pagesë të barabartë dhe kushte të sigurta pune, formimin e grupeve ndërtuese të grave dhe vendosjen e synimeve për pjesëmarrjen e grave në strukturat qeverisëse dhe komunitetet e risistemuara),
 - » **Fushata për rritjen e vetëdijes** për sigurinë në rrugë, HIV dhe rreziqet e trafikimit, përfshirja e zyrtareve të zgjedhura gra, lidereve të komunitetit dhe grupeve të grave,
 - » **Partneriteti me OJQ-të lokale apo ZBGJ-të** për të përkrahur gratë e risistemuara në kërkesat për dhënie të shërbimeve bazike dhe kompensimet tjera.

MJETI 8: ANALIZA E DREJTËSISË SOCIALE (ADS)

Drejtësia sociale dhe përfitimet nga ajo

Drejtësia sociale i referohet ofrimit të paanshëm, të drejtë dhe të barabartë të të mirave dhe shërbimeve publike për qytetarët. Ajo e sheh zbatimin e politikave publike nga këndvështrimi i qytetarëve. Politikat hartohen për ata/ato. Qytetarët përballen si me përfitimet ashtu dhe detyrimet me të cilat ata duhet të ballafaqohen si pranues të veprimeve të politikave. Sidoqoftë, jo çdo grup në shoqëri ka të njëjtën pikë fillimi dhe jo të gjithë kanë të njëjtat mundësi për të gëzuar përfitimet që pritet të sjellin politikën. Njëkohësisht, grupe të caktuara do ta kenë më të lehtë të përballojnë detyrime të caktuara se sa të tjerat.

Shumë politika ndikojnë grupe të ndryshme në mënyrë të ndryshme. Politikën mund të zbatohen në praktikë në mënyrë shumë më efektive dhe efikase për disa grupe. Grupe të tjera, megjithatë, mund të mos arrihen nga politikën, që rezulton në pabarazi, anshmëri dhe padrejtësi. Si rrjedhojë, rezultati i dëshiruar i politikave nuk arrihet.

Thelbësore është të theksohet se shkak i mangësive të politikave shpesh mund të gjendet mbrapa analizave dhe konsultimeve jo të duhura gjatë zhvillimit të politikave. Kjo pastaj rezulton në miratimin e një politike që është jo e plotë. Në vend që t'u mundësohet qytetarëve të përdorin të mirat dhe shërbimet publike, politikën joefektive nxisin përjashtimin. Kjo rrezikon krijimin e diskursit negativ dhe jostabilitetit mes grupeve të ndryshme sociale. Kohezioni social pëson si rezultat i kësaj dhe trazirat sociale mund të pasojnë, veçanërisht kur mangësitë e politikave nuk zvogëlohen me kohë. Prandaj, procesi i zhvillimit të politikave duhet të adresojë ndikimet e mundshme në grupe të veçanta në raport me nevojat e tyre.

Analiza e drejtësisë sociale nënkupton zbatimin e drejtësisë dhe paanshmërisë së barabartë në politika, veçanërisht në ato që kanë një dimension social. Qëllimi kryesor është që të sigurohet që të gjithë njerëzit në shoqëri kanë të njëjtin status sa i përket të drejtave civile dhe kanë mundësi të gëzojnë qasje të barabartë në të mirat dhe shërbimet publike. Kjo përfshin në veçanti grupet që mund të konsiderohen të pabarabarta krahasuar me të tjerat.

Drejtësia sociale trajton çështje si: qasja e paanshme, paanshmëria procedurale dhe rezultatet e barabarta të ofrimit të të mirave dhe shërbimeve publike.



Figura 30: Çështjet të cilat i adreson drejtësia sociale

Qasja e paanshme: çdo person duhet të ketë qasje të barabartë në të mira dhe shërbime që ofrohen në mënyrë publike; asnjë individ ose grup njerëzish nuk duhet të kufizohet në qasjen e tyre në këto të mira dhe shërbime publike si rezultat i veprimeve të Qeverisë ose për shkak të kushteve të pabarabarta në të cilat gjenden. Atyre në fakt duhet, bazuar në nevojat e tyre, t'u sigurohen mundësi shtesë për qasje në këto të mira dhe shërbime.

Paanshmëria procedurale: sigurimi i procedurave të paanshme dhe të drejta në mënyrë që vendimmarrësit dhe autoritetet publike, pasi të kenë identifikuar nevojat e palëve të ndikuara, të ndërmarrin një vendim korrekt.

Rezultatet e barabarta të ofrimit të të mirave dhe shërbimeve publike: procedurat zbatohen, afatet gjithmonë respektohen dhe vendimet zbatohen pa ekuivoke dhe në mënyrë të padiskutueshme për të gjithë.

Duke analizuar paanshmërinë, drejtësinë dhe barazinë e politikave dhe mjeteve të propozuara për të promovuar këto tri koncepte, forcohet kohezioni social. Politikat e Qeverisë duhet të udhëhiqen nga parimi i “nevojës” së grupeve të ndikuara. Karakteristikat e ndryshme i bëjnë këto grupe të ndryshme nga njëri-tjetri, gjë që i bën edhe nevojat e tyre të ndryshme. Këto dallime nuk duhet të rezultojnë në një situatë ku grupet specifike vihen sistematikisht në disavantazh për shkak të karakteristikave që i veçojnë ato nga të tjerat.



Figura 31: Parimi i nevojës

“Parimi i nevojës” i referohet të kuptuarit se lloji i intervenimeve nga autoritetet publike dhe mënyra se si këto intervenime zbatohen në të vërtetë, mund të ketë rëndësi të madhe kur bëhet fjalë për arritjen e rezultateve të pritshme të barabarta për të gjitha grupet e ndikuara. Thënë shkurt, shkalla në të cilën një grup mund të ketë qasje në të mirat dhe shërbimet publike dhe mund të shfrytëzojë mundësitë e ofruara çon peshë kur është fjala për arritjen e qëllimeve të politikave.



Figura 32: Kontrolli i shpejtë për analizën e drejtësisë sociale, si hap i detyrueshëm për çdo koncept dokument

Mjeti për analizën e drejtësisë sociale është një mjet i detyrueshëm për t'u lexuar nga anëtarët e grupit punues për koncept dokumentet. Duhet të kryhet gjithmonë kontrolli i shpejtë i drejtësisë sociale (pika 2 më poshtë), për të vendosur nëse do të bëhet një analizë më e hollësishme e drejtësisë sociale.

Analiza e drejtësisë sociale kontribuon në një përkufizim më të mirë të politikave duke vlerësuar ndikimet në jetën e njerëzve, veçanërisht të atyre që mund - për çfarëdo arsye - të jenë në disavantazh. Analiza e drejtësisë sociale (ADS) nxit diskutimin mbi paanshmërinë e politikave qeveritare. Ajo zbulon pabarazitë aktuale dhe të mundshme, si dhe efektet e tyre. Kjo, nga ana tjetër, i mundëson Qeverisë t'i adresojë këto dhe, kudo që është e mundur, t'i eliminojë ato. Kryerja e ADS-së i rrit gjasat që politikat të arrijnë rezultatet që ato synojnë të arrijnë. Gjatë zbatimit të politikave, kjo do të nxisë pranimin e tyre nga grupet e ndikuara. Kjo rezulton në një përdorim më efikas dhe më efektiv të burimeve të Qeverisë, meqenëse qëllimet e politikave arrihen më mirë dhe me më pak ankesa. Eventualisht, besimi në punën e Qeverisë rritet dhe kohezioni social mbahet.

Kontrolli i shpejtë i drejtësisë sociale

Ky mjet për analizën e drejtësisë sociale duhet të diskutohet nga çdo grup punues që zhvillon një koncept dokument. Nëse nevojitet apo jo një analizë e detajuar varet nga çështjet që adreson KD dhe nga konkluzionet që grupi punues nxjerr nga diskutimet e brendshme dhe konsultimi i palëve të jashtme të interesit. Si rregull, analiza e drejtësisë sociale ka shumë të ngjarë të jetë e rëndësishme kur tema e koncept dokumentit lidhet me kushtet e jetesës së njerëzve, ndikon në statusin e tyre social ose përcakton faktorët e lëvizshmërisë sociale. Rëndësia e ADS del në pah veçanërisht në lidhje me dimensionet e mëposhtme jetësore: kushtet materiale të jetesës; aktivitetet produktive; shëndetin; edukimin; kohën e lirë; ndërveprimet shoqërore; stabilitetin ekonomik; sigurinë fizike; mjetet e qeverisjes; të drejtat themelore dhe mjedisin jetësor.



Figura 33: Dimensionet jetësore dhe shembujt

- Kushtet materiale të jetesës (aftësia për të përballuar shpenzimet e jetesës duke pasur parasysh nivelet e të ardhurave, konsumin, strehimin dhe nevojat bazë; furnizimin me ujë, energji elektrike, ngrohje, disponueshmërinë dhe qasjen në internet)
- Aktivitetet produktive (disponueshmëria e vendeve të punës dhe cilësia e tyre - orët e punës, pagat, siguria në punë)
- Shëndeti (qasja dhe cilësia e kujdesit shëndetësor; vdekshmëria)
- Edukimi (qasja dhe kualiteti i kopshteve për fëmijë, shkollave fillore dhe të mesme; arsimi dhe aftësimi profesional; arsimi i lartë; mësimi gjatë gjithë jetës)
- Koha e lirë dhe ndërveprimet sociale (pjesëmarrja në aktivitete që lidhen me artin, kulturën dhe sportet)
- Stabiliteti ekonomik (qëndrueshmëria ndaj fateve (fatkeqësive) ekonomike)
- Siguria fizike (probabiliteti për t'u bërë viktimë e krimit; rreziqet e sigurisë)
- Qeverisja dhe të drejtat themelore (mosdiskriminimi; pjesëmarrja në jetën publike dhe politike - partitë politike, sindikatat)
- Ambienti jetësor (mbrojtja nga ndotja e ajrit, uji dhe zhurma; mosekspozimi ndaj rrezikut nga fatkeqësitë)

Kur përkufizimi i problemit, objektivat dhe opsionet e koncept dokumentit duket se kanë një ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në këto dimensione, analiza e drejtësisë sociale duhet të kryhet me rigorozitet. Në veçanti, duhet të konsultohen ekspertë nga brenda administratës dhe palë të jashtme të interesit.

Në mënyrë të natyrshme, analiza e drejtësisë sociale nuk do të jetë relevante për çdo koncept dokument. Kjo ka të ngjarë të ndodhë në rastet kur koncept dokumentet kanë të bëjnë ekskluzivisht me rishtrukturimin e organizimit të brendshëm të organeve të administratës publike. Megjithatë, kur KD-të e tilla përfshijnë gjithashtu aspekte të ofrimit të shërbimeve nga administrata, ADS ende mund të jetë e rëndësishme.



Figura 34: Ofrimi i shërbimeve

Ofrimi i shërbimeve u referohet proceseve të përdorura për të ofruar shërbime publike për qytetarët dhe kompanitë. Shembuj të shërbimeve të tilla janë: ofrimi i përfitimeve sociale; ofrimi i edukimit; lëshimi i licencave dhe lejeve; distribuimi i ujit, ngrohjes dhe energjisë elektrike; ofrimi i strehimit/banimit etj.

Ofrimi efektiv dhe efikas i shërbimeve bazohet në parime, standarde, politika dhe kufizime që përdoren për të udhëhequr hartimin, zhvillimin, vendosjen dhe funksionimin e shërbimeve të ofruara nga Qeveria, si ofrues i shërbimeve. Qëllimi i përgjithshëm është që të ofrohet një cilësi e lartë e vazhdueshme e shërbimeve, të sigurohet një përvojë e qëndrueshme shërbimesh për të gjithë përdoruesit dhe të përshtaten shërbimet për grupe të veçanta, kur kjo është e nevojshme për të ofruar shërbimin në mënyrë efektive.

Zbatimi i analizës së drejtësisë sociale

Gjatë zbatimit të analizës së drejtësisë sociale, duhet të përcaktohen aspektet e mëposhtme: 1) përfitimet dhe detyrimet e ardhshme që janë duke u shqyrtuar sipas opsioneve të politikave të koncept dokumentit; dhe 2) grupet që ndikohen nga veprimet e propozuara, karakteristikat e tyre specifike dhe nevojat e veçanta, si dhe ndarësit në mes tyre. Identifikimi i këtyre aspekteve është thelbësor për të vlerësuar ndërlidhjen e tyre dhe për përcaktimin e ndikimeve të pritura specifike për grupe.

Përfitimet e politikave përfshijnë të gjitha të mirat dhe shërbimet që u ofrohen personave nga institucionet publike. Përfitimet pritet që të përmirësojnë jetën e qytetarëve. Detyrimet, nga ana tjetër, përfshijnë përgjegjësitë e personave ndaj institucioneve publike. Këto detyrime janë të lidhura qenësisht me përfitimet që ofrojnë politikat pasi që individët duhet të kryejnë aktivitete të caktuara në mënyrë që të gëzojnë përfitimet e ofruara nga institucionet publike. Për të gjitha opsionet e propozuara të politikave duhet të analizohen përfitimet, detyrimet dhe ndikimet e tyre.

Është e rëndësishme të kemi parasysh se ndërsa ligjet dhe politikat nuk përjashtojnë në mënyrë eksplicite grupe të caktuara, zbatimi faktik i ligjeve dhe politikave mund ta bëjë këtë në praktikë. Grupet kanë kapacitete të ndryshme për të përmbushur detyrimet e kërkuara. Dallimet mund të jenë mjaft të drejtpërdrejta, siç janë ato në mes të një familjeje të një gruaje të ve, me një punë me gjysmë orari që mban pesë fëmijë dhe një familje e një çifti të martuar, ku që të dytë kanë punë dhe kanë dy fëmijë. Në shembullin e shkollës që përdoret në këtë mjet, të njëjtat detyrime për secilën familje do të jenë më të vështira për t'u përballur në rastin e një familjeje me të ardhura të ulëta, krahasuar me një familje me të ardhura të larta. Analiza e drejtësisë sociale synon zbulimin e këtyre dallimeve në mënyrë që këto të adresohen në mënyrë efektive.



Figura 35: Shembuj të përfitimeve dhe detyrimeve në arsimin fillor

Përfitimet e mundshme nga arsimi fillor janë:

- Arsim i rregullt i detyrueshëm i ofruar falas fëmijëve sipas programeve qeveritare;
- Arsimi jashtëprogramor me pagesë, jo i detyrueshëm;
- Librat shkollorë dhe materiale të tjera të ofruara falas për fëmijët deri në klasën e pestë. Këto përfitime, natyrisht, krijojnë detyrime, si:
 - Përgjegjësia e prindërve/kujdestarëve për t'i dërguar fëmijët në arsimim të rregullt;
 - Përgjegjësia e prindërve/kujdestarëve për t'u siguruar fëmijëve ushqim dhe transport;
 - Përgjegjësia e prindërve/kujdestarëve të fëmijëve që ndjekin klasën e gjashtë dhe më lart për të siguruar libra shkollorë dhe materiale të tjera.

Identifikimi i grupeve të ndikuara

Politikat e Qeverisë zhvillohen për të ofruar përfitime për shoqërinë në përgjithësi dhe individët në veçanti. Politikat e Qeverisë duhet të përcaktojnë detyrime në mënyrë që të funksionojnë siç duhet: duhet të paguhet taksat; kompanitë duhet të respektojnë masat për rritjen e sigurisë në punë; dhe qytetarët duhet të japin informacion që të marrin dokumente personale. Këto janë vetëm tre shembuj të gamës së gjerë të detyrimeve që janë të përfshira në politika dhe zbatohen përmes legjislacionit. Çdo politikë është e ndryshme dhe për këtë arsye ndikon në grupe të ndryshme në mënyra të ndryshme. Kur zhvillohet një politikë, këto grupe mund të identifikohen përmes hulumtimit, konsultimit dhe komunikimit të targetuar.

Identifikimi i grupeve të ndikuara bazohet në analizën e palëve të interesuara që pritet të ndikohen nga opsionet e politikave që konsiderohen përmes koncept dokumentit. Hulumtim shtesë kërkohet për të specifikuar grupet e synuara dhe për të ndarë grupet e përgjithshme në nëngrupe. Ky hulumtim duhet të përfshijë materiale të tilla, si: strategjitë, aktet ligjore, raportet, artikujt e lajmeve, pyetjet parlamentare, hulumtimet ndërkombëtare dhe burimet e tjera të informacionit, përfshirë mediat sociale. Hulumtimi duhet të ofrojë përgjigje në pyetjen nëse grupet specifike mund të përjetojnë një ndikim ndryshe.

Ky hulumtim duhet të plotësohet me konsultimin e organeve publike dhe palëve të tjera të interesit. Konsultimi i brendshëm do të thotë, për shembull, diskutimet me organet zbatuese të asaj politike dhe duhet të mbulojnë si nivelin qendror ashtu edhe atë lokal. Kur ADS është veçanërisht e rëndësishme, ekspertëve nga këto organe duhet t'u kërkohet që të marrin pjesë në grupin punues për koncept dokumentin ose të paktën t'u kërkohet të ofrojnë një paraqitje të detajuar.

Analiza e drejtësisë sociale duhet të plotësohet me konsultimin e grupeve që ndikohen nga politika aktuale dhe do të ndikohen nga ndryshimet e propozuara në opsionet. Në veçanti duhet të punohet me OSHC-të që përfaqësojnë interesat e këtyre grupeve ose OSHC-të që punojnë në një fushë të caktuar të politikave. Për të identifikuar OSHC-të që janë relevante për ADS, kryesuesi i grupit punues për një koncept dokument duhet të kontaktojë me organizatat kornizë, siç janë CIVIKOS dhe KCSF (shih gjithashtu Pjesën 05 të Manualit - "Komunikimi dhe Konsultimi").



Figura 36: Rëndësia e komunikimit në kryerjen e analizës së drejtësisë sociale

Për të kryer në mënyrë efektive ADS-në, duhet të identifikohen grupet që parashihet se do të përjetojnë një ndikim më pak të favorshëm nga propozimi. Këto janë grupe që shpesh janë më të pabarabarta në krahasim me grupet e tjera të identifikuara. Natyrshëm, grupet në disavantazh përballen me më shumë vështirësi në paraqitjen e nevojave të tyre. Analfabetizmi mund të jetë më i lartë në mesin e tyre, ata mund të kenë më pak mundësi në qasjen dhe përdorimin efektiv të internetit, ose të kenë qasje të kufizuar në gazeta dhe lloje të tjera të informacionit.

Këto grupe ka të ngjarë që nuk mund të arrihen përmes aktiviteteve standarde të konsultimit dhe komunikimit. Për këtë arsye, është me rëndësi të madhe që aktivitete specifike të komunikimit të ndërmerren për ato grupe të pabarabarta, në përputhje me karakteristikat e tyre. Kjo do të mundësonte një identifikim të saktë të nevojave të tyre.

Gjatë ADS-së dhe sidomos gjatë konsultimeve me palët e interesuara si pjesë e ADS-së, vëmendja duhet t'u kushtohet grupeve (nëngrupeve) që në pamje të parë nuk shihen si shumë të rëndësishme për politikën. Rreziku është që grupet të mos analizohen në mënyrë të mjaftueshme dhe që karakteristika të rëndësishme të nëngrupeve të anashkalohen.

Për shembull, për politikën e Qeverisë që ka për qëllim ndërtimin e shkollave shtesë në një rajon të caktuar, vetëm fëmijët që jetojnë në atë rajon mund të shihen si grupi i synuar përkatës. Analiza e drejtësisë sociale synon të kontrollojë gjithashtu nëse nevojat e fëmijëve që jetojnë në rajone të tjera merren parasysh siç duhet. Këta fëmijë janë gjithashtu një grup i ndikuar pasi nuk përfitojnë shkolla shtesë.

Grupet e ndikuara duhet të identifikohen sa më saktë që të jetë e mundur. Kjo do të thotë që të merren në konsideratë karakteristika të ndryshme sociale dhe të tjera që mund të kenë një ndikim në mënyrën se si funksionojnë politikat qeveritare në praktikë.



Figura 37 - Grupet që mund të ndikohen në mënyra të ndryshme nga politikat:

- » Burrat/Gratë
- » Grupet etnike (shqiptarë, serbë, romë, ashkalinj, egjiptas (RAE), turq, boshnjakë, goranë, etj.)
- » Vendbanimi urban/rural
- » Personat me aftësi të kufizuara
- » Pensionistët/personat që pranojnë ndihmë sociale
- » Shërbyesit publikë (mësimdhënësit, mjekët, gjyqtarët, etj.)
- » Personat e papunë
- » Ata me shkollim të ulët/lartë
- » Ata që dinë shkrim lexim ose jo (ose njohuri për përdorim kompjuteri)
- » Studentët (nxënësit)
- » Bujqit

Përcaktimi i nevojave dhe ndarësive

Në procesin e identifikimit të grupeve të ndikuara, gjithashtu duhet të përcaktohen edhe nevojat e tyre. Nevoja i referohet një çështjeje që ndërlidhet në mënyrë specifike me një grup të caktuar. Ato mund të ndryshojnë nga njëri grup në tjetrin. Nevojat mund të përcaktohen në bazë të përvojës që grupet e ndikuara kanë pasur me politikën ekzistuese ose nga pritjet që ato kanë nga opsionet e propozuara. Duhet të theksohet se nevojat e identifikuara nga hulumtimet e literaturës dhe ato nga procesi i konsultimit (nevojat e vetidentifikuara të grupeve) mund të ndryshojnë dhe të jenë në kundërshtim me njëra-tjetrën. Prandaj është esenciale të bëhet një vlerësim i kujdesshëm për të përcaktuar nevojat reale të grupeve sa më saktë që të jetë e mundur.

Përveç kësaj, duhet të përcaktohen ndarësit thelbësore ndërmjet grupeve të ndikuara - siç janë dallimet ideologjike, etnike apo kulturore dhe mungesa e gjërave elementare për jetesë. Ndarësit potencialisht mund të çojnë në përvoja ose trajtim të ndryshëm të grupeve të ndryshme. Kjo, nga ana tjetër, mund të rezultojë në (ndjenjën e) përjashtimit(t) dhe tensione të tjera, të cilat janë faktorët nxitës të jostabilitetit social.



Figura 38: Pyetjet udhëzuese për identifikimin e nevojave dhe përcaktimin e ndarësve

- » A ka indikacione se grupe të caktuara janë të pabarabarta krahasuar me të tjerat?
- » A është korniza ligjore ekzistuese jodiskriminuese?
- » A ka përjetuar grupi probleme me paanshmërinë procedurale?
- » A ka përjetuar grupi vështirësi në qasjen e përfitimeve?
- » A është mbingarkuar grupi nga kërkesat për zbatimin e një politike dhe prandaj nuk ka mundur të gëzojë përfitimet që ofrohen?
- » A ka përjetuar grupi nivel të ndryshëm të cilësisë së përfitimeve apo kërkesave të përcaktuara në detyrime?
- » A janë pjesëtarët e një grupi të pabarabartë për arsyen e vetme se i përkasin atij grupi?
- » A janë pjesëtarët e një grupi të pabarabartë për shkak të mungesës së burimeve materiale apo jomateriale?
- » A ka ndikuar politika në marrëdhëniet ndërmjet këtij grupi dhe grupeve të tjera, sepse është parë sikur favorizon një grup në krahasim me grupin tjetër?
- » A ndihen pjesëtarët e një grupi veçanërisht të ndryshëm nga pjesëtarët e grupit tjetër?
- » A e konsideron grupi politikën e propozuar si përmirësim të gjendjes aktuale? Nëse jo, pse jo?



Figura 39 - Shembull i grupeve të ndikuara dhe nevojat e tyre në politikën e arsimit fillor

Përfitimet	Grupet	Nevojat
Arsimi i rregullt i detyrueshëm që u ofrohet falas fëmijëve sipas programit të Qeverisë	Fëmijët (klasat 1-9)	Vijojnë arsimin e rregullt, arsimin jashtë-programor, shujtat, posedojnë librat dhe materialet e tjera shkollore
Arsimi jo i detyrueshëm jashtëprogramor me pagesë	Prindërit/kujdestarët e fëmijëve (klasa 1-5) me të ardhura të ulëta dhe më shumë se 2 fëmijë	Para për të mbuluar shpenzimet e shujtave, transportin dhe arsimin jashtëprogramor të fëmijëve të tyre
Librat dhe materialet e tjera shkollore që ofrohen falas për fëmijët deri në klasën 5	Prindërit/kujdestarët e fëmijëve (klasa 1-5) me të ardhura të larta dhe 1 ose 2 fëmijë	Nuk kanë nevoja të veçanta
	Prindërit/kujdestarët e fëmijëve (klasa 6-9) me të ardhura të ulëta dhe më shumë se 2 fëmijë	Para për të mbuluar shpenzimet e shujtave, transportin, librat dhe materialet e tjera shkollore, si dhe arsimin jashtëprogramor
	Prindërit/kujdestarët e fëmijëve (klasa 6-9) me të ardhura të larta dhe 1 ose 2 fëmijë	Nuk kanë nevoja të veçanta

Siç shihet nga shembulli i mësipërm, analiza e drejtësisë sociale siguron informacionin mbi atë nëse arsyetohet ofrimi i mundësive shtesë për grupe të caktuara, që në të vërtetë të gëzojnë përfitimet që politikën e Qeverisë synojnë të ofrojnë. Kur grupet nuk janë në gjendje të përbushin detyrimet që politikën qeveritare imponojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi mbi ta, politikën nuk do të arrijnë rezultatin e synuar të barazisë. Në shembullin e përdorur, nocioni i të pasurit të shumicës së fëmijëve nga familjet e pasura të arsimuar dhe të kufizuarit e shanseve arsimore për fëmijët nga familjet e varfra krijon një ndarës të përhershëm ndërmjet tyre. Në të njëjtën kohë, sigurimi i një shërbimi, siç është autobusi shkollor, bën që të përfitojnë veçanërisht familjet me më pak mjete financiare, por e lehtëson jetën e çdo familjeje. Një shërbim i tillë për të gjithë ka gjasa gjithashtu të rrisë gatishmërinë për të mbështetur një veprim të tillë.

Vlerësimi i ndikimit të opsioneve të propozuara në grupet e ndikuara

Kur identifikohen përfitimet dhe detyrimet për çdo opSION të propozuar dhe grupet e ndikuara, hapi tjetër është vlerësimi i ndikimeve faktike të pritura.



Figura 40 - Pyetjet udhëzuese për të vlerësuar ndikimin e opsioneve të propozuara në grupet e ndikuara

- » A i plotësojnë përfitimet dhe detyrimet e propozuara të secilit opSION nevojat e grupeve të ndikuara?
- » A i fuqizojnë apo reduktojnë përfitimet dhe detyrimet e propozuara ndarësit ndërmjet grupeve të ndikuara?
- » A i reduktojnë përfitimet dhe detyrimet e propozuara pabarazitë aktuale?
- » A i përmirësojnë apo përkeqësojnë përfitimet dhe detyrimet e propozuara kushtet e jetesës së grupeve të ndikuara?
- » A ndikojnë pozitivisht apo negativisht përfitimet dhe detyrimet e propozuara në grupe që nuk kanë nevojë të veçanta të identifikuar?

Bazuar në pyetjet udhëzuese të listuara në tabelën e mësipërme, mund të ndërmerren veprime lehtësuese për të zvogëluar ndikimet negative. Këto mund të adresojnë nevojat specifike të grupeve dhe duhet të përdoren për të përditësuar dhe përmirësuar opsionet e identifikuar.

Analiza e drejtësisë sociale mund, për shembull, të sigurojë informacionin e nevojshëm për të ndryshuar një ligj, për të siguruar një trajtim të veçantë për një grup të caktuar me qëllim të sigurimit të drejtësisë; për të organizuar trajnimin e zyrtarëve dhe për të përshtatur praktikën zbatuese që de facto rezultuan në pabarazi; për të nxitur përfshirjen e një grupi të caktuar duke u dhënë atyre mbështetje specifike; për të parashikuar aktivitete dhe për të nxitur grupet për një ndërveprim më të madh (gjuhë, religjion, kulturë, tregti, shkollë, infrastrukturë të përbashkët); dhe masa të tjera për të zbutur situatat ekzistuese ose të mundshme që rezultojnë në situata në të cilat grupet nuk janë në gjendje të gëzojnë përfitimet e politikave qeveritare.



Figura 41: Shembull i veprimeve lehtësuese për politikën mbi arsimin fillor të cekura më sipër

Grupet	Veprimet lehtësuese
Prindërit/kujdestarët e fëmijëve (klasa 1-5) me të ardhura të ulëta dhe më shumë se 2 fëmijë	Subvencione për prindërit/shujta falas. Transport falas për në shkollë. Transformimi i arsimit jashtëprogramor në arsim të rregullt falas.
Prindërit/kujdestarët e fëmijëve (klasa 6-9) me të ardhura të ulëta dhe më shumë se 2 fëmijë	Subvencione për prindërit/shujta falas. Autobus falas për në shkollë. Libra dhe materiale tjera shkollore falas. Transformimi i arsimit jashtëprogramor në arsim të rregullt falas.

Veprimet lehtësuese duhet të trajtohen me përparësi bazuar në koston e zbatimit; përmasat e ndikimit (ndikimeve) në (nën) grupe, rrezikun e përkeqësimit të tensioneve ekzistuese ose krijimin e tensioneve të reja; dhe ndërlidhjen me objektivat dhe politikat strategjike të Qeverisë.



Figura 42: Tabela finale

	Përfitimet	Detyrimet	Grupet e ndikuara	Ndikimet pozitive (mbi nevojat dhe ndarësit)	Ndikimet negative (mbi nevojat dhe ndarësit)	Veprimet lehtësuese
Opsioni 1						(nuk zbatohen, pasi që Opsioni 1 duhet të jetë gjithmonë status-quo)
Opsioni 2						
Opsioni 3						

Gjetjet nga tabela e mësipërme duhet të paraqiten në formë të një raporti narrativ në Kapitullin 4 të koncept dokumentit. Raporti duhet të shtjellojë ndikimet pozitive dhe negative të përfitimeve dhe detyrimeve nga çdo opsion i propozuar në grupet e ndikuara. Veprimet lehtësuese duhet të integrohen në kapitullin 3 të KD, si modifikim i opsioneve të propozuara.



Figura 43: Realizimi i analizës së drejtësisë sociale

<input type="checkbox"/>	Analizoni sërish koncept dokumentin, në veçanti seksionet mbi përkufizimin e problemit, objektivat, opsionet dhe ndikimet e pritshme.
<input type="checkbox"/>	Identifikoni cilat grupe pritet të gëzojnë cilat përfitime. Përqendrohuni këtu në të mirat dhe shërbimet që ofrohen, për shembull subvencionet, pensionet, ndihma sociale, shërbimet arsimore, shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe zgjidhja e kontesteve.
<input type="checkbox"/>	Identifikoni detyrimet që grupet e ndryshme do të duhej t'i përmbushin. Përqendrohuni këtu në përgjegjësitë, për shembull koha e nevojshme (dhe në cilën kohë të ditës), pagesa e kontributeve apo tatimeve, në nevojën për shërbime komunale dhe kërkesat e transportit.
<input type="checkbox"/>	Listoni përfitimet dhe detyrimet e identifikuar për çdo opion të propozuar.
<input type="checkbox"/>	Kërkoni për grupe specifike të përmendura në përkufizimin e problemit, objektivat specifike dhe opsionet e propozuara. Bazuar në pyetjet udhëzuese për analizën e drejtësisë sociale, identifikoni nëse një grup ose nëngrup ishte ndikuar ndryshe krahasuar me grupet e tjera. Vlerësoni nëse kjo ende ndodh dhe nëse po, identifikoni nevojat dhe dallimet.
<input type="checkbox"/>	Angazhohuni në konsultime të brendshme me organet/zyrtarët zbatues, si të nivelit qendror ashtu edhe lokal.
<input type="checkbox"/>	Realizoni konsultime me palët e interesit, veçanërisht me grupet e ndikuara dhe OSHC-të që operojnë në sektorin që lidhet me temën e mbuluar nga koncept dokumenti.
<input type="checkbox"/>	Listoni grupet e ndikuara, nevojat e tyre dhe ndarësit mes tyre bazuar në tabelën për paraqitjen e ADS në një koncept dokument.
<input type="checkbox"/>	Diskutoni gjetjet nga analiza e drejtësisë sociale në një takim të grupit punues për hartimin e koncept dokumentit. Nëse është relevante, ftoni në takim palët e interesuara dhe organe të tjera publike me qëllim diskutimin e këtyre gjetjeve në takim.

MJETI 9: VLERËSIMI I NDIKIMIT TE TË RINJTË (VNRN)

Rëndësia e vlerësimit të ndikimit të të rinjtë


Të rinjtë janë grupmosha më e madhe e popullsisë së Kosovës. Ata luajnë rol kyç për të ardhmen e shoqërisë dhe të vendit. Është thelbësore që të krijohen kushte që u mundësojnë të rinjve të sotëm të zhvillojnë një jetë të suksesshme. Mundësitë e tyre socio-ekonomike duhet të rriten në mënyrë që të shfaqet dhe shfrytëzohet potenciali i të rinjve.

 Figura 44: Përkufizimi ligjor i të rinjve

Neni 3(1.1) i Ligjit nr. 03/L-145 për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë përkufizon moshën rinore/ të rinjtë si në vijim:

“Moshë rinore ose ‘i ri, e re’ - grupmosha e të rinjve prej pesëmbëdhjetë (15) deri njëzetekatër (24) vjeç.”

 Figura 45: Piramida e popullsisë, 2015




Burimi: Burrat dhe gratë në Kosovë. Agjencia e Statistikave të Kosovës 2016.

Fatkeqësisht, të rinjtë në Kosovë duhet të përballen me një sërë sfidash dhe vështirësish. Këto kanë efekt negativ në shanset e tyre në jetë, zhvillim të karrierës së tyre profesionale dhe mundësitë që ata kanë për të jetuar në mënyrë të pavarur. Sfidat dhe vështirësitë lidhen kryesisht me aspektet e mëposhtme: qasjen në arsim; cilësinë e arsimit; punësimin, shëndetin; pjesëmarrjen qytetare dhe politike; dhe sigurinë.

Papunësia e të rinjve të Kosovës është një nga më të lartat në rajon, tri herë më e lartë se mesatarja e BE-së dhe rreth 10% më e lartë se e vendeve me papunësinë më të madhe të të rinjve në BE, si Greqia dhe Spanja.



Figura 46: Shkalla e papunësisë e të rinjve në vitin 2015



Burimi: Raportet e Komisionit Evropian për secilin vend për vitin 2016 dhe Eurostat: Statistikat e papunësisë 2015

Politikat e mangëta dhe joefektive mund të krijojnë vështirësi shtesë dhe të padëshiruara. Një rast i humbur për të rinjtë prodhon efekte të menjëhershme negative. Megjithatë, efektet për individët dhe shoqërinë mund të shfaqen shumë më vonë. Për shembull, rastet për punësim dëmtohen nga mungesa e arsimit ose nga cilësia e ulët e arsimit ekzistues. Niveli arsimor që të rinjtë mund të arrijnë në pesë vjetët e ardhshme ka ndikim të madh në mundësitë e tyre më vonë. Arsimi i pamjaftueshëm pra mund të sjellë papunësi. Papunësia sjell varfëri. Të qenit i varfër, pa sigurim shëndetësor, e bën më të vështirë adresimin e problemeve shëndetësore. Rastet e humbura për të rinjtë sot nënkupton që një numër i madhi tyre mund, kur të bëhen të rritur, të punojnë në ekonominë gri apo atë të zezë. Në rastin më të keq, disa individë mund t'i kthehen krimin, të jenë subjekt i eksploatimit ose të emigrojnë ilegalisht. Politikat e papërshtatshme rrezikojnë të vënë në situatë më të papërshtatshme disa të rinj, krahasuar me brezin e tanishëm të të rinjve. Efekti do të ndihet në të ardhmen nga mundësitë e humbura ose zbehja e perspektivave për zhvillim ekonomik, qytetar dhe politik. Këto, nga ana tjetër, do të kenë një kosto shumë të lartë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë për shoqërinë.

Veprimet e Qeverisë që synojnë të mbështesin të rinjtë kryesisht prodhojnë efektet e dëshiruara 5 deri në 10 vjet më vonë. Duke pasur parasysh këtë, propozimet e politikave duhet të synojnë identifikimin e efekteve eventuale të menjëhershme dhe të mëvonshme të të rinjtë dhe shoqëria. Qëllimi është të zhvillohen politika të mira që zbusin dhe eliminojnë efektet negative sa më shumë që të jetë e mundur. Politikat e tilla përmirësojnë mundësitë që të rinjtë e tanishëm të kenë jetë të pavarur dhe të arrijnë prosperitet në të ardhmen.



Figura 47: Grupi NEET

NEET është akronim për 'personat që nuk janë të punësuar, as në shkollim, as trajnim'. Pothuajse një e treta (30.1%) e të rinjve në Kosovë i përkasin këtij grupi. Kjo shifër është 26.5% për meshkujt e rinj dhe 34.2% për femrat e reja.

Grupit NEET duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë gjatë zbatimit të vlerësimit të ndikimit të të rinjtë.

Burim i këtyre të dhënave është 'Anketa e fuqisë punëtore 2016' e Agjencisë së Statistikave të Kosovës.

Shembulli i pemës së problemit më poshtë tregon se si faktorët, të tillë si mangësitë e politikave dhe mangësitë e tjera, ndikojnë në suksesin e ardhshëm të të rinjve, pasi këta faktorë bëjnë që një numër i madh i të rinjve të jenë pjesë e grupit NEET.



Figura 48: Shembulli i pemës së problemit në lidhje me të rinjtë që i përkasin grupit NEET, e të cilët vijnë nga zonat rurale në rajonin XY

EFEKTET INDIVIDUALE

Depresion ose abuzim me përdorimin e substancave - që mund të shpie në vetëvrasje.

Nivel i ulët ndërgjegjësimi për masat parandaluese të sëmundjeve.

Hyrje në ekonominë gri apo në krim.

Mungesë e njohurive dhe aftësive për kycje në tregun e punës.

Mungesë e pjesëmarrjes qytetare apo politike.

Varësi nga sistemi social.

EFEKTET SHOQËRORE

Zhvillim më i ulët ekonomik.

Shkallë më e lartë e krimit.

Vuajtje psikologjike për familjet e të rinjve.

Rritje e shpenzimeve mjekësore.

Rritje e shpenzimeve sociale.

Pjesëmarrje më e ulët demokratike.

PROBLEMI

Numri i lartë i të rinjve në grupin NEET.

SHKAQET

Shkollat e stërbushura që punojnë me tri ndërrime.

Shkollat në distancë të madhe - mungesa e infrastrukturës.

Mësimdhënësit jo të specializuar - një mësimdhënës ligjëron tri ose më shumë lëndë të ndryshme.

Familjet e varfra që nuk janë në gjendje t'i dërgojnë fëmijët e tyre në AAP ose në arsim të lartë jashtë rajonit të tyre.

Mungesa e Arsimit dhe Aftësisit Profesional (AAP) dhe e institucioneve të arsimit të lartë në rajonin ku banojnë.

Mundësitë e pakta të edukimit joformal. Shumica e aktiviteteve janë ad hoc dhe të shkurtra.

Mundësitë e pakta të edukimit joformal. Shumica e aktiviteteve janë ad hoc dhe të shkurtra.

Të rinjtë e angazhuar në punët e shtëpisë për të cilat nuk paguhen dhe shkollimi shihet nga familjet si më pak i rëndësishëm.

Familjet vendosin për zgjedhjet jetësore të fëmijëve të tyre (në arsimim, martesë etj.), veçanërisht për femrat e reja.

Kontrolli i shpejtë i vlerësimit të ndikimit të rinjtë

Nëse vlerësimi i ndikimit të rinjtë është relevant apo jo për një koncept dokument, varet nga çështja që adresohet. VNR është relevant vetëm për politikat që ndikojnë në dimensionet e suksesit të rinjve në të ardhmen. Ky sukses lidhet në veçanti me arsimin dhe aftësitë, punësimin, shëndetin, pjesëmarrjen qytetare dhe sigurinë.

Masat e shqyrtuara në opsionet e propozuara duhet të vlerësohen në detaje për të parë nëse ato lidhen me ndonjë nga dimensionet që përcaktojnë suksesin e të rinjve në të ardhmen.



Figura 49: Aspektet e dimensioneve të suksesit në të ardhmen

Arsimi dhe aftësitë	Punësimi	Shëndeti
<ul style="list-style-type: none"> • Qasja në arsim • Cilësia e arsimit • Edukimi joformal • AAP • Të mësuarit gjatë gjithë jetës 	<ul style="list-style-type: none"> • Qasja në punësim • Cilësia e punësimit • Mundësitë e ndërmarrësisë • Trajnimi në punë • Praktika profesionale 	<ul style="list-style-type: none"> • Parandalimi i sëmundjeve • Qendrat shëndetësore miqësore ndaj të rinjve • Shëndeti seksual dhe riprodhues • Abuzimi me substancat (droga, alkooli, duhani etj.)
Pjesëmarrja civile	Siguria	
<ul style="list-style-type: none"> • Shoqatat • Angazhimi politik • Vullnetarizmi • Bashkëpunimi ndërmjet të rinjve me karakteristika të ndryshme • Pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrjen e Qeverisë • Aktivitetet kulturore, sportive dhe rekreative 	<ul style="list-style-type: none"> • Parandalimi i krimit • Siguria në trafik • Mbrojtja e mjedisit 	

Grupi punues për KD duhet të diskutojë për ndërlidhjen e opsioneve të propozuara me aspektet e renditura në tabelën e mësipërme. Për të forcuar analizën duhet të konsultohen përfaqësues të të rinjve, ekspertë për të rinjtë dhe ekspertët e politikave nga dimensionet përkatëse. Këta ekspertë duhet të jenë si profesionistët nga administrata, ashtu dhe akterët e jashtëm.

Vlerësimi i ndikimit të rinjtë duhet të zbatohet atëherë kur grupi punues arrin në përfundim se dimensionet e të rinjve do të ndikohen. Analiza duhet të përqendrohet në ato dimensione të suksesit në të ardhmen për të cilat GP konsideron se do të ndikohen.



Figura 50: Shembull i masave që ndikojnë në aspekte të dimensioneve të suksesit të të rinjve në të ardhmen

Propozimi i politikave mbi riorganizimin e sistemit shëndetësor parashikon masa për rinovimin e objekteve ekzistuese dhe ndërtimin e objekteve të reja shëndetësore. Ky propozim pa dyshim ndikon në dimensionin e shëndetit dhe të gjitha aspektet e tij për të rinjtë. Për vlerësimin e ndikimit, duhet të përcaktohet nëse politika parasheh, për shembull, krijimin e objekteve shëndetësore miqësore ndaj të rinjve, veçanërisht në shkollë.

Objektet shëndetësore miqësore ndaj të rinjve janë ato të përshtatura posaçërisht për rininë dhe që plotësojnë nevojat e tyre specifike. Ato duhet të jenë të barabarta/paanshme, të qasshme, të pranueshme, të përshtatshme dhe efektive. Për shembull, një shërbim shëndetësor riprodhues, miqësor për të rinjtë, duhet të jetë i qasshëm gjeografikisht dhe financiarisht dhe duhet të përfshijë ofruesit e trajnuar, mbrojtjen e konfidencialitetit dhe privatësinë e të rinjve.

Vlerësimi i ndikimit të politikave të propozuara te të rinjtë

Kur kontrolli i shpejtë tregon se vlerësimi i ndikimit të të rinjtë është i nevojshëm, duhet të analizohet konteksti i dimensioneve të ndikuara. Analiza duhet të përfshijë tri karakteristika: kushtet ekzistuese, pikëpamjet dhe nevojat, si dhe efektet në të ardhmen.



Figura 51: Pyetjet udhëzuese për vlerësimin e ndikimit të të rinjtë

Kushtet ekzistuese të të rinjve në dimensionin e ndikuar	Pikëpamjet dhe nevojat e të rinjve për masat e propozuara në KD	Efektet eventuale të menjëhershme dhe të mëvonshme të masave të propozuara në të ardhmen
<ol style="list-style-type: none"> 1 Cili është opinioni i të rinjve për gjendjen aktuale? 2 A ka ndonjë vështirësi me të cilën përballen të rinjtë? 3 Nëse po, cilat janë këto vështirësi? 4 A ka shembuj të mirë dhe praktika më të mira që mund të përdoren? 5 A është ndonjë grup i veçantë i të rinjve në disavantazh më shumë se grupet e tjera? 6 Nëse po, për çfarë arsye? 	<ol style="list-style-type: none"> 1 Cilat janë pikëpamjet e të rinjve për propozimin? 2 Cilat janë nevojat specifike të të rinjve (transporti në shkollë, më shumë objekte sportive, etj.)? 3 A do ta ndryshojë propozimi gjendjen aktuale? 4 A janë ndryshimet e pritura pozitive apo negative? 5 Si mund të përmirësohet propozimi, sipas pikëpamjes së tyre ose sipas ekspertëve? 	<ol style="list-style-type: none"> 1 Cilat janë efektet pozitive dhe negative të menjëhershme dhe të mëvonshme të të rinjtë? 2 Cilat janë efektet pozitive dhe negative të menjëhershme dhe të mëvonshme të shoqëria?

Informacione relevante dhe të besueshme duhet të mblidhen për të analizuar kontekstin specifik të të rinjve dhe për të dhënë përgjigje në pyetjet relevante, siç janë paraqitur në figurën e mësipërme. Hulumtimi i literaturës shpesh do të sigurojë një masë substanciale të informacioneve relevante. Ky informacion mund të përdoret për të përkufizuar më tej problemin, objektivat dhe opsionet. Informacioni që është relevant për vlerësimin e ndikimit të të rinjtë mund të vijë nga burime të ndryshme: raporte qeveritare dhe raporte tjera, artikuj të lajmeve, deklarata për shtyp, diskutime online, etj.

Hulumtimi i literaturës duhet të plotësohet me konsultim të brendshëm dhe me një konsultim të targetuar që përfshin të rinjtë dhe/ose ekspertët përkatës. Kjo nënkupton në veçanti procesin e konsultimit dhe caktimin e të rinjve për aktivitetet e komunikimit. Mesazhet dhe kanalet e komunikimit duhet të përzgjidhen me kujdes për të siguruar konsultime efektive.



Figura 52: Sigurimi i një procesi të duhur të komunikimit dhe konsultimit për vlerësimin e ndikimit të të rinjtë

- 1 Konsultoni përbrenda** institucionet përkatëse. Konsultoni nivelin lokal, gjegjësisht komunitat, të cilat ndikohen nga propozimi (drejtoritë komunale përkatëse për arsim, kulturë, rini, sport dhe shëndetësi). Konsultoni nivelin qendror (Departamentin e Rinisë në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit; dhe departamentet tjera relevante në kuadër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale; Ministrisë së Shëndetësisë; Ministrisë së Punëve të Brendshme; Ministrisë së Drejtësisë; Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; dhe Zyrës së Kryeministrit).
- 2 Informoni të rinjtë** rreth politikës së propozuar, masave dhe objektivave të saj. Konsideroni zhvillimin e fushatave të komunikimit, specifike për të rinjtë. Përdorni të gjitha kanalet përkatëse për përcjelljen e mesazheve përkatëse, në veçanti mediat sociale. Informoni audiencën e synuar në një mënyrë të përshtatshme që e bën të lehtë për të rinjtë të kuptojnë informacionin dhe rëndësinë e përfshirjes së tyre.
- 3 Konsultoni të rinjtë** dhe shoqatat e tyre. Vlerësoni formatin dhe lokacionin më të mirë për konsultim, pasi që takimet zyrtare mund të mos japin rezultatet e synuara. Diskutoni paraprakisht për procesin e konsultimit dhe aktivitetet specifike me akterët kryesorë.
- 4 Siguroni komunikimin me grupet e të rinjve**, të cilat nuk janë lehtësisht të arritshme, p.sh. të rinjtë me aftësi të kufizuara, të rinjtë që jetojnë në zonat rurale ose që u përkasin pakicave.
- 5 Konsultoni organizatat joqeveritare dhe partnerët e zhvillimit** që punojnë në çështjet që lidhen me zhvillimin ekonomik, arsimin, punësimin, shëndetësinë, mjedisin, sigurinë, drejtësinë dhe çështjet politike. Qëllimi i konsultimit është marrja e opinionit të tyre mbi gjendjen ekzistuese, pikëpamjet dhe nevojat e të rinjve, si dhe mbi efektet eventuale të menjëhershme dhe të mëvonshme mbi të rinjtë dhe shoqërinë. Organizatat relevante mund të jenë: një organizatë ndërkombëtare që zbaton një projekt në fushën e arsimit, një think tank që analizon faktorët relevantë për zhvillimin ekonomik të Kosovës, ose organizatat bazë që hulumtojnë faktorët shtytës të papunësisë së lartë të të rinjve.

Është shumë e rëndësishme të kemi parasysh se të rinjtë nuk janë një grup homogjen. Për shkak të karakteristikave të ndryshme, grupet e veçanta të të rinjve do të përjetojnë ndikim të ndryshëm nga grupet e tjera. Këto grupe mund të dallojnë nga gjinia, etnia, vendbanimi urban/rural, aftësitë e kufizuara dhe karakteristika të tjera. Në këtë rast, duhet të merret në konsideratë përdorimi i Mjetit #8 Analiza e drejtësisë sociale, për sigurimin e rezultateve të barabarta për të gjitha grupet e të rinjve.

Pas hulumtimeve të literaturës dhe konsultimeve, hapi përfundimtar është vlerësimi i ndikimeve të masave të propozuara në KD. GP duhet të vlerësojë në mënyrë specifike:

- » ndikimin e masave të propozuara në kushtet ekzistuese të të rinjve,
- » nëse këto masa plotësojnë pikëpamjet dhe nevojat e të rinjve, dhe
- » efektet e tyre mbi të rinjtë dhe shoqërinë.



Figura 53: Shembull i vlerësimit të ndikimit të shërbimeve shëndetësore miqësore ndaj të rinjve

Masa	Ndikimi
Krijimi i objekteve shëndetësore miqësore ndaj të rinjve për shëndetin riprodhues	<p>Kushtet ekzistuese – Nuk ka objekte të tilla. Të rinjtë aktualisht shërbehen nga ofruesit e përgjithshëm që nuk janë të përgatitur për nevojat specifike të të rinjve.</p> <p>Prandaj ndikimi i masës është pozitiv.</p>
	<p>Pikëpamjet dhe nevojat – Të rinjtë e ndikuar nga propozimi janë të mendimit se shërbimet shëndetësore miqësore ndaj të rinjve janë të nevojshme dhe pozitive për shëndetin e tyre riprodhues. Ekspertët e kujdesit shëndetësor dhe të të rinjve ndajnë këto pikëpamje.</p> <p>Pikëpamjet dhe nevojat e tyre janë përbushur.</p>
	<p>Efektet e të rinjtë – Të menjëhershme: Mbrojtja e shëndetit riprodhues. Parandalimi i sëmundjeve të transmetueshme. Parandalimi i shtatzënisë së hershme. Të mëvonshme: Rritja e mundësive të tyre për të zhvilluar një jetë të pavarur dhe punësim. Përfshirja sociale.</p> <p>Efektet në shoqëri – Të menjëhershme: Rritja e kostove shëndetësore të menjëhershme. Më pak sëmundje të transmetueshme. Të mëvonshme: Zvogëlimi i kostove të përgjithshme të kujdesit shëndetësor dhe asistencës sociale. Më pak fëmijë të braktisur dhe familje të shqetësuara. Të ardhura më të larta nga taksat.</p>

Masat e propozuara dhe rezultatet e vlerësimit duhet të renditen në tabelën më poshtë. Nëse ndikimi është negativ, GP duhet të zhvillojë veprime lehtësuese, në formë të rekomandimeve për modifikimin e opsioneve të propozuara. Veprime të tilla, në varësi të temës, mund të përfshijnë p.sh. krijimin e qendrave për edukimin joformal; fushata kundër abuzimit të substancave; instalimin e kamerave të sigurisë në shkolla etj. Tabela duhet të elaborohet në KD: ndikimet e parashikuara në Kapitullin 4 dhe veprimet lehtësuese në Kapitullin 3 mbi opsionet.



Figura 54: Vlerësimi i ndikimit të të rinjtë: përmbledhje

Masat	Ndikimi në kushtet ekzistuese	A janë trajtuar pikëpamjet dhe nevojat e të rinjve?	Efektet tek të të rinjtë dhe shoqëria	Veprimet lehtësuese
Opsioni 1 (status-quo)				Nuk parashihet ndryshim i politikës
Opsioni 2				
Opsioni 3				



Figura 55: Kryerja e Vlerësimit të Ndikimit tek të Rinjtë

<input type="checkbox"/>	Analizoni përsëri KD, në veçanti pjesët mbi definimin e problemit, objektivat, opsionet dhe ndikimet e pritura.
<input type="checkbox"/>	Identifikoni masat e parashikuara nga opsionet e paraqitura në KD.
<input type="checkbox"/>	Vlerësoni nëse këto masa ndikojnë në dimensionet e suksesit të të rinjve në të ardhmen dhe identifikoni se si ndikohen këto dimensione.
<input type="checkbox"/>	Analizoni kontekstin e dimensioneve të ndikuara që kanë të bëjnë me suksesin në të ardhmen. Analizoni kushtet ekzistuese të të rinjve, pikëpamjet dhe nevojat e tyre dhe efektet eventuale të menjëhershme dhe të mëvonshme/ në të ardhmen për ta dhe për shoqërinë.
<input type="checkbox"/>	Siguroni informacione nga hulumtimi i literaturës dhe konsultimi.
<input type="checkbox"/>	Strukturoni ndikimin e masave të propozuara të të rinjtë duke përdorur pyetjet udhëzuese dhe përmbledhjen e vlerësimit të ndikimit të të rinjtë. Nëse ndikimi është negativ, zhvilloni veprime lehtësuese në formë të rekomandimeve për modifikimin e politikave.
<input type="checkbox"/>	Renditni të gjeturat tuaja në koncept dokument.

MJETI 10: PLANI I ZBATIMIT PËR OPSIONET E POLITIKAVE

Përkufizimi i problemit tregon shkaqet dhe ndikimet e problemit që është identifikuar. Opsionet tregojnë zgjidhjet e mundshme për të trajtuar shtytësit ose për të zbutur shkaqet negative.

Opsionet duhet të bëhen funksionale në praktikë. Nëse qëndrojnë vetëm në letër, situata aktuale nuk do të ndryshojë aspak. Secili opsion, përfshirë edhe opsionin “asnjë ndryshim”, është bazë për punën që duhet të bëhet: punën nga administrata, punën nga kompanitë, punën nga shoqëria civile dhe punën nga qytetarët.

Kjo punë kërkon burime. Këtu mund të përfshihen: koha e punës që nëpunësit civilë duhet të investojnë në trajnime; buxheti që duhet të rezervohet për prokurimin/blerjen e materialeve; aktivitetet nga kompanitë që duhet të përputhen me legjislacionin e ri; si dhe koha që qytetarët duhet të shpenzojnë për respektimin e rregulloreve.



Figura 56: Plani i zbatimit dhe logjika produkt-aktivitet

Plani i zbatimit është mjet që ilustron në detaje punën e nevojshme për të zbatuar opsionet e politikave dhe për të arritur qëllimet dhe objektivat e politikave. Plani liston aktivitetet, produktet (outputs) dhe afatet kohore me qëllim të zbatimit të opsioneve të politikave .

Raporti mes produkteve dhe aktiviteteve duhet të jetë logjik. Për shembull, një shërbim nuk mund të ofrohet pa krijuar strukturat organizative për ofrimin e shërbimit. Përfitimet nuk mund t'i paguhen ndonjë qytetari nëse nuk ka një departament të ngarkuar për pagesat. Ky departament duhet të ketë numër të duhur të personelit dhe infrastrukturë të TI-së.

Plani i zbatimit është një përmbledhje e produkteve (outputs) dhe burimeve të nevojshme nga administrata. Ai përcakton produktet që duhet të zhvillohen, aktivitetet që duhet të kryhen për t'i zhvilluar këto produkte, tregon se kush është përgjegjës për këto aktivitete dhe tregon afatet për të përfunduar këto detyra. Plani i zbatimit duhet të përmbajë të gjitha produktet e nevojshme për zbatim të suksesshëm të opsionit të politikave.



Figura 57: Shembuj të produkteve (outputs) dhe aktiviteteve

Shembulli 1

Produkti: Inspektorë të trajnuar për të përmirësuar zbatimin e rregullave ekzistuese.

Aktivitetet: Zhvillimi i programit të trajnimit dhe certifikimi i inspektorëve të ardhshëm; rezervimi i buxhetit për zbatimin e programit; identifikimi i trajnerëve; trajnimi i inspektorëve të ardhshëm; sigurimi i certifikimit të inspektorëve.

Shembulli 2

Produkti: Fushata informuese për të adresuar problemin.

Aktivitetet: Zhvillimi i një plani të komunikimit së bashku me Divizionin për Komunikim me Publikun; planifikimi i buxhetit për fushatën informuese; prokurimi i shërbimeve; lansimi i fushatës; monitorimi i aktiviteteve të fushatës; vlerësimi i ndikimit të fushatës informuese.

Shembulli 3

Produkti: Ligji i ndryshuar për të adresuar një mangësi rregullative.

Aktivitetet: Hartimi i ndryshimeve të ligjit; konsultimi me ministrinë përkatëse dhe palët e interesuara gjatë zhvillimit të ndryshimeve; paraqitja e projekt-ndryshimeve për konsultime ndërministrorë; paraqitja e projekt-ndryshimeve për konsultim publik nëpërmjet faqes së internetit të konsultimit online; paraqitja e projekt-ndryshimeve me të gjitha dokumentet relevante mbështetëse për miratim nga Qeveria; sigurimi i miratimit të projekt-ndryshimeve nga Parlamenti; sigurimi që organizatat zbatuese të kenë kohë të mjaftueshme, burime njerëzore dhe buxhetore për të zbatuar ndryshimet; informimi i qytetarëve / kompanive / organizatave rreth ndryshimeve.

Koncept dokumentet janë baza për hartimin e ligjeve të reja, për ndryshimin e atyre ekzistuese dhe për shumë masa të tjera që Qeveria i miraton. Aktivitetet që pasojnë nga një koncept dokument marrin kohë. Për shembull, hartimi i propozimit për një ligj të ri, konsultimi me palët e interesuara për këtë propozim, miratimi i propozimit nga Qeveria dhe aprovimi nga Parlamenti mund të zgjasin një vit ose më shumë. Në fakt, për përgatitjet për zbatimin e një ligji të ri nëpërmjet trajnimit të inspektorëve, informimit të qytetarëve dhe kompanive dhe prokurimeve/zhvillimit të materialeve/shërbimeve përkatëse, do të duhen të paktën disa muaj. Vetëm pasi të përfundohen të gjitha këto aktivitete, ligji mund të zbatohet në praktikë.

Siç shihet në figurën e mësipërme, zbatimi i një politike duhet të bazohet në zbatimin afatmesëm. Prandaj, një plan i zbatimit duhet të mbulojë periudhën prej 3 deri në 5 vjet. Kjo periudhë është e nevojshme për t'u siguruar që, për shembull, kapacitetet janë zhvilluar dhe institucionet dhe popullata janë informuar. Gjithashtu, kjo kohë është e nevojshme për të integruar një politikë të re në kornizën e politikave dhe për të siguruar që zbatimi i saj të bëhet proces standard. Përmbledhja më poshtë ofron një model për një plan të zbatimit.



Figura 58: Shembuj të planit të zbatimit

Qëllimi i politikës								
Objektivi strategjik								
	Produktet, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës							
Objektivi Specifik 1	Produkti 1.1		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni / departamenti përgjegjës
		Aktiviteti 1.1.1						
	Aktiviteti 1.1.2							
	Aktiviteti 1.1.3							
	Produkti 1.2		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni/ departamenti përgjegjës
		Aktiviteti 1.2.1						
Objektivi Specifik 2	Produkti 2.1	Etj.						
	Produkti 2.2	Etj.						
Objektivi Specifik N	Produkti N.1	Etj.						

Plani i zbatimit shërben si input i dobishëm për dokumentet e planifikimit qendror të Qeverisë. Për shembull, aktivitetet mund të pasqyrohen në Planin vjetor të punës së Qeverisë. Plani i zbatimit gjithashtu mund të shërbejë si bazë për procesin e buxhetimit kur kërkohen burime shtesë për zbatimin e opsioneve. Kjo çështje trajtohet në Mjetin 11: Kostimi për koncept dokumente, dhe Mjetin 12: Pajtuueshmëria me vlerësimin e ndikimit buxhetor.

MJETI 11: KOSTIMI PËR KONCEPT DOKUMENTE

Rezultatet dhe aktivitetet sigurojnë bazën për përcaktimin e kostove që shkaktohen kur një opsion zbatohet. Këto janë kostot vetëm për buxhetin e Kosovës. Kostot e tjera, siç janë ato për kompanitë dhe qytetarët, llogariten me anë të mjeteve të tjera.

Kostot buxhetore me siguri kanë vlerë kur nevojiten për adresimin e një problemi shumë të rëndësishëm. Në rastet kur kostot e pritshme janë të ulëta dhe përfitimet e parashikuara janë të larta, ia vlen të zbatohet një opsion.

Vlerësimi i kostove të ardhshme për zbatimin e opsioneve të politikave është një faktor i rëndësishëm për të vendosur cili opsion të zgjidhet. Gjithashtu ndihmon me rivlerësimin e fizibilitetit praktik të opsioneve, të afateve që janë përcaktuar për zbatim dhe pengesave të mundshme. Një kostim i detajuar i opsioneve, me pak fjalë, përmirëson cilësinë e analizës për një koncept dokument. Ai ofron njohuri thelbësore për nevojat e financimit të organizatave të përfshira në zbatimin e politikave.



Figura 59: Kategoritë kryesore të kostove që duhet të përcaktohen gjatë hartimit të politikave

1. Burimet njerëzore (pagat dhe mëditjet)
2. Prokurimi i shërbimeve (mallrat dhe shërbimet)
3. Prokurimi i mallrave (mallrat dhe shërbimet)
4. Mbështetja direkte për përfituesit (subvencionet dhe transferet)
5. Investimet në pajisje (shpenzimet kapitale)
6. Investimet në infrastrukturë (shpenzimet kapitale)

Plani i zbatimit është mjeti kyç për të përcaktuar kostot për zbatimin e vendimeve të paraqitura në një koncept dokument. Plani ofron përmbledhjen e produkteve dhe aktivitetet e nevojshme për arritjen e tyre. Kostot e aktiviteteve të veçanta mund të vlerësohen duke vlerësuar burimet njerëzore dhe buxhetin e nevojshëm për realizimin e tyre. Llogaritja e kostove të të gjitha aktiviteteve për një produkt (output) jep koston e atij produkti. Pasi që plani i zbatimit tashmë rendit aktivitetet dhe tregon se kush është përgjegjës për zbatimin e tyre, kostimi nënkupton vlerësimin e përpjekjeve të nevojshme për të siguruar se aktivitetet mund të realizohen. Përmbledhja e mëposhtme tregon hapat e nevojshëm për të kryer një kostim adekuat të opsioneve të politikave.



Figura 60: Procesi i kostimit të opsioneve të politikave

Hapi	Përshkrimi
Hapi 1: Përcaktoni produktet dhe afatin kohor për arritjen e tyre Hapi 1: Përcaktoni produktet dhe afatin kohor për arritjen e tyre	Plani i zbatimit tashmë e ofron këtë informacion. Në qoftë se një plan i tillë nuk është bërë, rezultatet duhet të shprehen qartë, së bashku me afatin kohor në të cilin ato duhet të arrihen.
Hapi 2: Përcaktoni aktivitetet	Aktivitetet nevojiten për të siguruar arritjen e rezultateve. Këto aktivitete duhet të renditen në mënyrë të qartë. Në rastet kur një plan i zbatimit është zhvilluar paraprakisht, ky informacion tashmë është pjesë e planit.
Hapi 3: Identifikoni burimet e nevojshme	Burimet janë të nevojshme për secilin aktivitet. Ato duhet të identifikohen në mënyrë të qartë. Në këtë fazë, duhet të bëhet dallimi në mes të përdorimit të burimeve ekzistuese dhe burimeve të reja. Për shembull, për të hartuar një ligj, shpesh mjaftojnë burimet njerëzore ekzistuese brenda një ministrie të linjës. Megjithatë, me qëllim të zbatimit të ligjit, mund të nevojiten burime shtesë. Këtu mund të përfshihet stafi shtesë, por edhe automjete dhe materiale të tjera. Nëse këto ende nuk janë siguruar, do të krijohen kosto të reja. Këto kosto do të duhej të mbulohej nga buxheti, për të siguruar që zbatimi të mos pengohet.
Hapi 4: Kontakttoni Departamentin e Buxhetit për finalizimin e kostimit	Secili departament i buxhetit ka specialistë që merren me kostimin e politikave. Ata janë të familjarizuar me metodologjinë e detajuar të kostimit. Ata gjithashtu mund të mbështeten në përvojën e mëparshme me kostimin e politikave. Me rëndësi: edhe kur një përfaqësues i Departamentit të Buxhetit është pjesë e grupit punues për koncept dokumentin, planifikoni një takim të ndarë për kostimin e opsioneve.
Hapi 5: Finalizoni kostot për aktivitetet	Kostimi i politikave bazohet në një metodologji të kostimit të zhvilluar nga Ministria e Financave. Lloje të ndryshme të kostove, p.sh. ato për burimet njerëzore ose pajisjet, etiketohen me kode të ndryshme. Kjo e bën më të lehtë analizimin e shifrave të kostimit. Kur koncept dokumenti miratohet, kodet lejojnë një integrim më të lehtë të shifrave të kostimit në procesin buxhetor. Është zhvilluar një dokument i veçantë në Excel për kostimin e koncept dokumentit. Ky dokument-excel është në dispozicion në internet, është shpërndarë te të gjitha departamentet e buxhetit të ministrive të linjës dhe gjithashtu mund të kërkohet nga SKQ-ja. Specialistët e buxhetit do të jenë në gjendje t'ju ndihmojnë me finalizimin e llogaritjeve të kostimit.

<p>Hapi 6: Mbledhja e kostos</p>	<p>Gjatë përdorimit të formularit për kostim për koncept dokumente, kostot totale do të llogariten në mënyrë automatike. Nëse nuk e përdorni formularin, sigurohuni që të mblidhni të gjitha kostot për të gjitha aktivitetet dhe rezultatet siç duhet. Kjo është thelbësore për hapin e ardhshëm.</p>
<p>Hapi 7: Identifikoni dhe mblidhni kursimet</p>	<p>Përveç fillimit të aktiviteteve shtesë dhe shfaqjes së kostove të reja, ekziston mundësia e ndërprerjes së aktiviteteve të caktuara ose thjeshtimit të tyre. Kjo çon në ulje të kostove për zbatim të politikave. Këto reduktime të kostove duhet të merren parasysh gjatë vlerësimit të nevojave të ardhshme të buxhetit. Këto përcaktojnë nëse është i nevojshëm buxhet shtesë ose nëse zhvendosja e buxhetit ose zhvendosja e aktiviteteve do të ishte e mjaftueshme për të zbatuar opsionet që janë analizuar në koncept dokument.</p>
<p>Hapi 8: Vlerësoni nëse është i nevojshëm vlerësimi i ndikimit buxhetor</p>	<p>Koncept dokumentet janë baza për veprime të reja të politikave të qeverisë. Zbatimi i opsionit që është zgjedhur përfundimisht, duhet të planifikohet mirë në mënyrë që përfitimet e pritura të materializohen. Në praktikë kjo do të thotë se nëse nuk ka buxhet (të mjaftueshëm) të ndarë për zbatimin e një politike, asgjë nuk do të ndryshojë. Nëse kjo ndodh, do të thotë se është bërë shumë punë për asgjë. Pritjet që situata do të përmirësohet do të shpartallohen.</p> <p>Bazuar në shifrat e kostimit dhe kursimit që rezultojnë nga llogaritja, është e mundur që të përcaktohet nëse kostoja e përgjithshme ende bie në kuadër të buxhetit në dispozicion të ndonjë ministrie. Secila ministri ka të ashtuquajturat kufizime buxhetore. Nëse kostot e nevojshme për zbatim janë nën tavanin buxhetor për një ministri, hapi tjetër do të ishte ndarja e buxhetit të nevojshëm në mënyrë që të qartësohet se fondet janë në dispozicion kur zbatimi të fillojë.</p> <p>Mund të ndodhë që të mos ketë buxhet të mjaftueshëm në dispozicion për zbatimin e vendimeve që rrjedhin nga një koncept dokument. Në këtë rast, duhet të informohet Ministria e Financave dhe duhet të negociohet rialokimi i buxhetit. Në praktikë kjo karakterizohet me punë të përbashkët me Departamentin e Buxhetit për të aplikuar Mjetin 12: Pajtueshmëria me vlerësimin e ndikimit buxhetor.</p>
<p>Hapi 9: Shtoni numrat e kostimit në planin e zbatimit</p>	<p>Nëse nuk nevojitet vlerësimi i ndikimit buxhetor, shifrat e kostimit dhe informatat mbi linjat buxhetore në të cilat kostot janë integruar, duhet të shtohen në koncept dokument. Kostot për rezultat dhe aktivitet mund të shtohen në Planin e zbatimit. Nga ana tjetër, kostot totale mund të shtohen në seksionin e kostimit dhe mund të bashkëngjitet dokumenti në excel për kostimin e koncept dokumentit në vetë koncept dokumentin si shtojcë.</p>

MJETI 12: PAJTUESHMËRIA ME VLERËSIMIN E NDIKIMIT BUXHETOR

Kur kostimi i një koncept dokumenti tregon se tavani buxhetor i një ministrie do të tejkalohet, fillon procesi i përgatitjes së vlerësimit të ndikimit buxhetor (VNB). Ministria e Financave punon me një Udhëzim administrativ të detajuar dhe Doracak që mundëson finalizimin e formularëve të kërkuar. Këta formularë do të bazohen në kostimin që tashmë është bërë për koncept dokumentin.

Departamenti i buxhetit i një ministrie ka qasje në të dhënat e nevojshme për vlerësimin e ndikimit buxhetor. Ai ka përvojë në plotësimin e këtyre formularëve në përputhje me standardet që duhet të aplikohen në procesin e buxhetimit. Departamenti gjithashtu udhëheq negociatat me Ministrinë e Financave. Natyrisht, kjo duhet të ndodhë në bashkëpunim të ngushtë me departamentin e politikave që është përgjegjës për koncept dokumentin dhe zbatimin e të gjitha zotimeve që rrjedhin nga ai.

Vlerësimi i ndikimit buxhetor është i bazuar në të njëjtat rezultate dhe aktivitete sikurse kostimi që është zhvilluar nën Mjetin 11: Kostimi për koncept dokumente. Por, pasi që tavani i kostove të një ministrie është tejkaluar, burimet e financimit ende duhet të identifikohen. Kjo duhet të bazohet në buxhetin në dispozicion, shpenzimet aktuale për ministri dhe projeksionet buxhetore për periudhën afatmesme.

Një vlerësim i ndikimit buxhetor është i nevojshëm kur duhet të bëhen përpjekje thelbësore për të siguruar që zotimet që rrjedhin nga koncept dokumenti të mund të realizohen. Pasi që tavani buxhetor është tejkaluar, duhet të identifikohen burime të reja të financimit. Këtu mund të përfshihen opsionet e kursimit, p.sh. zvogëlimi i buxhetit të një ministrie tjetër; ndarja e buxhetit të ardhshëm shtesë nga një ministri te tjetra; sigurimi direkt i mbështetjes buxhetore nga partnerët zhvillimorë; ose huamarrja e fondeve shtesë. Të gjitha këto opsione duhet të aprovohen nga Qeveria dhe kjo është arsyeja pse është zhvilluar procesi i vlerësimit të ndikimit buxhetor. Ai ofron mundësinë që të hartohen politika qeveritare që nënkuptojnë se një ministri shkon përtej kufirit të saj të përcaktuar buxhetor. Por, pasi që një zhvillim i tillë ndikon në planet e ardhshme të Qeverisë, një vendim i tillë duhet të përgatitet siç duhet.



Figura 61: Dokumentet përkatëse për vlerësimin e ndikimit buxhetor

Qëllimi i Doracakut mbi vlerësimin e ndikimit buxhetor të nismave të reja është të sigurojë udhëzime për organizatat buxhetore. Doracaku ndihmon në identifikimin e kostove që ndërlidhen me ndonjë nismë të re brenda fushës së tyre të përgjegjësisë dhe për të siguruar që të identifikohen burimet e nevojshme të financimit. Doracaku është i rëndësishëm për profesionistët, të cilët zhvillojnë dhe propozojnë nisma të reja në një organizatë buxhetore, siç është ministria e linjës.

Dokumentet përkatëse për vlerësimin e ndikimit buxhetor mund të gjenden këtu:

http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Doracaku_per_Vleresimin_e_Ndikimit_Buxhetor_te_Nismave_te_Reja_Qeveritar....pdf

http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Formulari_i_vlersimit_te_ndikimt_buxhetor_shqip.xlsx

MJETI 13: PËRCAKTIMI I RËNDËSISË SË NDIKIMEVE

Analiza për koncept dokumentin duhet të trajtojë sa më shumë çështje që është e mundur. Megjithatë, për t'u siguruar se analiza është bërë në mënyrë efikase, duhet të vendoset një limit që merr në konsideratë rëndësinë e ndikimit. Në praktikë kjo do të thotë se te koncept dokumentet që trajtojnë tema me një problem që është i kufizuar në fushëveprim, edhe analiza mund të jetë koncize. Koncept dokumentet që trajtojnë çështjet shoqërore, natyrisht do të përmbajnë një listë më të gjatë të ndikimeve të rëndësishme që duhet të analizohen. Prandaj, natyra e ndikimeve të pritshme dhe rëndësia e tyre janë faktorë të rëndësishëm që përcaktojnë kohën që është e nevojshme për të përfunduar analizën për një koncept dokument. Kur bëhet planifikimi për realizimin e koncept dokumentit, kjo duhet të merren parasysh.

Rëndësia e ndikimeve përcaktohet duke u bazuar në faktorët e mëposhtëm:

1. numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur nga ndikimi,
2. përfitimi apo kostoja e pritshme e ndikimit.



Figura 62: Parimi i analizës proporcionale

Analiza e politikave i shërben një qëllimi: marrja e vendimeve të informuara mbi politikat dhe legjislacionin. Nga ana tjetër, kjo ndihmon në përmirësimin e cilësisë së këtyre politikave dhe legjislacionit.

Megjithatë, nuk është e mundur që gjithçka të analizohet në hollësi. Kjo do të kërkonte shumë kohë, shumë orë pune dhe shumë buxhet. Prandaj, duhet të merret një vendim praktik se çfarë dhe si të analizohet.

Parimi i analizës proporcionale siguron kornizën për vendime të tilla praktike. Pyetja themelore mbi të cilën bazohet ky parim është: a i ofron analiza koncept dokumentit vlerë të mjaftueshme të shtuar duke pasur parasysh përpjekjet që nevojiten për ta bërë këtë analizë?

Për ndikime të rëndësishme, për ligjet e reja dhe rregullimet thelbësore të një kuadri ekzistues të politikave, është e justifikueshme që të investohet shumë në analizën e politikave. Megjithatë, përpjekjet e bëra në analizë duhet të gjykohen kundrejt pyetjes nëse përpjekjet e nevojshme për të kryer këtë analizë janë të justifikueshme. Ky mjet ndihmon në përcaktimin e hollësisë së analizës që duhet të bëhet për një koncept dokument.

Rëndësia e ndikimit duhet ta orientojë edhe mënyrën e analizës. Mbledhja e të dhënave duhet të jetë prioritet për ndikimet që pritet të jenë me rëndësi. Këto ndikime duhet gjithashtu të konsultohen përderisa të zhvillohet koncept dokumenti, për shembull, përmes konsultimeve dhe diskutimeve me palët e interesuara të ndikuara.

Dy faktorët së bashku përcaktojnë rëndësinë e ndikimeve. Katër kombinimet e këtyre dy faktorëve përcaktojnë shkallën e preferuar të analizës për ndikimet, siç tregohet në përmbledhjen e mëposhtme.



Figura 63: Përcaktimi i rëndësisë së ndikimeve dhe shkalla e preferuar e analizës

Faktorët që përcaktojnë rëndësinë e ndikimeve		Shkalla e preferuar e analizës
Numri i madh i institucioneve, kompanive dhe/ose individëve të ndikuar	Përfitimi i lartë i pritur ose kostoja e ndikimit	Ndikimet duhet të analizohen në hollësi dhe të mbështeten nga të dhënat dhe konsultimi (i synuar)
Numri i madh i institucioneve, kompanive dhe/ose individëve të ndikuar	Përfitimi i ulët i pritur ose kostoja e ndikimit	Ndikimet duhet të paraqiten në aspektin cilësor dhe të mbështeten nga konsultimi i synuar; të dhënat paraqiten vetëm kur janë lehtësisht të arritshme
Numri i vogël i institucioneve, kompanive dhe/ose individëve të ndikuar	Përfitimi i lartë i pritur ose kostoja e ndikimit	Ndikimet duhet të analizohen në thellësi dhe të mbështeten nga të dhënat dhe konsultimi (i synuar)
Numri i vogël i institucioneve, kompanive dhe/ose individëve të ndikuar	Përfitimi i ulët i pritur ose kostoja e ndikimit	Ndikimet mund të paraqiten në aspektin cilësor; të dhënat paraqiten vetëm kur janë lehtësisht të arritshme

MJETI 14: MBLEDHJA E TË DHËNAVE

Zhvillimi i një koncept dokumenti ka të bëjë me identifikimin e problemit dhe gjetjen e zgjidhjeve për shkaqet dhe efektet e tij. Ky mjet paraqet një gamë të mundësive për mbledhjen e të dhënave për një koncept dokument. Ky mjet specifik në asnjë mënyrë nuk jep një përmbledhje të plotë të mundësive të mbledhjes së të dhënave. Zhvillimi dhe analiza e politikave janë detyra të rëndësishme dhe komplekse. Informatat që ndihmojnë në zhvillimin e një koncept dokumenti mund të gjenden në shumë vende.

Mbledhja e të dhënave bëhet gjatë gjithë procesit të zhvillimit të koncept dokumentit. Kjo ndodh për shkak të natyrës së analizës së politikave. Kjo analizë çon në njohuri, njohuritë çojnë në pyetje, pyetjet çojnë në hulumtime dhe hulumtimet çojnë në përgjigje.

Koncept dokumentet merren me tema shumë të ndryshme. Nuk ekziston një proces i vetëm për mbledhjen e të dhënave, i cili mund të zbatohet për të gjitha koncept dokumentet. Ka disa mënyra që mund të jenë të dobishme. Këto janë paraqitur në përmbledhjen e mëposhtme.



Figura 64: Mbledhja e të dhënave

Qasja	Shpjegimi
Konsultim	<p>Cilësia e analizës së politikave përfiton nga inputi i ekspertëve, personat e ndikuar nga problemi, specialistët që kanë punuar në çështje specifike dhe shumë të tjera.</p> <p>Përfshirja e grupeve të tilla në analizën për një koncept dokument është një mënyrë e shpejtë e qasjes në informata të dobishme. Palët e interesuara mund të ofrojnë informata lidhur me: (1) problemet, shkaqet dhe efektet e tyre; (2) raportet ekzistuese dhe burime të tjera informative; (3) mund të ofrojnë informata kthyesë mbi ndikimet e pritshme dhe mënyrën për t'i vlerësuar ato; (4) çdo çështje tjetër që mund të jetë relevante për analizën.</p> <p>Konsultimet luajnë një rol thelbësor në analizën e politikave. Ato përshkruhen më hollësisht në pjesën Konsultimi me palët e interesuara.</p>

<p>Programi i mbledhjes së të dhënave</p>	<p>Të dhënat shpeshherë mund të mblidhen brenda një kohe të arsyeshme. Kjo është diçka që ia vlen pasiqë ofron një pasqyrë shumë më të mirë të gjendjes dhe mund të tregojë në mënyrë të drejtpërdrejtë se çfarë llojesh të problemeve ekzistojnë. Si rrjedhojë, të dhënat që janë mbledhur për një koncept dokument shpesh çojnë direkt në njohuri rreth opsioneve të mundshme për trajtimin e problemit.</p> <p>Një program i mbledhjes së të dhënave shpesh mund të kombinohet me konsultime të synuara dhe publike. Palët e interesuara mund të ofrojnë raporte, analiza dhe të dhëna të tjera relevante.</p> <p>Konsultimi gjithashtu është i dobishëm për të verifikuar të dhënat që janë mbledhur dhe analizën që është kryer. Kjo mund të bëhet gjatë konsultimit publik, në internet ose nëpërmjet konsultimit të synuar me palët e interesuara.</p>
<p>Statistikat e Kosovës: http://ask.rks-gov.net</p>	<p>Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) mbledh dhe publikon një gamë të gjerë të statistikave që mund të përdoren për zhvillimin e politikave. Këto statistika, për shembull, përshkruajnë gjendjen e sektorëve ekonomikë ose ofrojnë një pasqyrë të infrastrukturës ekzistuese të transportit. Kur statistikave mblidhen nga ASK, ato mund të jenë shumë të dobishme, sidomos për zhvillimin e përkufizimit të problemit, përcaktimin e objektivave dhe identifikimin e opsioneve.</p>
<p>Raportet etj., të zhvilluara nga organet qeveritare</p>	<p>Administrata është një grumbull i madh i organizatave të ndryshme. Kontaktimi i atyre që duken relevante për çështjet për të cilat hartohet koncept dokumenti mund të jetë një mënyrë e shpejtë për marrjen e të dhënave, raporteve dhe informatave të tjera që janë të dobishme për koncept dokumentin.</p>
<p>Raportet etj., të zhvilluara nga organizatat e shoqërisë civile</p>	<p>Kosova ka një komunitet të gjerë të organizatave të shoqërisë civile. Kontaktimi i atyre që duken relevante për një koncept dokument specifik, mund të jetë një mënyrë e shpejtë për marrjen e të dhënave, raporteve dhe informatave të tjera që janë të dobishme për koncept dokumentin. Në qoftë se nuk është e qartë se cilat organizata të shoqërisë civile janë të rëndësishme për koncept dokumentin, është e mundur të kontaktoni, për shembull, Fondacionin Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) ose Platformën CiviKos, ato mund të ndihmojnë me identifikimin e organizatave përkatëse të shoqërisë civile. Ato gjithashtu, në mënyrë direkte mund të ofrojnë informata që janë të dobishme për koncept dokumentin.</p>

Raportet etj., të zhvilluara nga vendet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare

Ekzistojnë shumë informata për politika. Organizatat që analizojnë efektet e pritshme të politikave dhe legjislacionit nëpërmjet vlerësimit të ndikimit (dhe/ose bëjnë vlerësime për të kontrolluar se cilat efekte vërtet materializohen), normalisht i publikojnë ato raporte online. Bashkimi Evropian, Britania e Madhe dhe Gjermania janë vetëm tre shembuj se ku mund të gjenden informata relevante. Gjithashtu, ato ofrojnë raporte në gjuhët që dikush në kuadër të grupit punues për zhvillimin e një koncept dokumenti i flet.

Raportet e vlerësimit të ndikimit të Komisionit Evropian mund, për shembull, të përdoren për të përcaktuar arsyen se pse BE-ja ka zhvilluar një ligj të caktuar. Këto raporte do të rendisin ndikimet më të rëndësishme pozitive dhe negative.

Shënim me rëndësi: Vlerësime të ndikimit, vlerësime dhe raporte të tjera të hartuara nga organizatat ndërkombëtare dhe vendet e tjera janë zhvilluar lidhur me mjedisin e tyre specifik politik dhe ligjor. Kjo do të thotë se përdorimi i informacionit nga raportet e tilla duhet të kontrollohet dy herë dhe të vlerësohet në mënyrë kritike mbi rëndësinë e tyre për Kosovën.



Figura 65: Zhvillimi i bazës së të dhënave të vlerësimit të ndikimit

Strategjia për rregullim më të mirë 2.0 njofton se sistemi aktual i koncept dokumenteve përfundimisht do të zëvendësohet me një sistem plotësisht të zhvilluar të vlerësimit të ndikimit. Koncept dokumentet janë tashmë një lloj i vlerësimit të ndikimit. Kur bëhet fjalë për zhvillimin e politikave, Kosova renditet lart në mesin e grupit të vendeve udhëheqëse në rajon. Kjo është një arritje për të qenë krenar, por jo një arsye për të mos avancuar tutje. Ende ekzistojnë sfida të qarta përpara, para se procesi i zhvillimit të politikave të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira.

Në veçanti, ende ekzistojnë boshllëqe të qarta në cilësinë e analizës së politikave. Këto janë pjesërisht për shkak të mungesës së të dhënave apo vështirësive që ekzistojnë me gjetjen e këtyre të dhënave. Për të zgjidhur këto çështje, Sekretariati Koordinues i Qeverisë dhe Zyra Ligjore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit do të zhvillojnë një përmbledhje të të dhënave që do të përmirësonin cilësinë e një koncept dokumenti, por që deri më tani nuk ishte në dispozicion. Qëllimi është mbledhja e këtyre të dhënave kur vlerësohet si thelbësore për të ardhmen. Ky informacion do të renditet në bazën e të dhënave të vlerësimit të ndikimit që do të zhvillohet gjatë viteve të ardhshme. Në mënyrë që të sigurohemi se baza e të dhënave përmban informata sa më të dobishme që është e mundur, boshllëqet e të dhënave për çdo koncept dokument duhet të identifikohen në mënyrë të qartë dhe të renditen në dokument. Përveç kësaj, të dhënat e mbledhura për koncept dokumentet që mund të jenë të dobishme në të ardhmen gjithashtu do të ruhen dhe të vihen në dispozicion përmes bazës së të dhënave të vlerësimit të ndikimit.

MJETI 15: ANALIZA E POLITIKAVE PËR TRANSPOZIMIN E ACQUIS-IT TË BE-SË

Integrimi evropian është një qëllim strategjik i Qeverisë. Ndër të tjera, kjo nënkupton transpozimin e legjislacionit evropian në kuadrin ligjor kombëtar. Kur një koncept dokument ka të bëjë posaçërisht me transpozimin e legjislacionit të BE-së, ky mjet siguron informata dhe hapat e nevojshëm të procesit për hartimin e koncept dokumentit duke u lidhur me analizën e politikave të kryera nga Bashkimi Evropian, veçanërisht Komisioni Evropian.



Figura 66: Tabelat e përputhshmërisë dhe analizat e politikave për dokumentet e integritit evropian

Kur zhvillohet legjislacioni që transponon Acquis të BE-së, aplikohen kërkesa specifike. Më e rëndësishmja, duhet të hartohet një tabelë e përputhshmërisë dhe deklarata e përputhshmërisë. Neni 30.3 i 'Udhëzimit administrativ për hartimin e akteve normative' përcakton si në vijim: tabelat e përputhshmërisë dhe deklarata e përputhshmërisë janë dokumente pune krahasuese, që pasqyrojnë shkallën e përputhshmërisë së një projekt-akti normativ vendor me Acquis të BE-së.

Këto tabela të përputhshmërisë tregojnë në detaje nëse kërkesat ligjore specifike evropiane janë transpozuar dhe nëse ky transpozim është i plotë ose i pjesshëm. Tabelat e përputhshmërisë gjithashtu kanë një seksion në të cilin mund të ofrohen shpjegime (në veçanti kur transpozimi nuk është i plotë). Informata e renditur në këtë seksion mund të rrjedhë nga analiza që kryhet për koncept dokumentin.

Analiza që duhet të bëhet për transpozimin e legjislacionit të BE-së është mjaft specifike. Arsyeja për këtë është se kërkesat ligjore tashmë janë vendosur në Acquis të BE-së dhe ka vetëm mundësi të kufizuara për devijim nga to. Koncept dokumenti duhet të fokusohet në mënyrën se si mund të transpozohen këto kërkesa më së miri. Natyrisht, analiza ndjek të njëjtën metodologji si një koncept dokument që nuk mbulon transpozimin e legjislacionit të BE-së. Analiza e politikave, në fund të fundit, ndjek hapa të ngjashëm çdo herë. Megjithatë, pikënisja për koncept dokumentin është shumë më ndryshe. Hapat kryesorë analitikë janë renditur në përmbledhjen e mëposhtme.



Figura 67: Analiza e politikave për transpozimin e Acquis-it të BE-së

Hapi analitik	Shpjegimi
1) Renditni legjislacionin përkatës të BE-së	<p>Kur një koncept dokument adreson transpozimin e Acquis të BE-së, duhet të theksohen qartë direktivat, rregulloret dhe aktet tjera ligjore që duhet të transpozohen.</p> <p>Acquis i BE-së mund të gjendet në faqen e internetit të Gazetës zyrtare të Bashkimit Evropian: http://eur-lex.europa.eu/homepage.html.</p>
2) Vlerësoni nivelin aktual të përafrimit dhe specifikoni qartë se cilat akte të BE-së mbeten për t'u transpozuar	<p>Duke pasur Hapin 1 si bazë, përcaktoni se cilat pjesë të legjislacionit relevant të BE-së tashmë janë transpozuar. Përdorni tabelat ekzistuese dhe deklaratat e pajtueshmërisë për këto akte ligjore dhe bëni një listë të pjesëve që ende nuk janë transpozuar.</p>
3) Kontrolloni nëse legjislacioni që pritet të transpozohet është në procedura brenda BE-së	<p>BE rregullisht e përditëson dhe ndryshon legjislacionin e vet. Kjo mund të ketë efekt në mënyrën në të cilën mund të kryhet dhe planifikohet më së miri transpozimi i legjislacionit.</p> <p>Parlamenti Evropian fut të gjitha dosjet legjislative, të cilat i diskuton në Observatorin e saj legjislativ (Legislative Observatory): http://www.europarl.europa.eu/oeil/home/home.do</p> <p>Programi legjislativ (Legislative Train) paraqet përparimin në propozimet që lidhen drejtpërdrejt me prioritetet kryesore të Komisionit Evropian: http://www.europarl.europa.eu/legislative-train</p> <p>Programi i punës së Komisionit dhe planet e menaxhimit të drejtorive të përgjithshme individuale mund të gjenden nëpërmjet kësaj vegëze: https://ec.europa.eu/info/strategy-documents_en</p> <p>Vlerësimet e ndikimeve fillestare dhe udhërrëfyesit, përmes të cilëve Komisioni Evropian njofton se po përgatit propozime të politikave dhe legjislative, janë të renditura këtu: http://ec.europa.eu/smart-regulation/roadmaps/index_en.htm</p> <p>Planifikimi për vlerësime mund të gjendet këtu: https://ec.europa.eu/info/planned-evaluations_en</p>

<p>4) Gjeni analizën mbështetëse të kryer nga institucionet e Bashkimit Evropian</p>	<p>Komisioni Evropian zhvillon rregullisht vlerësimet e ndikimit për propozimet e tij dhe gjithashtu vlerëson legjislacionin ekzistues evropian. Këto analiza japin informacione të dobishme në lidhje me arsyet pse është zhvilluar legjislacioni, palët e interesuara më të prekura dhe përfitimet dhe kostot e legjislacionit.</p> <p>Vlerësimet e ndikimeve janë të renditura në këtë faqe interneti: http://ec.europa.eu/smart-regulation/impact/ia_carried_out/cia_2016_en.htm</p> <p>Baza e të dhënave e Komisionit për vlerësimet e saj të ndikimit daton nga viti 2003. Kjo do të thotë se shumë direktiva dhe rregullore janë përgatitur përmes NV-ve.</p> <p>Baza e të dhënave të vlerësimit mund të gjendet në këtë faqe interneti: http://ec.europa.eu/smart-regulation/evaluation/search/search.do</p> <p>Baza e të dhënave mund të kërkohet sipas fushës së politikave. Kjo e bën më të lehtë për të parë nëse është bërë vlerësimi.</p> <p>Një kërkim në internet sipas emërimit të legjislacionit të BE-së mund të çojë gjithashtu në faqen e internetit të Komisionit Evropian në të cilën publikohen të gjitha hulumtimet relevante dhe publikimet lidhur me atë legjislacion. Natyrisht, kjo uebfaqe mund të gjendet edhe përmes faqes së internetit të DG përgjegjëse të Komisionit. Gjithashtu është e mundur që të kontaktoni Komisionin direkt përmes faqes së tij për kontakt: https://europa.eu/european-union/contact_en.</p>
<p>5) Përmbliidni analizën e kryer nga BE dhe përcaktoni se cilat informata janë relevante për Kosovën</p>	<p>Analiza e politikave të kryera nga Bashkimi Evropian siguron një bollëk të informatave dhe të dhënave. Kjo mund të jetë shumë e dobishme kur ndërtohet analiza e politikave për transpozimin e Acquis të BE-së.</p> <p>Në veçanti, vlerësimet e ndikimit të zhvilluara nga Komisioni Evropian tregojnë arsyet për zhvillimin e legjislacionit nëpërmjet përkufizimit të problemit, objektivave dhe opsioneve të shqyrtuara. Analiza tregon gjithashtu se çfarë lloj ndikimesh janë më të rëndësishme dhe cilat palë të interesuara ka të ngjarë të ndikohen. Për pjesët shumë komplekse dhe shumë kërkuese të legjislacionit, vlerësimet e ndikimeve mund të sigurojë gjithashtu informata për ndikimin e buxhetit dhe procesin e transpozimit të dispozitave ligjore.</p> <p>Mjeti18: Testi i konkurrencës rregullative mund të përdoret për të vlerësuar se si vendet e tjera kanë zgjedhur të transpozojnë Acquis të BE-së.</p>
<p>6) Bëni dallimin mes dispozitave detyruese dhe jo-detyruese</p>	<p>Direktivat e BE-së përmbajnë dispozita detyruese dhe jo-detyruese. Për koncept dokumentin dhe analizën e politikave, dallimi ndërmjet dy kategorive është thelbësor, pasi këto duhet të adresohen ndryshe. Për dispozitat detyruese, dy çështjet kryesore për të cilat kërkohen përgjigje janë se si dhe kur këto duhet të transpozohen. Për dispozitat jo-detyruese, pyetja kryesore është nëse ato duhet të transpozohen apo jo.</p>

<p>7) Përcaktoni përfitimet e pritshme shoqërore dhe kostot</p>	<p>Legjislacioni i BE-së pritet të ketë përfitime neto për Bashkimin Evropian si një tërësi. Vlerësimet e ndikimit tregojnë përfitimet që Komisioni Evropian pret të gjenerojë. Përmbledhja e Komisionit është një pikënisje e dobishme për të përcaktuar përfitimet që priten të rezultojnë nga hyrja në fuqi dhe zbatueshmëria e legjislacionit të tillë të BE-së në Kosovë.</p> <p>Legjislacioni i BE-së ka përfitime, njëkohësisht edhe kosto. Vlerësimi i ndikimit i zhvilluar nga Komisioni e pranon qartë këtë. Pra prapë, një dokument i tillë mund të jetë pikënisje për vlerësimin e kostove shoqërore për Kosovën.</p> <p>Është e rëndësishme të theksohet se koncepti dokumenti për rastet e transpozimit të legjislacionit të BE-së duhet të marrë parasysh opsionet aktuale të transpozimit. Këto duhet të analizohen në kontekstin e Kosovës, veçanërisht në lidhje me pyetjen se si mund të zbatohen kërkesat ligjore. Ndikimet e pritura për BE-në nuk mund të supozohen të zbatohen në Kosovë, veçanërisht jo kur vetëm pjesë të një direktive ose rregulloreje janë transpozuar.</p> <p>Mjeti 3: Identifikimi i ndikimeve ekonomike; Mjeti 4: Identifikimi i ndikimeve shoqërore; Mjeti 5: Identifikimi i ndikimeve mjedisore; dhe Mjeti 6: Ndikimet në të drejtat themelore, Mjeti 7: Vlerësimi i ndikimit gjinor dhe mjete të tjera ofrojnë kornizën për identifikimin e ndikimeve kryesore që mund të priten të ndodhin.</p> <p>Mjeti 13: Përcaktimi i rëndësisë së ndikimeve dhe Mjeti 14: Mbledhja e të dhënave, ofrojnë bazën për përcaktimin e rëndësisë së ndikimeve dhe se si këto mund të analizohen më së miri.</p>
<p>8) Vlerësoni se kur mund të transpozohen më së miri dispozitat detyruese</p>	<p>Përmbledhja e detyrimeve ligjore tregon dispozitat që duhet të transpozohen. Ekzistojnë tri opsione për zbatimin e detyrimeve ligjore: (1) të sigurojë që ato zbatohen me hyrjen e Kosovës në BE; (2) të fillojë aplikimin e dispozitave ligjore në afat të mesëm; (3) të sigurojë zbatimin menjëherë pas miratimit të ligjit ose aktit nënligjor përmes të cilit këto dispozita ligjore janë transpozuar. Këto tri opsione janë ato që duhet të analizohen në konceptin dokument.</p> <p>Kur duhet të transpozohen dispozitat e BE-së, varet nga kërkesat që vijnë prej tyre. Shumë faktorë ndikojnë në zgjedhjen se kur saktësisht do të transpozohen dispozitat ligjore. Pjesërisht, arsytet politike dhe shoqërore ndikojnë në zgjedhje të tilla. Transpozimi i standardeve të BE-së mund të ofrojë përfitime të menjëhershme për ekonominë pasi që kjo mund të hapë rrugë për investime dhe siguron bazën e nevojshme për kompanitë që dëshirojnë të eksportojnë mallra dhe shërbime. Shkurtimisht, zgjedhja se kur duhet të zbatohen kërkesat ligjore në legjislacionin e BE-së në praktikë, duhet të bazohet në analiza sa u përket meritave dhe përfitimeve të saj.</p>

<p>9) Vlerësoni nëse ia vlen transpozimi i dispozitave jo-detyruese</p>	<p>Për të qenë në përputhje me Acquis të BE-së, vetëm detyrimet ligjore duhet të transpozohen. Pjesët opsionale të Acquis të BE-së nuk duhet të transpozohen në rast se kjo nuk është e dobishme. Ky përfitim duhet të tregohet nëpërmjet një analize kosto-përfitim.</p> <p>Mjeti 18: Kontrolli i konkurrueshmërisë rregullative mund të përdoret për të përcaktuar se si vendet e tjera kanë zbatuar kërkesat e BE-së. Kontrolli ndihmon në identifikimin e opsioneve me më pak ngarkesa, të aplikuara nga vendet e tjera gjatë zbatimit të legjislacionit të BE-së.</p>
<p>10) Hartimi i planit të zbatimit</p>	<p>Zbatimi i Acquis të BE-së duhet të lidhet me mundësitë që institucionet e ngarkuara me zbatimin kanë që dispozitat ligjore të zbatohen në praktikë. Mjeti 10: Plani i zbatimit mund të rregullohet për zbatimin e Acquis të BE-së në mënyrë që ajo të mbulojë një kornizë më të gjatë kohore sesa 5 vjet, siç kërkohet aktualisht.</p>
<p>11) Përcaktoni kostot buxhetore të zbatimit bazuar në planin e zbatimit</p>	<p>Kostot aktuale për zbatimin e legjislacionit të BE-së mund të përcaktohen në bazë të Mjetit 11: Kostimi për koncept dokumente. Nëse ky mjet tregon se shpenzimet janë shumë të larta dhe se nevojiten fonde shtesë, duhet të përdoret Mjeti 12: Pajtueshmëria me vlerësimin e ndikimit buxhetor.</p> <p>Disponueshmëria e fondeve është thelbësore për çdo politikë, ashtu edhe për zbatimin e Acquis të BE-së. Nëse mos-disponueshmëria e buxhetit është problem, kjo duhet të diskutohet me MF-në. Është gjithashtu relevante që të përfshihet edhe MIE. Së bashku, ministria propozuese, MF dhe MEI mund të vlerësojnë se si mund të gjenden fondet e nevojshme për zbatim.</p>
<p>12) Konsultoni akterët relevantë</p>	<p>Meqenëse përfitimet dhe kostot e pritura vlerësohen për BE-në si një tërësi, ato duhet të krahasohen me rrethanat në Kosovë. Rrethanat në Kosovë mund të dallojnë shumë nga rrethanat në Bashkimin Evropian, si në aspektin ekonomik, shoqëror dhe mjedisor.</p> <p>Grupi punues që zhvillon koncept dokumentin duhet të përfshihet nga afër në diskutimin dhe përcaktimin e përfitimeve dhe kostove që mund të priten. Përveç kësaj, përfitimet dhe kostot e pritshme duhet të konsultohen me palët e interesuara për të parë nëse ato janë identifikuar plotësisht. Përveç kësaj, duhet të konsultohet edhe për kohën e propozuar për transpozim, në mënyrë që të vlerësohet nëse është reale. Konsultimi duhet të bëhet përmes konsultimeve të synuara, me palët e veçanta të interesuara që kanë një lidhje të qartë dhe / ose interes në temën e koncept dokumentit, si dhe përmes platformës online për konsultime publike.</p>
<p>13) Plotësoni koncept dokumentin bazuar në hapat e mëtejme detyrues</p>	<p>Kur të përfundojë analiza për koncept dokumentin, duhet të ndiqen procedurat standarde përpara se të miratohet. Këto janë paraqitur në pasqyrën e procesit të zhvillimit të koncept dokumenteve, që paraqitet në fillim të këtij Doracak.</p>

MJETI 16: MODELI I KOSTIMIT STANDARD

Legjislacioni i detyron kompanitë që të ndërmarrin veprime. Kjo mund të përfshijë raportimin mbi shpenzimet e tyre financiare në përputhje me rregullat e zonimit për ndërtimin e shtëpive, e shumë të tjera.

Një nëngrup i veçantë i detyrimeve ligjore referohen si kosto administrative. Këto janë kostot që shkaktohen për shkak se kërkesat ligjore përcaktojnë që kompanitë duhet të dorëzojnë informacionin te një autoritet publik ose ta ndajnë këtë informacion me të tjerët. Meqenëse MKS-ja llogarit kostot nga kërkesat ligjore, ajo duhet të përdoret vetëm për opsionet që përfshijnë ose hartimin e një ligji të ri, ose hartimin e një akti të ri nënligjor, apo ndryshimin e kërkesave ekzistuese ligjore, të cilat merren me kërkesat për biznesin e që ndërlidhen me kostot administrative.



Figura 68: Përkufizimi i kostove administrative

Kostot administrative janë detyrime të informimit (DI), të cilat kompanitë janë të detyruara me ligj t'i përmbushin.

Në nivel ndërkombëtar, modeli i kostimit standard përdoret kryesisht për përcaktimin e kostove administrative për kompanitë. Ai mund të përdoret gjithashtu për t'i llogaritur kostot administrative për qytetarët dhe autoritetet publike. Përfundimisht, aplikimi i MKS-së mund të zgjerohet më tej. MKS është një mjet i ri për zhvillimin e politikave për nëpunësit civilë. Duhet të zhvillohen burimet e informacionit dhe kapacitetet për të siguruar zbatimin e duhur. Prandaj, do të jetë i detyrueshëm vetëm për koncept dokumentet që trajtojnë kostot administrative për kompanitë.

Sipas MKS-së, dhënia e informacionit bazuar në detyrimet ligjore është përkufizuar shumë gjerësisht. Koncepti u referohet të gjitha aktiviteteve që lidhen me etiketimin, raportimin, regjistrimin, monitorimin, kërkimin, vlerësimin dhe kontrollin e cilësisë që nevojitet për të qenë në gjendje të ofrohet informacioni.

Transferimi i informacionit përcaktohet në dy mënyra. Disa informacione duhet të ofrohen në mënyrë aktive për autoritetet publike ose palët private. Informacione të tjera mund të ruhen në mënyrë që të jenë në dispozicion për inspektim ose të ofrohen sipas kërkesës. Të dyja llojet e informacionit bien nën përkufizimin e kostove administrative.

Kostot administrative ndahen në kosto administrative që përsëriten dhe kosto administrative të njëhershme. Aplikimi për leje, për shembull, është një kosto që përsëritet pasi leja duhet të rinovohet pas disa vitesh. Investimi në trajnime ose aktivitete të tjera për të siguruar që stafi i kupton kërkesat e reja ligjore është një shembull i një kostoje administrative të njëhershme.



Figura 69: Doracaku i modelit të kostimit standard

Ky mjet për modelin e kostimit standard jep një përmbledhje punuese në lidhje me modelin dhe mënyrën se si zbatohet ai. Doracaku i modelit të kostimit standard tregon në detaje se si duhet të bëhen llogaritjet me këtë model.


Për fund, kostot administrative ndahen në dy komponentë të ndryshëm: kostot e zakonshme të biznesit dhe ngarkesa administrative.

Kostot e zakonshme të biznesit shkaktohen nga mbledhja dhe përpunimi i informacionit që është thelbësor për funksionimin e biznesit. Ky informacion do të mblidhej edhe nëse nuk do të kishte legjislacion. Për shembull, kompanitë e mëdha gjithmonë mbledhin informacione për numrin e njerëzve që ata punësojnë dhe për pagat e tyre.

Ngarkesa administrative krijohet kur informacioni mblidhet vetëm për shkak se një gjë e tillë është detyrim ligjor. Për të sqaruar shembullin e mëparshëm, kompanitë e mëdha duhet të mbledhin dhe shkëmbejnë informatat me autoritetet tatimore. Gjithashtu, ato duhet të sigurohen që sistemi i tyre për dhënie e pagave ofron informata për tatimin mbi të ardhurat dhe çështje të tjera në lidhje me tatimin. Përveç kësaj, kompanitë duhet ta informojnë stafin e tyre në lidhje me tatimet në të ardhura dhe çështjet e tjera lidhur me tatimin. Kompanitë e bëjnë këtë vetëm për shkak se janë të detyruara me ligj të veprojnë kështu.



Figura 70: Kostot administrative, kostot e zakonshme të biznesit dhe ngarkesa administrative



MKS për ta matur efikasitetin

Kostot administrative llogariten përmes modelit të kostimit standard (MKS). Ky model lejon gjithashtu ndarjen në mes të kostove të zakonshme të biznesit dhe ngarkesës administrative.

MKS-ja mat efikasitetin e zbatimit të legjislacionit. Si i tillë, nuk paragjykon një kërkesë ligjore. Shembulli i kompanive të mëdha që duhet të mbledhin informacione sepse u duhet t'i paguajnë tatimet është një shembull i mirë. Është i qartë fakti që informacioni është i nevojshëm. MKS-ja e konsideron domosdoshmërinë e informacionit si një gjë të sigurt. Megjithatë, MKS-ja vlerëson efikasitetin e procesit dhe kërkesat e detajuara, të cilat duhet t'i përmbushin kompanitë kur ofrojnë informacione. De fakto, MKS-ja vlerëson cilësinë e zbatimit të kërkesave ligjore dhe ofron informacion se si të bëhet zbatimi më efikas.

Llogaritjet e MKS-së

Kostot dhe ngarkesa administrative mund të përcaktohen gjatë zhvillimit të koncept dokumentit. MKS-ja punon me katër variabla kryesore: (1) pagën për orë; (2) kohën e nevojshme për përmbushjen e detyrimit të informimit; (3) numrin e kompanive që duhet ta përmbushin detyrimin e informimit; dhe (4) shpeshtësinë në të cilën duhet të përmbushet detyrimi për informim.

Duhet të vlerësohen variablat e pagave për orë dhe ato të kohës së nevojshme. Doracaku për MKS-në shpjegon në detaje se si përcaktohet niveli i pagave me vlera të standardizuara. Koha që është e nevojshme për ta përmbushur një detyrim për informim bazohet kryesisht në kuptimin e përbashkët dhe disa teste të ideve, për shembull, përmes intervistave me bizneset. Koncepti dokumenti duhet ta përcaktojë kornizën për këto dy variabla, duke përcaktuar mënyrat për të kërkuar informacionin që do të mbajë ngarkesën administrative sa më ulët të jetë e mundur.


Numri i kompanive që duhet ta përmbushin detyrimin e informimit është i përcaktuar me ligj. Analiza për koncept dokumentin duhet të shqyrtojë dhe të përcaktojë qartë se cilat kompani duhet ta përmbushin detyrimin e informimit.

Edhe frekuenca në të cilën duhet të ofrohet informacioni është përcaktuar në legjislacion. Prandaj, koncepti dokumenti duhet të analizojë frekuencën më optimale ku përfitimet nga ofrimi i informacionit dhe ngarkesa administrative peshohen kundrejt njëra-tjetrës. Frekuenca gjithashtu varet nga miksi i masave që janë në dispozicion për të drejtuar aktivitetet e kompanive. Është e rëndësishme të theksohet se ngarkesat më të larta administrative për kompanitë dhe qytetarët zakonisht rezultojnë edhe me kosto më të larta për zbatimin e politikave nga ana e Qeverisë. Në fund, informacioni që ofrohet duhet të përpunohet dhe ruhet gjithashtu nga administrata e Qeverisë.

Figura e mëposhtme paraqet grafikisht mënyrën se si MKS-ja i kombinon këto katër variabla dhe tregon se si ato e kanë origjinën nga një ligj apo akt nënligjor.



Figura 71: Llogaritja e kostove dhe ngarkesave administrative



Dy mjete mund të jenë shumë të dobishme për t'i përcaktuar katër faktorët e MKS-së: Mjeti 17: Testi i NVM-ve dhe Mjeti 18: Testi i konkurrueshmërisë rregullative.



Figura 72: Frekuenca e detyrimeve të informimit: dy shembuj

SHEMBULLI 1: Pagesat e TVSH-së

Frekuenca e detyrimit për informim varet nga nevoja aktuale dhe vlera e shtuar e informacionit. Në fushën e tatimeve, shumë vende e kanë zgjedhur opsionin që ligjërisht detyron kompanitë me një qarkullim të madh të paraqesin deklaratën e tyre të TVSH-së në baza mujore. Për kompanitë me qarkullim të vogël, deklarata e TVSH-së duhet të dorëzohet vetëm çdo 3 muaj.

Logjika prapa kësaj zgjedhjeje është që të përqendrohet në pagesat më të mëdha pasi këto janë më të rëndësishmet. Gjithashtu, për një autoritet tatimor që pranon pagesat e TVSH-së, është më e logjikshme që të marrë pagesa më të mëdha secilën herë, sesa shumë pagesa të vogla. Autoriteti tatimor duhet ta përpunojë çdo pagesë dhe kjo ka një kosto gjithashtu. Nëse shumë kompani të vogla do të duhej ta paguanin TVSH-në e tyre çdo muaj, kostot për administrimin e sistemit të TVSH-së do të rriteshin ndjeshëm, ndërsa shuma totale e TVSH-së së paguar do të mbetet e njëjtë. Kjo do të çonte, në praktikë, në më pak të hyra nga TVSH-ja për qeverinë dhe një rritje të konsiderueshme të ngarkesës administrative për kompanitë. MKS mundëson parashikimin e kostove të tilla dhe ndihmon në gjetjen e zgjidhjeve efektive për zbatimin e legjislacionit.

SHEMBULLI2: Leja dhe inspektimi

Qeveria mund të përdorë një sërë mjetesh që ndikojnë në aktivitetet dhe sjelljen e kompanive. Duke kërkuar një leje për aktivitete të caktuara të biznesit, numri i kompanive që kryejnë këto aktivitete mund të kufizohet në ato që ndjekin standarde strikte profesionale. Për shembull, një impiant për përpunimin e kimikateve duhet të ketë leje për të siguruar që ndërmarrja të marrë masat e nevojshme për të parandaluar fatkeqësitë dhe të ketë punonjës të trajnuar mirë.

Se sa shpesh duhet të rinovohet kjo leje është një faktor i rëndësishëm për vendimet në lidhje me investimet. Është e rëndësishme për një kompani që të dijë se leja e saj do të jetë e vlefshme për një kohë të gjatë në mënyrë që investimet të sjellin fitim.

Megjithatë, një leje jep informacion në pika të veçanta, për shembull çdo 5, 10 ose 20 vjet. Natyrisht, gjatë viteve ndërmjet aplikimit për leje, administrata mund të përdorë inspektime për të siguruar që kompanitë të jenë në pajtim me kërkesat ligjore dhe që rreziqet të mbahen në shkallë të ulët.

Duke i kombinuar lejet me inspektimet, administrata siguron një grup të fuqishëm të mjeteve. Ato mund të ndërveprojnë shumë mirë së bashku kur përshtaten me njëra-tjetrën dhe t'i marrin parasysh nevojat e kompanive dhe investimet e tyre. Vlen edhe e kundërta: lejet me kohëzgjatje të shkurtër dhe inspektimet e tepërta do t'i pengojnë kompanitë që të fillojnë aktivitetet afariste. Kjo mund të arsyetohet për aktivitetet me rrezik të lartë, por për shumë aktivitete të tjera të biznesit kjo vetëm çon në humbje të rritjes ekonomike dhe mungesë të vendeve të punës.

Ndërtimi i një impianti të përpunimit të kimikateve kërkon disa vite. Gjithashtu mund të kalojnë një ose dy vjet para se fabrika të punojë me kapacitete të plota. Pajisjet e reja duhet të testohen, zinxhirët e furnizimit dhe faktorët e tjerë duhet të përcaktohen në detaje. Kjo nënkupton që impiantit i duhet kohë para se të vihet në përdorim të plotë. Nëse një kompani merr leje për 5 vjet, rreziku është që leja të mos ripërtërihet dhe nuk do të bëhen investime. Asnjë vend i ri pune nuk do të krijohet. Shteti nuk do të ketë rritje të të hyrave nga tatimet.

Sigurimi i një lejeje për 20 vjet ose më shumë ofron një garanci themelore për një kompani që ajo të mund ta ndërtojë dhe zgjerojë biznesin e saj me kalimin e kohës. Inspektimet i mundësojnë administratës të mbajë të dhëna për atë që ndodh në impiantin kimik dhe nëse kërkesat ligjore janë duke u respektuar. Nëse këto të fundit nuk respektohen, kompania mund të gjobitet. Kur kompania shkakton rreziqe të rënda, operacionet e saj madje mund edhe të mbyllen. Prandaj, inspektimet ofrojnë një garanci se rreziqet mbahen në nivel të ulët dhe që kompanitë respektojnë kërkesat ligjore.

Lejet dhe inspektimet mund të funksionojnë mirë së bashku. MKS-ja ofron një pasqyrë të kostove të përbushjes së të dy llojeve të detyrimeve për informim. Kjo është e dobishme për analizën e koncept dokumentit dhe ndihmon në përcaktimin e kriterëve të duhura për të dyja.

Llogaritja e ngarkesave administrative

Ngarkesat administrative janë faktor i rëndësishëm gjatë vendosjes se si duhet të hartohen kërkesat ligjore. Për këtë arsye, analiza për koncept dokumentin është e një rëndësie të madhe. Përmbledhja e mëposhtme tregon hapat që duhet të realizohen për t'i bërë llogaritjet e MKS-së.



Figure 73: Kryerja e llogaritjes së MKS-së

Hapi në procesin e llogaritjes	Shpjegimi
Hapi 1: Mblidhni të gjithë informacionin përkatës	Merrni versionet e fundit të ligjeve dhe/ose akteve nënligjore, të cilat ndërlidhen me koncept dokumentin tuaj. Gjithashtu, mblidhni formularët dhe dokumentet e tjera që lidhen me zbatimin e kërkesave ligjore. Sigurohuni që ta keni në dorë Doracakun e MKS-së.
Hapi 2: Identifikoni të gjitha detyrimet e informimit	Kontrolloni ligjet dhe/ose aktet nënligjore sa u përket detyrimeve të informimit. Renditini ato në një dokument të veçantë në Excel për kryerjen e llogaritjeve të MKS-së, dokument i cili ofrohet së bashku me Doracakun e MKS-së.
Hapi 3: Bëni llogaritjen e parë të MKS-së	Përdorni njohuritë tuaja që ta plotësoni dokumentin në Excel për llogaritjet e MKS-së.

<p>Hapi 4: Kontaktoni SKQ-në për mbështetje të mëtejshme</p>	<p>Qëndroni në kontakt me Sekretariatit Koordinues të Qeverisë për përfundimin e llogaritjeve të MKS-së. Sekretariati mund t'ju ndihmojë me mbledhjen e statistikave mbi numrin e kompanive, përcaktimin e niveleve të pagave dhe faktorëve të tjerë të MKS-së.</p>
<p>Hapi 5: Konsultohuni me organizatat biznesore dhe bizneset individuale</p>	<p>Ky hap është esencial gjatë kompletimit të llogaritjeve të MKS-së. Është e nevojshme që vërtetohen të dhënat e llogaritjeve të MKS-së. Sekretariati Koordinues i Qeverisë mund të ofrojë ndihmë edhe në këtë proces, si dhe mund të punojë me ju së bashku në këtë hap dhe ata në vijim.</p>
<p>Hapi 6: Përcaktoni opsionet e detajuara për legjislacionin</p>	<p>Bazuar në informacionin që e ofron MKS-ja, ju mund t'i përcaktoni kërkesat e detajuara rregullative për legjislacionin e ardhshëm.</p>
<p>Hapi 7: Zgjidhni opsionin më pak rëndues për detyrimet e reja të informimit</p>	<p>Me të dhënat e MKS-së në dispozicion, mund të zgjidhni opsionin më pak rëndues për biznesin, por që prapëseprapë ju lejon t'i arrini objektivat specifike.</p>
<p>Hapi 8: Kontrolloni nëse detyrimet ekzistuese të informimit mund të thjeshtohen</p>	<p>Kur koncepti dokumenti juaj mbulon mundësinë e ndryshimit të legjislacionit, gjithashtu kontrolloni nëse është e mundur të thjeshtësohen detyrimet ekzistuese të informimit. Këtë mund ta bëni edhe kur përkufizimi i problemit nuk i mbulon ngarkesat administrative si shkak apo efekt i problemit. MKS-ja ju lejon ta përmirësoni efikasitetin e kërkesave ligjore. Duhet të përdoret çdo mundësi për t'i ulur ngarkesat administrative. Sekretariati Koordinues i Qeverisë mund të ndihmojnë në këtë proces.</p>

MJETI 17: TESTI I NVM-VE

NVM-të janë shtylla kryesore e ekonomisë. Shumica e kompanive në Kosovë janë NVM. Meqenëse janë ndërmarrje të vogla dhe punësojnë vetëm disa persona, NVM-të përballen me kosto shumë më të larta të rregullimit se sa kompanitë e mëdha. Për shembull, NVM-të shpesh duhet të punojnë me specialistë të jashtëm, siç janë kontabilistët dhe avokatët. Kompanitë e mëdha kanë specialistë që punojnë në departamentin e financave ose atë ligjor. Shumicës së NVM-ve iu mungojnë mundësitë që drejtpërdrejt të punësojnë specialistë financiarë dhe ligjorë.



Figura 74: Përkufizimi i NVM-ve sipas Ligjit nr. 04/L-220 për investimet e huaja

Përkufizimi ligjor i NVM-ve është:

- » Mikro-ndërmarrja duhet të ketë të punësuar deri nëntë (9) punëtorë;
- » Ndërmarrja e vogël duhet të ketë të punësuar prej dhjetë (10) deri dyzet e nëntë (49) punëtorë;
- » Ndërmarrja e mesme duhet të ketë të punësuar prej pesëdhjetë (50) deri dyqind e dyzet e nëntë (249) punëtorë.

Nga kjo rrjedh që kompanitë që kanë 250 ose më shumë punëtorë janë kompani të mëdha.

Qëllimi i Testit të NVM-ve është që t'i bëjë legjislacionin, rregullat dhe procedurat administrative miqësore ndaj NVM-ve. Ato duhet të jenë të lehta të kuptohen dhe të aplikohen. Për ta arritur këtë qëllim, duhet të analizohet gjendja e NVM-ve për qëllim të përdorimit të analizës në koncept dokument.



Figure 75: 10 qëllimet e politikave dhe legjislacionit miqësor ndaj NVM-ve

- 1 Të krijohet një mjedis ku ndërmarrësit dhe bizneset familjare mund të lulëzojnë, si dhe të shpërblehet ndërmarrësia.
- 2 Të sigurohet që ndërmarrësve të ndershëm, të cilët përballen me falimentim, shpejt t'u jepet një mundësi e dytë.
- 3 Të përcaktohen rregulla, të cilat mund të respektohen me lehtësi nga NVM-të.
- 4 Të bëhet administrata publike e përgjegjshme ndaj nevojave të NVM-ve.
- 5 Mjetet e politikave publike, të tilla si procedurat e prokurimit publik, t'u përshtaten nevojave të NVM-ve.
- 6 Të lehtësohet qasja e NVM-ve në financa.
- 7 Të promovohet një mjedis pozitiv ligjor dhe afarist për NVM-të dhe të zbatohet legjislacioni për NVM-të vetëm kur është e nevojshme.
- 8 Të promovohet avancimi i shkathtësive në NVM dhe të gjitha formave të inovacionit.
- 9 T'u mundësohet NVM-ve t'i kthejnë sfidat mjedisore në mundësi.
- 10 T'i inkurajojnë dhe mbështesin NVM-të që të përfitojnë nga rritja e tregjeve.

Testi i NVM-ve është kombinim i analizave dhe konsultimeve që përmirëson njohuritë mbi mundësitë dhe sfidat me të cilat përballen NVM-të. Testi mundëson zhvillimin e një legjislacioni që përshtatet me nevojat dhe specifikat e NVM-ve. Testi ekzekutohet në katër hapa, të renditur në përmbledhjen e mëposhtme.



Figura 76: Realizimi i testit të NVM-ve

Hapi në testin e NVM-ve	Shpjegimi
1) Konsultimi me palët e interesuara të NVM-ve	Kur koncepti dokumenti trajton çështjet që janë relevante për NVM-të, ato duhet të konsultohen drejtpërdrejt. Kjo duhet të bëhet krahas konsultimit publik. Veprimet e konsultimit mund të përfshijnë intervista, diskutime në tryeza të rrumbullakëta, takime me fokus grupe dhe/ose dëgjime publike. NVM-të duhet të përfshihen në këto aktivitete konsultative në shkallën më të madhe të mundshme. Ndërkaq, konsultimi mund të drejtohet nga organizatat që përfaqësojnë NVM-të.
2) Identifikimi i NVM-ve të ndikuara	Gjatë konsultimit, ju mund të përcaktoni më saktë se cilat NVM dhe cilët sektorë të biznesit mund të ndikohen. Kjo jua mundëson të gjeni informacione të rëndësishme, siç është numri i NVM-ve, numri i stafit të angazhuar, roli i tyre në zinxhirët e furnizimit të biznesit, vlera e shitjeve të tyre për konsumatorët dhe më shumë.
3) Matja e ndikimit në NVM	<p>Ky doracak ofron mjetet për vlerësimin e efekteve mbi NVM-të. Më të rëndësishmet janë kostot që kanë të bëjnë me përputhjen me kërkesat ligjore. Këto kosto, në terma relativë, janë gjithmonë shumë më të larta për NVM-të sesa për kompanitë e mëdha. Kjo i zvogëlon mundësitë e NVM-ve që të konkurrojnë. Nga ana tjetër, kjo e pengon rritjen ekonomike dhe bllokon krijimin e vendeve të reja të punës.</p> <p>Gjithashtu, kostot lindin nga çështje të tilla, si: detyrimi për të paguar tarifën apo taksat; përshtatja e proceseve të punës; blerja e pajisjeve të reja, trajnimi i stafit dhe investimet e tjera.</p> <p>Barrët administrative mund të vlerësohen duke u bazuar në Mjetin 16: Modeli i kostimit standard.</p> <p>Këshillë: Kostot e ndikimeve të identifikuar për NVM-të mund të krahasohen me ato të ndërmarrjeve të mëdha. Një mundësi është krahasimi i kostos në bazë të madhësisë së kompanive. Kostot llogariten për kompani dhe për punëtorë. Kjo tregon kostot relative dhe e bën të lehtë krahasimin e efekteve mes kompanive të madhësive të ndryshme.</p>

<p>4) Vendosja e politikave miqësore ndaj NVM-ve</p>	<p>Në shumë raste, vendosja e kërkesave ligjore të llojit “vlen për të gjitha njësoj” (one-size-fits-all) si për NVM ashtu dhe për kompanitë e mëdha nuk e shton vlerën. Zgjidhjet e tilla normalisht imponojnë kosto shumë më të larta për NVM-të dhe shpesh këto kosto nuk arsyetohen. Vetëm kur NVM-të dhe kompanitë e mëdha janë në të njëjtën situatë (për shembull, kur merren me të njëjtën sasi të substancave të rrezikshme ose kur rreziqet për punëtorët janë të njëjta), rregullat duhet të jenë të njëjta për të dy llojet e kompanive.</p> <p>Qëllimi i testit të NVM-ve është të harmonizojë legjislacionin me nevojat dhe situatën specifike të NVM-ve. Kur nevojiten kërkesa të reja, ato duhet të futen, por futja e tyre duhet të bëhet në një mënyrë miqësore për NVM-të.</p> <p>Ekzistojnë shumë mundësi për hartimin e legjislacionit dhe akteve nënligjore në përputhje me nevojat e NVM-ve. Disa nga opsionet janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1 Përrjashtime të plota ose të pjesshme nga detyrimet ligjore në bazë të madhësisë së kompanisë; 2 Përrjashtime të plota ose të pjesshme nga detyrimet ligjore në bazë të rrezikut që një kompani bart; 3 Afate më të gjata që NVM-të t’i përmbushin kërkesat ligjore; 4 Tarifa të reduktuara në bazë të madhësisë së kompanisë; 5 Detyrime të thjeshtuara të raportimit; 6 Fushata specifike informuese apo udhëzues për përdoruesit, trajnime dhe zyra ndihmëse të dedikuara për to; 7 Inspektime të thjeshtuara.
<p>5) Përcaktimi se si do të informohen NVM-të për masat e reja</p>	<p>Zhvillimi i politikave miqësore për NVM duhet t’u komunikohet në mënyrë efektive atyre që përfitojnë nga politika të tilla. NVM-të ekzistuese duhet të informohen për masat nga të cilat do të përfitojnë. Përveç kësaj, personat që mund të jenë të gatshëm të fillojnë bizneset ose të lëvizin aktivitetin e tyre të biznesit nga sektori joformal në ekonominë formale, duhet të njoftohen për kushtet e përmirësuara nën të cilat ato mund të veprojnë.</p> <p>Plani i zbatimit duhet të adresojë çështjen e informimit të grupeve përkatëse të synuara. Kjo mund të bëhet përmes fushatave informuese, fletëpalosjeve, konferencave etj. dhe duhet të fokusohet në grupet e synuara që janë veçanërisht të rëndësishme.</p>

MJETI 18: TESTI I KONKURRUESHMËRISË RREGULLATIVE

Cilësia e legjislacionit dhe akteve nënligjore bazohet në dy aspekte: (1) cilësinë e gjuhës dhe hartimit ligjor dhe (2) ndikimin që rregullat bartin, si dhe vlerën e shtuar që sjellin ato. Këto ndikime mund të jenë të dobishme, por gjithmonë shkaktajnë disa kosto. Efikasiteti i legjislacionit - ndërlidhja me kostot që duhen për ta arritur një qëllim të caktuar - është i rëndësishëm për shumë arsye. Procedurat joefikase mund t'i bllokojnë investimet në shoqëri. Ato u marrin shumë kohë atyre që duhet të përbushin procedurat. Kjo vlen njësoj për qytetarët, kompanitë dhe administratat.

Jo gjithmonë është e lehtë të vendosen standarde dhe kërkesa ligjore. Kur ato janë shumë kërkuese dhe shumë komplekse, mund ta huqin qëllimin e tyre, por edhe kur janë shumë të buta, mund të mos i arrijnë qëllimet e synuara.

Testi i konkurrueshmërisë rregullative ndihmon me përcaktimin e standardeve ligjore që janë të krahasueshme me ato të përcaktuara nga vendet e rajonit dhe të Bashkimit Evropian.

Testi i konkurrueshmërisë rregullative gjithashtu ndihmon me gjetjen e mënyrave për zbatimin e kërkesave ligjore. Kjo përfshin masat që synojnë sigurimin e informacionit për ata që janë të rregulluar (p.sh. broshura, informacion në faqen e internetit etj.) dhe llojet dhe përmbajtjen e formave të përdorura për zbatim (përfshirë zgjidhjet e TI-së).

Përmbledhja e mëposhtme tregon hapat e ndryshëm që duhet të realizohen për testin e konkurrueshmërisë rregullative. Gjithashtu, kjo tregon edhe se si duhet të përdoren të dhënat e mbledhura.




Figura 77: Realizimi i testit të konkurrueshmërisë rregullative

Hapi në testin e konkurrueshmërisë rregullative	Shpjegimi
Hapi 1	Identifikoni çështjet për të cilat doni të analizoni se si vendet tjera i kanë rregulluar ato.
Hapi 2	Zgjidhni vendet për krahasim. Sugjerohet që krahasimi të bëhet me Shqipërinë, Malin e Zi dhe Kroacinë. Nëse është e nevojshme, krahasimi mund të zgjerohet edhe me vendet e tjera kur këto janë më relevante për analizat. Sigurisht, kjo përzgjedhje duhet të ndërlidhet me aftësitë gjuhësore të atyre që punojnë në testin e konkurrueshmërisë rregullative apo kapacitetet e përkthimit që janë në dispozicion.
Hapi 3	Kërkoni në internet për dokumentacion përkatës: ligje, akte nënligjore, forma, procedura etj.

Hapi 4	Analizoni dhe përmbliidhni çështjet kryesore në një tabelë ku i krahasoni vendet e analizuar me njëra-tjetrën.
Hapi 5	Nëse keni nevojë për më shumë informacion, kontaktoni ministrinë dhe institucionet e tjera qeveritare në vendet që i analizoni.
Hapi 6	Diskutoni analizën në grupin punues për koncept dokumentin. Vendosi për qasjen që do ta merrni.
Hapi 7	<p>Zgjidhni një prej tri opsioneve të mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none">1 Zbatoni standardet e përgjithshme ligjore në Kosovë, ashtu si kanë vepruar vendet e tjera; gjithmonë rregulloni tekstet dhe formulimet në mënyrë që të jenë në përputhje me ligjin në fuqi; përdorni forma dhe procedura të zhvilluara nga vendet e tjera si frymëzim për të hartuar zgjidhje specifike për Kosovën.2 Kur është e mundur, aplikoni norma ligjore që janë më pak të rrepta se sa në vendet krahasuese; kjo do t'i zvogëlojë kostot e zbatimit dhe do ta bëjë kornizën rregullative më të lehtë; përdorni forma dhe procedura të zhvilluara nga vendet e tjera si frymëzim për të hartuar zgjidhje specifike për Kosovën.3 Kur është e nevojshme, aplikoni norma më të rrepta ligjore; gjithmonë shpjegoni dhe arsyetoni këtë zgjedhje në koncept dokument; përdorni forma dhe procedura të zhvilluara nga vendet e tjera si frymëzim për të hartuar zgjidhje specifike për Kosovën.

05



PJESA 05: KOMUNIKIMI DHE KONSULTIMI

Komunikimi dhe konsultimi ka të bëjë me mbledhjen e komenteve për një koncept dokument, por edhe për komunikimin e qëllimeve të qeverisë për ndryshimin ose përmirësimin e politikave dhe motivimin që qëndron pas këtyre qëllimeve. Kjo pjesë ju ndihmon:

- Komunikim efektiv gjatë hartimit të Koncept Dokumentit;
- Të kryeni konsultime të brendshme brenda administratës, dhe konsultime publike me të gjitha grupet e interesuara që nuk janë pjesë e administratës;
- Identifikoni grupet e synuara për aktivitetet e komunikimit
- Të siguroheni që konsultimi publik të maksimizojë pjesëmarrjen, të jetë transparent dhe të shtoj vlerën e të gjithë të përfshirëve;
- Të identifikoni grupet e duhura të interesuara që duhet të konsultohen për konsultime publike;
- Të planifikoni aktivitetet e konsultimeve në mënyrë efektive, duke përfshirë takimin e obligueshëm publik dhe konsultimin publik në internet;
- Të harmonizoni aktivitetet e konsultimit dhe komunikimit;
- Të organizoni konsultime të synuara gjatë gjithë procesit të zhvillimit të Koncept Dokumentit.

Komunikimi ka të bëjë me dërgimin e mesazheve të Qeverisë tek audiencat përkatëse të synuara. Qëllimi kryesor i komunikimit gjatë zhvillimit të një koncepti dokumenti është që të informojë personat dhe organizatat përkatëse për planet që janë në shqyrtim. Përveç kësaj, i mundëson Qeverisë të tregojë se po punon për zgjidhje për të adresuar problemet dhe çështjet që janë relevante për të gjithë qytetarët ose nëngrupe të veçanta përkatëse. Komunikimi gjithashtu mund të forcojë aktivitetet që lidhen me konsultimin e publikut të gjerë dhe aktorëve të veçantë.

Konsultimi është metodë shumë e dobishme për mbledhjen e të dhënave, verifikimin e informacioneve dhe për të fituar njohuri të reja. Konsultimi ka për qëllim të ulë së bashku administratën dhe grupet e interesit për të diskutuar problemet në detaje, për të trajtuar opsionet për adresimin e këtyre problemeve dhe për të vlerësuar së cilë është përfitimi dhe kostoja. Konsultimi publik nxit shkëmbimin e informacioneve, pikëpamjeve dhe të dhënave, të cilat më pas mund të inkorporohen në vendimmarrje nga qeveria. Konsultimi mundëson pjesëmarrjen aktive në zhvillimin e politikave të qytetarëve, kompanive, organizatave të shoqërisë civile, përfaqësuesve të biznesit dhe partnerëve të zhvillimit .

Për arsyet e lartpërmendura, konsultimi dhe komunikimi duhet të jenë pjesë përbërëse të procesit për hartimin e koncepti dokumentit.

Përshkrimi i çështjes, përcaktimi i objektivave dhe opsioneve, identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve, krahasimi i opsioneve të ndryshme, përcaktimi i planit të zbatimit dhe segmentet tjera të një koncepti dokumenti janë më cilësore falë konsultimit të brendshëm dhe konsultimit publik. Në mënyrë që ky konsultim të jetë efektiv, duhet të komunikohet në mënyrë të duhur. Kjo pjesë e udhëzuesit fokusohet kryesisht në komunikim dhe konsultim përtej administratës dhe ministrive të linjës që janë përgjegjëse për hartimin e politikave.

MJETI 19: DUKE IU PËRMBAJTUR STANDARDEVE MINIMALE PËR KONSULTIM

Qëllimi i konsultimit është mbledhja e të dhënave për një koncept dokument, por edhe për komunikimin e qëllimeve të Qeverisë për ndryshimin ose përmirësimin e politikave dhe motivin që qëndron pas këtyre qëllimeve. Nëse realizohet në mënyrë të duhur, konsultimi nxit të kuptuarit dhe në këtë mënyrë pranimin e politikave dhe më vonë zbatimin e tyre.



Figura 78: Konsultimi publik dhe konsultimi i brendshëm

Gjatë hartimit të një koncept dokumenti duhet të realizohen dy lloje të konsultimeve: konsultimi i brendshëm dhe konsultimi publik.

Konsultimi i brendshëm i referohet konsultimit brenda administratës. Ky proces përfshin, ndër të tjera, diskutimet si pjesë e përgatitjes së një koncept dokumenti, pjesëmarrjen në grupet punuese dhe procesin e konsultimit paraprak bazuar në Nenin 7 të RRPQ që duhet të realizohet para se të dërgohet një propozim për përfshirje në mbledhjen qeveritare për diskutim dhe miratim. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e rregullave ekzistuese dhe/ose zbatimin e kërkesave të ardhshme që dalin nga koncept dokumenti kanë rëndësi të veçantë për një koncept dokument. Ato duhet të konsultohen gjithmonë.

Grupet punuese janë përgjegjëse për përfshirjen e palëve të interesuara të rëndësishëm brenda dhe jashtë administratës në hartimin e një koncept dokumenti. Kjo praktikë është konsultim i fokusuar, ku një grupi të veçantë të palëve të interesuara i kërkohet që të shkëmbejnë njohuritë dhe ekspertizën e tyre. Sidoqoftë, një grup punues që përfshin grupe të organizatave të ndryshme, nuk pritet që ta konsiderojë këtë si zëvendësim të konsultimit publik.

Konsultimi publik mbulon konsultimin e të gjitha palëve të interesuara që nuk janë pjesë e administratës. Kjo përfshin bizneset, OJQ-të, qytetarët dhe organizatat ndërkombëtare. Në fund të fundit, këto palë të interesuara janë ata që do të duhej të përmbushin kërkesat që dalin nga një koncept dokument. Palët e interesuara që janë pjesë e administratave mund të jenë gjithashtu pjesë e konsultimit publik.

Përfitimet e mundshme nga konsultimi me palët e interesuara janë të shumëfishta. Për t'i arritur këto përfitime, aktivitetet konsultuese duhet të përgatiten me kujdes dhe të planifikohen mirë. Kjo kryesisht për shkak të faktit që konsultimi me palët e interesuara mbulon të gjitha aktivitetet në të cilat personave jashtë administratës u kërkohet që të ofrojnë komentet, idetë, sugjerimet, të dhënat e tyre, etj., për çështjet që janë relevante për atë koncept dokument. Një tjetër arsye e rëndësishme është që palët e interesuara në të vërtetë janë një grup personash dhe organizatash të ndryshme. Palët të ndryshme të interesuara kontaktohen në mënyra të ndryshme me qëllim që të lehtësohet sa më shumë pjesëmarrja e tyre në procesin e konsultimit.

Janë katër parime që drejtojnë procesin gjatë konsultimit me palët e interesuara. Këto parime paraqiten në figurën e mëposhtme. Ato janë relevante pasi që konsultimi me palët e interesuara ka të bëjë me motivimin e personave dhe organizatave që të punojnë me administratën dhe të ofrojnë pikëpamjet e tyre. Kjo sigurisht që merr kohë dhe kërkon resurse nga Qeveria. Është njësoj e rëndësishme se kjo kërkon kohë dhe përpjekje edhe nga ana e palëve të interesuara.

Gjatë realizimit të konsultimit me palët e interesuara, është thelbësore të kuptohet që të tjerët duhet të lënë anash punën e tyre të përditshme për të marrë pjesë në konsultim. Kjo nuk do të jetë problem për disa organizata, si OJQ-të profesionale (p.sh. Oda Ekonomike e Kosovës dhe organizata që veprojnë në fusha specifike, p.sh. të drejtat e njeriut, sundimi i ligjit, kundër korrupsionit, media, etj.). Organizatat e tilla mund të mbështeten në staf shumë profesional, i cili e ka për detyrë të marrë pjesë në konsultime. Kjo e bën më të mundur pjesëmarrjen e tyre në konsultime. Megjithatë, përpjekja që organizata të tilla duhet të bëjnë – për shembull në formë të hulumtimit, analizës dhe diskutimit me organizatat tjera – kërkon kohë dhe buxhet në dispozicion të këtyre organizatave.

Është thelbësore të kuptohet që shumica e organizatave të shoqërisë civile dhe kompanive nuk kanë kapacitete të gjëra apo staf të specializuar, si avokatë dhe ekonomistë, dhe që një pjesë të pagave të tyre vjen si rezultat i kontributit që japin gjatë konsultimit me palët e interesit për politikat qeveritare. Në fakt, shumica e kompanive janë NVM që do të duhej të vendosin ndërmjet drejtimit të biznesit të tyre apo kontributit në një konsultim. Shumica e organizatave të shoqërisë civile mund të operojnë vetëm falë përpjekjeve dhe kohës së shpenzuar nga vullnetarët e devotshëm. Siç paraqitet në Indeks të shoqërisë civile 2016 – i publikuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile – rreth një e treta e organizatave të shoqërisë civile operojnë vetëm falë vullnetarëve dhe operojnë pa punonjës apo financim. Nga ato të cilat kanë punonjës, dy e treta operojnë me deri në katër punonjës. Është thelbësore që të kihet parasysh se kur organizatat e shoqërisë civile marrin pjesë në konsultim, vullnetarët dhe punonjësit e tyre mund të jenë duke e shpenzuar kohën e tyre të lirë. Edhe kur një person merr pjesë në një konsultim si qytetar i pavarur, edhe atëherë ai person e shpenzon kohën e tij të lirë. Kjo nënkupton që aktivitetet e konsultimit duhet të përshtaten me resurset e palëve të interesuara që duhet të konsultohen. Ajo që është më e rëndësishmja, administrata duhet të vlerësojë kohën dhe përpjekjet që palët e interesuara bëjnë në konsultim publik duke treguar që këto përpjekje vlerësohen dhe trajtohen.



Figura 79: Katër parimet e konsultimit publik

Parimi i konsultimit	Shpjegimi dhe sugjerimet
1) Gjithmonë synoni pjesëmarrje maksimale	<p>Konsultimi ka vlerë atëherë kur shumë palë të interesuara mund të marrin pjesë. Kjo do të thotë që ata duhet të kenë kohë dhe informacione të mjaftueshme në lidhje me konsultimin, çështjet relevante dhe qëllimin e konsultimit. Ka teknika dhe aktivitete të ndryshme të konsultimit që mund të aplikohen. Këto varen nga tema dhe duhet të përshtaten me situatën specifike në të cilën veprojnë palët e interesuara.</p> <p>Mënyra e planifikimit dhe realizimit të një konsultimi përcakton në masë të madhe suksesin e një konsultimi. Si rregull e përgjithshme, sa më mirë që aktiviteti i konsultimit të përshtatet me rrethanat specifike të palëve të interesuara, aq më i dobishëm dhe informues do të jetë konsultimi. Konsultimet gjithashtu duhet të komunikohen në mënyrë të duhur dhe të mbështeten me shpjegim konciz dhe të qartë që tregon rëndësinë e konsultimit. Kjo iu mundëson palëve të interesuara që të kuptojnë shpejt konsultimin dhe kështu ata nuk do t'i humbasin konsultimet e rëndësishme.</p> <p>Shembull: Aktivitetet e konsultimit për një propozim politikë shumë komplekse për administrimin dhe rimëkëmbjen e bankave, duhet të sigurojnë që personat e konsultuar të jenë të përfshirë dhe të informuar në mënyrë të duhur. Bankat me gjasë që nuk do të përballen me vështirësi kur ta analizojnë një koncept dokument mbi këtë çështje me qëllim të ofrimit të përgjigjes në konsultim. Vetëm dërgimi i një draft koncept dokumenti për komente nuk do të jetë mënyrë e efikase për përfshirjen e organizatave të konsumatorëve, përfaqësuesve të NVM-ve dhe organizatave tjera relevante në konsultim. Këto organizata jo detyrimisht kanë ekspertizë të detajuar rregullative në shërbimet bankare dhe financiare. Për të përfshirë këto organizata, është thelbësore përshtatja për rrethanat e tyre. Kjo mund të nënkuptojë organizimin e një punëtorie dyditore mbi përmbajtjen e koncept dokumentit. Gjatë kësaj punëtorie, pjesët më të rëndësishme të koncept dokumentit mund të diskutohen në më shumë detaje dhe palët e interesuara mund të kuptojnë më mirë se në cilat çështje duhet të fokusohen.</p>

<p>2) Gjithmonë jini transparent dhe jepni informata kthyesë</p>	<p>Konsultimi asnjëherë nuk duhet të shndërrohet në një kuti të zezë për palët e interesuara. Përpjekjet që bëhen për të marrë pjesë në procesin e konsultimit duhet të vlerësohen. Kjo nënkupton komunikimin në mënyrë të hapur me palët e interesit në lidhje me kontributet e tyre dhe se si janë marrë parasysh ato. Kjo gjithashtu nënkupton ofrimin e informatave kthyesë të palët e interesit për sugjerimet e tyre pas konsultimit publik me shkrim online.</p> <p>Në praktikë, kjo tregon dhe shpjegon se si janë trajtuar kontributet nga palët e interesit. Ekzistojnë tri mundësi për këtë. Kontributet mund të jenë (1) plotësisht apo (2) pjesërisht të integruara në koncept dokument. Opsioni (3) është refuzimi i kontributit nga palët e interesit. Është obligative të shpjegohet se pse është përzgjedhur cilado nga këto opsione.</p>
<p>3) Gjithmonë sigurohuni që konsultimi ta shtojë vlerën</p>	<p>Nevojitet kohë dhe përpjekje për organizimin e një konsultimi. Palët e interesuara shpenzojnë shumë kohë për të marrë pjesë në një konsultim të organizuar nga administrata. Nuk ka ndonjë vlerë kur konsultimi bëhet shumë vonë apo kur konsultimi merret me aspekte që tashmë janë vendosur, për shembull pasi që një politikë është hartuar.</p> <p>Sa më herët që fillon konsultimi, aq më shumë vlerë ka. Një fillim i tillë i hershëm iu lejon të gjithëve që të punojnë me konsultimin, të diskutojnë çështjet në detaje, të mbledhin të dhëna dhe të hartojnë një përmbledhje të qartë të çështjeve që kanë rëndësi. Konsultimet duhet të organizohen si pjesë e procesit të hartimit të koncept dokumentit. Konsultimi nuk duhet të konsiderohet si një aktivitet që zhvillohet vetëm një herë kur hartohet koncept dokumenti.</p>
<p>4) Gjithmonë sigurohuni që aktivitetet e konsultimit të fuqizojnë njëra-tjetrën</p>	<p>‘Konsultimi’ është një frazë e përgjithshme që përfshin një varg shumë të gjerë të aktiviteteve. Ekzistojnë shumë mundësi për konsultimin e palëve të interesuara. Një përmbledhje e detajuar është paraqitur në Mjetin 21: Përzgjedhja e metodave të konsultimit.</p> <p>Konsultimi funksionon më së miri kur ka për qëllim zhvillimin e një dialogu me palët e interesuara. Dialogu i mirë bazohet në shkëmbimin e rregullt të pikëpamjeve. Prandaj, aktivitetet e konsultimit duhet të promovojnë një shkëmbim të tillë.</p>

Standardet minimale për konsultim publik për koncept dokumente

Kërkesat për konsultim mbulohen nga Rregullorja e Qeverisë për standardet minimale për konsultim publik¹⁷. Këto standarde vlejnë për një sërë procesesh të vendimmarrjes dhe dokumenteve që hartohen për ministritë. Ky udhëzues ka mishëruar kërkesat që vlejnë për hartimin e koncept dokumenteve. Rregullorja përcakton kërkesa specifike që janë veçanërisht të rëndësishme për hartimin e koncept dokumenteve.

Zyrtari përgjegjës për hartimin e koncept dokumentit është edhe përgjegjës për aktivitetet e konsultimit dhe zbatimin e planit të konsultimit. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që ai person duhet t'i realizojë të gjitha aktivitetet e konsultimit. Zyrtari përgjegjës për konsultim duhet të marrë mbështetjen e të tjerëve në mënyrë që konsultimi të jetë i suksesshëm.

¹⁷ Rregullorja (QRK) nr. 05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik, është miratuar në mbledhjen e 86 të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin nr. 06/86, datë 29.04.2016.

Çdo ministri gjithashtu e ka të emëruar koordinatoren për konsultime publike. Ky person është përgjegjës për ofrimin e këshillave për mënyrën e zbatimit të konsultimeve në mënyrë efektive. Në veçanti, ky person mund të mbështesë me organizimin e konsultimit publik me shkrim që organizohet online nëpërmjet ueb-faqes zyrtare për konsultim:

<http://konsultimet.rks-gov.net>

Standardet minimale për konsultimet publike parashikojnë që dy aktivitete konsultuese janë të detyrueshme: takimet publike dhe konsultime publike me shkrim në internet. Përderisa këto janë të domosdoshme, referenca për "standardet minimale" dhe rregullorja si të tilla sugjerojnë që një sërë teknikash dhe aktiviteteve të konsultimit të palëve të interesuara duhet të zbatohen. Këto duhet të përshtaten me grupet përkatëse të synuara.



Figura 80: Publikimi i koncept dokumentit në platformën e konsultimeve publike në internet

Pas konsultimit ndërmisor, organi propozues duhet të organizojë një konsultim me shkrim publik në internet me qëllim të kërkimit të komenteve mbi përmbajtjen e koncept dokumentit. Ky konsultim publik në internet duhet të organizohet nëpërmjet <http://konsultimet.rks-gov.net/>

Kur koncept dokumenti është i gatshëm për konsultime publike, koordinatori i konsultimit publik i ministrisë mund të ngarkojë dokumentacionin në platformën e konsultimit publik në internet. Koncept dokumenti duhet të publikohet në gjuhën shqipe dhe serbe. Nëse është në dispozicion në anglisht, publikojeni në të tri gjuhët.

Një shpjegim që shoqëron koncept dokumentin duhet të publikohet edhe në gjuhën shqipe dhe serbe. Ai duhet të paraqesë arsyet prapa konsultimit publik, çështjet kryesore të trajtuara në koncept dokument dhe detajet e kontaktit të personave përkatës. Nëse është e mundur, publikojeni këtë shpjegim edhe në anglisht.

Në përfundim të procesit të konsultimit publik, duhet të publikohet një raport mbi mënyrën se si janë marrë parasysh komentet e ndryshme nga palët e interesuara. Ky raport duhet të përmbajë informata praktike rreth procesit të konsultimit dhe të tregojë arsyet për (pjesërisht) pranimin ose mospranimin e sugjerimeve që janë paraqitur nga palët e interesuara. Ky raport duhet të publikohet në faqen e internetit për konsultime publike.

Formatet për dokumentet shpjeguese dhe për raportin e konsultimit publik janë në dispozicion në faqen e internetit të konsultimeve publike.

Rekomandohet që rezultati i një konsultimi t'u komunikohet drejtpërdrejt palëve të interesuara që kanë marrë pjesë në konsultim. Në varësi të çështjeve të ngritura gjatë konsultimit publik dhe rëndësisë së diskutimit, rezultati mund t'i komunikohet edhe publikut të gjerë.

Përveç kësaj, standardet minimale përcaktojnë kërkesat që duhet të ndiqen kur organizohen takime publike dhe takime të tjera konsultuese. Këto kërkesa janë paraqitur në përmbledhjen e mëposhtme.



Figura 81: Kërkesat për organizimin e takimeve publike dhe ngjarjeve të tjera të konsultimit

Trupi propozues është gjithmonë përgjegjës për organizimin e aktiviteteve të konsultimit kur hartohen koncept dokumentet.

Gjatë hartimit të koncept dokumentit, është thelbësore që të angazhohen drejtpërdrejt publiku dhe palët e interesuara. Së paku, duhet të organizohet një takim publik për palët e interesuara dhe individët që kanë shprehur interesin e tyre për t'u përfshirë në temën që adreson koncept dokumenti. Ftesa duhet të dërgohet tek organizatat dhe individët që janë regjistruar përmes ueb faqes së konsultimeve. Për më tepër, takimet publike duhet të jenë të hapura për të gjitha palët e interesuara dhe prandaj duhet të publikohen nga ministria.

Njoftimet për takimet publike duhet të dërgohen me e-mail te palët e interesuara dhe individët që kanë shprehur interesimin të jenë pjesë e konsultimeve publike dhe janë regjistruar tashmë në këtë platformë. Metodat tjera për të shpallur takimet duhet të aplikohen gjithashtu, siç janë shpallja e njoftimit për takim në platformën e konsultimeve online dhe përmes partnerëve të shoqërisë civile, si KCSF dhe CiviKos, mediat sociale, TV, etj.

Palëve të interesuara mund t'ju kërkohet fillimisht të konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre vetëm për arsye logjistike. Asnjë palë e interesuar apo individ nuk mund të përjashtohet nga takimet publike dhe regjistrimi mund të mos jetë i kërkuar. Lista e pjesëmarrjes dhe shënimet e takimit publik duhet të publikohen.

Informatat për takimet publike dhe të gjitha materialet dhe të dhënat në dispozicion duhet të jenë të qasshme në mënyrë të barabartë për të gjithë: publikun, përfaqësues nga palët e interesuara, grupet punuese dhe të gjitha organizatat dhe individët që mund të jenë të interesuar të përfshihen në hartimin e koncept dokumentit.

Standardet minimale për konsultime publike rregullojnë aspektet praktike në vijim lidhur me organizimin e takimeve publike:

- 1) Takimi duhet të shpallet paraprakisht, së paku shtatë ditë kalendarike;
- 2) Ftesa duhet, nëse ekziston, të përfshijë analizën që është bërë tashmë për koncept dokumentin, p.sh. duke shpërndarë draftin e përkufizimit të problemit;
- 3) Ftesa duhet të sigurojë informacionin, dokumentet etj. që grupi punues po përdor për zhvillimin e koncept dokumentit;
- 4) Ftesa duhet të përfshijë kohën dhe vendin e takimit publik;
- 5) Ftesa duhet të përcaktojë qartë se kush është përgjegjës për organizimin e takimit publik dhe rrjedhimisht është personi i kontaktit për organizimin e takimit;
- 6) Përfaqësuesit nga autoriteti publik që organizojnë mbledhjen e drejtojnë takimin dhe marrin shënime;
- 7) Shënimet zyrtare të takimit paraqiten brenda 7 ditëve të punës pas mbajtjes së takimit publik; këto shënime duhet të pasqyrojnë diskutimin që është zhvilluar, duhet të përmbajnë konkluzionet kryesore nga takimi dhe duhet të ofrojnë një përmbledhje të takimit; këto shënime duhet t'u dërgohen me e-mail personave që kanë marrë pjesë në takimin publik.

Këto aspekte janë të rregulluara në Nenin 8 të Standardeve minimale për konsultimin publik dhe pasqyra është përshtatur për zhvillimin e koncept dokumentit. Ato zbatohen për organizimin e takimit publik dhe takimeve të tjera të konsultimit.

MJETI 20: IDENTIFIKIMI I PALËVE TË INTERESUARA

Dobia dhe suksesi sa i përket komunikimit dhe konsultimit të organizuar për një koncept dokument varet nga identifikimi i palëve të interesuara dhe audiencat relevante të synuara. Rregulli bazë është që komunikimi dhe konsultimi të bëhen në mënyrë të hapur dhe transparente.

Në shumicën e rasteve është e lehtë të bëhet identifikimi i palëve të interesuara, të cilat janë më të rëndësishme. Përkufizimi i problemit, sidomos kur është i organizuar në bazë të pemës së problemit , tregon problemin, shkaqet dhe efektet e tij. Duhet të bëhet konsultimi i organizatave dhe personave, të cilët ndikohen nga këto shkaqe dhe efekte. Kjo mund të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë përmes organizatave të tyre përfaqësuese.



Figura 82: Tri grupet kryesore të palëve të interesuara

1. Palët e interesuara, të cilat ndikohen nga ajo politikë
2. Palët e interesuara, të cilat do ta zbatojnë politikën
3. Palët e interesuara, të cilat kanë deklaruar interesin e tyre në atë politikë

KËSHILLË: Një numër i madh i palëve të interesuara janë regjistruar në platformën online për konsultime. Ata gjithashtu kanë treguar fushat e politikave për të cilat janë të interesuara. Zyra për Qeverisje të Mirë menaxhon këtë platformë dhe mund të ofrojë një pasqyrë të palëve të interesit që mund të jenë të interesuar në një koncept dokument specifik.

Të tri grupet e palëve të interesuara ndryshojnë në bazë të fushave të politikave dhe temave specifike. Prandaj, ato do të ndryshojnë për secilin koncept dokument. Grupet e gjera që duhet të merren në konsideratë për konsultim, janë të radhitura në pasqyrën e mëposhtme. Hapi i parë i duhur për identifikimin e palëve të interesuara do të ishte rishikimi i listës së palëve të interesuara që janë regjistruar në platformën online të konsultimit dhe kanë shfaqur interes për propozimet e politikave të disa ministrive.



Figura 83: Grupet që duhet të merren parasysh për aktivitetet e komunikimit dhe konsultimit

Qytetarët

Organizatat e shoqërisë civile që përfaqësojnë interesat e qytetarëve dhe të grupeve të veçanta
Sindikatat, në rast se qytetarët ndikohen në pozitën e tyre si punëtorë

Kompanitë (vendore dhe shumëkombëshe)

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

Odat ekonomike

Organizatrat që përfaqësojnë interesat e bizneseve

Organizatrat që përfaqësojnë profesione dhe zanate

Autoritetet publike në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal (konsultime të brendshme)

Agjencitë dhe inspektoratet (konsultimet e brendshme)

Organizatrat e shoqërisë civile që përfaqësojnë interesat e përgjithshme

Organizatrat think-tank

Universitetet

Shkollat

Institutet kërkimore

Ekspertët e brendshëm dhe të jashtëm

Organizatrat ndërkombëtare

Organizatrat e donatorëve

MJETI 21: PËRZGJEDHJA E METODAVE TË KONSULTIMIT

Konsultimi përfshin të gjitha aktivitetet në të cilat kërkohen mendime, ide dhe informata nga palët e interesuara mbi çështjet që i ngrit Qeveria. Konsultimi ka të bëjë me komunikimin me palët e interesuara, përmes aktiviteteve të fokusuara të konsultimit dhe konsultimeve me shkrim online. Për realizimin e konsultimit ka një sërë aktivitetesh që mund të zhvillohen.

Dy aktivitete të konsultimit janë të detyrueshme për çdo koncept dokument: organizimi i një takimi publik që në fillim të procesit të hartimit të koncept dokumentit për të filluar procesin e konsultimit publik dhe **konsultimin publik me shkrim online** që është organizuar përmes platformës zyrtare për konsultim, pas konsultimit paraprak me të gjitha organet përkatëse të administratës shtetërore. Konsultimi online bëhet përmes publikimit të koncept dokumentit dhe dokumentit për konsultim mbështetës në ueb faqe. Çdo person dhe çdo organizatë e interesuar për çështjen që trajtohet, ka mundësinë që t'i dërgojë pikëpamjet e veta.

Megjithatë, para se të bëhet konsultimi publik me shkrim online, institucioni propozues duhet të organizojë aktivitete shtesë të konsultimit për të siguruar që shumica e çështjeve do të trajtohen në mënyrë të duhur.

Konsultimet e fokusuara janë ato aktivitete në të cilat palët e interesit intervistohen ose ftohen për diskutime. Konsultimet e tilla janë të dobishme për të diskutuar çështjet në thelb dhe për të lejuar ndërveprim ose dialog më të fokusuar. Ato gjithashtu janë thelbësore për përfshirje në procesin e konsultimit të individëve dhe organizatave që nuk kanë kohë dhe burime për të reaguar për dokumentet e publikuara nga administrata.



Figura 84: Përfshirja e organizatave të komunitetit (grassroots organisations) dhe qytetarëve individualë

Shoqëria civile është duke u përfshirë më gjerësisht në hartimin e ligjeve dhe politikave me ndikim. Ka raste të shumta në të cilat organizatat e shoqërisë civile kanë bërë fushatë për të avokuar ndryshime në politikat dhe ligjet. Ato mund të ofrojnë ekspertizën e tyre duke marrë pjesë në grupet punuese për koncept dokumentet.

Meqenëse organizatat e komuniteteve janë afër komunitetit të tyre, konsultimi me to dhe qytetarë individualë mund të jetë shumë i rëndësishëm kur hartohet një koncept dokument. Ky është veçanërisht rasti kur ndikimet mund të ndodhin në një rajon ose qytet të caktuar.

Përfshirja e organizatave të komunitetit dhe qytetarëve individualë mund të jetë shumë e vështirë pasi që ato nuk janë gjithmonë të organizuara në mënyrë konvencionale si OJQ dhe pasi që ato ndoshta nuk kanë një faqe interneti. Megjithatë, shumë organizata të komunitetit dhe individë organizohen përmes lidhjes me rrjetet lokale të OJQ-ve ose rrjeteve sociale si Facebook dhe LinkedIn. Një hulumtim mbi këto dhe platforma të tjera sociale duke përdorur fjalë relevante kryesore dhe tregues gjeografikë mund të ofrojë një pasqyrë të organizatave relevante të komuniteteve dhe qytetarëve individualë. Një diskutim mbi çështjet e trajtuara në koncept dokument do të tregojë shpejt nëse është e rëndësishme të përfshihen grupet dhe individët e identifikuar.

Aktivitetet e konsultimit gjithashtu përfshijnë **organizimin e takimeve, konferencave, seancave dëgjimore** ose ngjarjeve të tjera. Në varësi të rolit që luan konsultimi, këto ngjarje mund të njoftohen gjerësisht dhe të jenë në dispozicion të të gjithë atyre që janë të interesuar. Ato gjithashtu mund të përfshijnë takime për të cilat ftohet një grup i caktuar i palëve të interesuara. Përveç kësaj, intervistat, anketimet dhe sondazhet mund të ofrojnë pikëpamje të dobishme.



Figura 85: Sondazhet ekzistuese

Sondazhet organizohen rregullisht në Kosovë dhe në Ballkan. Disa shembuj janë të listuar në këtë përmbledhje:

Sondazhi i Pulsit të përfundimit publik: sondazhet e synuara dhe fokus grupet që ofrojnë fakte të dorës së parë për perceptimin dhe opinionet e publikut mbi çështjet e hartimit. Puls publik mbulon katër zona standarde: (1) stabiliteti politik dhe institucional; (2) stabiliteti ekonomik dhe shoqëror; (3) marrëdhëniet ndëretnike; dhe (4) siguria publike dhe personale.

Link: http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/operations/projects/democratic_governance/PublicPulse.html

Barometri i opinionit ballkanik: sondazhe për qëndrimet e qytetarëve të vendeve të Ballkanit Perëndimor

Link: <http://www.rcc.int/seeds/results/2/balkan-opinion-barometer>

Barometri i biznesit ballkanik: sondazhe për qëndrimet e bizneseve që operojnë në vendet e Ballkanit Perëndimor

Link: <http://www.rcc.int/seeds/results/3/balkan-business-barometer>

Në mënyrë që konsultimi të jetë efektiv, duhet të kombinohen mjete të ndryshme të konsultimit dhe administrata duhet të sigurohet që të realizohen ndërveprime të rregullta me palët e interesuara. Konsultimi fillon me kontaktimin përmes telefonit me palët e interesuara duke i pyetur ata nëse mendojnë se kanë ndonjë çështje, e cila është me rëndësi për ta. Në shumicën e rasteve, konsultimi është relativisht i lehtë për t'u organizuar. Kërkesat kryesore që duhet të përmbushen janë: koha e mjaftueshme për konsultim; qartësimi i qëllimit të konsultimit; dhe se kontributi i palëve të interesit do të analizohet drejt.

MJETI 22: KOMUNIKIMI GJATË HARTIMIT TË KONCEPT DOKUMENTIT

Komunikimi është thelbësor për zhvillimin dhe zbatimin e politikave. Komunikimi qeveritar është më shumë se sa të emërosh një zëdhënës që do t'iu përgjigjet pyetjeve të gazetarëve, të bësh një komunikatë për shtyp apo të mbash një konferencë me gazetarë. Ai është një instrument i qeverisë gjatë tërë procesit të zhvillimit të politikave. Duhet të merret parasysh në secilin hap të këtij procesi. Komunikimi efikas me publikun ndihmon në vendosjen e bashkëpunimit me qytetarë për të hartuar programin qeveritar, për të kuptuar nevojat reale të qytetarëve dhe për të zhvilluar e zbatuar politika që u përgjigjen nevojave të tyre. Për më tepër, komunikimi efikas e bën vendimmarrjen në qeveri më transparente dhe e rrit llogaridhënien.



Figura 86: Dy funksionet kryesore të komunikimit në shoqëri

Komunikimi është një proces përmes të cilit organizatat lindin dhe zhvillohen. Është proces thelbësor përmes të cilit individët, grupet apo organizatat lidhen me njëri-tjetrin. Komunikimi është i nevojshëm në çdo proces vendimmarrës dhe posaçërisht i rëndësishëm për zhvillimin e politikave.

Dy funksionet kryesore të komunikimit janë dhënia e informacionit dhe bindja e njerëzve për të ndryshuar mënyrën se si punojnë.

Informacioni përbëhet nga faktet, shifrat dhe të dhënat që përpunohen për qëllime të ndryshme. Këto mund të jenë statistika, raporte, diskutime, shembuj dhe çfarëdo lloj të dhënash që shpjegojnë çështjet që duhet të komunikohen.

Bindja bazohet në informacionin dhe në mënyrën në të cilën është komunikuar. Bindja ka për qëllim të ndryshojë apo ndikojë qëndrimet dhe sjelljet. Kjo mund të arrihet me përdorimin e argumenteve më të mira për t'i bindur të tjerët dhe për të fituar.

Qëllimi i përgjithshëm i Qeverisë është të përmirësojë jetën e qytetarëve të vendit tonë. Ajo i mbledh taksat dhe i shpenzon në përputhje me prioritetet politike. Vendimet e Qeverisë ndikojnë në jetën e të gjithëve. Prandaj qytetarët kanë të drejtë të dinë çfarë bën Qeveria dhe si do të ndikojnë vendimet që i merr ajo në jetën e tyre, cilat janë apo do të jenë të drejtat, mundësitë dhe obligimet e tyre.

Komunikimi efikas i shërben qëllimit të përgjithshëm të Qeverisë për të zhvilluar dhe përmirësuar vendin. Që komunikimi të jetë efikas ai duhet të planifikohet, koordinohet dhe të bëhet nga personat përgjegjës, të cilët dinë të përcjellin mesazhin e Qeverisë në kohë të duhur dhe në mënyrë të përshtatshme.

Qasja e koordinuar e komunikimit brenda Qeverisë mundëson komunikim efikas me audiencën e jashtme gjatë procesit të zhvillimit të politikave. Komunikimi i mirë i brendshëm kontribuon gjithashtu që të punësuarit në Qeveri të ndjehen të përfshirë dhe të motivuar për të kryer detyrat në mënyrë efikase. Ai kontribuon gjithashtu në funksionimin më të mirë të Qeverisë në aktivitetet e përditshme

Roli i komunikimit gjatë procesit të zhvillimit të politikave

Komunikimi qeveritar përfshin shumë aktivitete, për shembull:

- dhënie e informatave për publikun,
- shpjegimin e politikave të caktuara, në veçanti të prioritetëve qeveritare,
- ndërgjegjësimin e qytetarëve për efektet që prodhojnë ato politika, dhe
- mundëson ndërveprim dhe komunikim të dyanshëm ndërmjet qeverisë dhe publikut.

Komunikimi i politikave gjatë procesit të zhvillimit të tyre, nënkupton që:

- Qeveria e përfshin publikun në vendimet e ardhshme,
- Qeveria i komunikon vendimet që i merr,
- ndihmon në zgjidhjen e problemeve,
- krijon më shumë mirëkuptim,
- lë hapërisë për më pak pyetje,
- zvogëlon keqkuptimet,
- shpjegon pse nuk janë marrë parasysh sugjerime të caktuara,
- fiton më shumë mbështetje, dhe
- ndihmon në përgatitjen, miratimin dhe zbatimin e politikave.

Kjo mund të arrihet përmes mjeteve të ndryshme të komunikimit, siç janë fushatat vetëdijesuese, diskutimet publike apo tryezat e rrumbullakëta me grupet e synuara (shoqëri të civilë, mësime të ndërkombëta, mjekët, komunitetin e biznesit, mediat...), krijimin e platformave të veçanta për komunikim me publikun, sesionet informuese, përmes konferencave për shtyp, përdorimit të ueb faqeve dhe rrjeteve sociale, teksteve autoriale që reflektojnë pikëpamjet e kryeministrit apo ministrave etj.

Meqenëse konsultimi publik nënkupton pjesëmarrjen aktive në zhvillimin e politikave të qytetarëve, kompanive, organizatave të shoqërisë civile, përfaqësuesve të bizneseve dhe partnerëve për zhvillim, komunikimi i rregullt gjatë këtij procesi është shumë i rëndësishëm. Kjo i mundëson administratës të informojë publikun në mënyrë më efektive për aktivitetet e konsultimeve publike. Rrjedhimisht ofron informatën që i duhet publikut për të marrë pjesë në mënyrë aktive në këto aktivitete të konsultimeve. Tabela më poshtë shpjegon parimet për komunikim të mirë gjatë zhvillimit të koncept dokumentit.



Figura 87: Parimet për komunikim të mirë

Parimet	Shpjegimi	Ndikimi në zhvillimin e koncept dokumentit
I hapur	Në komunikim me qytetarë, është e rëndësishme që Qeveria të jetë e hapur, e qartë dhe e qasshme	Informimi i qytetarëve për politikën e re në fazat e hershme të zhvillimit të saj
Të depërtojë te të gjithë	Qeveria duhet të sigurohet që aktivitetet e saj të komunikimit të arrijnë te të gjithë qytetarët	Përfshirja e sa më shumë qytetarëve të pjesëve të ndryshme të vendit gjatë procesit të zhvillimit të politikave
Përfshirës	Të sigurojë përfshirje të qytetarëve të ndikuar nga politikat e caktuara dhe të pranojë rritjen e besimit të publikut në vendimet e Qeverisë	Marrja parasysh e sugjerimeve të dhëna nga qytetarët për një politikë të caktuar, zhvillimi i aktiviteteve të konsultimit që i mundësojnë një spektri të gjerë të qytetarëve që të jenë të përfshirë
Aktiv	Është përgjegjësi e Qeverisë të komunikojë, të nxisë aktivitete të komunikimit dhe ta bëjë këtë në kohë të duhur për t'i informuar qytetarët për të drejtat e tyre, obligimet dhe mundësitë	Qasje proaktive për të depërtuar te publiku gjatë procesit të zhvillimit të politikave në mënyrë që të angazhojë qytetarët
Koherent	Komunikimi qeveritar duhet të jetë i arsyeshëm dhe i koordinuar	Integrimi i prioriteteve të Qeverisë në procesin e zhvillimit të politikave, planifikimi i mirë i aktiviteteve të komunikimit, duke siguruar që trupat qeveritare relevante janë të përfshira në këto aktivitete të komunikimit dhe mesazhet e ngjarjet janë të përafëruara.

Struktura e komunikimit në Qeveri

Shërbimi për komunikimin qeveritar përbëhet nga nëpunësit civil dhe këshilltarët politikë. Ata janë përgjegjës për të siguruar komunikim efektiv dhe të qartë të politikave dhe aktiviteteve të institucioneve publike për grupet e synuara ose palët e interesuara.

Zyra për Komunikim Publik në ZKM planifikon dhe koordinon komunikimin qeveritar, siguron që zëdhënësi i Qeverisë dhe kryeministri të informohen për çështjet dhe aktivitetet kryesore të Qeverisë, informon publikun lidhur me punën dhe vendimet e Qeverisë përmes zhvillimit të marrëdhënieve me mediat, planifikon zhvillimin e fushatave mediale dhe publicitare, është përgjegjëse për përditësimin e ueb-faqes, ofron raporte të rregullta nga mediat vendore dhe ndërkombëtare për kryeministrin, zëdhënësin e Qeverisë dhe ministrinë.

Zyrat për komunikim publik në ministri ofrojnë përkrahje profesionale për ministrin, zëdhënësin e ministrisë dhe ministrinë, duke ofruar këshilla për efektivitetin e paraqitjes së politikave; bëjnë përgatitjen, mirëmbajtjen dhe zbatimin e planit të komunikimit në bazë të planit të punës së ministrisë, bashkëpunojnë me zëdhënësin e ministrisë për organizimet e konferencave për shtyp dhe intervistave; përpilojnë dhe lëshojnë komunikata për shtyp, deklarata, raporte dhe publikime të tjera për publikun; janë përgjegjëse për përditësimin, sigurimin e qasjes dhe kredibilitetin e informatave në ueb-faqen zyrtare të ministrisë, sigurojnë qasje në informatat që komunikohen, ofrojnë raporte ditore të prezantimit medial të ministrit dhe ministrisë lidhur me politikat dhe aktivitetet që bien në përgjegjësinë e tyre.



Figura 88: Karakteristikat e efikasitetit në komunikimin e politikave:

Karakteristikat e efikasitetit në komunikim	Shpjegimi dhe sugjerimet
1) Identifikimi i audiencës relevante për çështje specifike	Në procesin e hartimit të politikave, koha është e çmueshme. Përcaktimi i qartë i audiencës dhe çështjes për të cilën do të komunikohet, kursen kohën e Qeverisë dhe të publikut. Është e rëndësishme gjithashtu të qartësohet relevanca e informatës për audiencën, për t'u siguruar se një grup relevant i synuar investon kohë të mjaftueshme për të absorbuar mesazhin.
2) Qartësimi i rolit të audiencës	Komunikimi i politikave është më shumë se sa prezantimi i informatave. Gjithashtu duhet të marrë parasysh mundësitë dhe përgjegjësitë e audiencës. Në mënyrë që komunikimi i politikave të ketë ndikim pozitiv, roli i audiencës duhet të qartësohet në mënyrën e duhur (për shembull: të qartësohet nëse audiencia me të cilën është komunikuar kanë qenë qytetarë, ekspertë të fushës, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të komunitetit të biznesit, zyrtarë qeveritarë apo të tjerë). Mesazhi duhet t'i ketë parasysh këto role.
3) Përdorimi i mjetit të duhur të komunikimit	Një sërë mjeteve mund të përdoren për të komunikuar politikën (komunikatë për shtyp, konferencë për media, intervistë, publikim i materialit në ueb-faqe, komunikim interaktiv përmes rrjeteve sociale, debat me audiencën, sesion informues, etj). Mjeti i zgjedhur i komunikimit, gjuha dhe lloji e stili i dokumentit duhet të mbështesin qëllimin e synuar të aktivitetit të komunikimit dhe të përkojë me pritjet e audiencës së synuar.
4) Disenjimi i formës së duhur	Në mënyrë që të nxitet pjesëmarrja e audiencës në procesin e hartimit të politikave, është e rëndësishme që dokumentet të jenë të strukturuara mirë dhe përmbajtja të jetë e qartë dhe e kuptueshme.

MJETI 23: PLANIFIKIMI I KOMUNIKIMIT PËR NJË KONCEPT DOKUMENT

Komunikimi efektiv dhe i dobishëm fillon me një planifikim të mirë të të gjitha aktiviteteve të komunikimit. Komunikimi është i nevojshëm në vazhdimësi gjatë procesit të hartimit të një koncept dokumenti. Ai ndërlihet me procesin e konsultimeve publike që mundëson pjesëmarrjen aktive të qytetarëve dhe kompanive në zhvillimin e politikave. Të gjitha aktivitetet e komunikimit duhet të planifikohen me kohë dhe duhet të përmbajnë:

- » mesazhin kryesor të komunikimit të politikës së re,
- » objektivin kryesor të komunikimit,
- » identifikimin e grupeve të interesuara (kush preket nga ndryshimi i politikës, grupet tjera partnere që ndihmojnë institucionin në zbatim),
- » objektivat specifike për secilin grup të interesit,
- » aktivitetet e komunikimit, kohën e realizimit dhe përgjegjësitë për zbatimin e tyre,
- » mjetet e zgjedhura të komunikimit,
- » indikatorët e arritshmërisë
- » buxhetin e nevojshëm për zbatimin e aktiviteteve të komunikimit.



Figura 89: Hapat për komunikim gjatë procesit të zhvillimit të një koncept dokumenti

Hapi	Shpjegime
Hapi 1	Përfshirja e zyrtarit të komunikimit në konsultimet për planifikimin e koncept dokumentit
Hapi 2	Përfshirja e zyrtarit të komunikimit në grupin punues për hartimin e koncept dokumentit
Hapi 3	<p>Përgatitja e planit të komunikimit në fillim të procesit të zhvillimit të koncept dokumentit, krahas përgatitjes së planit të konsultimit. Komunikimi i procesit të konsultimeve publike do të mbështetet përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> » zhvillimit të mesazheve të duhura lidhur me qëllimin e politikës, për ta bërë atë më të kuptueshëm për grupet kryesore të synuara dhe mediat, » organizimit të konferencave për shtyp / informimit të gazetarëve në fillim të procesit të konsultimeve për të paraqitur draft dokumentet dhe për të shpjeguar metodat e konsultimeve dhe mundësitë që qytetarët, OShC-të dhe palët tjera të jenë të përfshira në këtë proces, » rritjes së mbulimit medial të debateve / takimeve publike mbi koncept dokumentet dhe shpërndarjen e njoftimeve për komentet e dala nga këto diskutime nëpërmjet rrjeteve sociale dhe kanaleve të tjera të komunikimit, » prezentimit të raporteve mbi rezultatet e konsultimeve publike te mediat dhe publiku i gjerë.
Hapi 4	Analiza se si aktivitetet e komunikimit mund të mbështesin qëllimet që Qeveria dëshiron t'i arrijë, integrimi i tyre në planin e zbatimit për koncept dokumentin (shih po ashtu Mjetin 10).
Hapi 5	Për miratimin e koncept dokumentit, përgatitja e një njoftimi për media dhe publikun lidhur me vendimin e Qeverisë për koncept dokumentin dhe hapat e më tutjeshëm.
Hapi 6	Realizimi i aktiviteteve të komunikimit në bazë të planit të zbatimit për koncept dokumentin pas miratimit nga Qeveria.

MJETI 24: PLANIFIKIMI I KOMUNIKIMIT DHE KONSULTIMIT PËR NJË KONCEPT DOKUMENT

Komunikimi dhe konsultimi efektiv dhe i dobishëm fillon me një planifikim të mirë të të gjitha aktiviteteve relevante. Komunikimi dhe konsultimi nuk janë një aktivitet që realizohet vetëm një herë. Është një proces dinamik dhe i vazhdueshëm gjatë procesit të hartimit të një koncept dokumenti.

Të gjitha aktivitetet e komunikimit dhe konsultimit duhet të pasqyrohen në planin e komunikimit dhe konsultimit. Ky plan duhet të përfshijë:

- » qëllimin e aktiviteteve të komunikimit dhe grupeve të synuara;
- » qëllimet e aktiviteteve të konsultimit dhe të grupeve të synuara;
- » ndërlidhjen midis përkufizimit të problemit dhe aktiviteteve të konsultimit;
- » përgatitjen e të gjitha dokumenteve që duhet të prezentohen tek audiencia jashtë administratës;
- » përgatitjen e dokumenteve të konsultimit që do të përdoren përveç draft koncept dokumentit;
- » aktivitetet e konsultimit që do të organizohen dhe si duhet të komunikohen;
- » të gjitha grupet e interesit për aktivitetet e synuara të konsultimit;
- » për palët e interesit, të cilat nuk janë të specializuara për t'iu përgjigjur konsultimeve qeveritare, veprime për të siguruar që ato do të jenë të gatshme të përgjigjen;
- » kohën dhe burimet e nevojshme për të realizuar aktivitete të ndryshme të konsultimit;
- » personin (personat) përgjegjës për zbatimin e planit të komunikimit dhe konsultimit;
- » personat përgjegjës për secilin aktivitetet individual.

Plani i komunikimit dhe konsultimit është gjithmonë specifik për koncept dokumentin për të cilin është bërë. Ai duhet të përgatitet që në fillim dhe duhet të diskutohet gjatë takimit të parë të grupit punues për koncept dokumentin.



Figura 90: Pasqyra skematike për procesin e komunikimit dhe konsultimit për një koncept dokument

Hapi	Shpjegime
Hapi 1	Zhvillimi i planit të komunikimit dhe konsultimit për koncept dokumentin.
Hapi 2	Diskutimi i planit të komunikimit dhe konsultimit gjatë takimit të parë të grupit punues për koncept dokumentin me qëllim të dakordimit për: <ul style="list-style-type: none"> » listën e palëve të interesuara; » listën e planifikuar të aktiviteteve të komunikimit; » listën e planifikuar të aktiviteteve të konsultimit; » ndarjen e punëve për procesin e konsultimit; » përfshirjen e menaxhmentit të lartë dhe politikë në aktivitetet e komunikimit dhe konsultimit.
Hapi 3	Në rast se është relevante për hartimin e koncept dokumentit, komunikoni fillimin e hartimit të tij përmes një njoftimi për shtyp.
Hapi 4	Organizimi i takimit publik me palët që shprehin interesin e tyre për hartimin e koncept dokumentit; ky takim duhet të komunikohet gjerësisht; në rast se hartimi i koncept dokumentit është një prioritet për Qeverinë, duhet të konsiderohet të përfshihet ministri drejtpërdrejt në aktivitetet kryesore të komunikimit dhe konsultimit.
Hapi 5	Organizimi i aktiviteteve të konsultimeve të fokusuara dhe konsultimeve me qasje për publikun: <ul style="list-style-type: none"> » zbatimi i aktiviteteve të dakorduara në planin e konsultimit; » një përmbledhje se si këto aktivitete duhet të komunikohen; » raportimi mbi zbatimin e aktiviteteve të konsultimit gjatë takimeve të grupit punues.
Hapi 6	Konsultimi publik në formë të shkruar përmes portalit për konsultime.
Hapi 7	Analiza e përgjigjeve të ofruara gjatë konsultimit me shkrim.
Hapi 8	Hartimi i raportit për konsultimin publik me shkrim bazuar në metodologjinë dhe formatin e përcaktuar në standardet minimale për procesin e konsultimit publik.
Hapi 9	Publikimi i raportit për konsultimin publik me shkrim.
Hapi 10	Integrimi i përmbledhjes së rekomandimeve relevante, të dala gjatë konsultimeve, në koncept dokument; komunikimi i gjetjeve kryesore nga konsultimi të palët e interesuara që kanë marrë pjesë në procesin e konsultimit dhe në organizata / individë potencialisht të interesuar.
Hapi 11	Komunikoni miratimin e koncept dokumentit bazuar në planin e zbatimit; miratimi i koncept dokumentit gjithmonë duhet të shoqërohet me publikimin e një njoftimi për shtyp.

MJETI 25: SHEMBULLI I PLANIT TË KOMUNIKIMIT DHE KONSULTIMIT

Plani për strukturimin e komunikimit dhe konsultimit jep një përmbledhje për aktivitetet që do të zhvillohen për të përmirësuar cilësinë e një koncept dokumenti. Figura e mëposhtme tregon aspekte të ndryshme që mund të trajtohen në plan.

Plani duhet të mbulojë të dyja aktivitetet, ato të komunikimit dhe konsultimit pasi që të dyja këto janë të lidhura ngusht. Aktivitetet e komunikimit janë relevante për të treguar se Qeveria ka filluar punën në një temë relevante dhe se po zbaton prioritetet e saj. Konsultimi është i rëndësishëm për t'u angazhuar me palët e interesuara dhe për të siguruar që një kontribut i dobishëm për koncept dokumentin është siguruar nga këta aktorë.

Për çdo aktivitet të komunikimit që kryhet për një koncept dokument është thelbësore të kihet parasysh se palët e interesuara gjithashtu do të marrin informacionin që komunikohet. Dhe kur organizohet një aktivitet konsultimi, është thelbësore të kihet parasysh se këto aktivitete duhet të komunikohen siç duhet dhe të përshtaten në qasjen më të gjerë të komunikimit të një ministrie dhe të Qeverisë.



Figura 91: Shembull i planit të komunikimit dhe konsultimit


Procesi i konsultimit synon :

- » përmirësimin e përkufizimit të problemit nëpërmjet konsultimit të fokusuar
- » diskutimin e ndikimeve potenciale me palët e interesuara të prekura
- » marrjen e propozimeve të reja nga palët e interesuara

Qëllimi kryesor	Grupi i synuar	Aktiviteti	Komunikimi/njoftimi	Afati indikativ	Buxheti i nevojshëm	Personi përgjegjës
Informimi i publikut dhe palëve të interesuara rreth fillimit të punës	Publiku dhe palët e interesuara	Publikimi i njoftimit për shtyp	Njoftimi për shtyp	Janar	Nuk ka nevojë	Emri i personit
Rritja e vetëdijesimit për KD	Publiku dhe palët e interesuara	Intervistë me një ministër në televizion dhe radio	Televizion dhe intervistë në radio	Shkurt	Nuk ka nevojë	Emri i personit
Diskutimi i parë me palët e interesuara	Palët e interesuara	Takime publike	Njoftime për shtyp, publikime në web faqen e konsultimeve dhe ftesa përmes e-mailit	Mars	Nuk ka nevojë	Emri i personit



06



PJESA 06: PËRZGJEDHJA DHE PARAQITJA E ZGJIDHJES MË TË MIRË: KRAHASIMI I OPSIONEVE DHE NDIKIMEVE TË TYRE

Duhet të përcaktohet opsioni optimal që do të zhvillohet më tej dhe që do të zbatohet.
Kjo pjesë ju ndihmon:

- Të paraqitni përfitimet dhe kostot përkatëse të opsioneve nëpërmjet statistikave, shifrave dhe numrave konkretë;
- Të paraqitni informacionet në mënyrë logjike dhe të lehtë për t'u kuptuar;
- Të vlerësoni dhe krahasoni opsionet duke u bazuar në vlerën e shtuar që ato ofrojnë.

Gjatë analizës së opsioneve që i mundësojnë Qeverisë të arrijë objektivat specifike mblidhen shumë informacione. Për ata që janë të përfshirë në procesin e përgatitjes dhe analizës së çështjeve, koncepti dokumenti mund të jetë i qartë pasi ata kanë punuar në të që nga fillimi. Megjithatë, personave që nuk kanë qenë të përfshirë në hartimin e konceptit dokumentit duhet t'u paraqitet informacioni në një mënyrë logjike dhe të lehtë për t'u kuptuar.

Ka një numër mjetesh krahasuese që mund të përdoren për të përmbledhur dhe paraqitur të dhënat që janë mbledhur për konceptin dokumentar. Këto mjete shërbejnë gjithashtu për të përcaktuar opsionin optimal, i cili do të zhvillohet më tej dhe do të zbatohet në të vërtetë.

Parakushtet, të cilat duhet të përmbushen për aplikimin e këtyre mjeteve krahasuese janë të ndryshme. Përcaktuesi më i rëndësishëm është nëse përfitimet dhe kostot përkatëse mund të paraqiten përmes statistikave, shifrave dhe numrave konkretë (të referuar edhe si terma kuantitativë/sasiorë). Në një farë mënyre, tema e cila analizohet në konceptin dokumentar, të dhënat që janë në dispozicion dhe kushtet tjera, siç janë koha në dispozicion, udhëzimet politike etj., përcaktojnë në një masë të madhe llojin e mjetit krahasues që mund të përdoret më së miri. Mjetet krahasuese - dhe aplikimi i tyre më i dobishëm - janë paraqitur në pasqyrën e mëposhtme. Këto tri mjete janë: analiza e kosto-efektivitetit (AKE-CEA); analiza e kosto-përfitimit (AKP-CBA) dhe analiza shumë-kriterëshe (ASHK-MCA).



Figura 92: Analiza e kosto-efektivitetit (AKE); analiza e kosto-përfitimit (AKP) dhe analiza shumëkriterëshe (ASHK)

AKE krahason kostot që nevojiten për arritjen e një rezultati specifik. Ajo vlerëson opsionet në bazë të vlerës për para që ato ofrojnë.

AKP krahason opsionet duke llogaritur vlerën monetare të kostove dhe përfitimeve. Ajo vlerëson opsionet bazuar në përfitimet neto.

ASHK është një mjet i paracaktuar që duhet të aplikohet vetëm kur AKE dhe AKP nuk mund të zbatohen dhe duhet të trajtohet me kujdes të shtuar. Ajo përdoret për të krahasuar opsionet që nuk mund të kuantifikohen ose krahasohen lehtë.

MJETI 26: ANALIZA E KOSTO-EFEKTIVITETIT (AKE)

Analiza e kosto-efektivitet (AKE) krahason opsionet në bazë të kostove që nevojiten për arritjen e rezultatit të dëshiruar. Këto rezultate mund të jenë përfitime që nganjëherë është vështirë të kuantifikohen në terma monetare. Kjo vlen, për shembull, për përfitime, siç janë jetëgjatësia e rritur, cilësia e përmirësuar e arsimit dhe ndotja e zvogëluar. AKE tregon “vlerën-për-para” që një opsion bart.

Për një AKE, rezultati i synuar duhet të jetë i qartë dhe lehtësisht i krahasueshëm. AKE është një mjet i dobishëm kur qëllimet dhe objektivat strategjike janë të përkufizuara në hollësi, për shembull kur ato dalin nga një dokument strategjik ose nga një zotim i qartë politik për arritjen e një rezultati specifik. Qasja kërkon të kuptuarit e detajuar të kostos së nevojshme për zbatimin e veprimeve dhe mënyrën se si aktivitetet që financohen do të arrijnë rezultatin e kërkuar.

AKE funksionon më së miri kur ka një pikësnyim kryesor që duhet të arrihet dhe kur ky pikësnyim është i qartë. Pikësnyimi, si i tillë, duhet të mbështetet politikisht dhe të miratohet nga të gjithë akterët e prekur. Kur arrihet objektivi i pritshëm, natyrisht që mund të ketë shumë përfitime shtesë që vijnë prej tij. Ato nuk kanë nevojë të shtohen në AKE, por duhet që gjithmonë të paraqiten në analizën për koncept dokumentin.

AKE gjithashtu mund të kryhet duke caktuar një buxhet maksimal fiks për arritjen e objektivave strategjike ose specifike. Ky buxhet duhet të jetë real dhe kështu që të jetë brenda tavanit buxhetor të një ministrie, përveç nëse Qeveria me propozim të Ministrisë së Financave pajtohet të vërë në dispozicion një buxhet shtesë.

Përmbledhja e mëposhtme paraqet një shembull fiktiv të një analize të kosto-efektivitetit. Kjo mënyrë e prezentimit të informatave mund të përdoret në koncept dokumente.



Figura 93: Shembull i një analize të kosto-efektivitetit

Objektivi i përgjithshëm: zvogëlimi i përqindjes së braktisjes së shkollës në nivel të shkollës fillore

Kosto/përfitimi	Opsioni 1: asnjë ndryshim	Opsioni 2: përshtatja e kurrikulës shkollore	Opsioni 3: rritja e inspektimeve shkollore dhe vizitave te prindërit
Rënia e pritur në shkallën e braktisjes në bazë të analizës	0	mesatarisht 50% për shkollë	mesatarisht 12% për shkollë
Ndryshimet e nevojshme	-	Një mësues shtesë me orar jo të plotë dhe një staf shtesë mbështetës për shkollë	Një inspektor shkolle për shkollë
Kosto	-	8000 euro për shkollë në vit	5000 euro për shkollë në vit
Kosto e përgjithshme shtesë për 1000 shkolla		8 milionë euro në vit	5 milionë euro në vit
Rezultati	Asnjë ndryshim	160.000 euro për çdo rënie në përqindje (8 milionë euro / 50%)	417.000 euro për çdo rënie në përqindje (5 milionë euro / 12%)

Shembulli tregon lidhjen ndërmjet kostove dhe vlerës-për-para që sjellin këto kosto. Megjithatë, nuk nënkupton që automatikisht opsioni më kosto-efektiv - në këtë rast të thjeshtëzuar është Opsioni 2 - është po ashtu opsioni i cili mund të zbatohet.

Faktori i fundit që duhet të merret parasysh është buxheti aktual që është në dispozicion. Kostot e përgjithshme për të gjitha shkollat ende duhet të jenë brenda buxhetit që është në dispozicion për uljen e shkallës së braktisjes së shkollimit. Ky është një vendim, i cili duhet të adresohet edhe në koncept dokument dhe ndërlihet me Mjetin 10: Plani i zbatimit, Mjetin 11: Kostimi për koncept dokumentet dhe potencialisht edhe me Mjetin 12: Përputhja me vlerësimin e ndikimit buxhetor.



Figura 94: Hapat për realizimin e analizës së kosto-efektivitetit

Hapi	Shpjegime
Hapi 1: Identifiko rezultatit që duhet arritur	<p>Analiza e kosto-efektivitetit është një metodë e krahasimit të opsioneve të ndryshme, të cilat kanë për qëllim arritjen e një rezultati specifik. Ky rezultat duhet të jetë i njëjtë për çdo opsion, përndryshe krahasimi nuk mund të bëhet siç duhet. Ky rezultat shpesh mund të lidhet me eliminimin e problemit ose shtytësve apo efekteve të tij më të rëndësishëm.</p> <p>Rezultati, i cili duhet të arrihet, mund të formulohet gjerësisht. Për shembull, zvogëlimi i nivelit të plumbit në një lumë të caktuar për të paktën 50% brenda 5 vjetëve. Ky objektivi mund të arrihet përmes mënyrave të ndryshme, siç është legjislati i nivelin e ndotjes që fabrikat dhe minierat lejohen të shkaktojnë, subvencionet ose stimujt në tatime për instalimin e pajisjeve që parandalojnë ndotjen, zhvendosjen e industrisë, mbylljen e fabrikave/minierave ose opsioneve që janë shumë të ndryshme nga këto.</p>
Hapi 2: Rendit opsionet	<p>Identifiko opsionet e mundshme për arritjen e rezultatit gjatë analizës për koncept dokumentin. Ato gjithmonë duhet të përfshijnë opsionin 'asnjë ndryshim' dhe, nëse opsionet i referohen përmirësimit të kornizës ekzistuese rregullative, gjithashtu edhe opsionin për përmirësimin e zbatimit.</p>
Hapi 3: Përcakto veprimet e nevojshme për zbatim	<p>Opsionet do të ndryshojnë në mënyrën sipas të cilës ato duhet të zbatohen. Për secilin opsion, duhet përdorur Mjetin 10:Plani i zbatimit për të zhvilluar një pasqyrë të detajuar të aktiviteteve që janë të nevojshme për të bërë që një opsion të funksionojë në praktikë. Për AKE, një përmbledhje e këtij plani të zbatimit mund të përdoret në tabelën krahasuese.</p> <p>AKE duhet të marrë parasysh aktivitetet që duhet të zhvillohen nga të gjitha organizatat që ndikohen: ministrinë, komunat, agjencitë, kompanitë, qytetarët etj. Logjika e planit të zbatimit mund të aplikohet për organizatat që nuk janë pjesë e administratës. Kompanitë dhe qytetarët duhet të respektojnë politikën dhe legjislatin. Kjo do të thotë se ata do të duhej të ndryshojnë mënyrën sipas së cilës janë mësuar t'i bëjnë gjërat, ashtu siç duhet ta bëjë këtë edhe administrata.</p>

<p>Hapi 4: Përcakto koston për shoqërinë</p>	<p>Planet e zbatimit sigurojnë bazën për përcaktimin e kostove për secilin opsion. Mjeti 11: Kostimi për koncept dokumentet ofron udhëzimet për këtë gjë.</p> <p>Përveç kësaj, duhet të kalkulohen veprimet që duhet të kryhen nga kompanitë dhe qytetarët, komunat dhe organizatat e tjera. Kjo ofron një pasqyrë të plotë të kostove totale për shoqërinë që lidhen me zbatimin e një opsioni. Mjeti 16: Modeli i kostimit standard ofron një metodë praktike për të përcaktuar kostot që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit. Përveç këtij mjeti, ka mundësi të përdoren edhe metoda të tjera për të përcaktuar kostot. Logjika prapa modelit të kostimit standard ofron një qasje të dobishme për ta bërë këtë.</p>
<p>Hapi 5: Krahaso koston dhe zgjidh opsionin më të mirë</p>	<p>Hapi i fundit në AKE është krahasimi i opsioneve dhe zgjedhja e atij që është (1) më kosto-efektiv (2) është brenda buxhetit të caktuar. Ky mund të jetë ose tavani buxhetor i një ministrie ose buxheti shtesë i alokuar nga Ministria e Financave dhe/ose donatorët për arritjen e rezultatit.</p>

MJETI 27: ANALIZA E KOSTO-PËRFITIMIT (AKP)

Analiza e kosto-përfitimit (AKP) krahason opsionet përmes llogaritjes së vlerës monetare të kostove dhe përfitimeve. Ajo bazohet në mundësinë për të shprehur përfitimet dhe kostot e mëdha në vlera monetare, d.m.th. në euro. Kjo qasje kërkon sasi thelbësore të të dhënave dhe prandaj është më e vështirë se sa AKE. AKP është e dobishme kur opsionet e paraqitura në koncept dokument përfshijnë prezentimin e programeve ose kërkesave ligjore krejtësisht të reja. AKP ofron informata mbi vlerën aktuale të shtuar të nismave të reja.

Avantazhi kryesor i AKP-së është se ajo ofron një krahasim të dobishëm ndërmjet llojeve shumë të ndryshme të ndikimeve të opsioneve. Gjithashtu mund të përdoret për të krahasuar opsionet që do të kontribuonin në arritjen e dy ose më shumë pikësnyimeve.

Ekzistojnë dy lloje të analizës AKP: (1) një “AKP e plotë”, në të cilën të gjitha kostot dhe përfitimet relevante monetarizohen dhe (2) një “AKP e pjesshme”, e cila aplikohet vetëm kur kostot dhe përfitimet më të rëndësishme mund të shprehen në vlera euro.

AKP është shumë e dobishme kur koncept dokumenti adreson mundësinë për të filluar një ndërhyrje krejtësisht të re. AKP tregon vlerën e shtuar të ndërhyrjeve të reja si ‘përfitime neto’ dhe prandaj ofron njohurinë për të vlerësuar nëse ndërhyrjet ia vlejné apo jo.

Faktori i fundit që duhet të merret parasysh është buxheti faktik që është në dispozicion, i cili ndërlidhet me Mjetin10: Plani i zbatimit, Mjetin11: Kostimi për koncept dokumentet dhe potencialisht edhe me Mjetin 12: Përputhja me vlerësimin e ndikimit buxhetor.



Figura 95: Hapat për kryerjen e analizës së kosto-përfitimit

Hapi	Shpjegime
Hapi 1: Rendit opsionet dhe të gjitha përfitimet dhe kostot	<p>AKP radhit opsionet që janë identifikuar gjatë analizës për koncept dokumentin, si dhe të gjitha përfitimet dhe kostot relevante. Opsionet gjithmonë do të përfshijnë opsionin 'asnjë ndryshim' dhe, nëse opsionet i referohen përmirësimit të kornizës ekzistuese rregullative, gjithashtu edhe opsionin për përmirësimin e zbatimit.</p> <p>Qasja prapa AKP është e thjeshtë. Kostot e pritura zbriten nga përfitimet e pritura. Ato që janë të rëndësishme duhet të identifikohen dhe të radhiten në pasqyrën e AKP-së.</p>
Hapi 2: Përcakto vlerën e përfitimeve	<p>Përfitimet janë arsyt prapa politikave dhe legjislacionit. Veprimi i Qeverisë duhet të përmirësojë gjendjen e popullatës, kompanive dhe shoqërisë. AKP vetëm shton vlerën kur përfitimet relevante mund të vlerësohen në mënyrë të duhur në terma monetare. Kjo mundëson të paraqiten të dhënat në një AKP të pjesshme.</p> <p>Për fat të keq, jo gjithmonë është e thjeshtë të shprehen përfitimet në terma monetarë. Përfitimet ekonomike shpesh janë më të lehtë për t'u përcaktuar pasi ka shumë hulumtime dhe përvojë që mund të përdoret. Përfitimet mjedisore mund të vlerësohen kur, për shembull, mund të përcaktohen kostot e ndotjes dhe, si rezultat, përfitimet monetare nga reduktimi i ndotjes mund të peshohen kundrejt investimeve të nevojshme për të arritur këto reduktime të ndotjes.</p> <p>Për një AKP, përfitimet duhet të vlerësohen rregullisht mbi bazën e çdo rasti veç e veç bashkë me supozimet e qarta që qëndrojnë në themel të tyre. Mund të jetë shumë i vlefshëm përdorimi i procesit të konsultimit publik për të mësuar më shumë rreth përfitimeve, supozimeve të arsyeshme që mund të përdoren dhe/ose për të verifikuar të dhënat që janë mbledhur për koncept dokumentin. Gjithashtu mund të merret parasysh edhe krahasimi me analizat e politikave të zhvilluara nga vendet tjera pasi që përfitime të caktuara mund të jenë kuantifikuar diku tjetër tashmë. Mund të zbatohet edhe metodologjia e zhvilluar nga të tjerët, për aq kohë sa ajo përshtatet me kontekstin specifik të Kosovës.</p> <p>Shënim i rëndësishëm: nëse gjatë këtij hapi gjeni se përfitimet përkatëse nuk mund të përcaktohen lehtësisht në terma monetarë, ndoshta është më e dobishme të zgjidhni një mjet tjetër për krahasimin e opsioneve në koncept dokument. Në raste të tilla, një analizë e kosto-efektivitetit ka të ngjarë të jetë më e përshtatshme. Nëse as AKE nuk do të ishte e mundur, duhet të zhvillohet një analizë shumë-kriterëshe.</p>

<p>Hapi 3: Përcakto veprimet e nevojshme për zbatim</p>	<p>Opsionet do të ndryshojnë në mënyrën sipas së cilës ato duhet të zbatohen. Për secilin opsion, Mjeti 10: Plani i zbatimit mund të përdoret për të zhvilluar një pasqyrë të detajuar të aktiviteteve që janë të nevojshme për të bërë një opsion të funksionojë në praktikë. Për AKP-në, një përmbledhje e këtij plani të zbatimit mund të përdoret në tabelën e krahasimit.</p> <p>Një AKP duhet të marrë parasysh aktivitetet që duhet të zhvillohen nga të gjitha organizatat e prekura: ministritë, komunat, agjencitë, kompanitë, qytetarët etj. Logjika e planit të zbatimit mund të aplikohet për organizatat që nuk janë pjesë e administratës, të tilla si qytetarët dhe kompanitë.</p>
<p>Hapi 4: Përcakto koston për shoqërinë</p>	<p>Planet e zbatimit sigurojnë bazën për të përcaktuar koston për secilin opsion. Mjeti 11: Kostimi për koncept dokumentet ofron udhëzime për këtë.</p> <p>Përveç kësaj, duhet të koston veprimet që duhet të kryhen nga kompanitë dhe qytetarët, komunat dhe organizatat e tjera. Kjo siguron një pasqyrë të plotë të kostove totale për shoqërinë që lidhen me zbatimin e një opsioni. Mjeti 16: Modeli i kostimit standard ofron një metodë praktike për të përcaktuar koston që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit. Përveç këtij mjeti, ka mundësi të përdoren edhe metoda të tjera për të përcaktuar koston. Logjika prapa modelit të koston standarde e ofron një qasje të dobishme për ta bërë këtë.</p>
<p>Hapi 5: Krahaso koston dhe zgjidh opsionin më të mirë</p>	<p>Hapi i fundit në AKP është krahasimi i opsioneve dhe zgjedhja e atij që është (1) më kosto-përfituesi dhe (2) është brenda buxhetit të caktuar. Ky mund të jetë tavani buxhetor i një ministrie apo buxheti shtesë i ndarë nga Ministria e Financave dhe/ose donatorët për arritjen e rezultatit.</p>

MJETI 28: ANALIZA SHUMË-KRITERËSHE (ASHK)

Analiza shumë-kriterëshe (ASHK) shpesh është metoda më sfiduese për krahasimin e opsioneve. ASHK përdoret si opson i parazgjedhur/paracaktuar, kur AKE dhe AKP nuk do të ishin të dobishme. ASHK aplikohet kur një politikë synon të arrijë rezultate të shumëfishta ose rezultate shumë të ndryshme, ndërsa përfitimet dhe kostot kryesore nuk mund të shprehen në terma monetarë. Gjithashtu mund të jetë e dobishme kur kostot dhe/ose përfitimet e opsioneve ndikojnë në grupe të caktuara në mënyrë joproporcionale.

Megjithatë, ASHK është komplekse pasi që vendimet që përgatiten bazuar në qasjen e kësaj analize janë të vështira për t'u piketuar dhe mund të jenë shumë subjektive dhe, si pasojë, mund të jenë edhe shumë politike.

Faktori përfundimtar që duhet të merret në konsideratë është buxheti faktik që është në dispozicion dhe lidhet me Mjetin 10: Plani i zbatimit, Mjetin 11: Kostimi për koncept dokumentet dhe potencialisht edhe me Mjetin 12: Përputhja me vlerësimin e ndikimit buxhetor.




Figura 96: Hapat për kryerjen e analizës shumë-kriterëshe

Hapi	Shpjegimi
Hapi 1: Listo opsionet dhe të gjitha përfitimet dhe kostot	Identifikimi i opsioneve të mundshme për të arritur rezultatin. Këto opsione do të identifikohen gjatë analizës për koncept dokumentin. Ato gjithmonë do të përfshijnë opsionin 'asnjë ndryshim' dhe, nëse opsionet i referohen përmirësimit të kornizës rregullatore ekzistuese, po ashtu edhe opsionit për përmirësimin e zbatimit. Përveç opsioneve, duhet të renditen edhe kostot dhe përfitimet.
Hapi 2: Përcakto vlerën e përfitimeve që mund të monetarizohen	Përfitimet janë arsyt prapa politikave dhe legjislacionit. Veprimet e qeverisë duhet të përmirësojnë situatën e popullatës, kompanive dhe shoqërisë. ASHK përdoret sepse përfitimet më të rëndësishme nuk mund të kuantifikohen. Megjithatë, edhe nëse disa përfitime mund të shprehen në terma monetarë, kjo duhet të bëhet prapëseprapë. Nuk ka vegla specifike për të përcaktuar vlerën e përfitimeve. Për fat të keq, është pothuajse gjithmonë më e vështirë të shprehen përfitimet në terma monetarë sesa që është të përcaktohen kostot. Përfitimet shpesh duhet të vlerësohen sipas secilit rast veç e veç, me supozimet e qarta që i mbështesin ato. Mund të jetë shumë e vlefshme të përdoret procesi i konsultimit publik për të mësuar më shumë rreth përfitimeve, supozimeve të arsyeshme që mund të përdoren dhe/ose për të verifikuar të dhënat që janë mbledhur për koncept dokumentin. Krahasimi me analizat e politikave të zhvilluara nga vendet e tjera mund të merret po ashtu në konsideratë pasi që disa përfitime mund të jenë kuantifikuar diku tjetër tashmë. Mund të përdoret edhe metodologjia e zhvilluar nga të tjerët, për aq kohë sa ajo përshtatet me kontekstin specifik të Kosovës.

<p>Hapi 3: Ofro të dhëna shtesë mbi përfitimet jo të kuantifikueshme që janë në dispozicion</p>	<p>Duhet të ofrohet një shpjegim për përfitimet që nuk mund të shprehen në terma monetarë. Ku është e mundur, të dhënat e dobishme duhet të shtohen në tabelën e krahasimit. Këto mund të jenë të dhëna mbi numrin e qytetarëve të prekur pozitivisht, për shembull.</p>
<p>Hapi 4: Përcakto veprimet e nevojshme për zbatim</p>	<p>Opsionet do të ndryshojnë në mënyrën sipas të cilës ato duhet të zbatohen. Për secilin opsion, Mjeti 10: Plani i zbatimit mund të përdoret për të zhvilluar një pasqyrë të detajuar të aktiviteteve që janë të nevojshme për të bërë një opsion të funksionojë në praktikë. Për ASHK-në, një përmbledhje e këtij plani të zbatimit mund të zhvillohet për tabelën e krahasimit.</p> <p>Një ASHK duhet të marrë parasysh aktivitetet që duhet të zhvillohen nga të gjitha organizatat e prekura: ministritë, komunat, agjencitë, kompanitë, qytetarët etj. Logjika e planit të zbatimit mund të aplikohet për organizatat që nuk janë pjesë e administratës, si kompanitë dhe qytetarët.</p>
<p>Hapi 5: Përcakto koston për shoqërinë</p>	<p>Planet e zbatimit sigurojnë bazën për të përcaktuar kostot për secilin opsion. Mjeti 11: Kostimi për koncept dokumentet ofron udhëzimet për këtë.</p> <p>Përveç kësaj, duhet të kostohen veprimet që duhet të kryhen nga kompanitë dhe qytetarët, komunat dhe organizatat e tjera. Kjo siguron një pasqyrë të plotë të kostove totale për shoqërinë që lidhen me zbatimin e një opsioni. Mjeti 16: Modeli i kostimit standard ofron një metodë praktike për të përcaktuar kostot që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit. Krahas kësaj vegje, ndoshta do të duhej të përdoren edhe metoda të tjera për të përcaktuar kostot. Logjika prapa modelit të kostos standarde ofron një qasje të dobishme për të vepruar kështu.</p>
<p>Hapi 6: Ofro të dhëna mbi kostot jo të kuantifikueshme që janë në dispozicion</p>	<p>Duhet të ofrohet një shpjegim për kostot shoqërore që nuk mund të shprehen në terma monetarë. Ku është e mundur, të dhënat e dobishme duhet të shtohen në tabelën e krahasimit.</p>
<p>Hapi 7: Krahaso koston dhe zgjidh opsionin më të mirë</p>	<p>Hapi i fundit në MCA është krahasimi i opsioneve dhe zgjedhja e atij opsioni që konsiderohet mënyra më e mirë për të ecur përpara. Kjo është një zgjedhje që duhet të mbështetet në gjykimin dhe konsultimin profesional. Në fund të fundit, një ASHK nuk ofron një mënyrë të lehtë të krahasimit, siç bën një AKE ose AKP. Përveç kësaj, opsioni më i mirë duhet të jetë brenda burimeve financiare të përcaktuara nga tavani buxhetor i ministrisë. Nga ana tjetër, buxheti shtesë duhet të ndahet nga Ministria e Financave dhe/ose të sigurohet nga donatorët.</p>

//////
07



PJESA 07: PARAQITJA E KONKLUZIONEVE DHE HAPAVE TË ARDHSHËM PËR KONCEPT DOKUMENTIN

Opsioni i preferuar shërben si bazë për hapat e ardhshëm që janë identifikuar në planin e zbatimit. Kjo pjesë ju ndihmon:

- Të renditni masat që rrjedhin nga opsioni i preferuar dhe t'i paraqitni ato në një përmbledhje praktike;
- Të ndërlidhni analizën e politikave të koncept dokumentit me procesin e hartimit ligjor;
- Të përshkruani proceset për monitorim dhe vlerësim, për të vlerësuar efektet reale që dalin nga zbatimi i vendimeve të paraqitura në koncept dokument.

Krahasimi i opsioneve përmes analizës së kosto-efektivitetit, analizës së kosto-përfitimit dhe analizës shumëkriterëshe gjeneron opsionin e preferuar. Ky opsion i paraqitet Qeverisë për miratim. Kur të miratohet, duhet të zbatohet. Kjo nënkupton që opsioni i preferuar shërben si bazë për hapat e ardhshëm që identifikohen në planin e zbatimit.



Figura 97: Hartimi i koncept dokumentit

Një koncept dokument, i cili i dërgohet Qeverisë për miratim, është produkt i gjithë procesit analitik. Teksti për një koncept dokument është shkruar dhe riformuluar derisa analiza është në proces të përgatitjes. Një draft KD është një bazë e shkëlqyeshme për diskutimet brenda grupit punues dhe për shkëmbimin e informacionit me palët e interesuara.

Ndonjëherë, mund të jetë shumë sfiduese për të shkruar një tekst të gjatë që trajton një numër të madh çështjesh. Koncept dokumentet mund të jenë shumë komplekse, veçanërisht kur ato trajtojnë tema shumë të vështira ose mbulojnë disa ligje ose politika në një analizë. Mund të jetë e dobishme të strukturohet teksti në paragrafë të numëruar për të lehtësuar diskutimet në tekst.

Pjesa përfundimtare e koncept dokumentit është pjesa që përmbledh të gjithë punën e investuar në analizë, konsultimin publik dhe konsultimin e brendshëm. Duhet të plotësohet një dokument i veçantë përmbledhës. Për të mundësuar analizën e shpejtë të dokumentit përmbledhës, ai është i vendosur në fillim të koncept dokumentit.

Të dhënat që duhet të shtohen në dokumentin përmbledhës janë të dhënat kryesore që duhet t'i dijë Qeveria në mënyrë që të marrë një vendim. Tabela e mëposhtme tregon të dhënat që duhet të jenë pjesë e dokumentit përmbledhës.



Figura 98: Të dhënat kryesore të përmbledhjes së koncept dokumentit

Përkufizimi i problemit
Objektivat
Opsioni i preferuar
Lloji i përdorur i analizës krahasuese
Ndikimet pozitive të pritshme
Ndikimet negative të pritshme
Ndikimi në kosto dhe buxhet
Përmbledhje e procesit të konsultimit
Hapat e ardhshëm kryesorë nga plani i zbatimit

KONCEPT DOKUMENTI, PJESË PËRBËRËSE NË CIKLIN E ZHVILLIMIT TË POLITIKAVE

Koncept dokumenti është një hap brenda procesit më të gjerë të zhvillimit të politikave dhe legjislacionit dhe përmirësimit të kornizës rregullatore në përgjithësi. Prandaj, duhet të paraqiten dy tema në dokument në mënyrë që lidhja me hapat e ardhshëm të shpjegohet në mënyrë të mjaftueshme.

Baza për hartimin e legjislacionit

Kur koncept dokumenti kërkon hartimin e një ligji të ri, një akti nënligjor ose ndryshimin e rregullave ekzistuese, korniza e synuar për legjislacionin e ardhshëm duhet të bëhet e qartë. Kjo do të thotë se masat ligjore aktuale që duhet të hartohen për të zbatuar opsionin e preferuar duhet të paraqiten në një pasqyrë praktike. Ky vështrim do të jetë fillimi i procesit të hartimit të legjislacionit dhe siguron lidhjen midis analizës së politikave të realizuara për koncept dokumentin dhe procesin e hartimit të legjislacionit. Tabela më poshtë tregon çështjet që duhet të merren në konsideratë për të përgatitur zhvillimin e akteve ligjore pas miratimit të koncept dokumentit.

Ndryshimet e ligjit që shkaktojnë ndryshime në ligje të tjera

Kur si përfundim i një koncept dokumenti del hartimi i një ligji të ri apo ndryshimi i një ligji, kjo mund të nënkuptojë se përfundimisht edhe ligje të tjera do të duhej të ndryshohen në përputhje me kërkesat e reja ligjore. Ligjet që përfundimisht do të duhej të ndryshohen në përputhje me kërkesat e reja ligjore duhet të listohen në koncept dokument . Kur të bëhet kjo, koncept dokumenti paraqet bazën për të gjitha ndryshimet e kërkuara ligjore që do të ndjekin zbatimin e vendimit që paraqet koncept dokumenti.



Figura 99: Koncept dokumenti si bazë për propozimet ligjore

Kur hapi që vijon pas miratimit të koncept dokumentit është hartimi i një ligji ose akti nënligjor, analiza që është kryer është bazë për hartimin e legjislacionit. Për të thjeshtuar punën e ekipit që do të zhvillojë propozimin ligjor, përmbledhja e analizës duhet të tregojë kornizën për tekstin ligjor. Se si duket kjo kornizë, varet nga tema që analizohet në koncept dokument.

Përmbledhja mund të jetë një listë shumë specifike e neneve ligjore dhe akteve nënligjore që duhet të ndryshohen. Kjo ka të ngjarë të jetë rasti kur koncept dokumenti adreson mangësitë specifike rregullative dhe kërkon përmirësimin e kornizës ligjore. Kjo mund të ndodhë edhe kur synimi është zvogëlimi i ngarkesës administrative. Ndryshimet ligjore specifike shpesh janë të mjaftueshme për të arritur një zvogëlim substancial të ngarkesës administrative.

Në rast se kërkohet të zhvillohet një ligj i ri ose një akt nënligjor, korniza mund të jetë e një natyre më të përgjithshme. Analiza e një koncept dokumenti mund të përcaktojë parimet për tekstin ligjor në kuptim të asaj që do të përfshihet. Gjithashtu mund të tregojë se cilat parime duhet të vendosen në ligjin primar ose në një akt nënligjor.

Analiza e kryer në bazë të Mjetit 16: Modeli i kostimit standard ; Mjetit 17: Testi i NVM-ve; dhe Mjeti 18: Testi i konkurrueshmërisë rregullative ofron informacion të drejtpërdrejtë se si duhet hartuar një ligj në të ardhmen.

E rëndësishme është të theksohet se baza për propozimet ligjore duhet të jetë sa më e plotë që të jetë e mundur. Megjithatë, nuk duhet të supozohet se analiza e koncept dokumentit gjithmonë do të ofrojë një pasqyrë të plotë se si duhet të zhvillohen aktet ligjore dhe nënligjore. Në fund të fundit, gjatë hartimit të propozimeve ligjore dhe konsultimeve publike pasuese mbi tekstet e sugjeruara, mund të lindin probleme të reja. Ajo që ka rëndësi është që këto çështje të reja duhet të ballafaqohen me analizën. Kur të kuptohet se ka devijime nga konkluzionet e koncept dokumentit, Qeveria duhet të informohet në mënyrë specifike për këtë situatë. Një koncept dokument i azhurnuar mund të dorëzohet së bashku me projekt propozimin kur paraqitet në Qeveri për miratim.

Koncept dokumenti duhet të përditësohet dhe të dorëzohet për miratim nga Qeveria kur ndryshimet në lidhje me ndikimet e pritura janë të konsiderueshme. Ky është rasti, për shembull, kur ndikimi në buxhet ka ndryshuar ose kur shumë akterë të ndryshëm do të ndikohen nga vendimet nga sa pritej fillimisht.

Monitorimi dhe vlerësimi

Meqenëse vendimi që vijon nga koncept dokumenti duhet të zbatohet, duhet të përcaktohet mënyra në të cilën do të monitorohet zbatimi. Gjithashtu, mund të jetë e nevojshme që të vlerësohen edhe efektet. Kjo vlen veçanërisht në rastin kur ndikimet e pritura janë shumë të rëndësishme.

Pyetjet e rëndësishme duhet të adresohen në mënyrë efektive. Këto janë nëse monitorimi mund të bëhet përmes strukturave ekzistuese të raportimit ose duhet të zhvillohet një skemë specifike e monitorimit. Gjithashtu, indikatorët e përdorur për monitorim duhet të përcaktohen qartë dhe detyrat e institucioneve të përfshira duhet të përcaktohen dhe të dakordohen.

Udhëzuesi për vlerësimin legjislativ është miratuar në vitin 2015 dhe çdo vit kryhen disa vlerësime nën ombrellën e Strategjisë për rregullim më të mirë 2.0. Planifikimi i punës së Qeverisë është zgjeruar dhe ka një fokus afatmesëm. Aktivitetet që janë planifikuar të ndodhin në disa vite të ardhshme mund të shtohen tashmë në planin indikativ të punës së Qeverisë.

Pjesa përmblylëse e koncept dokumentit duhet të përmbajë gjithashtu një përshkrim të qartë në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin. Pasqyra e mëposhtme paraqet disa tema që duhet të merren parasysh. Aktivitetet për vlerësim dhe monitorim duhet të integrohen në planin e zbatimit për opsionin e preferuar të paraqitur në koncept dokument.



Figura 100: Monitorimi dhe vlerësimi për zbatimin e vendimeve që burojnë nga koncept dokumenti

Vendimet që dalin nga koncept dokumenti do të duhej të vihen në funksion. Në praktikë kjo duhet të bëhet nga ministritë, agjencitë ose organet e tjera qeveritare që zbatojnë këto vendime. Ato duhet të sigurohen që (1) të zbatohen politikat dhe kërkesat ligjore; (2) të trajtohet personeli; (3) dokumentacioni i nevojshëm të jetë i disponueshëm për publikun e ndikuar; (4) ndryshimet t'i komunikohen efektivisht audiencës së synuar; etj.

Qasja e monitorimit duhet të identifikojë indikatorët kyç që tregojnë nëse vendimet që pasojnë nga koncept dokumenti po zbatohen aktualisht dhe nëse ato shkaktojnë ndikimet e pritura.

Planifikimi i vlerësimit duhet të lidhet me pyetjen se kur dhe si do të vlerësohen vendimet pasuese nga koncept dokumenti. Kjo duhet të trajtojë çështjen nëse vlerësimi mund të integrohet në një politikë ose vlerësim legjislativ të planifikuar; nëse një vlerësim i veçantë duhet të organizohet brenda pak vitesh pas zbatimit; ose nëse ndryshimet nuk meritojnë një vlerësim të tillë.

Udhëzuesi dhe Doracaku për hartimin e koncept dokumenteve janë përgatitur si pjesë e Projektit për mbështetje në zhvillim të politikave, i cili zbatohet nën përgjegjësinë e Sekretariatit Koordinues të Qeverisë dhe është i financuar nga Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SIDA).



